

KËQYRJA E VENDIT TË NGJARJES ME VËSHTRIM TË POSAÇËM TEK VEPRA PENALE E VRASJES

Besim ARIFI

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në shkencat Juridike
me profil e Drejta Penale, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Irakli Koçollari

Numri i fjalëve: 56756

Tiranë, Maj 2018

DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklaroj me përgjegjësi të plotë se ky disertacion doctoral përfaqëson punimin tim origjinal, duke respektuar rregullat e shkrimit akademik, të kërkimeve shkencore në të cilin janë të përfshira citimet dhe referencat. Burimet e të dhënave në formë informacioni apo të dhënat tjera janë të paraqitura në paragrafët përkatës, po ashtu edhe në pjesën e citimit të literaturës. Punimi nuk është prezantuar dhe nuk është publikuar më herët në asnjë institucion tjetër.

ABSTRAKTI

Ky disertacion me titull: “Këqyrja e vendit të ngjarjes tek veprat penale e vrasjeve”, ka për synim të hulumtojë dhe paraqes në mënyrë sa më përmbajtjesore së çka është vendi i ngjarjes, si zhvillohet këqyrja e tij, si bëhet ruajtja dhe sigurimi i vendit të ngjarjes, çka është dokumentimi i vendit të ngjarjes, duke ditur se gjurmët dhe provat materiale zënë një vend të veçantë në procesin hetimor, në këtë punim gjurmët dhe provat materiale kanë zënë vend të veçantë. Menaxhimi i vendit të ngjarjes në një rast të vrasjes, rolin e prokurorit gjatë procesit të këqyrjes së një vendi të ngjarjes, janë ndër veprimet shumë të rëndësishme, prandaj në këtë disertacion janë paraqitur si hapat kryesor të një hetimi të suksesshëm.

Në këtë disertacion janë trajtuar të gjitha hapat që duhet ndërmarrë për të zhvilluar një këqyrje në nivelin e kërkuar dhe dëshiruar, pasi që këqyrja e vendit të ngjarjes është veprim hetimor i paraparë edhe me ligj. Gjithashtu janë paraqitur edhe mënyra se si kërkohen, gjenden, fiksohen, merren, ekzaminohen dhe paraqiten para gjykatës të gjitha gjurmët dhe provat materiale që gjenden në një vend ngjarje. Një vend të veçantë në këtë disertacion zënë gjurmët dhe provat materiale. Këqyrja e vendit të ngjarjes në përgjithësi dhe atij të veprave penale të vrasjes në veçanti zënë po ashtu një vend të caktuar. Si zhvillohet dhe menaxhohet këqyrja e një vendi të ngjarjes në rastet e vrasjeve, si bëhet këqyrja e kufomave/viktimave, dëshmitarëve në vendin e ngjarjes tek rastet e vrasjeve. Po ashtu në këtë punim është theksuar siguria që i ofrohet viktimës dhe dëshmitarit gjatë procesit hetimor. Për t`a bërë sa më të kompletuar këtë punim janë përdorur metoda përshkruese, metoda e analizës së përmbajtjes, metoda shpjeguese.

Rezultatet nga ky disertacion konfirmojnë faktin se këqyrja e vendit të ngjarjes si veprim hetimor ka rëndësinë e madhe në tërë procesin e hetimit dhe në procedurën penale.

Fusha: E Drejta Penale

Fjalët Kyçe: vendi i ngjarjes, gjurmët dhe provat materiale, menaxhimi i vendit të ngjarjes, vrasja, ekzaminimi.

ABSTRACT

This dissertation entitled "Examination of the scene to the criminal acts of murder", aims to explore and present in the most substantial of which is the scene as developed examination of him, as is done to protect and ensure the scene event, which is to document the scene, knowing that traces and material evidence occupy a special place in the investigative process, this paper trail and exhibits occupy special place. Crime scene management in a case of murder, the prosecutor's role during the examination of a crime scene, are among many important actions, and therefore in this dissertation are presented as key steps to a successful investigation.

In this dissertation are treated all the steps to be taken to develop an insight into the required and desired, as the examination of the crime scene investigation action is foreseen by law. Also they are presented the way sought, found, fixed, handle, and appear before the court examined all traces and physical evidence found at a scene. A special place in this dissertation they have occupied tracks and material evidence. Examination of the scene in general and the offenses of murder in particular also occupied a certain place. Developed and managed as a scene examination of the scene in murder cases, like getting the examination of corpses / victims, witnesses at the scene to murder cases. Also in this paper it stated that security is offered to victims and witnesses during the investigation process. Tinkering at the edges as you did to complete this paper are used descriptive methods, methods of content analysis, explanatory methods.

The results from this dissertation confirm the fact that the examination of the scene as investigative action has a great importance in the whole process of investigation and criminal procedure.

Areas: Criminal Law

Keywords: scene, tracks and material evidence, crime scene management, murder examination.

DEDIKIMI

Këtë disertacion ua dedikoj familjes sime, shokëve, miqve dhe gjithë atyre që më ndihmuan për të arritur deri këtu. Në veçanti këtë punim ua dedikoj prindërvetë mi, nënës dhe babait, motrave dhe vëllait tim të cilët më kanë përkrahur dhe ndihmuar që më sukses ta përfundojë këtë rrugë të nisur. Dedikimi në mënyrë të veçantë është edhe për gruan time dhe fëmijët e mi, të cilët më kanë mbështetur dhe motivuar shumë gjatë tërë kohës sa kam punuar në këtë disertacion.

FALENDERIME

*Është nder, kënaqësi dhe detyrim për mua, që këtu, në këtë fazë të paraqes falënderimin dhe mirënjohjet e mia të gjithë atyre që ishin pranë meje, në këtë rrugëtim të gjatë dhe të vështirë, në realizimin e këtij punimi shkencor. Dua të nënvijëzoj dhe në mënyrë të veçantë ta falënderoj njeriun që më tregoi se si arrihet deri këtu, njeriun që më udhëzoi se si bëhet kjo punë e çmuar dhe shumë e vlefshme, njeriun që pa asnjë hezitim me përkrahje në mënyrë kaq të mirë, njeriun pa të cilin ky punim nuk do ta shihte dritën e diellit, ky pra, është udhëheqësi im, profesori shumë i nderuar dhe i respektuar: **Prof. Dr. Irakli KOÇOLLARI**, të cilit i jam mirënjohës gjithë jetën. Faleminderit profesori im i nderuar!*

Dua t'i falënderoj gjithashtu edhe shokët dhe miqtë e mi të respektuar, të cilët më përkrahën dhe ndihmuan që në hapat e parë të punës në këtë punim. Së fundmi, falënderimi më i veçantë është për familjen time; prindërit e mi, gruan time dhe fëmijët e mi, të cilët në çdo kohë ishin pranë meje dhe më frymëzuan, më dhanë kurajo gjatë gjithë kohës së punimit të këtij disertacioni.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

LISTA E SHKURTIMEVE.....	14
INDEKSI.....	15
LISTA E FIGURAVE DHE TABELAVE.....	16
KAPITULLI I	
1.HYRJE.....	19
1.2 SHTRIMI I PROBLEMIT.....	21
1.3 QËLLIMI I STUDIMIT.....	22
1.4 BURIMET E REFERIMIT.....	24
1.5 PYETJA KËRKIMORE DHE HIPOTEZA.....	25
1.6 METODOLOGJIA DHE METODAT.....	26
1.7 RËNDËSIA E PUNIMIT.....	27

KAPITULLI II: VENDI I NGJARJES DHE SPECIFIKAT E TIJ

2.1 KUPTIMI, IDENTIFIKIMI DHE SIGURIMI I VENDIT TË NGJARJES.....	30
2.2 Kuptimi i vendit të ngjarjes.....	30
2.3 Kuptimi juridik dhe kriminalistik i vendit të ngjarjes.....	31
2.4 Rëndësia kriminalistike e këqyrjes së vendit të ngjarjes.....	38
2.5 Përgatitja për të shkuar në vendin e ngjarjes (masat përgatitore).....	40
2.6 Njoftimi për lokacionin e vendit të ngjarjes (saktësimi i vendndodhjes).....	40
2.7 Verifikimi i ngjarjes.....	40
2.8 Dhënia e instruksioneve për ruajtjen e vendit të ngjarjes.....	41
2.9 Kompletimi i personelit dhe pajisjeve të nevojshme për këqyrjen e vendit të ngjarjes..	41
2.10 Ruajtja e vendit të ngjarjes.....	43
2.11 Sigurimi i vendit të ngjarjes.....	44
2.12 Perimetri i përgjithshëm vendit të ngjarjes.....	49
2.12.1 <i>Perimetri i brendshëm</i>	49
2.12.2 <i>Perimetri i jashtëm</i>	50
2.13 Qendra komanduese.....	50
2.14 Hyrja në vendin e ngjarjes.....	50
2.15 Masat mbrojtëse.....	52

KAPITULLI III: PROCESI I KËQYRJES DHE MBLEDHJES SË GJURMËVE DHE PROVAVE MATERIALE NË VENDIN E NGJARJES

PËRMBLEDHJE E KAPITULLIT III

3.1 Qëllimi i këqyrjes.....	55
3.2 Teknikat e këqyrjes.....	58
3.2.1 Metoda spirale.....	58
3.2.2 Metoda rrethore.....	60
3.2.3 Metoda e zonës.....	60
3.2.4 Metoda rrjetore.....	61
3.2.5 Metoda brezore.....	62
3.3 Mbledhja dhe shënimi i gjurmëve dhe provave materiale.....	63
3.4 Nocioni provë.....	63
3.5 Mbledhja e gjurmëve dhe provave materiale.....	68
3.6 Vlerësimi i gjurmëve dhe provave materiale.....	70
3.7 Përcaktimi i gjurmëve dhe provave materiale.....	71
3.8 Shënimi i gjurmëve dhe provave materiale.....	71
3.9 Krijimi i procesverbalit dhe ruajtja e paketimi i gjurmëve dhe provave materiale.....	72
3.10 Ruajtja dhe paketimi i gjurmëve dhe provave materiale.....	73

KAPITULLI IV: PËRSHKRIMI, SKICIMI, FOTOGRAFIMI DHE MBLEDHJA E GJURMËVE

PERMBLEDHJE E KAPITULLIT IV

4.1 Marrja e shënimeve (procesverbali i këqyrjes).....	78
4.2 Skicimi.....	80
4.2.1 Informatat që përfshihen në skicë.....	81
4.2.2 Pajisjet.....	82
4.2.3 Llojet e skicave.....	82
4.2.4 Metodat e skicimit.....	84
4.3 Fotografimi i vendit të ngjarjes.....	85
4.4 Përpunimi dhe zbulimi i gjurmëve në vendin e ngjarjes.....	87
4.5 Gjurmët dhe kuptimi i tyre.....	87
4.6 Ku duhet kërkuar gjurmët.....	95
4.7 Gjurmët sipërfaqësore dhe ato të thelluara.....	96
4.8 Zbulimi dhe Fiksimi i Gjurmëve.....	97
4.9 Gjurmët e gishtërinjve.....	99
4.10 Sipërfaqet ku gjenden Gjurmët e Gishtërinjve.....	102
4.11 Faktorët dhe kushtet e tërheqjes apo marrjes së gjurmëve të gishtërinjve.....	102
4.12 Llojet e Gjurmëve të Gishtërinjve.....	103
4.13 Standardet e identifikimit të gjurmëve të gishtërinjve.....	103
4.14 Gjurmët e këpucëve dhe gomave.....	105

4.15 Ku duhet kërkuar këto gjurmë.....	107
4.16 Marrja e këtyre gjurmëve.....	107
4.17 Zbulimi dhe marrja e gjurmëve të veglave.....	110
4.18 Veglat.....	110
4.19 Si janë formuar gjurmët e veglave.....	110
4.20 Ndrydhja (shtypja).....	110
4.21 Fërkimi dhe prerja.....	111
4.22 Përsëritja (gjurmë-sharrimi).....	111
4.23 Kombinimi.....	112
4.24 Përcaktimet nga studimi i gjurmëve të veglave.....	112
4.25 Ku gjenden dhe si merren këto gjurmë.....	113

KAPITULLI V: KUPTIMI I VEPRËS PENALE TË VRASJES

PËRMBLEDHJE E KAPITULLIT V

5.1 Përcaktueshmëria ligjore.....	117
5.2 Përcaktimi i momentit të lindjes	118
5.3 Përcaktimi i momentit të vdekjes	119
5.4 Kodi i Procedurës Penale për Këqyrjen dhe Provat	120
5.5 Llojet e veprave penale te vrasjes.....	122
5.6 Mënyra e kryerjes.....	127
5.7 Sipas Motiveve.....	127
5.8 Sipas objektit mbrojtës(viktimës).....	132

5.9 Sipas pasojave	135
5.10 Roli i prokurorit të shtetit në këqyrjen e vendit të ngjarjes në rastet e vrasjeve.....	144
5.11 Detyrat dhe Kompetencat e Prokurorisë Publike.....	147
5.12 Struktura Organizative dhe Juridiksioni i Prokurorit të Shtetit.....	148
5.13 Gjykatat.....	149

KAPITULLI I VI:VEÇORITË E KËQYRJES SË VENDIT TË NGJARJES TEK RASTET E VRASJEVE

PËRMBLEDHJE E KAPITULLIT VI

6.1 Menaxhimi i vendit të ngjarjes së vrasjes.....	155
6.2 Menaxhimi i hetimeve të rastit.....	155
6.3 Përgatitja paraprake.....	156
6.4 Pengesat në menaxhimin e rastit.....	160
6.5 Procedurat dhe rëndësia e tyre në rastet e vrasjeve.....	161
6.6 Mbikëqyrja në rastet e vrasjeve.....	162
6.7 Detyrat pas arritjes në vendin e ngjarjes.....	163
6.8 Zbatimi i ligjeve në fuqi.....	164
6.9 Këqyrja e kufomave në rastet e vrasjeve.....	168
6.10 Këqyrja e plagëve të kufomës në vendin e ngjarjes.....	170

KAPITULLI VII: OFRIMI I SIGURISË PËR VIKTIMËN DHE DËSHMITARIN

PËRMBLEDHJE E KAPITULLIT VII

7.1 Siguria për viktimën.....	179
7.2 Siguria për dëshmitarin.....	181

7.3 Zbulimi, fiksimi dhe marrja e armës së zjarrit në vendin e ngjarjes.....	182
7.4 Kërkimi dhe zbulimi i armës së zjarrit.....	182
7.5 Fiksimi dhe marrja e armës së zjarrit....	182
7.6 Bashkëpunimi me njësitet tjera të specializuara.....	184
7.7 Mjekësia Ligjore.....	185
7.8 Detyrat dhe Përgjegjësit.....	185
7.9 Sigurimi i provave materiale.....	187
7.10 Rregullat e përgjithshme për prova.....	189
7.11 Klasifikimi i provave.....	191
8. PËRFUNDIMI	193

KAPITULLI I VIII

9. KONKLUSIONE.....	195
10. REKOMANDIME.....	199
11. BIBLIOGRAFIA.....	201

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

KRP – Kushtetuta e Republikës së Kosovës

KPRK – Kodi Penal i Republikës së Kosovës

KPPRK- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës

KKP – Komentari i Kodit Penal

KKPP – Komentari Kodit të Procedurës Penale

VN – Vendi i Ngjarjes

PSH- Prokurori i Shtetit

GJPP- Gjykatësi i Procedurës Paraprake

DML- Departamenti i Mjekësisë Ligjore

KPRSH- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

KPPRSH – Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë

KPRM – Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë

KPRS – Kodi Penal i Republikës së Sllovenisë

CSI – CrimeSceneInvestigation

FBI – Federal Bureau of Investigations

INDEKSI

Vendi i Ngjarjes – Vendi, ambienti, terreni ku dyshohet se ka ndodhur krimi, në të cilin gjenden gjurmë, lëndë, prova apo dëshmi me interes për të ndihmuar hetimin dhe dokumentimin e ngjarjes.

Kodi Penal - Është infrastrukturë juridike kryesore e policisë, prokurorisë dhe gjykatave dhe është përmbledhës i normave juridike me karakter penal dhe të kundërvajtjes.

Kodi i Procedurës Penale – Është një përmbledhës i rregullave dhe procedurave që zbatohen nga strukturat e prokurorisë, gjykatave e policisë në gjurmimin, hetimin apo gjykimin e rasteve penale.

Këqyrja e Vendit të Ngjarjes – Është proces ligjor që kryhet nga specialistë të Forenzikës për vëzhgimin, qëmtimin, fotografimin, skicimin, matjen dhe mbledhjen e gjurmëve dhe provave materiale në një terren apo ambient ku dyshohet se ka ndodhur një akt kriminal.

Ekspert të Këqyrjes - Specialist që thirret për të dhënë mendime e vlerësime të përpikta për vendin e ngjarjes, gjurmët dhe provat materiale që gjenden në atë vend, për të zgjidhur një çështje e cila kërkon njohuri specifike dhe përgatitje të posaçme në këtë fushë.

Rikonstruksioni i Vendit të Ngjarjes – Rikrijim i fakteve me vendosjen e të gjitha provave materiale nëpër të njëjtat vende ashtu siç janë gjetur në momentin e këqyrjes së vendit të ngjarjes.

Veprim Hetimor – Veprim që bëjnë organet e ndjekjes me qëllim të zbulimit të fakteve dhe sigurimit të tyre, për të zbardhur të vërtetën lidhur me rastet e caktuara.

Gjurmë - Me gjurmë kuptojmë shenjat, nga të cilat mund të njihet fakti dhe ngjarja që na dërgojnë tek autori. Gjurmët mund të lindin apo të shkaktohen nga veprimet e njerëzve, shtazëve dhe objekteve, e ndonjëherë edhe nga veprimi i bimëve. Fjala është për ndryshimin material në realitetin objektiv, në raport me gjendjen ekzistuese para ndryshimeve, përkatësisht para tentimit apo kryerjes së veprës penale.

Dëshmitë – Dëshmi llogaritet gjithçka që i dorëzohet gjykatës në mënyrë legale për të vërtetuar ndonjë çështje të caktuar.

Fiksimi i gjurmëve – Pjesë e procesit të këqyrjes së vendit të ngjarjes për të bërë evidente gjurmët apo prova materiale që konsiderohen si dëshmi apo prova të mundshme për ngjarjen.

Mikrogjurmët – Janë shenja apo gjurmë, të cilat është vështirë të dallohen apo identifikohen me vështrim të lirë dhe për identifikimin apo fiksimin e tyre lipsen mjete kriminalistike si: lenta, mikroskop, ndriçues etj.

Figura e Veprës Penale – Nënkuptohet tërësia e elementeve të posaçme, të cilat duhet të shprehen në veprën penale të caktuar. Këto elemente të posaçme, të cilat ndryshe quhen edhe tipare, sajojnë veprën penale të posaçme, sajojnë autonominë e saj, e cila e dallon prej veprave tjera penale. Elementet e posaçme të çdo vepre penale përmenden në dispozitën e normës penale-juridike. Me figurë të veprës penale duhen nënkuptuar ato elemente, të cilat duhet të shprehen në veprimin e njeriut për t'u konsideruar se është kryer vepra penale, ta zëmë, vepra penale e vjedhjes përbëhet prej këtyre elementeve të posaçme: marrjes së pasurisë së huaj të luajtshme me qëllim përvetësimin e saj, që t'i sjellë vetes ose tjetrit fitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme (Ismet SALIHU, Hilmi ZHITIJA, Fejzullah HASANI, KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, KOMENTAR Botimi I, 2014, faqe 27).

Traseologji – shkenca që studion gjurmët.

Poroze – sipërfaqe që thithë lagështinë siç është letra.

Jo poroze – sipërfaqe që nuk thithë lagështinë, siç janë sipërfaqet e forta plastike.

Mullazhim – procesi i marrjes së gjurmëve të këpucëve dhe gomave duke përdorur gurin dental në procedurat e parapara në udhëzimin e tij.

Balistikë – shkenca që studion armët dhe lëvizjen e predhave në tytë dhe jashtë saj.

Lista e Figurave dhe tabelave

Fig. 1.....masat mbrojtëse

Fig. 2.....metoda spirale

Fig. 3.....metoda rrethore

Fig. 4.....metoda e zonës

Fig.5.....metoda rrjetore

Fig.6.....metoda brezore

Fig.7.....etiketa e provave

Fig. 8.....pajisjet për paketimin e provës

Fig. 9.....pajisjet për marrjen dhe shënimin e provave

Fig. 10.....skica dydimensionale

Fig.11.....skica tredimensionale

Fig.12.....vijat papilare

Fig.13.....gjurmët e gishtërinjve (prerja e tërthortë)

Fig.14.....vijat papilare në sipërfaqen nën gishtore

Fig.15.....gjurmët e këpucëve pas marrjes dhe mostra standarde

Fig.16.....pajisjet për marrjen e gjurmëve të këpucëve

Fig.17.....përgatitja e materialit për mullazhim

Fig.18..... gjurmët dydimensionale

Fig.19.....ndrydhja nga goditja me çekan

Fig.20.....veglat për prerje

Fig.21.....sharrimi në hekur

Fig.22.....sharrimi në dru

Fig. 23.....veprimi i veglës

Fig.24.....kaçavidat

Fig. 25.....mikrosili me shpatullat dhe letrën e fortë

Tab.1tabelë nga Henry C.Lee, MaterijalniTragovi, 1998, Zagreb

Foto. 1....Gazërat që liron arma në momentin e shkreptjes dhe daljes së predhës nga tyta

Foto 1,2,3,4vrima hyrëse dhe dalëse, rasti i parë

Foto 1,2,3,4vrima hyrëse dhe dalëse, rasti i dytë

KAPITULLI I

1. HYRJE

Ky punim paraqet njërën ndër sfidat kryesore të punës që bëjnë ekipet hetimore lidhur me atë që quhet Vendi i Ngjarjes. Në këtë punim është paraqitur gjerësisht ajo se çka në të vërtetë është vendi i ngjarjes. Duke ditur se krimet mund të ndodhin kudo e kurdo, atëherë kemi edhe vende të ndryshme të ngjarjes që ndodhin nëpër lokacione të ndryshme. Sigurisht, sfida kryesore për profesionistët gjatë punës në terren është këqyrja e vendit të ngjarjes, që ngërthen në vete taktikat dhe teknikat e saj.

Se këto taktika dhe teknika janë të rëndësishme, tregon fakti se të njëjtat zënë një vend të konsiderueshëm në këtë punim. Ruajtja dhe sigurimi i vendit të ngjarjes është pothuaj çështje kryesore që ka të bëjë me ecurinë e gjithë rastit të këqyrjes në përgjithësi. Metodatat e këqyrjes janë gjithashtu njëra prej çështjeve kryesore që duhet të ndërmerren gjatë punës në këqyrjen dhe hetimin e vendit të ngjarjes. Për të kryer një këqyrje të suksesshme, ekipi që e zhvillon atë, duhet të ketë kujdes të veçantë edhe në dokumentimin e vendit të ngjarjes. Dokumentimi paraqet, pothuaj, pjesën kryesore të punës në atë vend të ngjarjes. Me dokumentimin e vendit të ngjarjes kemi bërë të gjitha shkrimet, shënimet, skicat, fotografitë etj. Kjo kërkon një angazhim të madh të një grupi, gjithashtu, të madh ekspertësh që punojnë pa u ndalur në të.

Gjurmët dhe provat materiale zënë një vend të veçantë në procedurën penale, sepse ato së pari kompletojnë rastin e pastaj sjellin para organeve te ndjekjes fakte relevante lidhur me rastin dhe për këtë arsye janë trajtuar me kujdes të veçantë në këtë punim. Si edhe të gjitha gjurmët dhe provat materiale që gjenden në një vend të ngjarjes ashtu edhe gjurmët e gishtërinjve kanë rëndësinë e vet për sa i përket argumentimit se personi i caktuar ka prekur objektin e dhënë. Ekzaminimi i tyre është njëri ndër hapat kryesor i hetueseve të vendit të ngjarjes dhe i njëjti është paraqitur edhe në këtë punim. Rëndësi të madhe, gjithashtu kanë edhe dëshmitë apo provat tjera materiale që gjenden në vendin e ngjarjes. Ndër këto, prova të rëndësishme janë edhe gjurmët e veglave dhe gjurmët e këpucëve dhe gomave, të cilat nëse kërkohen në mënyrë të duhur, gjenden dhe merren në mënyrë të

duhur, atëherë patjetër do të japin një rezultat të kënaqshëm sa i përket punës së grupit hetimor. Si kërkohen, gjenden dhe ekzaminohen këto gjurmë janë të paraqitura në mënyrë të detajuar në këtë punim.

Vepra penale e vrasjes është një ndër veprat më të rënda që njeriu mund ta bëjë. Kur kemi parasysh se me rastin e kryerjes së kësaj vepre, njeriu humb gjënë më të rëndësishme që ka, pra humb jetën, atëherë mund të konstatojmë se hetimi i këtyre veprave është i një rëndësie shumë të madhe. Këto vepra penale janë të parapara me ligjet në fuqi dhe në të gjitha vendet janë të dënueshme dhe të njëjtat sanksionohen me ligj. Në këtë punim sa i përket veprave penale të vrasjeve, paraqiten format e kryerjes, mënyrat e kryerjes dhe parashikimi i tyre në ligj dhe me kodet penale e të procedurës penale. Gjithashtu, punimi paraqet edhe rolin e rëndësishëm dhe të patjetërsueshëm edhe të policisë, e cila është ndër organet e para që merret me këtë lloj të veprave penale. Pastaj, vend të rëndësishëm në këtë punim zë edhe roli i prokurorit të shtetit si dhe gjykatave dhe agjencioneve tjera që merren me luftimin e kësaj dukurie të dëmshme për shoqërinë. Që këto vepra të parandalohen dhe të gjithë ata që kryejnë këto vepra të vetëdijesohen, atëherë në këtë drejtim, rol të veçantë ka edhe prokurori dhe gjykatat, të cilat duke shqiptuar dënimet e merituar për të gjithë kryerësit e këtyre veprave penale, mund të themi se luajnë një rol të patjetërsueshëm edhe parandalues. Gjithë puna e tyre bazohet në ligjet e zbatueshme dhe ligjet që janë në fuqi; së pari për një ndjekje të bazuar gjithnjë në dyshime reale, të provuara me fakte dhe argumente të forta, si dhe me një dënim meritator nga gjykata, për të gjithë ata që kryejnë këto vepra, po gjithnjë duke u bazuar në gjykim të drejtë, prova e fakte, në mënyrë që dënimi që do ta marrë autori i veprës penale të jetë meritator.

1.2 Shtrimi i Problemit

Të gjithë ne, jemi dëshmitarë se vitet e fundit, është rritur numri i krimeve penale. Ndër çështjet kryesore që janë analizuar dhe studiuar në këtë punim janë:

- Të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me hetimin e vendit të ngjarjes në përgjithësi dhe veprave penale të vrasje me theks të veçantë. Pra, rëndësia e hetimit të vendit të ngjarjes në kuptimin kriminalistik dhe juridik, si dhe rëndësia që ka ky veprim hetimor në gjithë procesin e hetimit të rastit. Përdorimi i metodave më bashkëkohore për kërkimin, gjetjen, skicimin, fotografimin, dokumentimin e vendit të ngjarjes në rastet e vrasjeve.
- Prezenca e gjurmëve dhe provave materiale në një vend të ngjarjes është e pa diskutueshme, atëherë si analizë dhe studim të këtij punimi, është shtruar edhe ekzaminimi i gjurmëve dhe provave materiale në përgjithësi, por me theks të veçantë të gjurmëve të gishtërinjve, gjurmëve të veglave, këpucëve dhe gomave. Që ky proces hetimor të ketë ecurinë e duhur si objekt studimi në këtë punim, kemi marrë edhe
- Dokumentimin e vendit të ngjarjes, duke paraqitur përparësitë që ka një veprim i tillë në përmbushjen e gjithë objektivave që ka grupi hetimor në procesin e këqyrjes dhe hetimit të vendit të ngjarjes. Si problem tjetër që është shtruar në këtë punim, është edhe
- Procesi i menaxhimit të hetimeve në vendin e ngjarjes në rastet e vrasjeve, duke shtjelluar të gjitha sfidat që ka hetimi i një vendi të ngjarjes në veprat e tilla. Menaxhimi i rasteve të vrasjeve është një proces me plot sfida, që kërkon një staf të përgatitur mirë si në aspektin e njohurive të përgjithshme, ashtu edhe në atë të njohurive specifike, pasi që për të hetuar një rast të tillë, nevojitet një personel i trajnuar mirë, që ka aftësi dhe shkathtësi në kryerjen e këtyre detyrave të rëndësishme.

- Përparësitë dhe mangësitë që kanë ekipet hetimore sa i përket bashkëpunimit në mes të agjencioneve të cilat merren me luftimin, ndjekjen e autorëve të veprave penale

1.3 Qëllimi i studimit

Ky studim ka si objektiv të evidentoj rëndësinë që merr në kohët moderne studimi i kujdesshëm i vendit të ngjarjes, veçanërisht në rastet e vrasjes. Në fokusin e këtij studimi janë hetimi i vendit të ngjarjes dhe arritjet më të reja sa i përket këqyrjes së tij dhe të veprave të vrasjeve. Qëllimet kryesore të këtij punimi janë:

1. Të trajtojë këqyrjen e vendit të ngjarjes, me të gjitha specifikat, karakteristikat, veçoritë që qojnë në zbulimin e autorëve të këtij lloji të krimit që është pranishëm dhe i dëmshëm për shoqërinë në Kosovë dhe mëtej.

2. Prezantimi i arritjeve të fundit duke u bazuar edhe në eksperiencën e autorit, sa i përket hetimit të vendit të ngjarjes në përgjithësi dhe atë të vrasjes në veçanti dhe jo vetëm kaq. Gjithashtu edhe të rejat e fundit sa i përket mënyrës dhe formave të: zbulimit, ndjekjes dhe kapjes së autorëve të veprës penale të vrasjes si dhe menaxhimit të vendit të ngjarjes në rastet e vrasjeve. Po ashtu edhe praktikat, eksperiencat, gjetjet dhe shembujt e autorit si ekspert kriminalist.

3. Qëllim tjetër i këtij punimi është edhe kuptimi i rëndësisë së madhe që ka këqyrja e vendit të ngjarjes në procesin e hetimit të rasteve, e cila pa dyshim se kryhet nga specialist të Forenzikës të cilët si qëllim të tyre kanë vëzhgimin, qëmtimin, fotografimin, skicimin, matjen, mbledhjen e të gjitha gjurmëve dhe provave materiale që gjenden në atë terren apo mjedis ku dyshohet se është kryer një akt kriminal.

4. Qëllim tjetër i këtij punimi është prezantimi i teknikave dhe teorive bashkëkohore mbi reja që sot ofron bota moderne për teknikën dhe mjetet që përdoren në lëmin e kriminalistikës në përgjithësi dhe të këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe hetimin e veprave të vrasjes në veçanti.

5. Pastaj, qëllim tjetër i këtij punimi është edhe fakti se këtu bëhen të njohura eksperimentet të cilat i kryejnë ekipet vendore të këqyrjes si dhe prezantimi i teorive bashkëkohore, duke pasur parasysh që bota moderne ka evoluar mjaft mirë në këtë drejtim. Prezantimi i mjeteve dhe teknikave të reja që aplikohen nëpër botë në kohën e tanishme, zë një vend të konsiderueshëm në këtë punim.

6. Duke ditur rëndësinë që ka bashkëpunimi me agjencionet tjera të luftimit të krimit, ky punim qëllim tjetër ka edhe sqarimin e bashkëpunimit në mes të këtyre agjencive si dhe rolin e tyre në procesin hetimor.

7. Qëllim tjetër po ashtu ka edhe interpretimin e gjurmëve dhe provave materiale që gjenden në vendin e ngjarjes dhe të shpallë se cilat janë metodat më produktive në praktikat e këqyrjes së vendit të ngjarjes.

8. Qëllim tjetër i këtij studimi është edhe arritja e objektivave në plasimin e këtij materiali tek ata të cilët punojnë nëpër organet e ndjekjes së krimit.

9. Duke mos anashkaluar edhe rolin që ka policia, prokuroria dhe gjykata, në procesin ligjor të hetimit të krimit dhe duke pasur parasysh ndihmën që ata ofrojnë në këtë proces, si qëllim tjetër të këtij studimi, jam përpjekur që ta bëjë sa më të kuptueshëm këtë punim edhe për ata që kanë rastin ta lexojnë.

1.4 Burimet e Referimit

Për realizimin e këtij qëllimi/punimi janë shfrytëzuar burime dhe autorë të njohur dhe të rëndësishëm në fushën e Forenzikës si: Bary Fisher, Veron Geberth, Henry LEE, Charles SWANSON, Neil CHAMELIN, Leonard TERRITO, Keith Inman, Norah Rudin. Gjithashtu, burimet e shfrytëzuara në këtë punim paraqesin literaturën tonë të çmuar, kryesisht monografi dhe tekste të fushës penale, në veçanti të kriminalistikës, të profesorëve të respektuar si: prof.dr. Ilir MANDRO, dr. Estref MIFTARI, prof.dr. Sokrat MEKSI. Burim tjetër kam pasur edhe literaturë nga profesorët: prof.dr. Ismet SALIHU, prof.dr. Ejup SAHITI, prof.dr. Rexhep MURATI, prof.acc.dr.Luan VELIÇOTI si dhe konsultimet e bisedat në formë interviste që kam pasur me disa profesor dhe njohës të kësaj fushe siç janë: prof.acc.dr. Luan VELIÇOTI, dr. Arsim GËRGJALIU. Burimin tim kryesor e kam pasur prof.dr. Irakli KOÇOLLARI, nga i cili kam marrë të gjitha shkrimet, botimet teorike me karakter juridik e konsultat e ndryshme e të shumta. Nga literatura e huaj, kam shfrytëzuar kryesisht literaturë amerikane, pasi që jam trajnuar nga ekspertë amerikanë për një kohë të gjatë dhe kam ndjekur trajnime të ndryshme të organizuara nga Departamenti Amerikan i Shtetit, Byroja Federale e Hetimit (FBI), pastaj programet e trajnimeve të ndryshme nga ICITAP, OSCE, UNMIK, KFOR etj. si dhe përvoja ime gjatë punës së përditshme në terren.

Si burim themeltar të këtij studimi, jam munduar ta paraqesë përvojën time 18 vjeçare në fushën e hetimit të krimit në përgjithësi dhe në atë të hetimit të vendit të ngjarjes në veçanti. Duke u bazuar në këtë eksperiencë, jam munduar t'i paraqesë të rejtat e fundit sa i përket hetimit të vendit të ngjarjes dhe hetimit të veprës penale të vrasjes.

Nga artikuj dhe shkrime të ndryshme nëpër revista dhe burime nga interneti, kam shfrytëzuar relativisht pak, sepse kam konsideruar se burimet nga librat dhe dokumentet zyrtare në njërën anë dhe pasqyrimi i punës sime praktike në anën tjetër, janë më të vlefshme dhe më të çmuara.

Burime tjera ndihmëse, që ky punim të marrë formën e kërkuar shkencore kanë qenë Ligjet dhe Kodet Penale, Kodet e Procedurave Penale, vendimet e gjykatave etj.

1.5 Pyetjet Kërkimore dhe Hipoteza

Gjatë cilit do punim shkencor, pyetjet kërkimore kanë rëndësi të veçantë sepse ato sistemojnë procesin kërkimor. Ky punim do të synojë të jap përgjigje të qartë në këto pyetje:

1. Cilat janë problemet, vështirësitë dhe sfidat në hetimin e një rasti të vrasjes dhe procesi i këqyrjes së vendit të ngjarjes tek këto vepra?
2. Si bëhet kërkimi, fiksimi, marrja, ruajtja dhe ekzaminimi i gjurmëve dhe provave materiale në vendin e ngjarjes?
3. Cilat hapa duhet të ndjekin ekspertët gjatë hetimit të vrasjeve në një vendngjarje?

Hipoteza: Qasja kualitative e ekspertëve të këqyrjes së vendit të ngjarjes kërkon njohuri dhe përgatitje profesionale, që mundësojnë ndjekjen, zbulimin dhe kapjen e autorëve të veprës penale. Përdorimi efikas i metodave të këqyrjes së vendit të ngjarjes sjell si rezultat uljen e numrit të veprës penale të vrasjes.

1.6 Metodologjia dhe Metodat

Metodologjia e kërkimit në këtë punim shkencor, mbështetet kryesisht në përvojën që ka autori gjatë punës së tij shumë vjeçare, trajnimet e shumta që ai ka në këtë fushë, legjislacionin penal si dhe praktikën gjyqësore. Metodat e përdorura në këtë punim janë:

- **Metodës krahasuese**, duke pasur parasysh se autori i këtij punimi ka një eksperiencë të gjatë në këtë fushë, prandaj është përdorur kjo metodë duke krahasuar eksperiencën që ai ka në njërën anë, me përvojat dhe praktikën e autorëve të huaj në anën tjetër. Gjithashtu është krahasuar punapraktike që zhvillojnë ekspertet në vende të ndryshme të botës, veçanërisht në SHBA, me punën që zhvillohet tek ne. Kjo është bazuar në faktin, pasi që autori ka një mori trajnimesh të organizuara nga agjencionet dhe programet e ndryshme të këtyre vendeve. Krahasimi i këtyre praktikave gjithmonë ka si bazë përshtatshmërinë e kushteve dhe rrethanave ekzistuese në të cilat grupet hetimore punojnë tek ne.
- **Metoda përshkruese**, kjo metodë është përdorur duke përshkruar ndonjë ngjarje të ndodhur nga praktika e autorit apo duke përshkruar ndonjë situatë në të cilën është gjetur grupi hetimor gjatë punës së përditshme.
- **Metoda e analizës**, duke përdorur këtë metodë, janë analizuar dhe studiuar në mënyrë të hollësishme të gjitha situatat që grupi hetimor ka hasur gjatë punës së përditshme në terren. Gjithashtu janë analizuar edhe gjetjet e reja të cilat janë paraqitur në këtë punim.
- **Metoda shpjeguese**, edhe kjo metodë është përdorur duke i shpjeguar të gjitha çështjet e rëndësishme në mënyrë sa më të kuptueshme dhe më të hollësishme, gjithmonë duke u bazuar në eksperiencën e autorit, por pa lënë anash në asnjë moment literaturën tonë dhe atë të huaj. Gjithashtu janë shpjeguar edhe çështjet qëndërlidhën me punën praktike, eksperiencën si dhe harmonizimin që kanë këto me ligjet në fuqi.
- **Intervistë me profesionistë, njohës dhe studiues të kësaj fushë**, gjatë intervistave me njohës dhe profesionist të fushës, duke u bazuar në eksperiencën dhe përvojën

tyre, janë shtjelluar çështjet me rëndësi të veçantë sa i përket hetimit të këtyre veprave. Këta janë profesor të nderuar, njohës dhe ekspert të ndryshëm të kësaj fushe.

1.7 Rëndësia e Punimit

Që në fillim duhet thënë se ky studim, do të ofroj përvojë praktike e njohuri teorike në lidhje me rëndësinë që ka këqyrja e vendit të ngjarjes në përgjithësi dhe e rasteve të vrasjeve në veçanti. Hulumtimi do të ofroj informacione të freskëta dhe fakte të çmueshme për zhvillimet e fundit në këtë fushë. Rëndësia e këtij punimi është se autori gjatë punës së tij ka përmbledhur dhe shfrytëzuar, respektivisht ka shfletuar e krahasuar literaturë moderne dhe mjaft të pasur me informacione sa i përket kësaj fushe.

Ky punim do të shërbejë dhe kontribuojë në luftën kundër krimit, parandalimit të tij, dokumentimit shkencor, zbulimin dhe ndëshkimin ligjor të autorëve të tij. Duke e njohur faktin se vepra penale e vrasjes është një dukuri që ndodh, fatkeqësisht shpesh, atëherë ata që merren me hetimin e kësaj vepre penale do të kenë mundësinë ta kenë në dorë një material mjaft interesant dhe mjaft të rëndësishëm për ta. Ky punim është bazuar në hulumtime të shumta të përzgjedhura rreth hetimit të vendit të ngjarjes, aplikimit dhe përdorimit të metodave praktike të vendeve të ndryshme të botës, duke marrë për bazë praktikatat më të mira të tyre. Këto praktika përfshijnë punën në terren të ekipeve me të cilat unë personalisht kam pasur rastin të punoj dhe të ndjek trajnime nga më të ndryshmet. Këto praktika përfshijnë por jo vetëm: eksperiencën në fushën e luftimit të krimit në SHBA, Angli, Gjermani, Itali etj. Këto praktika, kolegët/ekspertët me të cilët unë kam pasur rastin të punoj, në terren i kanë shpërndarë tek ne, në mënyrën më të mirë.

Përveç kësaj, është me rëndësi të theksohet se këto praktika kanë ardhur tek ne nga njerëzit më kompetent që mund të jenë: oficerë të policisë me përvojë të gjatë të punës, ekspert që nga niveli i parë deri tek niveli i FBI-së, ekzaminues të ndryshëm të cilët kanë ardhur nga laboratorët më eminent të SHBA-ve, Anglisë etj., të cilët kanë demonstruar përvojën tyre në hetimin e vendit të ngjarjes dhe ekzaminimin e gjurmëve dhe provave materiale që gjenden aty.

Pra, ekzaminimi i gjurmëve dhe provave materiale është njeri nga hapat kryesor që ekipi hetimor i bën gjatë fazës së dokumentimit dhe hetimit të rastit dhe në këtë drejtim ata kanë meritat e tyre të padiskutueshme, duke përcjellë tek ne gjithë ato njohuri të tyre dhe duke na trajnuar në mënyrën më të mirë të mundshme. Përdorimi i mjeteve dhe teknikave të ndryshme për kërkimin, gjetjen, marrjen dhe ekzaminimin e të gjitha gjurmëve dhe provave materiale është, pothuaj, hapi kryesor në një hetim të rastit në përgjithësi, prandaj konsideroj që ky punim ka rëndësinë e vet të madhe, sepse në të pasqyrohen edhe mënyrat e përdorimit të këtyre mjeteve dhe pajisjeve të cilat përdoren për ekzaminimin e gjurmëve dhe provave materiale. Përdorimi i literaturës në tërësinë këtë studim paraqet formën, mënyrën, metodat e llojllojshme si dhe aplikimin e tyre nëpër praktikatat e vendeve të ndryshme të botës. Rëndësi tjetër e këtij punimi që unë konsideroj se është mjaft e madhe është edhe fakti se; duke u bazuar në këto trajnime dhe përvoja që ne kemi pasur rastin t'i marrim nga këta ekspertë, kemi arritur që gjatë punës sonë të përditshme të arrijmë suksese të mëdha në fushën e hetimit të vendit të ngjarjes.

Në këtë kontekst, shpresoj që studimi do të jetë me interes edhe për ata që në punën e tyre praktike merren me këtë çështje. Duke pasur parasysh se në këtë punim janë paraqitur edhe disa të reja sa i përket punës së ekipeve të këqyrjes së vendit të ngjarjes, kam shpresë se kjo do ta bëjë këtë punim edhe më të pasur dhe më të rëndësishëm për ata që do ta marrin për ta lexuar. Këto të reja kanë të bëjnë me taktikat e këqyrjes së vendit të ngjarjes, më konkretisht me metodat e këqyrjes, për të cilat kemi mendime të ndryshme nga autorët e ndryshëm. Jam përpjekur t'i paraqesë faktet dhe argumentet, të cilat besoj se janë të forta, të bazuara gjithmonë në punën time praktike. Këto metoda mund të gjejnë zbatim edhe në formën se si i kam paraqitur këtu, duke i mbështetur gjithnjë në fakte dhe argumente të sigurt, të provuara madje më shumë se një herë. Pra, duke respektuar secilin nga autorët që kanë dhënë mendimet e tyre për këtë çështje, kam paraqitur mënyrën e këndvështrimin tim origjinal, ashtu siç e kam parë gjatë punës sime praktike.

Të reja të tjera që kam paraqitur në këtë punim, të cilat kanë rëndësi të madhe, kanë të bëjnë me këqyrjen dhe ekzaminimin e trupave të vdekur apo me saktësisht plagëve që ata kanë marrë. Edhe në këtë aspekt kam paraqitur diçka që deri me tani është menduar ndryshe, apo është vërejtur fare pak, nga ata që kanë bërë këto ekzaminime. Kam parë se

madhësia e plagës hyrëse dhe dalëse, si dhe forma e saj, nuk është gjithmonë e njëjtë, ashtu siç është thënë deri tani, sepse gjatë përvojës sime kam pasur më shumë se një rast që e ka argumentuar të kundërtën e asaj çfarë është menduar deri tani. Besoj se këto të reja, këtij punimi do t'ia rrisin vlerën dhe rëndësinë.

Pjesa tjetër e audiencës dhe qarqet akademike do të kenë në dorë një punim të shtjelluar në mënyrë profesionale, i bazuar në përvojën praktike që autori ka pasur për një kohë të gjatë në këtë fushë, me përmbajtje domethënëse, si edhe aspekti hulumtues me të dhënat për zhvillimet më të reja në këtë fushë. Në këtë aspekt, pa modesti e them se rezultatet e studimit do të mund t'i inkorporojnë edhe ekspertët e kurikulave arsimore.

KAPITULLI II: KUPTIMI, IDENTIFIKIMI DHE SIGURIMI I VENDIT TË NGJARJES

2.1 Kuptimi i vendit të ngjarjes

Në literaturën klasike dhe atë bashkëkohore, definicionet për vendin e ngjarjes kanë ngjashmëri njëra me tjetrën. Në përgjithësi vendi ku ka ndodhur krimi është vendi i ngjarjes, por, megjithëkëtë të shohim ndonjë nga formulimet:

“Vendngjarje”, në kuptimin e përgjithshëm klasik është jo vetëm vendi ku ka ndodhur vepra penale (ndërtesa, territori, vendi i hapur), por edhe vendi ku janë zbuluar rrethana që lidhen me to dhe pasojat e tij, pavarësisht nga largësitë midis këtyre vendeve, si vend i zbulimit të kufomës në një vend tjetër, i gjurmëve të këmbëve, automjetit të larguar nga vendi i ngjarjes, i armës së zjarrit ose mjetit të thyerjes të hedhur nga fajtori pas kryerjes së veprës penale¹.

Vendi ku dyshohet se ka ndodhur krimi, në të cilin mund të ekzistojnë gjurmët dhe provat materiale, ku duhet bërë hetime që të sqarohen rrethanat e ndodhjes dhe mbi këto rrethana të caktohen shkaqet dhe mekanizmat e ndodhjes, pasojat dhe autori i tyre², është një mendim tjetër.

Vend ngjarje (emërtohet, thirret, konsiderohet) ai terren ku mendohet se ka ndodhur krimi (një ose disa) në apo rreth të cilit ekziston mundësia e pranisë së shenjave, mjeteve, provave materiale, të lëna nga aktet e kryera dhe për këtë shkak organizohet qëmtimi (kërkimi detal), fotografimi, skicimi, fiksimi, pasqyrimi dokumentar i gjendjes, grumbullimi i lëndëve dhe mjeteve, të cilat mund të kenë lidhje me ngjarjen dhe mund të shërbejnë si bazë për të gjetur shkaqet, rrethanat, mënyrat, autorin apo autorët e mundshëm të kryerjes së veprës penale³.

¹Prof.asc. Ilir Mandro, “Këqyrja e vendit të ngjarjes në vrasjet me armë zjarri”, Ilar 2000, Tiranë, faqe 19.

²Estref Myftari, Këqyrja e vendit të ngjarjes, Tiranë, 1984, faqe 9.

³Dr. Sc. Irakli KOÇOLLARI, Tribunë Juridike, Tiranë, Nr. 85, 2010.

2.2 Kuptimi juridik dhe kriminalistik i këqyrjes së vendit të ngjarjes

Në kuptimin juridik, këqyrja e vendit të ngjarjes është paraparë edhe në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës⁴, në të cilin thuhet:

Këqyrja dhe rikonstruksioni

Neni 150

(1) “Prokurori i shtetit mund të urdhërojë këqyrjen ose rikonstruksionin e vendit të ngjarjes për të shqyrtuar provat e mbledhura ose për të qartësuar faktet e rëndësishme për procedurën penale”.

Në këtë paragraf është paraparë autoriteti i cili mund të urdhërojë këqyrjen dhe rikonstruksionin. Në të vërtetë në këtë paragraf ligjdhënësi shprehimisht përcakton se mundësia për të urdhëruar këqyrjen dhe rikonstruksionin takon prokurorit të shtetit.

(2) “Këqyrjen ose rikonstruksionin e tillë të vendit të ngjarjes e kryen prokurori i shtetit ose policia. Prokurori i shtetit dhe policia mund të kryejnë këqyrjen ose rikonstruksionin e tillë për t’u njoftuar personalisht me gjendjen, e cila do t’u ndihmonte në përcaktimin e besueshmërisë ose gjetjen e fakteve, por në rastin e tillë, rezultatet për gjykatën janë të papranueshme, përveç nëse është në pajtim me paragrafin 3. ose 4. të këtij neni. Prokurori i shtetit mund ta përsërisë këqyrjen ose rikonstruksionin e tillë me njoftim, siç parashihet me këtë nen, me ç’ rast rezultatet e tilla janë të pranueshme.”

Në këtë paragraf është paraparë autoriteti që zbaton këqyrjen dhe përsëritjen e saj si dhe besueshmëria dhe pranimi i fakteve nga gjykata nëse këqyrja dhe rikonstruktimi janë bërë pa u njoftuar i pandehuri dhe mbrojtësi i tij.

Në fakt gjatë analizës se këtij paragrafi shtrohen tri çështje të nevojshme për komentim: **e para-** ka të bëjë me përcaktimin e autoritetit që e realizon këqyrjen dhe rikonstruksionin. Këtë autoritet për të zbatuar këto dy veprime i ka prokurori i shtetit ose policia. Pra,

⁴Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 04/ L-123, I aprovuar më 13 dhjetor 2012. Hyrja në fuqi më 01.01.2013. Prishtinë, faqe 89.

prokurori publik udhëheq hetimet, ndërsa policia merr autorizim nga prokurori publik për kryerjen e hetimeve.

e dyta- ka të bëjë me efektet që manifeston këqyrja dhe rikonstruksioni, sidomos në rastet kur ato i zbaton prokurori publik ose policia⁵. Pra kur prokurori dhe policia bëjnë këqyrjen ose rikonstruksionin vetëm, pa njoftuar të pandehurin apo mbrojtësin e tij, rezultatet e këtyre dy veprimeve nuk pranohen nga gjykata.

e treta- ka të bëjë me përsëritjen e këqyrjes ose rikonstruksionit. Përsëritja realizohet kur këqyrja e parë është bërë në rrethana objektive të papranueshme, p.sh.: gjatë natës, në borë, shi të rrëmbyeshëm etj., dhe kryhet me qëllim që të evitohen të metat e këqyrjes së parë ose kur gjatë hetimit dalin në shesh prova të reja të cilat nuk ishin zbuluar gjatë këqyrjes së parë si dhe kur këqyrja është kryer me cilësi të dobët, p.sh.: nuk janë zbuluar prova e gjurmë të cilat nga vetë natyra e veprës së kryer gjykohet se ato duhet të ekzistojnë ⁶.

(3) “Nëse identiteti i tyre është i njohur, prokurori i shtetit njofton të dyshuarin, të pandehurin apo mbrojtësin e tij lidhur me këqyrjen dhe rikonstruksionin. Mbrojtësi i të pandehurit ka të drejtë të jetë i pranishëm në këqyrje ose në rikonstruksion të vendit të ngjarjes”.

(4). Nëse i dyshuari, i pandehuri apo mbrojtësi i tij janë të panjohur për prokurorin e shtetit, gjyqtari i procedurës paraprake merr pjesë dhe vëzhgon këqyrjen dhe rikonstruksionin.

Në këto dy paragrafë është parashikuar e drejta që i pandehuri dhe mbrojtësi i tij të jenë të pranishëm gjatë këqyrjes dhe rikonstruksionit.

Ata mund ta shfrytëzojnë mundësinë që të jenë të pranishëm, por mos prezenca e tyre nuk është pengesë për zbatimin e këtyre veprimeve, i rëndësishëm është elementi i njoftimit që i duhet bërë të pandehurit dhe mbrojtësit të tij mbi zbatimin e këqyrjes dhe rikonstruksionit, e jo domosdoja e prezencës së tyre⁷.

⁵ Dr. Azem Hajdari, Procedura Penale – Komentar, Prishtinë 2010, faqe 377.

⁶ Po aty, faqe 377

⁷ Po aty, faqe 377

(5) *“Rikonstruksioni kryhet me rikrijimin e fakteve ose të situatave nën rrethanat e të cilave është zhvilluar ngjarja, bazuar në provat e mbledhura. Nëse faktet ose situatat paraqiten ndryshe në dëshmitë e dëshmitarëve konkretë, në parim, rikonstruksioni i ngjarjes zbatohet veçmas me secilin dëshmitar”.*

Këtu kemi të bëjmë me krijimin e fakte dhe situatave kundërthënëse nën rrethanat e të cilave është zhvilluar ngjarja, në këto kushte rikonstruksioni zbatohet veçmas për secilin dëshmitar.

Gjatë analizës që mund t’i bëhet këtij paragrafi shtrohet nevoja që të komentohen dy çështje:

e para- rikonstruksioni është një veprim procedural që konsiston në krijimin e fakteve ose të situatave nën rrethanat e të cilave është zhvilluar ngjarja, bazuar në provat e mbledhura dhe

e dyta- është ajo që shtron nevojën e zbatimit të rikonstruktimit veçmas për secilin dëshmitar, pasi që faktet dhe gjendjet paraqiten ndryshe në dëshmitë e dëshmitarëve konkretë⁸.

(6) *“Gjatë rikonstruksionit të ngjarjes duhet pasur kujdes që të mos shkelet ligji dhe rendi, të mos fyhet morali publik apo të vihet në rrezik jeta ose shëndeti i njerëzve”.*

Në këtë paragraf parashihet që gjatë rikonstruksionit të zbatohen dispozitat ligjore dhe të mos ketë rrezikim të moralit të publikut apo rrezikim të jetës së njerëzve. Nuk është e lejueshme, që në rast të zbatimit të rikonstruktimit, të bëhen thyerje të reja në objektin i cili ka qenë i atakuar me veprën penale⁹.

(7) *“Këqyrja ose rikonstruksioni i vendit të ngjarjes mund të ndihmohet nga specialistët e mjekësisë ligjore, nga personeli i transportit dhe nga ekspertë të lëmenjve të tjera për të mbrojtur ose përshkruar provat, për të bërë matjet dhe incizimet e nevojshme, për të bërë skicat apo për të mbledhur informata të tjera. Dispozitat nga ky nen nuk prejudikojnë*

⁸ Dr. Azem Hajdari, Procedura Penale – Komentar, Prishtinë 2010, faqe 378.

⁹ Po aty, faqe 378.

kompetencat e policisë për të ndërmarrë hapa fillestarë në mbledhjen e informatave, për të bërë matje, incizime, skica dhe për të mbledhur prova mjeko-ligjore nga nenet 70-77 të këtij Kodi.”

Në këtë paragraf rregullohet çështja e angazhimit të ekspertëve të fushave të ndryshme siç janë: ekspertët e mjekësisë ligjore, ekspertët e balistikës etj.

Si rregull, ekspertët angazhohen për të sqaruar fakte që kanë rëndësi qenësore për zgjidhjen e drejtë të çështjes penale, siç janë ato që mundësojnë zbulimin e veprës penale dhe të kryerësit, si dhe për të përcaktuar mekanizmin e kryerjes së figurës konkrete të veprës penale¹⁰.

(8) Të dhënat e marra sipas neneve 70-77¹¹ të këtij Kodi në një raport që është përshtatshmërisht në pajtim me paragrafët 1. dhe 2. të nenit 138 të këtij Kodi mund të jenë të pranueshme bazuar në shqyrtimin e gjyqtarit të procedurës paraprake. Gjyqtari i procedurës paraprake mund të urdhërojë këqyrje dhe rikonstrukcion minimal të vendit të ngjarjes për të vërtetuar gjetjet në raportin nga ky paragraf. Gjyqtari i procedurës paraprake urdhëron që raporti të jetë i pranueshëm.

(9). Eksperti gjithashtu mund të thirret që të jetë i pranishëm në këqyrje apo në rikonstrukcion të vendit të ngjarjes kur prania e tij konsiderohet e dobishme nga prokurori i shtetit ose nga gjykata.

(10). Pas ngritjes së aktakuzës, kryetari i trupit gjykues mund të urdhërojë rikonstrukcionin e vendit të ngjarjes nga ky nen vetëm nëse fajësia apo pafajësia e të pandehurit kërkon që trupi gjykues të ketë njohuri të drejtpërdrejtë nga rikonstrukcioni i vendit të ngjarjes apo nga vizita në vendin e kryerjes së veprës penale.

Edhe në këtë paragrafë parashihet koha se kur mund të thirret eksperti i një fushë të caktuar. Prokurori i shtetit dhe gjykata gjatë këqyrjes dhe rikonstrukcionit mund të

¹⁰ Po aty, faqe 378.

¹¹ Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Veprimet Fillestare të Policisë, nenet 70-77, faqe 34-37, aprovuar më 13 dhjetor 2012, hyrja në fuqi e këtij kodi 01.01.2013, Prishtinë.

angazhojë çdo ekspert të mundshëm për të cilin ka vlerësime se do të ndihmonte në zgjidhjen e drejtë të çështjes, përkatësisht sqarimin e rrethanave të caktuara¹².

Shkaku i këqyrjes së vendit të ngjarjes nxitet nga arsyetimi që, në vendin ku ka ndodhur krimi, mund të ekzistojnë ose ekzistojnë provat e mundshme që kanë të bëjnë me atë krim dhe caktimi i rrethanave dhe mekanizmave të ndodhjes na mundëson ecjen përpara në aspektin e ndjekjes dhe të kapjes së autorit të krimit.

Vendi i ngjarjes mund të jetë shtëpia ose objekti, vetura ose ndonjë lokacion i hapur (jashtë shtëpisë ose veturës)¹³.

Vendi i ngjarjes është një kulm i piramidës që zgjerohet për të përfshirë: hetimin e një krimi, njohjen, analizën, interpretimin e provave dhe në fund prezantimin në gjyq¹⁴.

Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës¹⁵, Këqyrja e Vendit të Ngjarjes është paraparë në nenin 10, Vendi i Kryerjes së veprës penale i cili thotë:

Vendi i kryerjes së veprave penale

Neni 10

1.Vepra penale është kryer në vendin ku kryerësi ka vepruar apo ka qenë i detyruar të veprojë, ashtu si dhe në vendin ku është shkaktuar pasoja.

2.Vepra penale është tentuar në vendin ku kryerësi ka vepruar si dhe në vendin ku sipas dashjes së kryerësit është dashur të shkaktohet pasoja.

Në kuptimin kriminalistik, këqyrja e vendit të ngjarjes është një tërësi veprimesh të ndërlikuara dhe një sistem i aplikimit të metodave dhe mjeteve të posaçme teknike me të

¹² Dr. Azem Hajdari, Procedura Penale – Komentar, Prishtinë 2010, faqe 379

¹³ Këqyrja e vendit të ngjarjes, doracak për studentë, Kursi bazik i Forenzikës, Vushtrri, 2002, faqe 8

¹⁴ Keith Inman & Norah Rudin, Principles and Practice of Criminalistics the profession of Forensic Science, CRC PRESS LLC, 2001, faqe 197.

¹⁵ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 10, Vendi i Kryerjes së Veprës Penale, faqe 4, Kodi Nr. 04/L-82, i aprovuar më 20 prill 2012, hyrja në fuqi e këtij kodi 01.01.2013, Prishtinë

cilat nëpërmjet vëzhgimit zbulohen, sigurohen, përshkruhen dhe regjistrohen sendet, gjurmët dhe rrethanat tjera të rëndësishme për procedurë penale¹⁶.

Pasi që krimet nuk janë të njëjta edhe nëse kryhen nga i njëjti person, ashtu edhe vendi i ngjarjes nuk është i njëjtë me vendin tjetër të ngjarjes dhe për këtë arsye nuk ka asnjë formë a formulë e cila do të vlente për të gjitha vendet e ngjarjeve, gjithmonë duke përjashtuar disa rregulla themelore në lidhje me vendin e ngjarjes dhe këqyrjen e tij, që janë të përbashkëta për të gjitha vendet e ngjarjes, duke pasur parasysh vendin dhe natyrën e krimit.

Vend i ngjarjes është vendi ku janë gjetur gjurmët dhe provat materiale, të cilat lidhen me krimin që është kryer pa marrë parasysh largësinë e këtyre dy vendeve dhe kjo mund të shpjegohet me faktin se autori gjatë ikjes nga vendi i ngjarjes në një largësi të caktuar, cilado qoftë ajo, ka hedhur ose i ka rënë nga dora mjeti me të cilin e ka kryer krimin, dhe gjatë kontrollimit të atij vendi nga ekipi i këqyrjes ose nga ndonjë dëshmitar, në mësojmë për vendndodhjen e asaj gjurme ose prove materiale, ndaj këtë vend gjithashtu duhet llogaritur si vendngjarje. Do të ishte vështirë të përcaktohen kufijtë e vendit të ngjarjes menjëherë pasi që ne të arrijmë aty, por sidoqoftë, kur rasti ka ndodhur në ndonjë objekt të mbyllur (shtëpi, bankë, shitore etj.) atëherë vendi i ngjarjes është në ndërtesën e dhënë¹⁷. Por, nëse gjejmë ndonjë gjurmë ose provë materiale jashtë këtij vendi të mbyllur (rruga që ka bërë autori kur është futur brenda dhe kur ka ikur) atëherë edhe këtë vend duhet llogaritur vendngjarje.

Pra, të gjitha gjurmët dhe provat materiale që i gjejmë gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes, pa marrë parasysh vendin dhe çfarë gjurme ose prove materiale është, ai vend duhet llogaritur si vendngjarje në të njëjtën vlerë dokumentuese dhe provuese¹⁸. Kjo gjithashtu ka rëndësinë e vet si në aspektin e dokumentimit, ashtu edhe në rast se

¹⁶Prof.dr. Ejup Sahiti, prof.dr. Rexhep Murati, mr.sc. Xhevdet Elshani, KOMENTAR, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, KOMENTAR, Botimi i I, 2014, i publikuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Prishtinë, faqe 408.

¹⁷Prof.dr. Vesel LATIFI, Kriminalistika, zbulimi dhe të provuarit e krimit, Prishtinë, 2009, faqe 171.

¹⁸Prof. ass. dr. Luan VELIÇOTI, Tribunë Juridike, Tiranë Nr. 82, 2010.

dëshmojmë në gjyq, në lidhje me atë gjurmë apo provë materiale dhe vendin se ku e kemi gjetur.

Vendi i ngjarjes ka disa veçori nga veprimet e tjera hetimore.

- Vendi i ngjarjes është i papërsëritshëm. Ai ndodh në vende e mjedise ku jetohet, punohet apo lëvizet. Mbas realizimit të këqyrjes dhe largimit të grupit hetimor, aty do të vazhdojë normaliteti ndaj mund të dëmtohet ndonjë gjurmë ose provë që mund të mos jetë zbuluar e fiksuar. Dëmtimi mund të ndodhë edhe nga kushtet atmosferike, prandaj këqyrja e vendit të ngjarjes kryhet me angazhim dhe profesionalizëm të lartë.
- Vendi i ngjarjes është një veprim hetimor emergjent, sidomos në krime të rënda apo kur në këto krime ka edhe kufoma. Shkuarja me shpejtësi është e domosdoshme sepse:
 - gjurmët dhe provat materiale mund të dëmtohen me dashje apo nga pakujdesia e njerëzve;
 - për të ndërprerë pasojat eventuale në një vepër tjetër penale, siç mund të jetë një hakmarrje (vetëgjyqësi) ndaj autorit;
 - për të zbuluar dhe kapur autorin e krimit.

Për momentin e vëzhgimit e hulumtimit të vend krimit, respektivisht vendngjarjes, kriminologu francez Locard thotë:

”koha që po kalon është e vërtetë që po ikëm”¹⁹.

Pra, vendi i ngjarjes është një veprim hetimor i pazëvendësueshëm dhe shumë i rëndësishëm për të zbuluar gjurmë dhe prova materiale, me synim zbulimin e autorit të veprës penale. Për këtë qëllim grupi hetimor pasi që të shkojë në vendin e ngjarjes mban parasysh dhe zbaton thënien “ngutu ngadalë”²⁰.

Për çështjet penale në vendin e ngjarjes, këqyrja e tij është veprim i parë hetimor, i cili kryhet pa filluar çështjen penale, prandaj vendi i ngjarjes është një kulm i

¹⁹Locard, kriminalist francez, cituar nga prof. Haki DEMOLLI, “Terrorizmi”, Prishtinë, 2002, faqe 260.

²⁰Prof. ass. dr. Luan VELIÇOTI, Tribunë Juridike, Tiranë, nr. 82, 2010.

piramidës që zgjerohet për të përfshirë hetimin e një krimi, njohjen, analizën dhe interpretimin e provave dhe në fund prezantimin në gjyq²¹.

2.3 Rëndësia kriminalistike e këqyrjes së vendit të ngjarjes

Këqyrja e vendit të ngjarjes ka rëndësi të madhe për arritjen e qëllimit final, sqarimin e rrethanave të këqyrjes, mjetet e përdorura, autorët e mundshëm etj. Gjithashtu rëndësi tjetër është se ai është terreni ku besohet se ka ndodhur akti kriminal dhe si i tillë ai duhet të ketë shumë gjurmë apo prova materiale, që kanë të bëjnë me krimin, mekanizmin e kryerjes së tij, mënyrën e kryerjes, mjetin e kryerjes, autorin apo autorët e mundshëm, prova këto materiale (gjurmë, mjete, instrumente, mekanizma, dokumente etj.), të cilat mund të qojnë drejt dokumentimit ligjor të aktit kriminal apo zbulimit të autorit. Këqyrja e vendit të ngjarjes është një veprim hetimor, me anë të të cilit organi procedurës percepton drejtpërsëdrejti mjedisin ku ka ndodhur vepra penale, zbulon, mbledh, fikson prova materiale dhe sqaron rrethanat që kanë rëndësi për çështjen²².

Gjatë procesit të këqyrjes ekspertët zbulojnë, fiksojnë, mbledhin prova që kanë rëndësi të veçantë për të përcaktuar rrethanat dhe mbi këtë çështje shpjegohen mekanizmat e ngjarjes. Prandaj, që këqyrja të jetë sa më efikase ekipi i cili e bën atë duhet të jetë i kujdesshëm që gjatë këqyrjes të zbulojë, fiksojë dhe mbledh të gjitha gjurmët dhe provat materiale të cilat i hasin në vendin e ngjarjes.

Dimë se krimet ndodhin në kohë të ndryshme, pra ato mund të ndodhin edhe natën me ç'rast kërkohet nga ekipi i këqyrjes së vendit të ngjarjes që ai vend të procedohet. Nëse është e mundur që këqyrja e vendit të ngjarjes të shtyhet deri sa të arrijë dita, do të ishte mirë, sepse këqyrja gjatë ditës, në kushte të mjaftueshme të dritës natyrore është më efikase dhe me shumë sukses²³.

²¹ Keith Inman & Norah Rudin, Principles and Practice of Criminalistics the profession of Forensic Science, CRC PRESS LLC, 2001, faqe 197.

²² Dr. Vesel LATIFI, Kriminalistika - Zbulimi dhe të provuarit e krimit, faqe 171, Prishtinë, 2009.

²³ Këqyrja e vendit të ngjarjes, doracak për studentë, Akademia Policore Vushtrri, 2002, Kosovë, faqe 7.

Rëndësi e veçantë e këqyrjes është edhe ajo se koncepti mbi gjurmët dhe provat materiale dhe vlerën e tyre duhet të zgjerohet kur prova duhet të llogariten jo vetëm gjurmët e gishtërinjve, apo gjurmët e këpucëve dhe gomave, por prova duhet të llogariten edhe **mikrogjurmët** të cilat nganjëherë duken pak ose nuk duken fare. Ato duhet kërkuar në trupin e viktimës, në teshë, në sende të ambientit rrethues dhe kryesisht fiksohen: gjurmë daktiloskopike, gjurmë traseologjike të këmbëve, pjesë të teshave të grisura, mjetet e kryerjes së krimit, sende të tjera që i përkasin fajtorit: flokë, pjesë lëkure, gjak, pështymë, ekskreme të ndryshme, gjurme të veprimeve të kryera nga autori mbi viktimën si; plagët që ka marrë, dëmtime të teshave, gjurmë të përleshjes së ndodhur midis tyre²⁴. Këto gjurmë dhe prova materiale kanë rëndësinë e njëjtë sikurse provat të cilat duken dhe rëndësia e tyre është shumë e madhe. Nëse ekipi që bën këqyrjen i kushton rëndësi të madhe asaj, atëherë këto prova do të krijojnë lidhjen në mes tyre me njërën anë dhe me rrethanat dhe mekanizmat e ndodhjes në anën tjetër, kështu që do të sqarojnë shumë çështje të panjohura.

Që këqyrja të jetë sa më efikase ajo nuk duhet të bëhet kryesisht në qendrën e vendit të ngjarjes, duke u koncentruar vetëm në një zonë të vogël; ajo duhet të zgjerohet edhe jashtë kësaj zone duke i futur në procesin e këqyrjes edhe vendet tjera që gjenden rreth asaj zone dhe që kanë lidhje me atë vepër.

Këqyrja e vendit të ngjarjes është gjithashtu një burim i madh informacioni për zbulimin e autorit dhe të provuarit e kryerjes prej tij të veprës penale. Gjurmët dhe provat materiale, të zbuluara në vendin e ngjarjes, janë të ashtuquajturit “dëshmitarë memecë”, janë të pazëvendësueshme, gati të vetme në mungesën e dëshmitarit dhe mbi të gjitha të pa korruptueshme²⁵.

²⁴Prof.asoc. Ilir Mandro, “Këqyrja e Vendit të ngjarjes në vrasjet me armë zjarri”, Ilar, Tiranë, 2002, faqe 12.

²⁵Prof. Ass. Dr. Luan VELIÇOTI, Tribunë Juridike, Tiranë, nr. 82, 2010.

2.4 PËRGADITJA PËR TË SHKUAR NË VENDIN E NGJARJES (MASAT PËRGADITORE)

Masat që ndërmerren për përgatitjen për të shkuar në vendin e ngjarjes lidhen me disa veprime që eksperti i bën kur merr thirrjen për të shkuar në vendngjarje. Në këtë fazë përgatitore hyjnë të gjitha përgatitjet që bëhen nga ekipi, i cili do i përgjigjet kësaj thirrjeje:

- *Njoftimi për lokacionin e vendit të ngjarjes (saktësimi i vendndodhjes);*
- *Verifikimi i njoftimit;*
- *Dhënia e instruksioneve për ruajtjen e vendit të ngjarjes;*
- *Kompletimi i të gjitha pajisjeve të nevojshme dhe personelit;*

2.5 Njoftimi për lokacionin e vendit të ngjarjes (saktësimi i vendndodhjes)

Ekipi i cili do t'i përgjigjet kësaj thirrjeje duhet ta ketë të njohur vendndodhjen e saktë se ku ka ndodhur ngjarja, në mënyrë që të mos ngatërrohen gjatë rrugës për në vendngjarje, por ta kenë të qartë dhe ta dinë saktësisht se ku duhet shkuar, në mënyrë që të shmangen nga ndonjë vonesë e panevojshme.

Nëse rasti ka ndodhur në ndonjë vend të hapur ose vend malor, ku nuk ka adresë të saktë, atëherë do të kërkohen koordinatat. Duke përcaktuar me saktësi vendin se ku ka ndodhur ngjarja bëhet e mundur edhe shkuarja më e shpejtë, si një kërkesë dhe veçori që ka ky veprim hetimor. Shpejtësia e kryerjes së veprimeve paraprahe për të shkuar në vendngjarje është parim bazë për të siguruar provat që ndodhen në të²⁶.

2.6 Verifikimi i ngjarjes

Ky verifikim bëhet për të përcaktuar nëse ngjarja përmban elementet e figurës së veprës penale, për ta përcaktuar nëse është e mundur llojin e veprës, nëse ngjarja ka

²⁶Dr. Xhemajl ADEMAJ, Ekspertizat kriminalistike, Prishtinë, 2010, faqe 112.

ndodhur në rrethana që nuk e lejojnë fillimin e çështjes penale, që në përshtatje me karakterin e veprës të formohet ekipi që do të shkojë në atë vend²⁷. Të gjitha këto bëhen jo për të kryer hetime lidhur me atë rast, pasi që për hetime është ende herët të flitet, por qëllimi është që të mblidhen sa më shumë hollësi lidhur me veprën dhe ato mund të mblidhen nga personat që e kanë paraqitur rastin, nga dikush që është munduar ta parandalojë atë, nga pronarët të cilët janë të dëmtuar, në objektet e të cilëve ka ndodhur ngjarja, nga personeli mjekësor si dhe nga policët e parë që janë njoftuar për këtë ngjarje. Mbi bazën e këtij verifikimi dhe informacioni të grupit hetimor, ekspertët e nevojshëm veprojnë dhe funksionalizohen.

2.7 Dhënia e instruksioneve për ruajtjen e vendit të ngjarjes

Ruajtja e vendit të ngjarjes do të thotë sigurimi i terrenit, ambienti ku ka ndodhur vepra në të njëjtat kushte fizike që e ka lënë autori.

Duhet dhënë porositë që vendi i ngjarjes të ruhet nga ndërhyrjet, derisa atje të arrijë ekipi i cili do të punojë në atë vend, duke përdorur mjetet e nevojshme për kufizimin e vendit të ngjarjes siç janë: shiritat e ndryshëm rrethues të vendit të ngjarjes ose në mungesë të tyre të përdoren pengesa të tjera që në këtë mënyrë të pengohet hyrja e personave të paautorizuar brenda vendit ku ka ndodhur ngjarja. Porosia tjetër që duhet dhënë, nëse është e mundur dëshmitarët që kanë parë ose dinë diçka të njoftohen dhe të mbahen aty afër vendit të ngjarjes veç e veç njëri-tjetrit, në mënyrë që deklaratat e tyre të mos jenë të njëjta. Porosia mund të jepet gjithashtu edhe sipas rastit apo nevojës, për të dhënë ndihmë personave të dëmtuar apo për të kapur, mbajtur dhe shoqëruar autorin e veprës penale.

2.8 Kompletimi i personelit dhe pajisjeve të nevojshme për këqyrjen e vendit të ngjarjes

Kompletimi i pajisjeve të nevojshme do të kapërcejë çdo vështirësi dhe do të përgjigjet nevojës që do të paraqitet gjatë procesit të këqyrjes, pasi që vendi i ngjarjes ka edhe të papritura, të cilat paraqiten aty për aty dhe nuk mund të parashikohen.

²⁷Prof. dr. Vesel LATIFI, Kriminalistika, Zbulimi dhe të provuarit e krimit, Prishtinë, 2009, faqe 173.

Pajisjet teknike kriminalistike i bënë eksperti kriminalist në fazën e verifikimit për ngjarjen, në përshtatje me llojin e saj²⁸.

Duke pasur parasysh natyrën e rastit, për të cilin jemi thirrur, duhet të llogaritet edhe personeli, i cili do të merr pjesë në atë këqyrje. Duke u bazuar në informatat e para lidhur me llojin e krimit, duhet të caktohet personeli adekuat i cili është i trajnuar dhe kualifikuar për këqyrjen e atij lloji të krimit. Në një rast zjarr vënie, pjesë e ekipit duhet të jetë eksperti i cili është i trajnuar në këtë lëmi, në rast të shpërthimit-eksplodimit, në ekipin e këqyrjes duhet të përfshihet eksperti i deminimit etj.

Pra, është e domosdoshme që ekipi i cili përgjigjet në thirrje të ketë edhe ekspertët e trajnuar për lëmi të ndryshme, në mënyrë që varësisht nga rasti edhe ata të përgjigjen në këto situata. Ekspertët e tillë mund të thirren edhe nga agjencitë tjera si: Forca e Sigurisë së Kosovës, KFOR-i apo zjarrfikësit.

²⁸Dr. Estref MIFTARI, mr.sc. Fitim SHISHANI, Hysen KOTRI, Kriminalistika, Prishtinë, 2010, faqe 99.

2.9 RUAJTJA E VENDIT TË NGJARJES

Njëra prej çështjeve kryesore për ekspertët e vendit të ngjarjes, është ruajtja e tij. Prekja, lëvizja dhe ecja mbi gjurmët dhe provat materiale që gjenden në atë vend do të zvogëlonte besueshmërinë në lidhje me ato prova që kanë mbetur në atë vend. Nëse një herë të vetme një provë apo gjurmë lëvizet nga vendi i vet, ajo kurrë më dhe nga askush nuk mund të kthehet në gjendjen e saj fillestare (siç e ka lënë autori)²⁹. Këto prova u nënshtrohen edhe ndikimit të njerëzve që kanë interes t'i ndryshojnë, t'i zhdukin apo t'i fshehin me qëllim që të mos zbulohet e vërteta dhe autori³⁰.

Duke pasur parasysh se vendi i ngjarjes duhet të procedohet, këqyret, kontrollohet apo bastiset, në mënyrë që të gjitha gjurmët dhe provat materiale që gjenden aty të zbulohen, fiksohen, mblidhen ashtu siç kërkohet, ruajtja e vendit të ngjarjes nënkupton marrjen e një tërësie masash të domosdoshme për të siguruar pandryshueshmërinë e ambientit ku ka ndodhur ngjarja, gjurmëve dhe provave materiale të ndodhura aty³¹.

Marrja e masave për ruajtjen e vendit të ngjarjes ka për qëllim sigurimin dhe ruajtjen e gjurmëve dhe provave materiale dhe nuk lejohet asnjëri të shkelë në atë vend para ardhjes së grupit hetimor³². Dëmtimi mund të ndodhë për shkaqe natyrore, p.sh.: në rast se bie borë, reshje shiu, kalimtar dhe kureshtarë i rastit, por edhe me dashje nga autori i rastit apo bashkëpunëtorët e tij.

Mbrojtja e vendit të ngjarjes fillon nga pika qendrore, vendi ku është zhvilluar ngjarja, për t'u zgjeruar në drejtim të perimetrit të jashtëm.

²⁹ Vernon J. Geberth M.S.,M.P.S.,B.B.A.,FBINA, PRACTICAL HOMICIDE INVESTIGATIONS, Tactics, Procedures and Forensic Techniques, Fourth Edition, page 4, Published in 2006, CRC Press, New-York, Suite 300, USA.

³⁰ Dr. Estref MIFTARI, mr.sc. Fitim SHISHANI, Hysen KOTRI, Kriminalistika, Prishtinë, 2010, faqe 97.

³¹ Prof.asc. Ilir Mandro, "Keqyrja e Vendit të ngjarjes në vrasjet me armë zjarri", ILAR 2002, Tiranë, faqe 15.

³² Prof. dr. Vesel LATIFI, Kriminalistika, zbulimi dhe të provuarit e krimit, Prishtinë, 2009, faqe 173.

Për mbrojtjen e vendit të ngjarjes kërkohet një angazhim mjaft i madh, duke pasur parasysh rrethanat, kohën dhe mekanizmat në të cilat është zhvilluar ngjarja dhe me çfarë rasti kemi të bëjmë. Por, një qasje e mirë në këtë drejtim do të mundësonte që ekipi i cili punon në atë vendngjarje të ketë rezultat të mirë.

2.10 Sigurimi i vendit të ngjarjes

Shpeshherë shtrohet pyetja se kush është përgjegjës për vendin e ngjarjes?

Përgjegjës për sigurimin e vendit të ngjarjes është polici i parë që arrin në atë vend³³. Vendi i ngjarjes është dinamik, mjedisi ndryshon në mënyrë të shpejtë dhe këtë duhet ta ketë parasysh çdo person që arrin i pari në atë vend të ngjarjes³⁴.

Marrja e masave për ruajtjen e vendit të ngjarjes ka për qëllim sigurimin dhe ruajtjen e provave si dhe të gjurmëve ku nuk lejohet asnjë njeri të ecë/shkelë në vendin e ngjarjes para ardhjes së grupit hetimor³⁵.

Me të arritur në atë vend polici i parë:

- Duhet të sigurohet se autori i veprës penale ka ikur nga vendi i ngjarjes.
Me arritjen në vendin e ngjarjes polici i parë duhet të kontrollojë për praninë ose jo të autorit në vendin e ngjarjes dhe rreth tij dhe nëse ai gjendet ende aty ta ndalojë dhe ta mbajë derisa aty të arrijnë ekipet tjera.
- Duhet ta kontrollojë viktimën, duke përfshirë dhënien e ndihmës së parë.
Nëse viktimë gjendet ende në vendngjarje; ai/ajo duhet të kontrollohet për shenja jete. Nëse viktimë ka shenja jete atëherë duhet t'i afrohet ndihma e parë nga vetë polici apo duke thirrur ambulancën ose ekipet e mjekëve. Nëse viktimë nuk ka shenja jete, atëherë duhet të sigurohet i tërë vendi i ngjarjes duke përfshirë edhe

³³ Në mungesë të policit ky person mund të jetë një punonjës i pushtetit vendor apo një qytetar i thjeshtë.

³⁴ Barry Fisher, *Techniques of Crime Scene Investigations*, seventh edition, 2004, CRC press LLC, faqe 28.

³⁵ Dr. Vesel Latifi, *Kriminalistika- zbulimi dhe të provuarit e krimit*, Prishtinë, 2009, faqe 173.

viktimën që gjendet aty dhe të pritët derisa të arrijnë ekipet e specializuara siç janë: ekipet mjeko-ligjore, ekspertët e vendit të ngjarjes etj.

- Të ndërmeret masat e sigurimit të vendit të ngjarjes.

Masat e sigurimit të vendit të ngjarjes duhet të merren menjëherë pasi të jenë bërë veprimet e lartcekura. Sigurimi i vendit të ngjarjes do të bëhet gjithashtu nga polici i parë që arrijnë në atë vend duke vendosur shiritin përkatës për rrethimin e vendit të ngjarjes me mbishkrimin “SKENË E KRIMIT MOS KALO”, ose duke përdorur qoftë edhe gjësende të tjera qoftë edhe pengesa të ndryshme vetëm sa për t’ua bërë të pamundur personave të paautorizuar të hyjnë në atë vend.

Që vendi i ngjarjes të jetë sa më i siguruar dhe i mbrojtur mirë ai që e bën këtë duhet të jetë i kujdesshëm dhe t’u përmbahet disa rregullave.

- Duhet të jetë i sigurt dhe të ketë dëshmi se vepra është kryer³⁶.
- Dhënia e ndihmës së parë dhe kujdesi për viktimën³⁷.

Dhënia e ndihmës së parë viktimës dhe kujdesi për të gjithmonë duhet të bëhet në atë mënyrë që sa më pak ose fare të mos kontaminohet vendi i ngjarjes. Në rastet e dhënies së ndihmës së parë, hyrja në vend të ngjarjes, mund t’i lejohet vetëm personelit mjekësor, i domosdoshëm për dhënien e ndihmës me efikasitet. Por personeli mjekësor duhet të jetë i vëmendshëm gjatë lëvizjeve nëpër vendin e ngjarjes.

- Arrestimi ose kapja e autorit të krimit, nëse ende është aty (në kushtet e flagrancës).
- Sigurimi i vendit të ngjarjes³⁸.

Detyrë dhe përgjegjësi tjetër e policit të parë që arrijnë në vendin e ngjarjes është që të identifikojë dhe t’i bëjë pyetje personit të parë që e ka lajmëruar atë, pasi që nganjëherë policët lajmërohen nga personat e ndryshëm lidhur me rastin. Gjithashtu veprim tjetër i

³⁶ Mbrojtja dhe këqyrja e vendit të ngjarjes, doracak për studentë, Akademia Policore Vushtrri, Kosovë, 2002, faqe 7.

³⁷ Po aty, faqe 7.

³⁸ Po aty, faqe 7.

polici të parë do të ishte edhe mbajtja e të gjithë personave, që në momentin kur vepra është kryer kanë qenë aty, duke i ndarë ata që deklaratat e tyre të jenë të pavarura njëra me tjetrën.

Personat e parëndësishëm duhet të largohen nga vendi i ngjarjes, duke mos përfshirë këtu personelin mjekësor, zjarrfikësit, të cilët gjithashtu mund dhe janë të dobishëm aty, ku prezenca e tyre ndonjëherë është e domosdoshme.

Mbyllja e rrugës, që shpie në drejtim të vendit të ngjarjes, duhet të mbyllet me shiritat përkatës për sigurimin e vendit të ngjarjes ose në mungesë të tyre përdorim mjete të ndryshme, litarë apo shenja të tjera dhe në këtë mënyrë u bëjmë me dije të gjithëve se brenda asaj pengese që është vendosur aty nuk mund të hyjë askush përveç personave të autorizuar. Një mbyllje e thjeshtë e derës (nëse ngjarja ka ndodhur brenda), ose përdorimi i çfarëdo pengese (litar apo ndonjë mjet tjetër) apo rrethimi me shiritin përkatës përgjatë perimetrit të brendshëm do ta siguronte dhe mbronte vendin e ngjarjes në mënyrë të duhur³⁹.

Duhet të vendoset vetëm një hyrje dhe dalje për të gjithë ata që hyjnë dhe dalin nga vendi i ngjarjes. Kjo mund të vlejë edhe për personelin mjekësor, ku varësisht nga rasti dhe nevoja se si ata duhet të futen brenda vendit të ngjarjes, për t'i dhënë ndihmë viktimës, duhet që edhe atyre t'ju bëhet me dije se është kjo hyrja dhe dalja dhe brenda mundësive që ata kanë, duke iu përshtatur kushteve, t'i shfrytëzojnë këto pika në mënyrë që të mos shkatërrohen apo kontaminohen gjurmët dhe provat materiale, të cilat janë aty, por jo duke i penguar ata që të hyjnë brenda vendit të ngjarjes, pa harruar asnjëherë se:

“dhënia e ndihmës së parë viktimës ka përparësi ndaj provave”⁴⁰.

Edhe pasi që janë marrë të gjitha këto masa për parandalimin e prishjes dhe kontaminimit të vendit të ngjarjes, polici i cili bën sigurimin e tij duhet që të ketë një

³⁹Barry Fisher, Technique of Crime Scene Investigations, seventh edition, 2004 by CRC press LLC, faqe 33.

⁴⁰Mbrojtja dhe këqyrja e vendit të ngjarjes, doracak për studentë, Akademia Policore Vushtrri, 2002, Kosovë, faqe 7.

formular për kontaminimin e vendit të ngjarjes. Ky formular do të shërbente për të treguar kohën e arritjes, hyrjes dhe daljes së secilit person që ka hyrë në vendin e ngjarjes, duke përfshirë këtu emrin, kohën e hyrjes dhe daljes, arsyen e hyrjes. Në këtë mënyrë do të sigurojmë bazën për përcaktimin se kush ka mundur në ndonjë mënyrë ta dëmtojë vendin e ngjarjes dhe dëshmitë që gjenden aty.

Polici i parë në vendin e ngjarjes duhet gjithashtu ta përdorë edhe fletoren e tij të xhepit ose ndonjë fletore tjetër për t'i shënuar disa informata të rëndësishme, të cilat mund të jenë të shkurtra por me vlerë të madhe pasi që këto informata më vonë do të jenë të dobishme dhe përfituese për hetuesit dhe teknikët e vendit të ngjarjes. Këto informata duhet të përfshijnë datën, kohën dhe ndonjë ndodhi të pazakonshme që zhvillohet aty⁴¹.

Po ashtu, në këto informata të policit të parë, duhet të shënohen edhe kushtet atmosferike, të cilat mund të jenë faktor i rëndësishëm për rastin. Dihet se kushtet atmosferike: shiu, bora, era etj., mund t'i shkatërrojnë gjurmët dhe provat materiale, të cilat gjenden në atë vend të ngjarjes, gjithashtu edhe dukshmëria është një faktor mjaft me rëndësi, për të cilën më vonë mund të bëhen edhe pyetje lidhur me të. Polici që merr shënimet në vendin e ngjarjes duhet që të shënojë fjalë për fjalë të gjitha gjërat që ka parë dhe me kënd ka biseduar⁴².

Detyrë tjetër e policit të parë, që arrin në vendin e ngjarjes, është edhe ajo se ai duhet të shënojë në fletoren e tij edhe gjendjen e objekteve që gjenden aty. Nëse rasti ka ndodhur në një ambient të mbyllur, në një shtëpi, duhet të shënohen se si janë gjetur dritaret e asaj shtëpie, të mbyllura apo të hapura dhe prej cilës anë ose si mbyllen dhe hapen ato, si janë gjetur dyert, të mbyllura apo të hapura, nëse ka pasur çelës në to, ku ka qenë i vendosur jashtë apo brenda? Dritat kanë qenë të ndezura apo jo, nëse po, cila dritë ka qenë e ndezur? Pastaj, ndonjë mbetje e cigares dhe të shënohen sa prej tyre kanë qenë? Përshkrimi i ambientit brenda shtëpisë, e pastruar ose jo? Nuhatja është element mjaft me

⁴¹Po aty, faqe 7.

⁴²Vernon J. Geberth M.S.,M.P.S.,B.B.A.,FBINA, PRACTICAL HOMICIDE INVESTIGATIONS, Tactics,Procedures and Forensic Techniques, Fourth Edition, page 32,Published in 2006,CRC Press, New-York, Suite 300, USA.

rëndësi; çka po nuhatni, sidomos tek rastet e zjarr vënies, kur gjendet gëzhoja e armës së zjarrit apo edhe vet arma, por pa dëmtuar gjurmët papilare e biologjike që mund të jenë në to si dhe pa ndryshuar pozicionin e tyre. Po ashtu edhe indikatorët e tjerë siç janë nxehtësit e ndryshme a janë të nxehta apo jo, së bashku me temperaturën e dhomës.

Gjithmonë me kujdes të duhur polici i parë duhet t'i kontrollojë të gjitha këto vende por pa prekur asgjë me dorë, duke përjashtuar mundësinë e lënies së gjurmëve të gishtërinjve nëpër ato objekte.

Nëse polici i parë ka në dispozicion kohën, para se të arrijnë hetuesit dhe ekspertët e kriminalistikës dhe posedon aparatin për fotografim, ai mund t'i bëjë ato, duke pasur gjithashtu kujdes që gjatë fotografimit të mos i dëmtojë gjurmët dhe provat materiale që gjenden aty.

Nga një kënd i veçantë, ku mund t'i fotografojë të gjithë njerëzit që janë prezent, duhet të bëhen fotografi, që më vonë në rast se kërkohet të përcaktohet se kush ishte prezent aty në atë kohë, ai do ta ketë atë. Njerëzit që janë afër ndonjëherë mund t'i marrin me vete provat me ose pa qëllim dhe më vonë mund të mos tregojnë të vërtetën se a ishin aty ose jo në atë kohë. Objektet që duhet fotografuar, nëse polici i parë ka aparatin, janë edhe automjetet e parkuara afër vendit të ngjarjes. Poashtu automjetet mund të marrin me vete gjurmët dhe provat materiale që gjenden aty.

Për t'i ikur çfarëdo shtrebmërimi të deklaratave që do t'i japin më vonë, lidhur me prezencën e tyre në atë vend ose jo, duhet të fotografohen edhe viktimat dhe dëshmitarët. Shpesh herë viktimat duan që objektet e çrregulluara t'i vendosin dhe t'i kthejnë në vendin e vet, para se aty të vijnë policët. Jo në të gjitha rastet viktimat janë persona të vdekur apo të plagosur, viktimë mund të jetë edhe pronari i një lokali apo shtëpie e cila është thyer nga autorët e veprave penale.

Pronarët e dyqaneve të ndryshme nganjëherë fillojnë t'i pastrojnë dhe rregullojnë ato duke mos pasur kujdes ndaj gjurmëve, të cilat nuk duken fare siç janë gjurmët e gishtërinjve, nganjëherë pa dashje shkatërrojnë ato dhe kështu bëhen subjekt i daktiloskopimit nga ana e policisë për t'i eliminuar gjurmët e tyre të gishtërinjve.

Derisa polici i parë, i cili bën sigurimin e vendit të ngjarjes, bën të gjitha këto punë, aty do të vijnë edhe policët tjerë dhe së bashku ata do të fillojnë me punët tjera derisa aty të arrijë ekipi i ekspertëve të kriminalistikës dhe hetuesit. Punë tjetër me rëndësi për policët që kanë arritur aty është se ata duhet menjëherë të fillojnë të shpërndajnë turmat, që eventualisht mblidhen aty afër vendit të ngjarjes. Gjatë shpërndarjes së këtyre turmave policët duhet pasur kujdes të mos i largojnë dëshmitarët nga vendi i ngjarjes, por vetëm personat e panevojshëm⁴³.

Duhet të përcaktohet kufiri i vendit të ngjarjes, duke vendosur kështu perimetrin e vendit të ngjarjes.

Detyrë tjetër e policit të parë, në vend ngjarjes, është edhe parandalimi i pasojave të tjera të ngjarjes siç mund të jenë p.sh.: shpëtimi i jetës së njerëzve në një rast zjarri, fundosje në ujë, ndalimi i një vrasjeje tjetër kur të afërmit e viktimës (kufomës) e dinë autorin e vrasjes dhe mund të hakmerren kundër tij apo të afërmeve të tij.

2.11 Perimetri i përgjithshëm i vendit të ngjarjes

Perimetri i vendit të ngjarjes është gjithnjë ai terren, që përfshin atë sipërfaqe tokësore apo ujore, ku mund të gjenden prova të plota apo të pjesshme, gjurmë apo shenja që kanë lidhje me ngjarjen, krimin apo autorët e saj.

Perimetri i vendit të ngjarjes ndahet në:

2.11.1 Perimetri i brendshëm

Zona nga kufiri i vendit të ngjarjes, në drejtim të pikës qendrore; zona e cila është rrethuar me shirit. ose me ndonjë mjet tjetër. Varësisht nga konfiguracioni i terrenit të vendit të ngjarjes, ky perimetër mund të zgjerohet me arritjen e ekipeve të këqyrjes së vendit të ngjarjes.

⁴³ Mbrojtja dhe këqyrja e vendit të ngjarjes, doracak për studentë, Akademia PolicoreVushtrri, 2002, Kosovë, faqe 6.

2.11.2 Perimetri i jashtëm

Zona e cila fillon nga kufirit i vendit të ngjarjes dhe vazhdon më tej. Kjo zonë ka pak gjasa të jetë e përfshirë në rastin që ka ndodhur, mirëpo duke pasur parasysh rrugën që autori ka bërë deri në vendin e ngjarjes, kjo zonë është mjaft e rëndësishme përpos të tjerash edhe për të pyetur dëshmitarët, lidhur me ngjarjen.

Ky është një vend ku mund të mblidhen mediat, njerëzit e ndryshëm dhe në këtë vend mund të vendoset qendra komanduese.

2.12 Qendra komanduese

Vendosja e qendrës komanduese ka rëndësinë e vet, kur kemi parasysh se këqyrja e vendit të ngjarjes ndonjëherë mund të jetë e komplikuar dhe nevojitet kohë për ta bërë atë. Qendra komanduese do të ndihmonte punën e ekspertëve të kriminalistikës, duke ju ofruar atyre ndihmë në shumë aspekte. Në këtë qendër do të vendosen udhëheqësit, të cilët do të udhëheqin punën e të gjithë atyre që punojnë brenda vendit të ngjarjes, duke ju ofruar ndihmë në koordinimin e punëve me organizatat dhe agjencitë tjera siç janë: zjarrfikësit, personeli mjekësor, patologu, sigurimi i pajisjeve shtesë⁴⁴etj. Mediat vendosen afër kësaj qendre dhe zyrtari për informim, i cili është pjesë e qendrës komanduese i informon ata në vazhdimësi.

2.13 Hyrja në vendin e ngjarjes

Ekipi i cili është caktuar të punojë në atë vend ngjarje dhe arrin aty, së pari duhet të kontaktojë me policin e parë që ka bërë sigurimin e vendit të ngjarjes dhe t'i bëjë atij disa pyetje lidhur me atë se çka ka parë ai në momentin kur ka arritur në atë vend. Para se të pyesë nëse dikush ka hyrë brenda vendit të ngjarjes, duke përfshirë këtu edhe policët, ta vëzhgojë atë vend nga një pozicion jashtë perimetrit të brendshëm dhe pastaj të vendosë për veprimet e më tutjeshme, duke mos nxituar për të hyrë brenda vendit të ngjarjes.

⁴⁴Mbrojtja dhe këqyrja e vendit të ngjarjes, doracak për studentë, Akademia Policore, Vushtrri, Kosovë, gusht 2002, faqe 6.

Hyrja në vendin e ngjarjes, për personat që nuk kanë punë aty, është e panevojshme dhe nganjëherë mund të shkaktojë edhe dëme në procesin e punës dhe të arritjes së rezultateve të dëshiruara nga ana e ekspertëve të kriminalistikës dhe hetuesve. Për secilin polic që kërkohet të hyjë në vendin e ngjarjes, ai duhet të jetë i kujdesshëm dhe t'i përmbahet disa rregullave që kërkohen gjatë hyrjes në atë vend.

Edhe nga ekspertët e kriminalistikës dhe hetuesit kërkohet një kujdes mjaft i madh kur ata hyjnë në vendin e ngjarjes. Secili ekspert i kriminalistikës, që hyn në vendin e ngjarjes, duhet së pari ta dijë dhe të jetë i sigurt se e din kufirin e vendit të ngjarjes, gjithashtu duhet të përmbahet nga lëvizjet e nxituara, ai duhet të jetë i qetë dhe i saktë në veprimet e tij.

Nëse polici i parë, që ka bërë sigurimin e vendit të ngjarjes, nuk e ka zgjedhur pikën hyrëse atëherë duhet të zgjidhet një pikë hyrëse dhe të kërkohet nga të gjithë të hyjnë nëpër këtë pikë. Kjo pikë hyrëse nuk duhet të jetë pika të cilën edhe autori e ka shfrytëzuar për hyrje. Zgjedhja e mirë e kësaj pike do të zvogëlonte mundësinë e prishjes së gjurmëve dhe provave materiale që gjenden në atë vend. Ata që hyjnë në vendin e ngjarjes duhet ta dinë për gjërat që nuk duken, gjërat që nuk i shohin, gjërat që nuk i dëgjojnë, nuhatin. Në vendin e ngjarjes autori mund të lërë edhe erën, aromën e trupit të tij, e cila është një gjurmë ose provë shumë e rëndësishme përmes së cilës ai mund të zbulohet dhe identifikohet duke përdorur qenin gjurmues ose metodën e gazkromatografisë dhe spektrometrisë së masës⁴⁵. Sistemi gazkromatograf – spektrometër mase (model GCMS-QP.1000) shërben për dy qëllime: për identifikimin e komponentëve të përzierjeve komplekse të lëndëve organike, që mund të kalojnë në gjendje të gaztë, pa u shpërbërë dhe për matjen e masës molekulare të tyre (më të vogël se 1000 Dalton)⁴⁶.

⁴⁵ Prof. ass. dr. Luan VELIÇOTI, "Tribunë Juridike" Tiranë, nr. 82, 2010.

⁴⁶ Prof. dr. Skënder Begeja, Kriminalistika, vëllimi II, 2011, Tiranë, faqe 63.

2.14 Masat Mbrojtëse

Disa vendngjarje paraqesin rrezik serioz për shëndetin e ekspertëve, sepse në varësi nga lloji i krimit, ata mund të ekspozohen nga rreziqet e ndryshme siç janë: helmet kimiko - biologjike, lëndët djegëse, lëndët shpërthyes. Poashtu, duhet t'i kushtohet vëmendje edhe viktimave, të cilat mund të jenë të infektuara nga sëmundje të ndryshme ngjitëse dhe kontakti me këto viktimë dhe lëngjet e tyre fiziologjike si : gjaku, sperma, urina, djersa etj., paraqet rrezik serioz për shëndetin.

Gjithashtu, masat mbrojtëse vendosen edhe për t'iu shmangur kontaminimit të provave që gjenden në vendngjarje.

Që masat mbrojtëse të jenë sa më të sigurta, përdoren këto pajisje: doreza plastike të ndryshme, maska mbrojtëse, syzet, helmeta, rroba të veçanta mbrojtëse, mbështjellës plastikë të këpucëve, çizmet etj.



Fig.1 Pajisjet për masat mbrojtëse

KAPITULLI III

PËRMBLEDHJE E KAPITULLIT III

Kapitulli i tretë do të trajtojë procesin e këqyrjes dhe mbledhjes së provave në vendin e ngjarjes. Procesi i këqyrjes është mjaft i ndërlikuar dhe kërkon një staf të përgatitur dhe të trajnuar mirë. Këtu do të flasim për qëllimin e këqyrjes, pra cili është qëllimi i këqyrjes që organi procedues e zhvillon atë. Gjithashtu në këtë kapitull do të flasim edhe për teknikat e këqyrjes, duke i përmendur të gjitha me rend. Vend të veçantë në këtë kapitull dhe në tërë punimin, kur është fjala për teknikat e këqyrjes zë edhe fakti se këtu është paraqitur mendimi personal i autorit lidhur me teknikën e këqyrjes tek metoda spirale. Për këtë metodë autorët e ndryshëm janë të ndarë në mendime sa i përket çështjes se ku duhet të filloj kontrollimi kur aplikohet metoda spirale. Duke respektuar gjithnjë mendimin ndryshe, duke u nisur nga eksperiencia ime në terren, unë kam konstatuar se fillimi i kontrollimit tek kjo metodë, duhet të jetë nga qendra në drejtim të periferisë së kufirit të vendit të ngjarjes.

Gjithashtu vend të veçantë në këtë kapitull ka zënë edhe mbledhja dhe shënimi i provave. Duke ditur se provat janë një fakt i pakontestueshëm në procesin e hetimit të vendit të ngjarjes, atëherë në këtë punim ato zënë një vend mjaft të rëndësishëm. Mbledhja e provave është njeri nga hapat kryesor që ekipi i këqyrjes e zhvillon në vendin e ngjarjes. Andaj këtu përshkruhet detajisht se si bëhet kërkimi, fiksimi dhe mbledhja e tyre. Provat që gjenden në vendin e ngjarjes duhet vlerësuar dhe çmuar mjaft, sepse ato janë zëri i viktimës. Në fund të këtij kapitulli flitet për krijimin e procesverbalit të provave dhe ruajtja e tyre. Krijimi i procesverbalit është një hap shumë i rëndësishëm gjatë dokumentimit të vendit të ngjarjes. Shënimi në atë procesverbal i gjithë veprimeve që ekipi i këqyrjes i zhvillon në atë vend, është njëdetyrë që grupi hetimor duhet ta bëjë, sepse me vonë gjatë fazave të ndryshme të hetimeve, këto shënime do të luajnë një rol të madh.

Në fund të këtij kapitulli flitet për ruajtjen e provave, veprim ky i cili është mjaft i rëndësishëm për dokumentimin e gjithë procesit të punës së grupit hetimor. Ruajtja e provave është e rëndësishme sepse gjatë procedurës së mëtutjeshme ato duhet të

ekzaminohen dhe të prezantohen në gjykatë. Një kujdes i shtuar për to, paraqet jo vetëm një profesionalizëm, por edhe një lehtësim gjatë procesit të testimit në gjyq.

3. PROCESI I KËQYRJES DHE MBLEDHJES SË GJURMËVE DHE PROVAVE MATERIALE NË VENDIN E NGJARJES

Sikurse krimet që janë të ndryshme, për nga mënyra dhe forma e kryerjes, ashtu edhe vendet e ngjarjes janë të ndryshme.

Me anë të këqyrjes gjurmojmë prej të tanishmes kah e kaluara, prej pasojave kah e panjohura dhe shpesh nga shkaktari enigmatik. Pa këqyrje nuk do të merrnim njohuri për faktet dhe natyrisht nuk do të nxjerrim konkluzione e nevojshme⁴⁷. Një qasje e duhur, sa i përket këqyrjes, do të ndihmonte në arritjen e qëllimit të saj.

Radha e veprimeve në këqyrjen e vendit të ngjarjes dhe teknika e realizimit të tyre varen shumë nga karakteri i saj, nga veçoritë që paraqet çdo rast dhe nga situata konkrete në të cilën e gjen vendin e ngjarjes njësia e këqyrjes⁴⁸.

Elementet themelore të këqyrjes janë:

Vrojtimi i subjekteve dhe operimet logjike; kërkimi dhe studimi i drejtpërdrejtë i gjurmëve materiale; veprimi procedural me theksin kriminalistik; ngritja e versioneve të veçanta mbi ngjarjen; këqyrja e vendit të ngjarjes është model ideal informativ - logjik i krimit; këqyrja e vendit të ngjarjes duhet të ketë karakter hulumtues⁴⁹.

⁴⁷ Vllado Vodinelic, Kriminalistika, Prishtinë, 1972, faqe 182.

⁴⁸ Dr. sc. Estref MYFTAI, mr. sc. Fitim SHISHANI, Hysen KOTRI, Kriminalistika, Prishtinë, 2010, faqe 100.

⁴⁹ Dr. Vesel Latifi, Kriminalistika - Zbulimi dhe të provuarit e krimit, Prishtinë, 2009, faqe 171.

3.1 Qëllimi i këqyrjes në vendin e ngjarjes

Qëllimi i këqyrjes së vendit të ngjarjes është gjetja, zbulimi dhe fiksimi i të gjitha gjurmëve dhe provave materiale që gjenden në atë vend, të cilat më vonë do të ndihmojnë në:

- Përcaktimin e fakteve.
- Përcaktimin e mekanizmit të formimit të gjurmëve e provave materiale si dhe mekanizmin e gjithë ngjarjes.
- Identifikimin e autorit të mundshëm dhe ndihma në kapjen ose arrestimin e tij.
- Përcaktimin e rrethanave negative⁵⁰.
- Përcaktimin e metodës së përdorur nga autori.

Qëllimi i këqyrjes së vendit të ngjarjes është që të evidentohen provat materiale të kryerjes së veprës penale, të gjenden provat të tjera dhe të zbulohen gjurmët e veprës duke i fiksuar ato me mënyrat e përcaktuara sipas rregullave procedurale⁵¹. Eksperti i kriminalistikës, para se të fillojë këqyrjen, duhet të sigurohet se e di vendin ose zonën ku ka për të bërë këqyrjen ose bastisjen. Në këtë mënyrë ai do të dijë se çfarë ndihme do t'i duhet atij në vazhdim. Një shikim vizual i tërë hapësirës ku ka ndodhur ngjarja, nëse mund të shihet, do të ndihmonte në këqyrjen e vendit të ngjarjes. Asgjë nuk duhet prekur para se të bëhet përshtkrimi, skicimi dhe fotografimi i dëshmive.

Faza statike e këqyrjes fikson të gjitha gjurmët që gjenden aty, duke u vendosur në një pozicion të vendit të ngjarjes dhe nga aty vështrohen të gjitha gjurmët dhe provat materiale, ku më pas në **fazën dinamike** ato procedohen, nëse ka mundësi, zhvendosen për t'u shikuar në të gjitha anët. Këto dy faza nuk mund të anashkalohen, të ndahen apo të bëhen njëra pa tjetrën. Secila gjurmë ose provë materiale që gjendet aty së pari fiksohet në gjendjen fillestare, ashtu siç e ka lënë autori, pastaj merren hapa të tjerë siç janë: fotografia, matja,

⁵⁰Nocioni “rrethanë negative” trajtohet në literaturën kriminalistike si një fakt që bie në kundërshtim me përfytyrimin real mbi mënyrën se si ka ndodhur ngjarja, duke vlerësuar gjurmët e provat materiale, veprimet e pjesëmarrësve në ngjarje dhe faktet tjera. Ajo është rezultat i krahasimit të një fakti me të dhënat e tjera faktike dhe evidencimi i mospërputhjes, i kundërtëhënies së këtij fakti me këto të dhëna. (shih dr. Vesel Latifi, Kriminalistika - Zbulimi dhe të provuarit e krimit, Prishtinë, 2009, faqe 175, cituar nga Prof.dr. Skender Begeja, Kriminalistika, Tiranë, 1997, faqe 321).

⁵¹Prof.asc. Ilir Mandro, “Këqyrja e vendit të ngjarjes në vrasjet me armë zjarri”, Ilir 2002, Tiranë, faqe 18.

këqyrja me kujdes dhe nëse arrihet ndonjë rezultat ose nëse shohim se mund të nxjerrim ndonjë gjurmë prej saj, e marrim atë për ekzaminime të mëtutjeshme, pastaj kalohet në dëshminë tjetër e kështu më radhë. Në asnjë mënyrë nuk duhet bërë këqyrjen vetëm sa për ta përfunduar atë, por ajo duhet të bëhet ngadalë, një herë në mënyrë vizuale, pastaj të merren gjurmët dhe provat materiale, me mjete teknike dhe laboratorike të shikohen, nëse nuk kemi mundur t'i ekzaminojmë aty për aty, në vendin e ngjarjes. Nëse këqyrja bëhet e atillë ku të gjitha dëshmitë janë marrë e paketuara me kujdes, në përfundim do të nxjerrim versionin e qëndrueshëm, i cili do të ndihmojë rastin.

Ndërsa, nëse gjurmët dhe provat materiale ndahen në të “ rëndësishme ” dhe të “parëndësishme” dhe këqyrja koncentrohet vetëm në qendër ose në hyrje daljet e vendit të ngjarjes, besueshmëria e versionit që do ta japim më vonë, në lidhje me atë rast do të jetë e vogël. Nuk duhet harruar se gjatë këqyrjes çdo version është i mundur dhe gjithçka që gjendet në vendin e ngjarjes duhet të llogaritet si gjurmë, provë materiale, dëshmi etj., derisa nuk vërtetohet e kundërta. Nuk është e preferuar nëse me të arritur në vendin e ngjarjes, nxitohet duke e krijuar bindjen e menjëhershme në lidhje me atë se si ka ndodhur ngjarja, pra të ngritet një version i cili duket të jetë i mundshëm dhe të fillohet të punohet vetëm në atë drejtim, për t'i lënë anash mundësitë tjera. Në këtë rast merren vetëm ato gjurmë dhe prova materiale që kanë lidhje me atë version dhe të tjerat lihen anash ose nuk merren fare. Një veprim i tillë do të na dërgojë në përfundim, i cili mund të jetë i ngutshëm dhe si rezultat i kësaj të na dështojë edhe i tërë rasti.

Duke pasur parasysh rrethanat dhe mekanizmat, mbi të cilat është kryer apo ka ndodhur ngjarja, gjatë këqyrjes duhet kërkuar edhe për gjurmët dhe provat materiale, të cilat gjenden nëpër ato zona që shtrihen afër vendit ku jemi duke kërkuar. Rruga nëpër të cilën autori ka ecur gjatë hyrjes dhe daljes nga ai vend, është gjithashtu një vend ku duhet kontrolluar me kujdes të veçantë, sepse edhe aty mund të ketë gjurmë dhe prova materiale, të cilat mund t'i kenë rënë nga dora apo mund t'i ketë fshehur vetë siç janë: mjetet e ndryshme në rastet e vjedhjeve, gjurmët e gomave, këpucëve, mbetjet e cigareve, ndonjë send ushqimi etj. Gjithashtu rëndësi duhet t'u kushtohet edhe atyre gjurmëve të cilat "duhet" të ishin aty p.sh.: gëzhhojat, në rast të gjuajtjes me armë, (ku autori mund t'i ketë

marrëme vete ato), gjurmët e gishtërinjve, *(ku autori mund të ketë pasur dorëza)* etj. Nuk është e caktuar koha dhe orari se kur duhet bërë këqyrja. Ajo bëhet në çdo kohë, ditën ose natën dhe mund të zgjasë me orë të tëra. Nëse këqyrja bëhet natën, duhet të krijohen kushtet e ndriçimit dhe ajo mund të bëhet; nëse nuk ka kushte të mjaftueshme dhe rrethanat na e lejojnë një gjë të tillë, këqyrja mund të shtyhet deri të nesërmen dhe pastaj vazhdohet me të. Fillimi sa më i shpejtë i këqyrjes zvogëlon mundësinë e prishjes së gjurmëve dhe provave materiale dhe në këtë rast nuk duhet harruar kushtet atmosferike siç janë: shiu, bora, erërat e ndryshme të cilat ndikojnë në prishjen apo shkatërrimin e gjurmëve dhe provave materiale.

Në shumicën e rasteve këqyrja e vendit të ngjarjes duhet të fillojë nga qendra në drejtim të periferisë, por këqyrja mund të bëhet edhe nga periferia në drejtim të qendrës, në rastet kur dihet saktësisht kufiri i vendit të ngjarjes.

Këqyrja nga qendra në drejtim të periferisë, na mundëson që objektet kryesore që kanë të bëjnë me rastin (siç është rasti me viktimat, dhe ky vend duhet të llogaritet qendër e vendit të ngjarjes), të ekzaminohen dhe kontrollohen sa më parë. Ekziston edhe një fakt tjetër se pse këqyrja duhet të fillojë nga qendra në periferi. Në asnjë rast nuk dihet se ku mund të gjenden gjurmët ose provat materiale, që lidhen me rastin dhe në këtë mënyrë duke zgjeruar këqyrjen nga qendra në periferi edhe nëse hasim në ato dëshmi, diku në periferinë e atij vendi, kufirin e atij vendi do ta zgjerojmë dhe në këtë mënyrë gjurmët dhe provat materiale që i kemi gjetur i fusim brenda atij kufiri. Nga praktika kemi mësuar se perimetri i vendit të ngjarjes nganjëherë mund të jetë edhe me kilometra i madh. Dhe, nëse hasim në këso vende të ngjarjes me hapësirë të madhe, mund të imagjinohet se çfarë efekti apo çfarë rezultati do të ketë këqyrja nga periferia në qendër⁵².

Mirëpo, nëse perimetri i vendit të ngjarjes është më i vogël, atëherë mund të fillojmë me këqyrjen nga periferia në qendër dhe kjo do të thotë lëvizja nga një pikë e caktuar në drejtim të qendrës duke i lidhur gjurmët dhe provat materiale njëën me tjetrën deri tek objekti kryesor. Kjo mënyrë e këqyrjes do të funksiononte mirë në rastet e

⁵²Intervistë (bisedë) me prof. dr. Luan VELIÇOTI, Tiranë, maj 2011.

vetëvrasjeve, kur perimetri nuk është edhe aq i madh dhe se vendi i ngjarjes është një mjedis i mbyllur si: banesa, hoteli a vendi i punës.

3.2 Teknikat e këqyrjes së vendit të ngjarjes

Mund të themi se ekzistojnë pesë metoda të këqyrjes, të cilat mund të zbatohen nga ekspertët e vendit të ngjarjes, dhe duke u bazuar në atë se çfarë vendi kemi për të proceduar, aplikohet metoda përkatëse e cila do të funksionojë më së miri. Pra, kemi metodën spirale, metodën rrethore, metodën e zonës, metodën rrjetore dhe metodën brezore.

3.2.1 Metoda spirale

Kjo metodë mund të zbatohet dhe është e përshtatshme zakonisht në vendet e ngjarjes me hapësira të mbyllura, por edhe jashtë mund të përdoret, varësisht prej konfiguracionit dhe terrenit të vendit të ngjarjes. Në këtë metodë kontrollimi fillohet nga qendra, duke u zgjeruar në drejtim të perimetrit të jashtëm të vendit të ngjarjes.




Fig.2. Metoda spirale

Autorët e ndryshëm ndahen në pikëpamje se nga ku duhet të fillojë këqyrja. Literatura i ofron të dyja opsionet. Disa autorë thonë se kontrollimi duhet të fillojë nga jashtë, në drejtim të qendrës, duke i ruajtur gjurmët dhe provat materiale. Por, kur kihet parasysh profesionalizmi i ekspertëve, pra fakti se ata duhet qenë profesionalistë të vërtetë, gjurmët

dhe provat materiale nuk duhet të kontaminohen apo të shkatërrohen nga vetë ekspertët e vendit të ngjarjes, atëherë mund të themi se këqyrja mund të fillojë nga qendra.

Nga puna praktike që kam bërë në këqyrjen e vendit të ngjarjes, mund të them se kjo metodë funksionon më mirë nëse fillohet nga qendra në periferi. E gjithë kjo mbështetet në faktin se ekipi i këqyrjes, e din tashmë se ku ndodhet qendra e vendit të ngjarjes dhe fillon kërkimin e gjurmëve dhe provave materiale nga aty, ndërsa kufiri i perimetrit të jashtëm mund të zgjerohet varësisht se çfarë gjurmë dhe prova materiale janë gjetur deri aty. Nëse ekspertët e vendit të ngjarjes e vlerësojnë se mund të ketë prova që kanë lidhje me ato që janë gjetur deri tani, atëherë ky perimetër mund edhe të zgjerohet. Perimetri i jashtëm mund të zgjerohet edhe për faktin se jashtë tij qëndrojnë; qytetarët, mediat etj., të cilat mund ta përcjellin, filmojnë, fotografojnë punën e ekipeve brenda shiritit, e që jo në të gjitha rastet kjo është e lejuar. Kjo mund të jetë pengesë për punën e këtyre ekipeve gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Gjatë punës sime në praktikë, nga të gjitha rastet që kam pasur, kur kam përdorur këtë metodë, në këtë mënyrë siç u cek më lartë, më është dukur më funksionale dhe më e përshtatshme, gjithmonë duke respektuar dhe vlerësuar edhe mendimin e kundërt lidhur me këtë.

3.2.2 Metoda rrethore

Kjo metodë përdoret si në vendet e ngjarjes, në mjedise të mbyllura ashtu edhe në ato të hapura. Kontrollimi bëhet ashtu që ekspertët e vendit të ngjarjes futen brenda tij dhe vendin e ngjarjes e ndajnë në formë rrethore, pastaj rrethin e ndajnë në të ashtuquajturën “prerja e pites” dhe pas kësaj ndarjeje fillohet me kontrollim e secilës pjesë. Varësisht nga madhësia e vendit të ngjarjes, këto pjesë ndahen në katër ose gjashtë prej tyre.




Fig. 3 Metoda rrethore

3.2.3 Metoda e zonës

Kjo metodë është e përshtatshme në vendet e ngjarjes me perimetër të madh. Në këtë mënyrë vendi i ngjarjes ndahet në zona ose sektorë, ku pastaj secili sektor mund të kontrollohet veç e veç. Në këta sektorë pastaj mund të përdoret secila metodë e zgjedhur nga vetë eksperti i vendit të ngjarjes: spirale, rrethore, rrjetore etj.




Fig. 4 Metoda e zonës

3.2.4 Metoda rrjetore

Kjo metodë është e përshtatshme për kontrollimin e vendit të ngjarjes jashtë dhe me hapësirë të madhe. Në këtë metodë ekspertët kontrollojnë një herë nga një drejtim prej njëres anë në anën tjetër, pastaj ndërrojnë drejtimin dhe anën duke kontrolluar. Në këtë mënyrë e kryqëzojnë rrugën e tyre të kontrollimit dhe mund të themi se nuk mbetet pothuajse asnjë hapësirë e vetme e vendit të ngjarjes pa u kontrolluar, edhe atë prej dy anëve ose këndeve të ndryshme.

Eksperienca ime në këqyrjen e vendit të ngjarjes tek rastet e vrasjeve, tregon se kjo metodë ka rezultuar të jetë më e mirë, për arsye se vendi i ngjarjes kontrollohet dy herë; herën e parë nga një anë dhe herën e dytë nga një anë tjetër. Edhe pse ekipet e ndryshme parapëlqejnë edhe metodat tjera që u përmendën më lartë, nga përvoja ime, mund të them se kjo është njëra ndër metodat më të mira të këqyrjes së vendit të ngjarjes.




Fig. 5 Metoda rrjetore

3.2.5 Metoda brezore

Me këtë metodë ekspertët që kërkojnë gjurmët dhe provat materiale shkon nga njëra anë në tjetrën, pastaj vazhdon dhe kthehet në anën e kundërt, përsëri deri në fund, duke bërë atë në formë të brezit.




Fig. 5 Metoda brezore

3.3 MBLEDHJA DHE SHËNIMI I GJURMËVE DHE PROVAVE MATERIALE

3.4 Nocioni provë

Prova janë njoftimet mbi faktet e rrethanat që lidhen me veprën penale, që merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij⁵³. Nëse paraqiten fakte dhe rrethana që na lidhen me veprën penale, apo burime që parashikon ligji procedural vërtetojnë se është kryer ose jo një vepër e caktuar penale dhe të gjitha këto janë siguruar në mënyrë ligjore janë prova.

Sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, në Kapitullin e XVI lidhur me provat thuhet:

PROVAT

Neni 257

Rregullat e përgjithshme për prova

1. Rregullat e provës të parapara në këtë nen zbatohen në të gjitha procedurat penale para gjykatës dhe, në rastet kur e parasheh ky Kod, ato gjithashtu zbatohen në procedurat para prokurorit të shtetit dhe policisë
2. Provat e marra me shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të papranueshme kur ky Kod ose dispozita të tjera të ligjit shprehimisht parashikojnë kështu
3. Gjykata nuk mund ta mbështesë vendimin e saj në prova të papranueshme
4. Gjatë çdo intervistimi ose marrjeje në pyetje ndaloheq që:

⁵³Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë. - TITULLI IV, PROVAT, KREU I, RREGULLA TË PËRGJITHSHME, Neni 149, Kuptimi i provës. Tiranë: Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, 2011, faqe 42, ISBN 978-9928-01-021-6

- 4.1. Liria e të pandehurit për të formuluar dhe shprehur mendimin e tij të ndikohet nëpërmjet keqtrajtimit, lodhjes së shkaktuar, ndërhyrjes fizike, përdorimit të drogës, torturës, shtrëngimit ose hipnotizimit
- 4.2. I pandehuri të kanoset me masa të ndaluara me ligj
- 4.3. Të premtohet ndonjë përfitim që nuk parashihet me ligj; dhe
- 4.4. Të dobësohet kujtesa e të pandehurit ose aftësia e tij për të kuptuar
5. Ndalesa nga paragrafi 4. i këtij neni zbatohet pavarësisht nga pëlqimi i personit të intervistuar ose të marrë në pyetje
6. Kur intervistimi ose marrja në pyetje është zbatuar në kundërshtim me paragrafin 4. të këtij neni, procesverbali i intervistimit ose marrjes së tillë në pyetje është i papranueshëm

Neni 258

Provat dhe rendi në gjykatë

1. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues është përgjegjës për funksionimin e mirëfilltë të shqyrtimit gjyqësor, përfshirë marrjen e provave
2. Gjykata mund të ndalojë marrjen e provave nëse:
 - 2.1. marrja e provave të tilla për të plotësuar provat tjera është e panevojshme dhe e tepërt sepse çështja në fjalë është e njohur në vija të përgjithshme
 - 2.2. fakti që do të provohet është i parëndësishëm për vendimin apo është provuar
 - 2.3. prova është tërësisht e papërshtatshme, e pamundshme ose e paarritshme; ose
 - 2.4. kërkesa bëhet për të zvarritur procedurën
3. Gjykata mund të ndalojë marrjen e provës apo të përjashtojë provën

Neni 259

Provat qartazi të parëndësishme apo thelbësisht të pa mbështetshme janë të papranueshme

1. Cilado provë që nuk ka të bëjë me të provuarit e ndonjë elementi të veprës penale, dëmit të shkaktuar me vepër penale, mbrojtjes nga ndjekja apo ndonjë çështjeje tjetër të rëndësishme mund të çmohet si provë qartazi e parëndësishme dhe është provë e papranueshme.
2. Cilado provë që është thelbësisht e pa mbështetshme, siç përkufizohet në nenin 19, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.29 të këtij Kodi është provë e papranueshme.

Neni 260

Shqyrtimi i provave të pranueshme në shqyrtim kryesor

1. Pasi që gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues të ketë përjashtuar provat në pajtim me nenin 249 të këtij Kodi, ato prova mund të shqyrtohen nga gjykata vetëm gjatë rigjykimit nëse aktvendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues për të përjashtuar provat ndryshohet pas ankesës.
2. Prova mund të shqyrtohen nga gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues gjatë shqyrtimit kryesor nëse nuk është përjashtuar sipas nenit 249 apo nëse nuk është e papranueshme sipas nenit 259 të këtij Kodi.
3. Gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues apo anëtari i trupit gjykues, çmon besueshmërinë, rëndësinë dhe vlerën provuese të provës së pranuar nga paragrafi 2. i këtij neni.

Neni 261

Përdorimi i deklaratave të mëparshme në shqyrtim gjyqësor

1. Deklarimi i të pandehurit dhënë policisë ose prokurorit të shtetit mund të jetë provë e pranueshme në gjykatë vetëm kur është marrë në pajtim me dispozitat e nenit 73, paragrafi 1. nenit 131 ose nenit 132 dhe në pajtim me nenet 151 deri 155 të këtij Kodi. Deklaratat e tilla mund të përdoren për ta kundërshtuar deklarimin e të pandehurit në gjyq ose si provë e drejtpërdrejtë në pajtim me nenin 262 paragrafi 2. të këtij Kodi.
2. Marrja në pyetje në procedurë paraprake mund të përdoret si provë në pajtim me nenin 123 paragrafi 2. të këtij Kodi.
3. Deklarata në procedurë paraprake mund të përdoret si provë në pajtim me nenin 123, paragrafi 3. të këtij Kodi.
4. Mundësia hetuese e veçantë mund të përdoret si provë në pajtim me nenin 123, paragrafi 4. të këtij Kodi.

Neni 262

Provat për përcaktimin e fajësisë

1. Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo një prove tjetër e cila nuk mund të

kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale.

2. Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare deklaramit të dhënë nga i pandehuri në polici ose para prokurorit të shtetit.

3. Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare dëshmisë së dhënë nga një dëshmitar, identiteti i të cilit është i panjohur për mbrojtësin dhe të akuzuarin.

4. Gjykata nuk e shpall personin fajtor vetëm mbi bazën e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues.

Neni 263

Mbështetja e pohimit

1. Prokurori i shtetit i cili synon të mbështetet në deklaratat e mëparshme nga neni 261 ose deklaratat e siguruara nga neni 219 paragrafi 6. i këtij Kodi duhet të paraqesë mbështetjen e pohimit.

2. Mbështetja e pohimit përmban:

2.1. Përshkrimin e dëshmive, deklaratën apo provën tjetër në të cilën prokurori i shtetit synon të mbështetet e që do të ishte e kufizuar sipas nenit 262 të këtij Kodi;

2.2. Përshkrimin e shkurtë të dëshmisë, shkresës apo provës që vërteton të dhënat fajësuese nga provat e cekura në nën-paragrafin 2.1. të këtij paragrafi.

3. Mbështetja e pohimit paraqitet së bashku me aktakuzë dhe jo më vonë se deri në fillim të shqyrtimit gjyqësor⁵⁴.

Provë apo dëshmi është diçka që i dorëzohet gjykatës në mënyrë legale, si mjet për të vërtetuar fajësinë apo pafajësinë për ndonjë çështje të caktuar⁵⁵.

⁵⁴Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Ky Kod hyn në fuqi më 1 Janar 2013.

Kodi Nr. 04/ L-123, 13 dhjetor 2012, Shpallur me dekretin Nr.DL-057-2012, datë 21.12.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

⁵⁵Kursi Bazik i Teknikës Kriminalistike, “Dëshmitë Fizike”, Vushtri, 2002, faqe 15.

Me provë nënkuptojmë të dhënat faktike të cilat i përmban ligji sipas burimeve të parapara mbi provat apo bartësit e tyre (personat, shtazët, bimët, sendet, gjurmët) në bazë të të cilave, në procedurën e rregulluar me ligjet pozitive, organi kompetent konstaton praninë apo jo të veprës penale, formën e fajësisë së personit të caktuar dhe rrethanat e tjera të rëndësishme për nxjerrjen e vendimit meritor⁵⁶. Në kuptimin të gjerë të fjalës, prova mund të definohet edhe si fakt i konstatuar që shërben për definimin e fakteve tjera⁵⁷. Provat, si fakte, duhet të jenë në lidhje objektive me objektin e argumentimit. Si provë mund të figurojë jo vetëm fakti që paraqesin informatat, të cilat mundësojnë përfundimin për veprën penale dhe autorin e saj. Provat duhet të jenë relevante- objektive. Këto prova lindin me planifikim, parapërgatitje, ekzekutim, fshehje dhe shfrytëzim “të fryteve” të veprës penale në mënyrën që kanë ardhur në lidhje reciproke me vetëdijen e njeriut (dëshmitari, i fajësuar apo objektet).

Provën nuk e krijon organi procedural me veprimet e tij, por atë e shkakton vetëm kryerja e veprës penale në procesin e veprimit reciprok, lidhjes reciproke me bartësin e provës, me burimin e provës, sinjalin e informatës. Prova gjithmonë është në marrëdhënie sekondare ndaj veprës penale dhe kryerësit si autorë dhe elementit primar. Fjala është këtu për dallimin ndërmjet fakteve kontestuese (themaprobandi) dhe provës⁵⁸.

Provat materiale janë sende, që kanë shërbyer si mjete për realizimin e veprës penale, ose mbi të cilat gjenden gjurmët apo që kanë qenë objekt i veprimeve të të pandehurit, produkt i veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër, që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36, Kodit Penal i Republikës së Shqipërisë si dhe çdo send tjetër që mund të ndihmojë për sqarimin e rrethanave të çështjes⁵⁹.

⁵⁶ Prof. dr. sc. Dushko Modly, TEORITË BASHKËKOHORE KRIMINALISTIKE, Titulli i originalit: “SUVREMENE KRIMINALISTIČKE TEORIJE” Përktheu nga kroatishja: prof. Mustafë Reçica, SARAJEVË / Prishtinë, 15. 01. **2007**, FSK/S - 14/06, faqe 120.

⁵⁷ Po aty, faqe 120.

⁵⁸ Po aty, faqe 121.

⁵⁹ Gentian Trenova, Interpretime gjyqësore të Kodit të Procedurës Penale (ripunim), neni 187, “DITA 200”, Tiranë, 2009, faqe 220.

Sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, kërkesa e të pandehurit ose të dëmtuarit për marrjen apo ruajtjen e provave gjatë hetimit thuhet:

PROVAT GJATË HETIMIT

Kërkesa e të pandehurit ose të dëmtuarit për marrjen apo ruajtjen e provave

Neni 216

Kërkesa e të pandehurit për marrjen apo ruajtjen e provave

1. Gjatë hetimit, i pandehuri mund të kërkojë nga prokurori i shtetit marrjen e ndonjë prove konkrete.
2. Prokurori i shtetit merr provën apo dëshminë e tillë nëse është e rëndësishme për procedurën dhe:
 - 2.1. kur ekziston rrezik për humbjen e provës apo dëshmisë ose kur ka gjasa që të mos jetë e mundshme në shqyrtim gjyqësor;
 - 2.2. kur prova e tillë arsyeton lirimin e të pandehurit nga paraburgimi;
 - 2.3. kur ka gjasa të arsyeshme që prova apo dëshmia që kërkohet të merret të jetë shfajësuese; ose
 - 2.4. kur ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për marrjen e provës apo dëshmisë së tillë.
3. Nëse i pandehuri ose mbrojtësi i tij kërkon nga prokurori i shtetit që të merr prova të caktuara të cilat gjenden jashtë Kosovës, prokurori i shtetit mund të mbledh provat e tilla në pajtim me nenin 219 të këtij Kodi.
4. Nëse prokurori i shtetit refuzon kërkesën për marrjen e provës, ai merr aktvendim të arsyetuar dhe njofton të pandehurin. I pandehuri mund të ankohet te gjyqtari i procedurës paraprake ndaj aktvendimit të tillë.

3.5 Mbledhja e gjurmëve dhe provave materiale

Gjurmët dhe provat materiale duhen kërkuar në disa vende dhe tek disa persona si më poshtë:

a. vendi i ngjarjes – vendi ku më së shumti hasim në gjurmë dhe prova materiale. Meqë ngjarja ka ndodhur tashmë, atëherë në vendin e ngjarjes kemi gjurmë dhe prova materiale që lidhen me atë rast apo ngjarje. Duhet një qasje profesionale nga ekipi i cili zhvillon këqyrjen, në kërkimin, fiksimin dhe marrjen e këtyre gjurmëve dhe provave materiale.

b. viktima – edhe tek viktimat kemi gjurmë dhe prova materiale, të cilat lidhen me rastin. Pavarësisht se për çfarë rasti bëhet fjalë, dëshmitë, gjurmët apo provat materiale të viktimës, i hasim pothuajse gjithmonë. Në rastet e vrasjeve, gjurmët që mund të hasim tek viktimat janë: plagët e shkaktuara nga arma, lëndime trupore të dukshme (në rast përleshje apo rrahje) etj.

c. i dyshuari dhe rrethi i tij - i dyshuari është gjithashtu burim potencial i dëshmive, gjurmëve dhe provave materiale. Edhe këtu, varësisht prej rastit, mund të hasim në prova nga më të ndryshmet. Me rrethin e të dyshuarit kuptojmë vendin ku i dyshuari ka lënë (fshehur) sendet apo vendin që ka përdorur pas kryerjes së veprës penale, qoftë për të fshehur mjetet me të cilat ka kryer veprën, qoftë për të fshehur provat dhe dëshmitë e marra nga ai vend⁶⁰.

Gjatë këqyrjes duhet pasur kujdes që gjurmët dhe provat materiale që gjenden aty, duhet të mbliidhen duke përcaktuar përparësinë se cila gjurmë dhe provë materiale do të mbliidhet e para. Gjurmët që janë më të ndjeshme p.sh.: gjurmët e gishtërinjve, gjaku dhe lëngjet tjera duhet të kenë përparësi gjatë mbledhjes, por gjithmonë duke pasur kujdes dhe ruajtur edhe gjurmët dhe provat tjera materiale. Këto gjurmë dhe prova materiale kanë përparësi sepse këto edhe lehtë prishen. Kushtet atmosferike: shiu, bora, temperaturat e larta janë faktorë kryesorë që ndikojnë në prishjen apo kontaminimin e këtyre gjurmëve.

Pas fiksimit, fotografimit dhe matjes, këto gjurmë dhe prova materiale duhet të mbliidhen me kujdes të madh. Që të arrihet një vlerë e madhe e besueshmërisë ndaj këtyre provave, ekspertët e vendit të ngjarjes duhet të dijë të kujdesen se si të mbliidhen këto prova. Pra, eksperti duhet të dijë si t'i identifikojë, mbledhë, shënojë, etiketojë e mbajë këto

⁶⁰Kursi Bazik i Teknikës Kriminallistike, “Dëshmitë Fizike”, Vushtri, 2002, faqe 15.

prova në mënyrë që analizat ose ekzaminimet laboratorike, që do të pasojnë pastaj dhe prezantimi i tyre në gjyq, të jenë të vlefshme dhe të kenë besueshmëri të lartë⁶¹.

Që mbledhja e këtyre provave të bëhet në mënyrën më të mirë eksperti i vendit të ngjarjes duhet pasur kujdes në:

- *Vlerësimin e gjurmëve dhe provave materiale dhe*
- *Përshkrimin e tyre.*

3.6 Vlerësimi i gjurmëve dhe provave materiale

Pyetja që shpesh shtrohet nga ekspertët e vendit të ngjarjes është ajo se objekti i dyshuar, si gjurmë ose prove materiale, ka me të vërtetë lidhje me rastin në fjalë. Gjithashtu kërkohen dhe zbulohen gjurmë e prova materiale në objektet e vendet, ku nuk justifikohet prania e autorit të krimit veçse në rastin e kryerjes së veprës penale.

Çmuarja e provave është përcaktimi i vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre. Çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar. Gjykata i çmon provat sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi⁶².

Ekspertii i vendit të ngjarjes do ta caktojë këtë duke u nisur nga rrethanat dhe kushtet e vendit të ngjarjes, duke bërë vlerësimin e drejtë dhe profesional. Nëse arrihet përfundimi se objekti i caktuar është gjurmë ose provë materiale atëherë ai duhet shënuar në procesverbalin e provave dhe ajo provë duhet të merret në mënyrën e duhur. Kurrsesi nuk duhet nxituar me vlerësimin se kjo është apo jo gjurmë ose provë materiale, por ai vlerësim

⁶¹Criminal Investigations, Charles R. SWANSON, Neil C. CHAMELIN, Leonard TERRITO, 7th, ed. 2000, faqe 52.

⁶²Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë. - TITULLI IV, PROVAT, KREU I, RREGULLA TË PËRGJITHSHME, Neni 152, Çmuarja e provave, Tiranë: Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, 2011, faqe 42, ISBN 978-9928-01-021-6.

bëhet vetëm pas kontrollimit të sigurt dhe lidhjes së asaj gjurme apo prove materiale me rrethanat, kushtet dhe mundësitë që na lejohen në vendin e ngjarjes⁶³.

3.7 Përcaktimi i gjurmëve dhe provave materiale

Që gjurmët dhe provat materiale të mbledhura të dihen saktësisht se nga ku janë marrë dhe si janë mbledhur, eksperti i vendit të ngjarjes, duhet që këto gjurmë dhe prova materiale t'i identifikojë edhe më vonë. Që kjo të arrihet në mënyrën e duhur ai duhet që provat t'i shënojë dhe etiketojë në mënyrë që kur parashihet nevoja e tillë ai të jetë në gjendje t'i identifikojë ato. Këto shënime dhe etiketime duhet të vendosen nëpër prova, në paketimet e tyre etj., dhe të gjitha këto duhet të shënohen në procesverbal. Nëpër disa paketime të provave materiale p.sh.: nëpër paketimet e letrës kërkohen disa informata ku përveç të tjerave kërkohet edhe ku është gjetur, nga kush, kur etj., pastaj në kartën e vendosjes së gjurmëve latente ose të panjohura të gishtërinjve kërkohen informatat se ku është gjetur gjurma, kur, nga kush; madje kërkohet që në formë të vizatimit të paraqitet vendi se ku është gjetur ajo.

3.8 Shënimi i gjurmëve dhe provave materiale

Shënimi i gjurmëve dhe provave materiale bëhet në atë mënyrë që eksperti apo ekzaminuesi më vonë do të jetë në gjendje të dijë se ku e ka marrë gjurmën apo provën dhe atë ta prezantojë në momentin që nga ai kërkohet. Shënimet në provë vendosen në ato vende ku nuk prishen karakteristikat dhe gjurmët e padukshme që gjenden në atë provë. Këto shënime ose shenja vendosen në ato vende të objektit, sendit, mjetit etj., nëse është e mundur, apo në kutinë ose mbështjellësin, qoftë letër, qese plastike etj., dhe shënohen me shenja të cilat eksperti do t'i evidentojë në procesverbalin e tij. Preferohet ndonjë laps me maje metalike sepse ngjyra mund të fshihet ose humbet më vonë.

Këto prova duhet t'i kenë edhe etiketat e tyre dhe në këto etiketa duhet të shënohen data, koha, vendi ku është marrë ajo, emri i ekspertit që ka marrë atë, përshkrimi i shenjave

⁶³ Mbrojtja dhe këqyrja e vendit të ngjarjes, doracak për studentë, Akademia Policore, Vushtri, Kosovë, 2002, faqe 28.

dalluese apo emërtimet e tyre. Dhe çdo provë duhet të ketë shenjën e vet nga e njëjta provë tjetër për nga dukja që të dallohet dhe të mos bashkohet si një provë e vetme. Madje, ky shënim mund të bazohet edhe në numrat që janë vendosur fillimisht gjatë procedimit të vendit të ngjarjes. Shënimi me shumë qartësi dhe i plotë i gjurmëve dhe provave materiale është i rëndësishëm, gjithashtu për të evituar çdo dëmtim të tyre me dashje apo nga pakujdesia.



Fig. 7 Etiketat e provave

3.9 Krijimi i procesverbalit dhe ruajtja e paketimi i gjurmëve dhe provave materiale

Një procesverbal është i nevojshëm që të krijohet dhe në të të shënohen të gjitha informatat e nevojshme për gjurmë dhe provat materiale të gjetura. Ky procesverbal do të shërbejë ekspertit që të përcaktojë radhitjen një pas një, të secilës provë dhe pjesë të saj. Gjithashtu, procesverbali do të mundësojë të përcaktohen numrat veç e veç për secilën provë.

Informatat e nevojshme që duhen të vendosen në këtë procesverbal:

- lloji i krimit dhe numri i rastit,
- numri ose shenja,
- data dhe koha e gjetjes,
- emri i personit që e ka gjetur,
- vendi ku është vendosur,

- zinxhiri i ruajtjes apo transferimet⁶⁴.

Në rast të zhvendosjes së provës për çfarëdo arsye nga vendi i ruajtjes së saj, apo transferimi i saj, në mes të personave të ndryshëm duhet të shënohet në procesverbal emri i të gjithë atyre personave që janë marrë me të.

3.10 Ruajtja dhe paketimi i gjurmëve dhe provave materiale

Rëndësi dhe kujdes mjaft të madh duhet kushtuar ruajtjes dhe paketimit të gjurmëve dhe provave materiale. Nëse dështojmë në paketimin e tyre, atëherë ruajtja e tyre është shumë e vështirë për t'u bërë.

Paketimi dhe ruajtja e gjurmëve dhe provave materiale bëhet në atë mënyrë që sa më pak ose fare të mos kemi fërkim dhe zhvendosje të tyre. Gjithashtu duhet pasur kujdes nga thyerjet, rrjedhjen apo kontaktin e provës me provën tjetër; këtu vjen në shprehje e ashtuquajtura **TEORIA E TRANSFERIT**⁶⁵. Kujdes të veçantë duhet t'u kushtohet njollave të gjakut dhe lëngjeve tjera trupore. Ato duhet të ruhen në vende të hapura (brenda mundësive). Nuk duhet të përdoren qeset e plastikës ose kutitë hermetikisht të mbyllura. Nëse këto njolla futen nëpër qese plastike ose kuti hermetikisht të mbyllura, atëherë bëhet djersitja dhe për shkak të kësaj mund të bëhet kontaminimi i tyre.

Një gjurmë biologjike mund të pakëtohet dhe të vendoset edhe në një epruvetë sterile, por mbyllja e grykës së saj të bëhet me tampon pambuku dhe jo me gomë. Nëse gjurma është gjak, spermë apo lëngje tjera trupore atëherë ajo duhet futur/ruajtur në letër. Nëse ka mundësi të përdoret letra; lypset të jetë letër e fortë për paketim. Në qese plastike duhet të futen vetëm provat të cilat nuk kanë rrezik edhe nëse bëhet djersitja e tyre. Nëse provat janë të lagura, ato duhet të ruhen në atë mënyrë që fillimisht të thahen në temperaturë të

⁶⁴ Mbrojtja dhe këqyrja e vendit të ngjarjes, doracak për studentë, Akademia Policore, Vushtri, Kosovë, 2002, faqe 30.

⁶⁵ Me rastin e kontaktit në mes tyre, karakteristikat individuale të secilës provë dhe mikrogjurmët transferohen nga njëra provë në tjetrën.

ambientit sa më shpejt që është e mundur, por pa përdorur ndonjë mjet si: nxehtë a furrë me qëllim të përsheptimit të tharjes.

Shpeshherë në vendin e ngjarjes si provë duhet të merren edhe rrobat e personave të dyshimtë ose viktimave; ato duhet të palosen por me kujdes të madh dhe thyerja gjatë palosjes së tyre të mos bie në gjurmë ose njollë dhe ato pastaj të vendosen apo të mbështjellën me letër.

Mjetet e mprehta si: thikat, sharrat, xhami etj., duhet të ruhen dhe paketrohen në kutia metalike që të mos depërtojnë dhe dalin nga ato paketime. Në mungesë të kutive metalike ato mund të vendosen ose të mbështjellën me letër të fortë dhe në të, të shënohet shenja përkatëse që e bën të shihet se aty ka prova që lehtë depërtojnë ose thyhen.

Provat tjera, siç është gjaku dhe lëngjet tjera biologjike, duhet të ruhen në frigorifer apo në ndonjë vend të ftohtë dhe të errët që të mos prishen.

Nëse si provë merret letra, brenda mundësive, ajo duhet të vendoset rrafsh-horizontalisht, ashtu siç është dhe të mos thyhet.

Armët e zjarrit, në përgjithësi duhet të ruhen dhe paketrohen në kutia metalike ose kutia të letrës së fortë që të mos dëmtohen nga ana e jashtme.



Fig. 8 Pajisjet për paketimin e provave

Fig. 9 Pajisjet për marrjen dhe shënimin e provave

KAPITULLI IV

PËRMBLEDHJE E KAPITULLIT IV

Përshkrimi(dokumentimi) i vendit të ngjarjes është një proces shumëi rëndësishëm që grupi hetimor e zhvillon gjatë këqyrjes së atij vendi të ngjarjes. Përshkrimi paraqet: marrjen e shënimeve, skicimin dhe fotografimin e vendit të ngjarjes.

Marrja e shënimeve apo krijimi i procesverbalit është një dokumentim dhe një pasqyrim i tërë punës së grupit hetimor duke përfshirë të gjitha veprimet që zhvillohen në të. Këtu paraqiten të dhënat nga arritja në lokacionin e dhënë, ndërmarrja e hapave të parë rreth këqyrjes, skicimi, fotografimi, pastaj aty shënohen edhe veprimet tjera që grupi hetimor i zhvillon siç janë: data, koha, lokacioni i saktëivendit të ngjarjes, për të vazhduar me intervistat e ndryshme me dëshmitarë, përshkrimi i tërë hapësirës ku ka ndodhur ngjarja, kush është gjetur aty në momentin e arritjes së grupit hetimor etj.

Nga praktika dihet se vetëm fotografia nuk përmbush të gjitha kërkesat që ka grupi hetimor, prandaj është e domosdoshme të bëhet edhe skicimi apo diagrami i vendit të ngjarjes. Skicimi është një veprim hetimor qëekspertii vendit të ngjarjes e bën atë duke vizatuar tërë hapësirën e vendit të ngjarjes. Kjo hapësirë paraqitet edhe gjatë fotografimit, por skica dallon nga fotografia, sepse në të paraqiten vetëm gjërat që kanë lidhje direkte me ngjarjen, duke i paraqitur në mënyrë të detajuar. Skicat dallojnë për nga mënyra e bërjes së tyre. Ato mund të paraqiten të shkallëzuara apo të pa shkallëzuara. Pastaj skicat ndahen në dy grupe: të përgjithësuar, e cila vizatohet në vendin e ngjarjes me dorë të lirë dhe ajo e detajuar e cila vizatohet me vonë me mjete/vegla teknike apo me kompjuter.

Fotografimi i vendit tëngjarjes është një veprim hetimor gjithashtu shume i rëndësishëm sepse në të paraqitet pamja e vendit të ngjarjes me të gjitha objektet që gjenden brenda tij. Fotografitë bëhen në disa mënyra, varësisht se çka jemi duke fotografuar, çfarë madhësie ka objekti që fotografojmë etj. Fotografimi i gjurmëve të gishtërinjve kërkon një saktësi më të madhe se sa fotografimi ihapësirës së vendit të ngjarjes, prandaj kur kemi të bëjmë me fotografi të mikrogjurmëve apo të gjurmëve që mezi duken, kërkohet një kujdes

shumëiveçantë. Fotografimi i vendit të ngjarjes duhet bërë në atë mënyrë që kushdo që e shikon ato fotografi në të ardhmen të ketë një pamje të kuptueshme të tërë hapësirës që është fotografuar.

Gjurmët gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes zënë një vend të rëndësishëm në tërë procesin hetimor. Kërkimi, zbulimi, fiksimi, marrja dhe ekzaminimi i tyre zënë një vend të veçantë në këtë kapitull. Këtu janë përmendur gjurmët e gishtërinjve, të cilat paraqesin argument të sigurt të kontaktit të personit të caktuar me sipërfaqen e caktuar ku është gjetur ajo gjurmë në vendin e ngjarjes. Llojet e gjurmëve të gishtërinjve dhe standardi i identifikimit të tyre gjithashtu është paraqitur në këtë kapitull.

Gjurmë tjetër që është paraqitur në këtë kapitull janë edhe gjurmët e këpucëve dhe gomave. Edhe këto gjurmë janë argument i sigurt i kontaktit të këpucës apo gomës me sipërfaqen e caktuar në vendin e ngjarjes. Se si bëhet kërkimi, zbulimi dhe marrja e tyre është paraqitur në mënyrë të detajuar në këtë kapitull.

Gjurmët e veglave janë të një rëndësie të veçantë, kur dihet se përdorimi i veglave haset shumë shpesh nëpër rastet e ndryshme. Këto vegla gjatë përdorimit të tyre patjetër se lënë gjurmët e veta. Këto gjurmë janë shumë të rëndësishme gjatë procesit hetimor. Kërkimi, gjetja dhe marrja e tyre është paraqitur gjithashtu në këtë kapitull.

4. PËRSHKRIMI, SKICIMI, FOTOGRAFIMI DHE MBLEDHJA E GJURMËVE

Që një rast të ketë suksesin dhe rezultatin e duhur, si në aspektin e kualitetit i cili do të duket pas një pune profesionale të grupit hetimor, ashtu edhe në aspektin e kuptimit sa më të mirë, të të gjithë atyre që do të kenë rastin ta shohin atë, duhet të bëhet një dokumentim profesional, i qartë dhe i kuptueshëm me të gjitha të dhënat e mjaftueshme.

Që të arrihet një rezultat i kënaqshëm dhe i kërkuar është e domosdoshme që të kemi një dokumentim të drejtë dhe profesional, në mënyrë që e gjithë puna e kryer dhe procedurat e ndjekura nga grupi hetimor të pasqyrohen shumë qartë dhe të jenë të kuptueshme për të gjithë ata që e shqyrtojnë këtë rast në fazat e mëvonshme.

Dokumentimi i vendit të ngjarjes përfshin:

Marrjen e shënimeve (Procesverbali i Këqyrjes),

Skicimin,

Fotografimin.

4.1 Marrja e shënimeve (procesverbali i këqyrjes)

Njëra prej veprimeve kryesore dhe shumë të rëndësishme eekspertit të vendit të ngjarjes është edhe marrja e shënimeve. Kjo bëhet për shumë arsye. Njëra prej arsyeve kryesore pse duhet të merren shënimet është se ato duhet të jenë në dispozicion të krejt rastit dhe atëherë kur kërkon diçka eksperti apo gjykata ato të jenë gati dhe të njëjta me veprimet që janë ndërmarrë në vendin e ngjarjes dhe të gjitha të dhënat tjera, si për vendin e ngjarjes ashtu edhe për gjurmët dhe provat materiale që janë gjetur aty.

Marrja e shënimeve fillon nga momenti i pranimit të thirrjes për rastin e dhënë duke shënuar kohën, datën, burimin nga kush është marrë informata si dhe instruksionet që janë dhënë për ruajtjen e vendit të ngjarjes, për të vazhduar pastaj me përbërjen e ekipit hetimor, zyrtarët përgjegjës të gjetur aty dhe kohën e arritjes në vendin e ngjarjes. Gjithashtu duhet të shënohen edhe të gjitha veprimet e grupit hetimor në lidhje me këqyrjen e vendit të ngjarjes deri në përfundim të asaj këqyrjeje.

Vëmendja përqendrohet tek objektet, tek gjurmët e tek provat materiale, me qëllim që të dallohet ajo gjurmë ose provë materiale që është e rëndësishme, që lidhet me ngjarjen, nga ajo që mund të gjendet rastësisht në vendin e ngjarjes⁶⁶.

Ja se si duhet të jenë shënimet e një eksperti të vendit të ngjarjes:

- *Shënimet duhet të jenë të sakta dhe të renditura në mënyrë kronologjike;*
- *Shënimet duhet t'i përshkruajnë hap pas hapi të gjitha veprimet;*
- *Shënimet duhet të jenë të kompletuara dhe harmonizuara;*
- *Shënimet duhet të jenë të shkruara mirë dhe të kuptueshme;*
- *Duhen shënuar edhe gjërat e pazakonshme si: gjaku, ndonjë dritë që ka qenë e ndezur etj.;*

⁶⁶Dr. Estref MIFTARI, mr.sc. Fitim SHISHANI, Hysen Kotri, Kriminalistika, Prishtinë, 2010, faqe 108.

- *Eksperti që merr shënime duhet të jetë sa më shumë që mundet specifik, në kuptimin që t'i shënojë edhe gjërat më të "imta" si: 20 cm nën shkallët e shtëpisë, në katin e parë është gjetur.... etj.*
- *Shënimet tjera siç janë: numri i rastit, video kamera a negativët e filmave, asnjëherë nuk duhet lënë pa shënuar. Ato mund të jenë të shënuara edhe në ndonjë vend tjetër, por edhe këtu vlen të shënohen;*
- *Përcaktimi e vendndodhja e gjurmës apo provës materiale të bëhet në lidhje me një objekt të palëvizshëm si: muri, shtylla elektrike, etj.*⁶⁷.

Eksperti i vendit të ngjarjes me të arritur në atë vend duhet të kontaktojë së pari oficerin e parë në vendin e ngjarjes dhe atë që ka bërë sigurimin e tij, viktimën, dëshmitarët. Në këtë mënyrë ai do të informohet për disa të dhëna të vendit të ngjarjes, të cilat ndoshta do t'i nevojiten më vonë. Të gjitha këto duhet të shënohen me kujdes.

Në procesverbalin e hartuar nga ekspertinë vendin e ngjarjes duhet të përfshihen:

- Data dhe koha kur rasti është raportuar në organet policore,
- Lloji i krimit,
- Vendndodhja dhe përshkrimi i tij,
- Emri i personit që urdhëroi/kërkoj vend shikimin,
- Emrat e të gjithë personave: policëve, dëshmitarëve, hetuesve, personelit të specializuar të atij vendi të ngjarjes,
- Emrat e atyre ekspertëve që fotografojnë, xhirojnë me kamerë, bëjnë skicën, nxisin gjurmët e gishtërinjve, kërkojnë dhe marrin gjurmë dhe provat materiale,
- Kushtet atmosferike dhe pamja në kohën e këqyrjes,
- Përshkrimin e parë të vendit të ngjarjes përfshirë edhe gjendjen e viktimës në kohën kur ka arritur grupi hetimor,
- Lokacionin e secilës gjurmë apo provë materiale që është gjetur dhe nga kush është gjetur, rezultatet e kërkimit të gjurmëve të gishtërinjve dhe mikrogjurmëve të tjera,

⁶⁷Intervistë (bisedë) me prof. dr. Luan VELIÇOTI, Tiranë, maj 2011.

- Përshkrimi i saktë i lokacionit të vendit të ngjarjes, shtëpive apo objekteve për rreth,
- Përshkrimi i saktë i hyrjes dhe daljes së vendit të ngjarjes, përshkrimi i shtëpisë, numrin e dhomave, dritaret etj.
- Përshkrimi i jashtëm i vendit të ngjarjes, tokës, arë e mbjellë, tokë me baltë, tokë e shtruar me asfalt, pllaka etj.
- Koha e përfundimit të këqyrjes së vendit të ngjarjes,
- Në këto shënime nuk jepen konkluzione, por vetëm çfarë shihet dhe gjendet aty,

Nëse nëpërmjet fotografisë “shkruajmë me anë të dritës”⁶⁸, në procesverbal shkruajmë vetëm atë që shikojmë. Konkluzionet i përkasin veprimeve të tjera hetimore si: ekspertimi, njohja, eksperimenti etj.

4.2 Skicimi

Skicimi i vendit të ngjarjes është një vizatim i thjeshtë i cili tregon pozicionin e trupit me objektet fikse të rëndësishme që gjenden në atë vend të ngjarjes⁶⁹.

Vetëm fotografia nuk është e mjaftueshme për incizimin e vendit të ngjarjes. Që një vend i ngjarjes të jetë më mirë dhe më saktë i paraqitur ai duhet të ketë edhe skicën. Pra, skica dhe fotografia plotësojnë njëra-tjetrën dhe të dyja paraqesin vendin e ngjarjes në mënyrë të saktë dhe adekuate. Skica e qartëson pamjen e vendit të ngjarjes dhe e bën atë më lehtë të kuptueshëm. Prandaj, është e rëndësishme që eksperti i vendit të ngjarjes të bëjë një skicë të mirë dhe që kuptohet lehtë.

Përpiluesi i skicës nuk duhet të jetë patjetër piktor apo vizatues i mirë, por gjithçka që paraqet në skicë duhet të jetë e qartë edhe për atë që nuk ka qenë në vendin e ngjarjes dhe

⁶⁸“Photo” nga greqishtja DRITË dhe “graphos” nga greqishtja SHKRUAJ.

⁶⁹Vernon J. Geberth M. S., M. P. S., B. B. A., FBINA, PRACTICAL HOMICIDE INVESTIGATIONS, Tactics, Procedures and Forensic Techniques, Fourth Edition, page 159, Published in 2006, CRC Press, New-York, Suite 300, USA.

nuk e ka parë atë. Pra, duhet një vizatim i thjeshtë, i kuptueshëm dhe në të të paraqitet pamja e vendit të ngjarjes.

Në fotografi duken edhe objektet që nuk “duam” t’i shohim, sepse nuk mund t’i ndajmë ose t’i largojmë pa intervenuar në të, ndërsa në skicë paraqesim vetëm objektet që na duhen dhe duam t’i paraqesim.

Skica i ndihmon ekspertët, gjykatësit dhe të tjerët për t’i rikujtuar gjërat. Gjithashtu, ajo shërben mjaft mirë në krahasim me fotografinë edhe kur kemi rastin për të parë veturat apo ndonjë pamje tjetër të vendit të ngjarjes dhe kjo mund të shfrytëzohet nga ekspertët edhe gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve apo viktimave.

Kemi dy lloje të skicave: e përgjithësuar dhe e detajuar.

Skica e përgjithësuar bëhet në vendin e ngjarjes, një vizatim i thjeshtë, me dorë të lirë dhe me të gjitha karakteristikat tjera që e përcjellin atë, ndërsa,

Skica e detajuar bëhet në zyrë me mjete teknike ose me kompjuter. Të dy këto skica hyjnë në dosjen e rastit dhe ruhen aty.

Skica gjithmonë bëhet në këndin 90 shkallë dhe quhet skicë *dydimensionale*, për dallim nga ajo *tredimensionale*, që bëhet në kënde të ndryshme dhe në raste të tjera (te varrezat masive, skica e puseve etj.).

Skica kompletton shumë mirë fotografitë dhe shënimet e vendit të ngjarjes.

4.2.1 Informatat që përfshihen në skicë

Sikur edhe të gjitha informatat tjera që identifikojnë rastin, po ato informata duhet të paraqiten edhe në skicë. Këto janë: numri i rastit, emri i viktimës, emri i të dyshimit, data dhe koha kur ka ndodhur rasti, data dhe koha kur është bërë skica, lokacioni, emri i personit që ka bërë skicën, shkalla e përpjesëtueshmërisë nëse është përdorur ose jo; një legjendë do

ta ndihmonte lexuesin e saj, orientimi hapësinor, pikat fikse nga ku janë bërë matjet, numrat e gjurmëve dhe provave materiale⁷⁰.

4.2.2 Pajisjet

Pajisjet që përdoren gjatë përpilimit të skicës janë të thjeshta duke përfshirë letër të bardhë, lapsa teknike apo të thjeshtë, vegla gjeometrike, vizore, kompas, trekëndësh, drejtkëndësh etj. apo nëse bëhet me kompjuter, atëherë shfrytëzohen programe të ndryshme për përpilimin e skicave.

4.2.3 Llojet e skicave

Varësisht nga vendi i ngjarjes kemi disa lloje skicash dhe metodash me të cilat ato realizohen. Këto lloje skicash janë:

1. Skica dydimensionale
2. Skica tredimensionale.

1. Skica dydimensionale përdoret pothuajse në të gjitha rastet kur kemi të bëjmë me sipërfaqe, që paraqitet vetëm gjerësia dhe gjatësia e terrenit të vendit të ngjarjes. Këtu përfshihen vendet e ngjarjes: të hapura, të mbyllura, në vetura etj.

⁷⁰Criminal Investigations, Charles R. SWANSON, Neil C. CHAMELIN, Leonard TERRITO, 7th, ed. 2000, faqe 57.




Fig. 10 Skica dy – dimensionale

- ***Skica tredimensionale*** përdoret në të gjitha rastet kur terreni i vendit të ngjarjes është me gjerësi, gjatësi dhe thellësi. Këto raste i kemi të varrezat masive, pusët e ndryshme, veturat etj., si dhe bërja e maketeve të ndryshme gjatë rikonstruktimit të vendit të ngjarjes apo prezantimit në gjyq.




Fig. 11 Skica tre dimensionale (A three – dimensional mock – up of one of the crime scenes from the infamous Hill side Strangler Case in Los Angeles, California.)

4.2.4 Metodat e skicimit

Kemi tri metoda të skicimit:

- *Metoda koordinatave*
- *Metoda trekëndore*
- *Metoda kryqëzore*

Metoda koordinatave- ka së paku dy pika fikse nga të cilat maten të gjitha gjurmët dhe provat materiale që gjenden në atë vend të ngjarjes. Me këtë metodë mund të përdoret edhe vija bazike, vijë kjo e cila imagjinohet në mes të vendit të ngjarjes dhe përgjatë kësajvije maten të gjitha provat në të dy anët e saj. Kjo metodë është e përshtatshme në ambiente të hapura.

Metoda trekëndore - ka së paku dy pika fikse nga të cilat maten të gjitha gjurmët dhe provat materiale në atë vend të ngjarjes. Kjo metodë përdoret në ambiente të hapura dhe në ato vende ku hasim në vështirësi për të gjetur pika fikse: në fusha, larg rrugës, gjatë rasteve të aksidenteve të trafikut etj.

Metoda kryqëzore- përdoret në vende të mbyllura. Këtu muret e dhomave figurojnë të shtrira. Tavani i dhomave duhet shtrirë së bashku me njërin nga muret e saj.

4.3 FOTOGRAFIMI I VENDIT TË NGJARJES

Thënia “një fotografi vlen sa një mijë fjalë” vlen sidomos për fotografimin e vendit të ngjarjes. Fotografimi ose “incizimi” i përhershëm i vendit të ngjarjes është një veprim shumë i rëndësishëm i grupit hetimor gjatë procedimit dhe këqyrjes së vendit të ngjarjes. Është mjaft e rëndësishme që para çdo veprimi tjetër, duke përfshirë prekjen, lëvizjen, ekzaminimin etj., të bëhet fotografimi i çdo gjëje që gjendet në vendin e ngjarjes dhe për të cilën vlerësohet se është gjurmë apo provë materiale. Asnjë objekt nuk duhet lëvizur para se ai të jetë fotografuar nga të gjitha këndet e nevojshme⁷¹.

Që e gjithë kjo të ketë efektin e vet edhe gjatë testimit në gjyq duhet të bëhen sa më shumë fotografi që është e mundur. Nuk duhet harruar se fotografitë mund të ndihmojnë edhe prokurorinë gjatë seancave gjyqësore; gjykatësin, ekspertët e policisë etj.

Është detyrë e çdo eksperti të vendit të ngjarjes që posa të arrijë aty, pas marrjes së informatave fillestare, të fillojë me fotografimin e përgjithshme apo orientuese të atij vendi të ngjarjes, e pastaj të vazhdojë me fokusimin e tyre nëpër pikat e rëndësishme të atij vendi p.sh.: në qendër të vendit të ngjarjes, të bëjë lidhjen e gjurmëve apo provave materiale me anë të fotografisë, fotografitë vazhduese etj.

Në fokus të veçantë duhet pasur natyrën e krimit, në mënyrë që të paraqiten elementet e veprës së kryer. Këtu duhet pasur parasysh: *pamjet e jashtme të shtëpisë, veturës, lidhjet e tyre mes veti, rrugën etj., pikat e hyrjes jashtë dhe brenda, pikat e daljes brenda dhe jashtë, kushtet e vendit të ngjarjes, gjërat që janë lënë në vendin e ngjarjes, provat si: qimet e flokëve, fijet sintetike, mbetjet e cigareve, gjurmët e gishtërinjve, shenjat e veglave, gjurmët e këpucëve, gjurmët e gomave, etj.*

⁷¹Criminal Investigations, Charles R. SWANSON, Neil C. CHAMELIN, Leonard TERRITO, 7th, ed. 2000, faqe 55.

Rëndësi të veçantë duhet kushtuar edhe fotografive kufizuese të vendit të ngjarjes, pasi që ato duhet të bëhen në atë mënyrë që kur të shikohen, të renditen në mënyrë logjike duke bërë një orientim real të atij vendi. Fotografitë kufizuese janë:

- **Fotografia me qitje të largët (orientuese).** Kjo fotografi bëhet në atë mënyrë që në të përfshihet tërë hapësira e vendit të ngjarjes (nëse është e mundur) në mënyrë që kur shikohet kjo fotografi krijon përshtypjen se je duke shikuar vendin e ngjarjes aty afër. Kjo fotografi tregon pozicionin e vendit të ngjarjes, në krahasim me objektet tjera që e rrethojnë qofshin ato ndërtesa, sende apo objekte⁷². Kjo fotografi bëhet në distancë të syve, gjashtë metra e tutje.
- **Fotografia me qitje të mesme (e përgjithshme).** Kjo fotografi bëhet në atë mënyrë që në të lidhen zonat e vendit të ngjarjes me zonat e fotografuara, dhe mundëson lidhjen e gjurmëve dhe provave materiale mes veti. Kjo fotografi bëhet në distancë nga tri deri në gjashtë metra në mënyrë që të kemi një shikim dhe lexim të qartë të asaj fotografie.
- **Fotografia me qitje të afërt (e objektit të afërt).** Këto fotografi bëhen në atë mënyrë që në to futen të gjitha pamjet, të cilat nuk kanë mundur të futen në fotografinë me qitje të mesme dhe të largët. Kjo fotografi bëhet në distancë prej një apo dy metrave.
- **Fotografia e shkallëzuar.** Kjo fotografi bëhet atëherë kur së bashku me gjurmët dhe provat materiale që gjenden në vendin e ngjarjes, fotografohet edhe me njësi matëse si vizore, metër etj. Pra, duke bërë fotografi të shkallëzuar tregohet se sa herë është zmadhuar apo është zvogëluar objekti i fotografuar⁷³.

⁷²Prof. dr. Skënder Begeja, Kriminalistika, vëllimi I, 2001, Tiranë, faqe 80.

⁷³Prof. ass. dr. Luan VELIÇOTI, Fotografia kriminalistike, Tiranë, 2001, faqe 138.

4.4 PËRPUNIMI DHE ZBULIMI I GJURMËVE NË VENDIN E NGJARJES

4.5 Gjurmët dhe kuptimi i tyre

Termi traseologji është fjalë e përbërë nga dy pjesë “ le trace ” që rrjedh nga gjuha frënge që do të thotë GJURMË dhe “ logos ” nga greqishtja do të thotë STUDIM dhe të dyja këto bëjnë Studimin mbi Gjurmët, që ndryshe quhet **Traseologji**.

Pra, traseologjia është degë e kriminalistikës e cila studion gjurmët që janë lënë nga objektet me një strukturë të jashtme të caktuar⁷⁴. Duke studiuar këto gjurmë dhe objektet që i kanë lënë ato, traseologjia studion dhe sqaron rrethanat në të cilat janë lënë këto gjurmë si dhe mekanizmat e formimit të këtyre gjurmëve. Duhet pasur parasysh që çdo objekt që përdoret në vendin e ngjarjes, qoftë nga autori, qoftë nga dikush tjetër, ka në përbërje strukturën e jashtme të tij, e cila me rastin e kontaktit me sipërfaqen e caktuar krijon gjurmë të dukshme apo edhe të padukshme. Është pra detyrë e traseologjisë të merret me studimin e këtyre gjurmëve, t'i klasifikojë ato dhe të arrijë në përfundime të caktuara, të cilat na dërgojnë tek kryerësi i veprës.

Traseologjia ndahet në procedurën e gjurmimit të shenjave, e cila e ka teknikën e saj, anën taktike, sigurimin e gjurmëve (gjithashtu me aspekte teknike dhe taktike), fiksimin e gjurmëve dhe shfrytëzimin e tyre për qëllime të zbulimit dhe dëshmimit, gjë që paraqet anën taktike të problematikës. Kur të jenë gjetur apo zbuluar dhe fiksuar gjurmët, fillon pjesa kryesore e aktivitetit dëshmues kriminalistik. Gjetja dhe fiksimi i gjurmëve gjithmonë duhet të ketë parasysh karakterin teknik, taktik dhe metodik⁷⁵.

⁷⁴Dr. Vesel Latifi, Kriminalistika - zbulimi dhe të provuarit e krimit, Prishtinë, faqe 366, 2009.

⁷⁵Prof. dr. sc. Dushko Modly, TEORITË BASHKËKOHORE KRIMINALISTIKE, Titulli i originalit: “SUVREMENE KRIMINALISTIČKE TEORIJE” Përktheu nga kroatishtja: prof. Mustafë Reçica, SARAJEVË / Prishtinë, 15. 01. 2007, FSK/S - 14/06, faqe 53.

Përgjithësisht me ***gjurmë nënkuptojmë çdo gjë që lë njeriu, kafsha, lënda ose mjeti, që mund të shërbejë për zbulimin e autorit të veprës ose të ndihmojë në konstatimin e disa rrethanave individuale.***

Në kuptimin kriminalistik ***me gjurmë kuptojmë shenjat nga të cilat mund të njihet fakti dhe ngjarja që na dërgojnë tek autori i veprës.***

Gjurmët mund të lindin apo të shkaktohen nga veprimet e njerëzve, shtazëve dhe objekteve e ndonjëherë edhe nga veprimi i bimëve.

Fjala është për ndryshimin material në realitetin objektiv, në raport me gjendjen ekzistuese para ndryshimeve, përkatësisht para tentimit apo kryerjes së veprës penale⁷⁶.

Kur flasim për krijimin e gjurmëve, duhet llogaritur edhe fakti se me këtë rast kemi të ashtuquajturin objektin (mjetin) lënës, (pra objekti ose mjeti që shkakton gjurmën) dhe objektin ose mjetin marrës (objekti që pranon gjurmën). Pra kemi të bëjmë me veprimin dinamik të objektit lënës në objektin marrës, duke çuar deri në krijimin e gjurmës. Këtu mund të përmendim krijimin e gjurmëve të veglave, kur objekti (mjeti) që ka kontakt me sipërfaqen e caktuar lë gjurmë në atë sipërfaqe dhe e tërë kjo si rezultat i veprimit dinamik të objektit (mjetit) që është përdorur në atë rast.

Përgjithësisht, gjurma materiale në vendin e ngjarjes mund të ndeshet në këto katër forma: si gjurmë kalimtare, si dukje e veçantë (formë, sistemim, mostër karakteristike), si gjurmë e kushtëzuar (kondicionale) dhe si gjurmë kontakti⁷⁷.

Gjurmët kalimtare (me zgjatje të shkurtër)

Gjurma kalimtare është gjurma që lë një lloj materiali provues i përkohshëm, i cili mund të ndryshojë dhe të zhduket lehtë. Këto gjurmë rëndom janë:

⁷⁶Prof. dr. sc. Dushko Modly, TEORITË BASHKËKOHORE KRIMINALISTIKE, Titulli i origjinalit: "SUVRÉMENE KRIMINALISTIČKE TEORIJE" Përktheu nga kroatishtja: prof. Mustafë Reçica, SARAJEVË / Prishtinë, 15. 01. 2007, FSK/S - 14/06, faqe 54.

⁷⁷Henry C.Lee, Materijalni Tragovi, Zagreb, 1998, faqe 3.

- *Aroma* e qelbësirave, ushqimit, parfumit, benzinës, aroma e trupit, urinës, djegies, eksplozivit, aroma e duhan-cigareve etj.
- *Temperatura* e lokalit; temperatura e kapelës mbrojtëse ose e motorit të makinës; temperatura e kafes, çajit ose ujit në gotë; temperatura e ujit në vaskë; temperatura e trupit të vdekur; temperatura e mbetjeve në vend-djegje etj.
- *Gjurmët dhe mbresat*: gjurmët e freskëta të shputave mbi sipërfaqen e nxehtë ose të thatë të rrugës; gjurmët e gishtave mbi materiale të tretshme; gjurmët e dhëmbëve në ushqimin që priset; gjurmët e gomave mbi plazhin ranor gjatë zbaticës; gjurmët e shputave në borë etj.

ç) *Njollat* kaltër (mavi) të kufomës në zhdukje e sipër, spërkatjet me gjak mbi objekte të lëvizshme, gjurma e buzëkuqit në filtrin e cigares; njollat e gjakut në rrobat e futura në ujëetj.⁷⁸.

Gjurmën kalimtare, zakonisht e zbulon personi që ndodhet i pari në vendin e ngjarjes – polici i parë ose personi i parë okular. Gjurma duhet të dokumentohet dhe të përshkruhet sa më parë. Shumica e gjurmëve të tilla mund të përshkruhen në procesverbal, gjë që mund të vërtetohet nga bashkëpunëtorët e pranishëm të vëzhgimit. Disa gjurmë kalimtare mund të filmohen me aparat fotografik ose video kamerë, të tjera mund të mblidhen me kujdes të posaçëm dhe të mbrohen nga ndryshimet e mëtejshme ose nga zhdukja⁷⁹.

Dukja e gjurmëve dhe e objekteve

Ky lloj i materialit krijohet nga kontakti i fortë, i drejtpërdrejtë ndërmjet personave dhe objekteve ose ndërmjet dy objekteve. Në vendin e ngjarjes, gjurmë të tilla, mund të gjenden shumë. Shumica e tyre janë në formën e shenjave, shtypjeve, njollave, thyerjeve ose shtresëzimeve. Këtyre gjurmëve nuk u kushtohet një vëmendje e duhur dhe nuk shfrytëzohet vlera e tyre e mundshme, sepse ato shpesh konsiderohen si “jo shumë

⁷⁸Henry C.Lee, *Materijalni Tragovi*, Zagreb, 1998, faqe 3.

⁷⁹ Po aty, faqe 3.

shkencore”. Mirëpo, ky material provues ka një vlerë të jashtëzakonshme për rikonstruktimin e ngjarjes. Ai mund të përdoret shumë shpesh për të vërtetuar ose për të kontestuar alibinë e të dyshuarit ose versionet e dëshmitarëve okularë të ngjarjes, me rastin e lidhjes ose përjashtimit të përzierjes së personave ose të objekteve në ngjarje të caktuara, ose për të siguruar pista të reja në përpunimin kriminalistik⁸⁰.

Lista e llojeve të këtij materiali provues, i cili gjendet shpesh në vende të caktuara, ku janë kryer vepra penale është e gjatë. Ndonjëherë, në një vendngjarje mund të gjenden disa lloje të ndryshme të gjurmëve materiale, të tilla si:

- prania e pikave të gjakut
- përhapja e grimcave të xhamit të thyer
- përhapja e mbeturinave në vendin e zjarrit
- renditja e mobileve
- dukja e gjurmëve të shputave dhe të mbathjeve
- dukja e gjurmëve të gomave ose e gjurmëve të frenimit
- sistemimi i rrobave ose i objekteve
- mënyra e veprimit (modus operandi)
- dukja e blozës së barutit
- dukja e dëmtimit në material
- pozita dhe dukja e trupit etj.

Njohja e këtij materiali provues kërkon një vëzhgim të kujdesshëm dhe një qasje sistematike si edhe detale ndaj hulumtimit të ngjarjes kriminale⁸¹.

⁸⁰ Po aty, faqe 3.

⁸¹ Po aty, faqe 4.

Gjurmët e kushtëzuara (kondicionale)

Në grupin e gjurmëve dhe provave materiale, që zakonisht gjenden në vendin e ngjarjes, bëjnë pjesë ato që janë pasojë e një ngjarjeje ose veprimi të caktuar. Nëse nuk përshkruhen me kujdes këto gjurmë mund të ndryshojnë ose të zhduken. Këto gjurmë janë jashtëzakonisht të rëndësishme për rikonstruktimin e vendit të ngjarjes dhe për përcaktimin e rrethanave të një ngjarjeje të caktuar. Disa nga shembujt e gjurmëve të kushtëzuara që ndeshen shpesh në vendin e ngjarjes, përfshijnë:

- *Dritën*, p.sh.: nëse dritat e makinës kanë qenë të fikura ose të ndezura para aksidentit, ndriçimi i hapësirës ku ka ndodhur ngjarja kriminale etj.
- *Tymin*, p.sh.: ngjyra, drejtimi i përhapjes, dendësia, aroma e tymit.
- *Zjarrin*, p.sh.: ngjyra e flakës, drejtimi i përhapjes së flakës, shpejtësia e përhapjes së zjarrit, temperatura dhe gjendja e zjarrit etj.
- *Pozicionin*, p.sh.: pozicioni i armëve ose gëzhgojave në raport me trupin e viktimës; radhitja dhe pozicioni i njollave të gjakut në objekte; pozicioni dhe vendi i makinës së viktimës; përhapja e xhamave të thyer; pozicioni i lëndimeve dhe plagëve.
- *Makinën*, p.sh.: a janë të kyçura a të shkyçura dyert e makinës; a është dritarja e hapur apo e mbyllur; a është radioja e kyçur apo e shkyçur, a është çelësi i kontaktit në bravë apo jo, kilometrat e kaluar në tabelën e komandës etj.
- *Trupin*, p.sh.: shkalla e shtangimit kufomor; zbehtësia, shkalla e dekompozimit; temperatura e trupit, pozicioni i trupit dhe llojet e lëndimeve⁸².

Gjurmët e kontaktit

Këto janë një lloj klasik gjurmësh që shkaktohen nga kontakti fizik ndërmjet personave ose ndërmjet objekteve, apo ndërmjet personit dhe objektit. Gjurmët e kontaktit mund t'i ndajmë sipas kriterëve të ndryshme, por asnjëra skemë nuk mund të jetë e kënaqshme, pasi nuk i merr parasysh të gjitha pikëpamjet e ndryshme. Janë shtatë skema, më shpesh të përshkruara për klasifikimin e gjurmëve të kontaktit. Secila prej tyre është e dobishme, sepse ofron pikëpamje të ndryshme, por disa prej tyre janë më të përshtatshme.

⁸²Po aty, faqe 4.

Klasifikimi sipas veprës penale: Një mënyrë evidente është ndarja e gjurmëve sipas llojit të veprës penale. Kështu, do të kemi gjurmë të vrasjes, grabitjes, dhunës, përdhunimit etj. Ndonëse kjo skemë vlen në raste të caktuara, duhet të kihet parasysh se secili lloj i gjurmës mund të paraqitet i lidhur gati me secilin lloj të veprës penale. Por, llojet e ndryshme të gjurmëve nuk janë të kufizuara vetëm te disa lloje të caktuara të veprave penale. Për shembull, njollat e gjakut janë të shpeshta tek sulmet ose vrasjet, por ato gjithashtu mund të jenë të rëndësishme edhe në vendin e grabitjes. Gjurmët e spermës më shpesh konsiderohen më të rëndësishme te rastet e përdhunimeve dhe tek veprat e tjera kundër lirisë seksuale dhe veprimet e panatyrshme seksuale, por në disa raste te këto vepra, gjurmë të tjera mund të jenë edhe më të rëndësishme. Ekziston një lidhje e caktuar ndërmjet llojit të veprës penale dhe llojit të gjurmës, lidhje kjo që mund të shërbejë si tregues me rastin e kërkimit të gjurmëve të kontaktit në vendin e kryerjes së veprës penale.

Klasifikimi i gjurmëve sipas llojit të materialit të lënë: Një mënyrë tjetër e ndarjes është ajo sipas llojit të materialit, nga i cili përbëhet gjurma. Kështu, kemi gjurmë metalesh, xhamash, gjurmë plastike, mirëpo, edhe këtu ka kufizime. P.sh.: shenja e gishtit në gotë ekzaminohet njësoj si shenja e gjetur mbi një sipërfaqe plastike ose sipërfaqe tjetër të tejdukshme. Po kështu, edhe gjurma mbi një sipërfaqe metali do të ekzaminohet dhe krahasohet njësoj si gjurma e gjetur mbi një material tjetër, ta zëmë, në dru.

Klasifikimi sipas prejardhjes: Gjurma mund të jetë fizike, kimike dhe biologjike; një skemë tjetër e ndarjes do të ishte ajo e gjurmëve me prejardhje shtazore, bimore ose minerare. Sipas klasifikimit të parë, “gjurmë fizike” do të ishin arma e zjarrit(*arma është provë materiale, mjet me të cilin është kryer apo që dyshohet të jetë kryer krimi. Këtu është paraqitur si diçka fizike, në kuptimin e sendit*), mjeti, gjurma e mjetit, gëzhojat, kurse një mostër droge do të ishte “gjurmë kimike”.

“Gjurmë biologjike” do të ishin p.sh.: flokët, marihuana dhe gjurmët e gjakut. Ky klasifikim ka një vlerë të madhe si tregues me rastin e përzgjedhjes së metodave më të përshtatshme për mbledhjen dhe ruajtjen e materialit provues. Në tabelën me poshtë janë radhitur shembujt e disa gjurmëve materiale të klasifikuara sipas kësaj që u tha më lart.

Klasifikimi sipas gjendjes agregate: Varësisht nga gjendja e tyre agregate gjurmët mund të klasifikohen në gjurmë të gazta, të lëngëta dhe të ngurta. Shumica e gjurmëve materiale në vendin e ngjarjes kriminale janë në gjendje të ngurtë, p.sh.: rrobat, mjete, arma, xhami, letra etj. Gjurmë të rëndësishme në gjendje të lëngët janë, gjurma e gjakut të freskët apo lëndët djegëse të lëngëta në rast dyshimi për zjarr vënie. Mostrat e gazta mbledhen rrallë, ndonëse prania e gjurmëve të gazta është e shpeshtë. Në treg mund të gjenden vegla të ndryshme për mbledhjen e materieve të gazta në vendin e kryerjes së veprës penale ose në vendin e zjarrit.

Klasifikimi sipas pyetjes së cilës i duhet përgjigjur: Sipas këtij klasifikimi, gjurmët materiale renditen varësisht se a do të shfrytëzohen ato me rastin e rikonstruktimit të ngjarjes për të lidhur të dyshuarin me të dëmtuarin ose me vendin e kryerjes së veprës penale si dhe për të përjashtuar ose për të liruar të dyshuarin. Po kështu, gjurmët mund të klasifikohen, varësisht nga ajo se a do të shërbejnë ato si pistë në përpunimin kriminalistik apo si material provues në gjykatë.

Klasifikimi sipas mënyrës së krijimit: Si bazë e këtij klasifikimi mund të shërbejë edhe lidhja e gjurmës me ngjarjen kriminale që përpunohet. Në këtë rast, është me rëndësi të merret parasysh mënyra në të cilën kanë ndërvepruar personat e përfshirë si edhe rrethi përqark dhe llojet e gjurmëve që kanë lindur me rastin e këtyre ndërveprimeve. Ekzaminimi dhe interpretimi i gjurmëve bën të mundur krijimin e idesë për ngjarjet e zhvilluara. Pra, ndonëse jo e përkryer, gjurma materiale është një shprehje e paqëllimtë e ndërveprimit të personave dhe mjedisit në vendin e ngjarjes. Një shikim i tillë i gjurmëve mund të ketë dobi të jashtëzakonshme në përpunimin kriminalistik dhe me rastin e rikonstruktimit të ngjarjes⁸³.

Klasifikimi sipas llojit të gjurmës. Sipas prejardhjes gjurmët mund të jenë të mjeteve/veglave, gjurmët e gishtërinjve, gjurmët e materieve organike, gjurmët e xhamit, gjurmët e gomave të makinës, gjurmët e ngjyrave, gjurmët e materialeve artificiale, gjurmët e drurit, gjurmët e pluhurit, gjurmët e spermës, gjurmët në letër, gjurmët e dheut, gjurmët e

⁸³Henry C.Lee, Materijalni Tragovi, Zagreb, 1998, faqe 5-6.

pëlhurës, gjurmët e armës, gjurmët e materialit ndërtimor, dokumentet, gjurmët e metalit, gjurmët e gjakut, gjurmët e mineraleve, gjurmët e materieve joorganike, gjurmët e zërit, video incizimet⁸⁴.

Gjurmët mund të klasifikohen edhe sipas prejardhjes së tyre. Klasifikimi i gjurmëve materiale sipas prejardhjes është si në vijim:

Biologjike	Kimike	Fizike (shenjat)	Të tjera
Gjak	Pëlhurë	Shenja të gishtërinjve	Etiketa në rroba
Spermë	Kimikate	Gjurmë të armës së zjarrit	Poligraf
Sekrecione të hundës	Xham	Dorëshkrim	Incizim zëri
Lëngje të tjera trupore	Dhe	Material i shtypur Fotografi	
Flokë	Barut	Numra dhe shenja mbi metal	
Bimor	Metal	Gjurmë të këpucëve	
Eshtra	Minerale	Gjurmë të gomave të makinës	
Inde	Drogë	Gjurmë të mjeteve/veglave	
Urinë	Letër	Makinë shkrimi	
	Ngjyrë		

Tabela 1. (tabelë nga HenryC.Lee, Materijalni Tragovi, 1998, Zagreb)

⁸⁴Henry C.Lee, Materijalni Tragovi, Zagreb, 1998, faqe 5-6.

4.6 Ku duhet kërkuar gjurmët

Gjurmët pra, gjenden në vendin e krimit dhe për t'i kërkuar, fiksuar, gjetur, ekzaminuar ato, duhen njohuri të caktuara nga fusha të ndryshme dhe përvojë në këto fusha. Ato duhet kërkuar në:

- ***Në vendin e ngjarjes***

Meqë gjurmët gjenden në vendin e krimit ose në vendin e ngjarjes, mund të themi se ato na tregojnë për ekzistencën ose jo të veprës penale. Me ekzaminimin e tyre, ne mund të vijmë deri tek ndjekja apo edhe kapja e autorit të veprës penale. Nëse në një vendngjarje kemi një trup të pajetë, i cili ka dy plagë, dhe në afërsi të tij gjenden edhe gëzhojat, të cilat pas ekzaminimit balistik na dërgojnë tek autori i veprës penale, atëherë këtu kemi gjurmë të cilat na tregojnë se së pari ekziston vepra penale e pastaj edhe gjurmë që na dërgojnë tek autori i veprës. E njëjta analizë vlen edhe kur gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes kemi gjetur gjurmë të gishtërinjve, pas identifikimit të të cilëve kemi gjetur autorin e veprës penale.

- ***Në vetë autorin e veprës penale***

Duke studiuar rrethanat e ndodhjes së veprës, ne bëjmë kërkimin e këtyre gjurmëve edhe tek autori i veprës, të cilat pastaj na dërgojnë tek identifikimi i personit që e ka kryer atë. Gjatë një përleshjeje me mjete të forta apo edhe me mjete të mprehta, kemi persona të lënduar nga këto mjete. Pas ekzaminimit të hollësishëm të personave, mund të gjejmë njolla gjaku të viktimës në trupin apo rrobat e autorit/ të dyshuarit dhe anasjelltas.

- ***Në viktimën***

Varësisht nga rasti me të cilin kemi të bëjmë, edhe kërkimi i gjurmëve tek viktimë është i ndryshëm dhe shumë i justifikueshëm. Në një rast përdorimi të dhunës me mjete të forta si shufër metalike, çekan etj., atëherë në trupin e viktimës do të kemi gjurmë të lëna nga veprimi i këtyre mjeteve. Gjurmët na ndihmojnë në vërtetimin e identitetit të viktimës ose të një personi të panjohur. Gjithashtu, gjurmët tregojnë edhe vërtetësinë e deklaramit të viktimës në raste të ndryshme. Pas një rasti dhunimi, në viktimën e

dhunuar do të gjejmë gjurmë të ndryshme si lëngje trupore (spermë, pështymë etj), lëndime trupore e kështu me radhë.

- ***Në objektet (lëndët, mjetet) që janë përdorur me rastin e kryerjes së veprës penale***

Gjurmët na tregojnë edhe mjetet apo lëndët me të cilat është kryer vepra penale ose mjetet që janë përdorur për kryerjen e saj. Në një rast vjedhjeje të rëndë, në derën e hyrjes do të gjejmë gjurmë të gishtërinjve, gjurmë të veglave etj., apo edhe në mjetet që janë përdorur me këtë rast, shufra hekuri, gërshërë metali, kaçavida etj. do të gjejmë gjurmë të cilat kanë ardhur si rezultat i teorisë së transferit. Pra, në këtë rast, ndodh transferimi i mikrogjurmëve nga njëri objekt në tjetrin.

- ***Në vendet që janë në lidhje me veprën penale***

Gjurmët tregojnë edhe vendet të cilat kanë lidhje me veprën penale, ta zëmë vendi ku është bërë përgatitja ose planifikimi i veprës penale apo edhe vendi që i dyshuari pas kryerjes së veprës penale shfrytëzon për të lënë sendet e vjedhura ose mjetet me të cilat ka kryer veprën.

4.7 Gjurmët sipërfaqësore dhe ato të thelluara

1. Gjurmë të thelluara (tredimensionale)

2. Gjurmë sipërfaqësore (dydimensionale)

1. Gjurmët e thelluara apo tredimensionale, janë ato gjurmë të cilat me rastin e kontaktit nga objekti lënës, formojnë relievin e gjurmës së këtij objekti në tre përmasa: gjerësi, gjatësi dhe thellësi. Këto gjurmë pra, depozitohen ose lihen nga objekti i cili është më i fortë se objekti në të cilën lihet gjurma. Këtu vlen të përmenden gjurmët e këpucëve, gomave etj. Këto gjurmë gjenden në vendin e ngjarjes, në përgjithësi në ato zona ku sipërfaqja është e butë si në argjilë, rërë ose borë dhe kur kryerësi i veprës ka ecur mbi këtë sipërfaqe. Gjithashtu, këto gjurmë mund të mbeten edhe nga gomat e veturave në sipërfaqe të buta, jo të asfaltuara. Prania e këtyre gjurmëve është argument i sigurt i kontaktit të

objektit që ka lënë gjurmën me sipërfaqen ku ajo ndodhet, mekanizmin e formimit, kohën, vlerat identifikuese si dhe përcaktime të tjera për llojin e mjetit, të dhëna për paraqitjen fizike të autorit të veprës penale. Gjurmët e gjetura flasin për mundësinë, nëse kontakti ka ndodhur ose jo. E kaluara e gjurmës ndihmon në identifikimin e llojit të saj.

2. Gjurmët sipërfaqësore apo dydimensionale

Janë ato gjurmë të cilat me rastin e kontaktit të objektit me sipërfaqen e pasqyrojnë atë në dy përmasa, gjatësi dhe gjerësi. Këto gjurmë gjenden në vendin e ngjarjes në ato zona ku sipërfaqja është e fortë. Këto sipërfaqe mund t'i hasim në ballkonet e shtëpive, asfalt, dyshemetë e forta, parke etj.

Vlera e këtyre gjurmëve është tejet e madhe, pasi këto na tregojnë apo janë një argument i sigurt i kontaktit të objektit me sipërfaqen.

4.8 Zbulimi dhe fiksimi i gjurmëve

Gjurmët, sendet dhe provat materiale që kanë lidhje me veprën penale ndodhen të shpërndara në qendrën e vendit të ngjarjes dhe në periferi të saj. Me “qendër” duhet kuptuar vendi ku gjenden objektet që kanë më shumë gjurmë, kufoma, vendi i thyerjes, vatra e zjarrit, automjeti i dëmtuar etj., ndërsa me “periferi” duhet kuptuar vendi që përmban pasojat e veprës penale si gjurmët e autorit të veprës penale, sendet e hedhura ose të lëna prej tij, kërkimi i kufomës kur nuk gjendet në vendin e ngjarjes⁸⁵. Këto gjurmë kërkohen nëpër gjithë vendin e ngjarjes me sy dhe duke përdorur mjete të ndryshme, duke filluar nga ndriçimi i zonës ku kontrollohet, për të vazhduar pastaj me përdorimin e mjeteve të ndryshme për t'i bërë ato të dukshme. Këto mjete janë pluhurat e ndryshëm, kimikatet, pajisjet e tjera, që kur përdoren i bëjnë këto gjurmë të duken.

Gjatë kontrollimit për gjurmë, kur i hasim, ato duhen fiksuar duke përdorur shtiza të holla metali në formë të flamurit, në mënyrë që kur bëjmë dokumentimin e tyre me numrat përkatës të mos humbasin. Pra, pasi kemi bërë fiksimin e tyre, ato duhen fotografuar me

⁸⁵Dr.Vesel Latifi, Kriminalistika, zbulimi dhe të provuarit e krimit, Prishtinë, 2009, faqe 368.


njësi matëse në mënyrë që të dihet madhësia reale e tyre, nëse kërkohet. Pasi të jenë kryer të gjitha veprimet e tjera siç janë matjet, fotografimi e kështu me radhë, ato duhet të paketohen dhe të merren me një kujdes të veçantë. Gjatë marrjes së gjurmëve, duhet pasur parasysh se ato duhet të paketohen veç e veç, në mënyrë që të mos krijohet kontakt dhe fërkim mes tyre. Në këtë mënyrë mund të shmangemi nga teoria e transferit. Të gjitha veprimet e mësipërme shënohen në procesverbalin e provave.

Gjurmët, të cilat hasen më shpesh në vendin e ngjarjes janë gjurmët e gishtave, gjurmët e këpucëve dhe gomave, gjurmët e veglave, gjurmët e armëve, gjurmët e zjarrit, gjurmë biologjike etj.

4.9 GJURMËT E GISHTËRINJVE

Sipërfaqja e brendshme e duarve, prej gishtërinjve deri tek nyja, përmban kreshta me vargje në mes çdo vije.

Një segment i gishtit duket pikërisht si një segment i arës së lëruar.



a b c

a. Shenjat e gishtërinjve b. Vijat papilare dhe poret c. Ara e lëruar

Fig.12 Vijat papilare

Gjurmët e gishtërinjve janë të gjitha ato vija apo kreshta të padukshme, gjysmë të dukshme ose të dukshme, që formohen nga shtresat e lëndës djersë-yndyrore të gishtërinjve, e cila gjendet në to dhe depozitohet (lihet) gjatë kontaktit me sipërfaqen e cila është prekur.

Këto vija gjenden vetëm në sipërfaqen e duarve dhe të shputës së këmbës së zbathur. Këto vija apo rrudha quhen edhe PAPILA – kreshta.

Siç dihet, lëkura e njeriut përbëhet nga dy shtresa, epiderma dhe derma. Epiderma është shtresa e sipërme e lëkurës dhe derma është shtresa ku gjenden papilat të cilat lirojnë

djersën dhe yndyrën që ka njeriu⁸⁶. Kjo djersë dhe yndyrë lirohet përmes poreve të cilat gjenden nëpër kreshta, në majat e tyre.

Papila është e ngritur mbi lëkurë afro 0.1 - 0.25 mm, kurse gjerësia e saj është 0.2 - 0.5 mm⁸⁷.




Fig.13 Gjurmët e gishtërinjve (prerja e tërthortë)

Djersitja është proces i vazhdueshëm, në të cilin poret paraqiten si burime të vogla mikroskopike, të cilat vazhdimisht, në një masë më të vogël apo më të madhe lirojnë djersën. Djersa me ujë përmban edhe substanca organike edhe inorganike (kripa e kuzhinës, urina, acidet, sidomos aminoacidet dhealbuminat). Lirimi i djersës, sidomos substancat organike në djersë, kryejnë funksion të ngjashëm sikurse në shtypshkronjë që e kryejnë

⁸⁶“Derma” nga greqishtja - do të thotë Lëkurë

⁸⁷Dr.Vesel Latifi, Kriminalistika,zbulimi dhe të provuarit e krimi, Prishtinë, 2009, faqe 372.

mjetet e ngjyrave, vetëm se për dallim, ngjyrimi natyror i gjurmëve të vijave papilare shpesh është pak i dukshëm apo i padukshëm⁸⁸.

Gjurmët e gishtërinjve janë unike, një gisht - një gjurmë gishti. Ato janë të përhershme dhe të rigjenerueshme, në rast se nuk është dëmtuar derma (indi). Nuk ndryshojnë asnjëherë, përveç madhësisë së tyre. Madhësia e gishtit të foshnjës rritet me rritjen dhe zhvillimin e saj. Deri sot nuk janë gjetur dy njerëz në botë që të kenë gjurmë të njëjta gishtërinjsh.



Fig.14. Vijat papilare në sipërfaqen nën gishtore

⁸⁸Prof. dr. sc. Dushko Modly, TEORITË BASHKËKOHORE KRIMINALISTIKE, Titulli i origjinalit: "SUVRÉMENE KRIMINALISTIČKE TEORIJE" Përktheu nga kroatishtja: prof. Mustafë Reçica, SARAJEVË / Prishtinë, 15. 01. 2007, FSK/S - 14/06, faqe 39.

4.10 Sipërfaqet ku gjenden gjurmët e gishtërinjve

Gjurmët e gishtërinjve gjenden në sipërfaqe të ndryshme. Këto sipërfaqe mund të jenë:

a. Poroze - thithëse, janë sipërfaqe që thithin lagështi, p.sh.: letra.

b. Jo-poroze - jo thithëse, janë sipërfaqe që nuk thithin lagështi, p.sh.: dyert, dritaret, xhamat, objektet plastike, porcelani, qeramika, hekuri etj.

Gjurmët e gishtërinjve gjenden kudo ku autori i veprës ka prekur sendet me dorë në vendin e ngjarjes. Varësisht nga vepra e ndodhur, këto gjurmë mund të gjenden nëpër vende të ndryshme, p.sh.: në një rast vjedhjeje këto gjurmë duhen kërkuar më shumë dhe mund të gjenden në derën e hyrjes apo dritare, nëpër tavolina, rafte etj.

Në rastet e vrasjeve apo kur janë përdorur armët, ato mund të gjenden në vetë armën, në mjetet e tjera si thika, shkopi etj., ndërsa në rastet e vetëvrasjeve në letrën e fundit, apo në letrën kërcënuese në rastet e kërcënimeve.

Gjetja e gjurmëve të gishtërinjve në një vendngjarje është argument i sigurtë i kontaktit të atij që ka lënë gjurmën me sipërfaqen, madje edhe argument i sigurtë i prezencës së tij në vendngjarje.

4.11 Faktorët dhe kushtet e tërheqjes apo marrjes së gjurmëve të gishtërinjve

Faktorët ose kushtet para tërheqjes - duhen pasur parasysh faktorët dhe kushtet që ekzistojnë para tërheqjes së gjurmëve të gishtërinjve. Së pari merret në konsideratë faktori kohë, i cili është mjaft i rëndësishëm. Pra, gjurmët duhen kërkuar në ato vende që dyshohet se janë prekur nga kryerësi dhe në ato objekte të përshtatshme për t'i mbajtur këto gjurmë. Pa humbur kohë dhe pas fiksimit të tyre, nuk duhet të lihen gjatë pa u tërhequr. Faktorët që ndikojnë në prishjen apo dëmtimin e tyre janë temperatura, lagështia etj.

Faktorët ose kushtet gjatë tërheqjes - gjatë tërheqjes së tyre duhen përdorur teknikat e përshtatshme për tërheqjen e gjurmëve të gishtërinjve. Varësisht se me çka i kemi zhvilluar apo nxitur apo çka kemi përdorur për zhvillimin dhe nxitjen e tyre, duhet kujdes gjatë përdorimit të këtyre mjeteve që shërbejnë për nxitjen dhe zhvillimin e tyre (sasinë e përdorur të kimikateve, përzierjen e tyre etj.).

Faktorët ose kushtet pas tërheqjes - pas tërheqjes, duhet që gjurmët e tërhequra të vendosen me kujdes nëpër kartelat për vendosjen e gjurmëve latente të gishtërinjve. Pastaj, ato të paketohen në mënyrën e duhur, që asnjë faktor i jashtëm të mos ndikojë për t'i dëmtuar ato. Faktorë të mundshëm për dëmtimin e tyre pas tërheqjes janë paketimi jo i duhur, lënia e tyre në temperaturë të lartë apo ekspozimi direkt në rrezet e diellit.

4.12 Llojet e Gjurmëve të Gishtërinjve

Ekzistojnë tri lloje të gjurmëve të gishtërinjve:

Të dukshme - janë gjurmët e formuara me njollosje nga substancat e jashtme (gjaku ose pluhuri) dhe si rezultat i kësaj bëhen të dukshme. p.sh.: gjurmët në sipërfaqe të caktuar ku ka gjak apo pluhur.

Të padukshme - janë gjurmët e fshehura, të padukshme ose gjysmë të dukshme, që nuk shihen me sy, por që ato të duken, duhet të zhvillohen duke përdorur mjetet për nxitjen e tyre apo edhe kimikatet.

Plastike apo të thelluara - Këto gjurmë gishtash formohen kur gishtat prekin mbi materiale të buta dhe krijojnë edhe thellësinë, p.sh.: sapuni, plastelina, çokollata etj.

4.13 Standardet e identifikimit të gjurmëve të gishtërinjve

Standardet e identifikimit të këtyre gjurmëve dallojë varësisht nga vendet e ndryshme si dhe nga përcaktimi ligjor i tyre. Varësisht prej shtetit kemi edhe standardet: në SHBA, në Byroën Federale të Hetimeve (FBI), nuk kërkohet numër i caktuar i këtyre pikave, në Australi kërkohen 12 pika për identifikimin e këtyre gjurmëve; në Francë dhe Itali kërkohen 16 pika etj. Në disa shtete të Evropës si Belgjikë, Greqi, Rumani, Portugali,

Zvicër, Poloni etj., zbatojnë si numër minimum për të arritur në identifikim 12 pika⁸⁹. Në Republikën e Kosovës nuk ka numër të caktuar të pikave gjatë identifikimit. Kjo arrihet duke punuar në nivelin e tretë të identifikimit dhe mendimin e tre ekspertëve. Pra, niveli i tretë i identifikimit përcakton apo analizon skajet e vijave papilare, fundin/përfundimin e tyre, poret si dhe përbërjen e tyre. Nëse eksperti është në gjendje të punojë në nivelin e tretë të identifikimit, atëherë mund të themi se kemi një ekzaminim bindës dhe shumë profesional, duke ditur se ky nivel kërkon njohuri të mëdha sa i përket fushës së identifikimit. Në vazhdim po i përmendim tri nivelet e identifikimit për t'ua sqaruar atë që u tha më lartë.

Niveli i parë i identifikimit është dallimi i gjurmëve/shenjave të gishtërinjve me karakteristika grupore, pra përcaktimi i grupit/modelit të gjurmës/shenjës (harkore, rrethore, lakore).

Niveli i dytë i krahasimit është ai që dallon karakteristikat individuale siç janë fundi i vijes, bifurkacioni, liqeni, pika, shpatulla etj., dhe

Niveli i tretë siç u tha më lartë, përcakton apo analizon skajet e vijave, fundin/përfundimin e tyre, poret si dhe përbërjen e tyre.

Personalisht mendoj se nuk duhet pasur standard të pikave gjatë identifikimit. E them këtë sepse gjatë ekzaminimit të gjurmës e cila si standard ka 17 pika dhe nuk është arritur të gjinden aq pika sa kërkon standardi i caktuar, por janë gjetur vetëm 15 pika, në këtë rast, ky krahasim nuk do të pranohet dhe gjurma e ekzaminuar do të jetë e pavlerë vetëm pse nuk i ka pikat e kërkuara sipas standardit.

⁸⁹Luan Veliçoti, Kriminalistika, Vëllimi I I, Geer, Tiranë, 2015, faqe 172.

4.14 GJURMËT E KËPUCËVE DHE GOMAVE

Për gjurmët e këpucëve dhe gomave duhet një kërkim nga i gjithë personeli i cili zhvillon këqyrjen e vendit të ngjarjes. Pasi të jetë siguruar vendi i ngjarjes, duhet bërë kërkim edhe për këto gjurmë, të cilat mund t'i këtë lënë autori i veprës. Gjurmët e këpucëve janë prova, që tregojnë përgjithësisht objekte ose materiale, të cilat kanë mbajtur karakteristikat e objekteve dhe materialeve që kanë bërë shtypje në sipërfaqen e caktuar. Bëhet fjalë për sipërfaqe të butë si baltë, borë, dysHEME etj.

Këto gjurmë janë argument i sigurtë i kontaktit të këpucës me sipërfaqen.

Si formë e provës fizike kjo gjurmë mund të sigurojë një lidhje të rëndësishme ndërmjet autorit të veprës penale dhe vendit të ngjarjes.

Çdo herë që një person hedh një hap, këpuca e tij shtyp sipërfaqen e tokës dhe mund të shkaktojë një deformim të kësaj sipërfaqeje ose e tërë kjo, rezulton në transferimin në gjurmë të materialeve dhe mbetjeve në mes të tokës dhe këpucëve.

Gjurmët e këpucëve formohen gjatë lëvizjes së njeriut në ecje, në vrap, në kërcim, por ato formohen edhe kur njeriu ndodhet në qëndrim⁹⁰.

Edhe pse jo të gjitha gjurmët janë të dukshme ose të dallueshme, gjasat janë shumë të mira që disa prej tyre të jenë të lëna në atë mënyrë, që hetuesi i vendit të ngjarjes t'i dallojë lehtë ato.

Gjurmët e këpucëve në shumë raste mund të zbulojnë llojin, të bëjnë përshkrimin, madhësinë nganjëherë të përafërt ose të saktë të këpucës që ka lënë gjurmën. Përveç kësaj, ato mund të tregojnë edhe vendndodhjen e autorit të veprës. Gjithashtu, gjurmët e këpucëve mund të ndihmojnë edhe në përcaktimin e numrit të të dyshuarve në vendin e ngjarjes, përfshirë këtu edhe rrugën e ardhjes, qëndrimin dhe ikjes nga vendi i ngjarjes. Ato mund të përcaktojnë gjithashtu edhe gjininë, shtatin, nganjëherë edhe profesionin. Në kërkim të gjurmës së këmbëve vihet edhe qeni i kërkimit në bazë të erës së trupit të autorit të veprës.

⁹⁰Prof. Dr. Skender Begeja, Kriminalistika, Vëllimi i I, 2001, Tiranë, faqe 136.




Fig.15. Gjurmët e këpucëve pas marrjes dhe mostra standarde

Nëse sipërfaqja është e butë dhe e lejon presionin e ushtruar nga këpuca, atëherë do të kemi një gjurmë të përkohshme apo edhe të përhershme të gjurmës dhe në këtë mënyrë do të marrim karakteristikat e nevojshme. Pra, nëse sipërfaqja është me borë, rërë apo baltë, do të kemi një gjurmë këpuce tredimensionale d.m.th. do të kemi gjurmën me gjerësi, gjatësi dhe thellësi. Nëse sipërfaqja nuk është e butë si asfalt, dysHEME e fortë etj., do të kemi një gjurmë dy dimensionale e cila ka vetëm gjerësi dhe gjatësi.

Në çdo vendngjarje duhet të merret parasysh mundësia e gjetjes së gjurmëve të këpucëve. Ekspertët e vendit të ngjarjes duhet të jenë këmbëngulës në kërkimin e tyre. Mungesa e suksesit në gjetjen e këtyre gjurmëve shpeshherë vjen nga:

- mosbesimi se ato do të gjenden në vendin e ngjarjes
- kërkimi jo i plotë nëpër tërë vendin e ngjarjes, ndoshta për mungesë të përcaktimit të pikës së hyrjes dhe daljes
- ardhja në vendin e ngjarjes e personave të paautorizuar
- kushtet atmosferike si një ndër faktorët që i prishin ato

4.15 Ku duhet kërkuar këto gjurmë?

Zonat më të mira për të kërkuar gjurmë të këpucëve janë:

-Pikat e vështimit

-Rruga deri tek vendi i ngjarjes

-Pika e hyrjes

-Lëvizja përgjatë vendit të ngjarjes

-Pika qendrore e vendndodhjes

-Pika e daljes

-Rruga e ikjes

4.16 Marrja e këtyre gjurmëve

Marrja e këtyre gjurmëve bëhet me mullazhim, duke përdorur gurin dental të përzier me ujë. Sasia e preferuar është 0,900 gr. guri dental, i cili përziehet me 0.340 l ujë, përzierje që me kujdes hidhet mbi gjurmën e lënë, e cila është e rrethuar paraprakisht me kornizën metalike dhe është tharë (ngrirë) me spray-in e tharjes. Pasi thahet dhe merr gjendjen e ngurtë, nga kjo përzierje fitojmë gjurmën e këpucës, të cilën mund ta pastrojmë me kujdes edhe me ujë dhe do të kemi një gjurmë, të cilën mund ta krahasojmë me mostrën që kemi marrë nga personi i dyshuar.



Fig.16 Pajisjet për marrjen e gjurmëve të këpucëve



Fig.17. Përgatitja e materialit për mullazhim (marrjen e gjurmës së këpucëve)



Fig.18 Gjurmët sipërfaqësore (dy-dimensionale)

4.17 ZBULIMI DHE MARRJA E GJURMËVE TË VEGLAVE

Gjurmët e veglave janë prova që përfshijnë standarde të njohura dhe të panjohura, pasi çdo shtypje, prerje, gërryerje ose gdhendje e lënë nga vegla pasi vjen në kontakt me objektin është gjurmë e veglave.

4.18 Veglat

Vegël është çdo objekt, që ka mundësi të bëjë shtypje në një objekt tjetër të fortë, p.sh: sëpatat, thikat, kaçavidat, daltat, qyskitë, pincat, gërshërët (për prerjen e metalit), etj.

4.19 Si janë formuar gjurmët e veglave

Fajtorët, për të arritur qëllimin e tyre kriminal, shkatërrojnë, theyejnë, dëmtojnë pengesa dhe objekte, duke përdorur mjete teknike dhe forcë fizike. Shkatërrimi i tyre bëhet me mënyra të ndryshme: me shqyerje, me hapje vrimash, me goditje, me prerje, me sharrim, me hapje të bravave, kasafortave, dyerve metalik⁹¹.

4.20 Ndrydhja (shtypja)

Është gjurmë statike e bërë nga goditja gjatë përdorimit të veglës.



Fig.19. Ndrydhja nga goditja me çekan

⁹¹Prof. dr. Skënder Begeja, Kriminalistika vëllimi i I-rë, 2001, Tiranë, faqe 149, 150

4.21 Fërkimi dhe prerja

Fërkimi është gjurmë lëvizëse e cila më së shpeshti lë vragë në skajet (tehet) e veçanta të sendeve, p. sh.: gërshërët, pincat, levat, kaçavidat etj.



Fig.20. Veglat (mjetet) për prerje

4.22 Përsëritja (gjurmë-sharrimi)

Është një gjurmë lëvizëse e bërë nga veglat përsëritëse siç janë limat apo sharrat. Këto gjurmë janë të vështira për t'u identifikuar, për shkak të numrit të madh të dhëmbëve dhe gjurmëve të çrregullta që mbeten.




Fig.21 Sharrimi në hekur (foto nga autori)



Fig.22 Sharrimi në dru(foto nga autori)

4.23 Kombinimi

Shpesh, gjatë përdorimit të tyre në vendngjarje të ndryshme dhe në vepra penale të ndryshme, veglat mund të lënë gjurmë të kombinuara, shtypje dhe fërkim. Në varësi të mjetit të përdorur, mund të kemi një gjurmë të veglës e cila është lënë aty. Nëse janë përdorur dy-tre lloje veglash, atëherë kemi kombinim të gjurmëve.



Fig.23 Veprimi i veglës (foto nga autori)

Fig.24 Kaçavidat (foto nga autori)

4.24 Përcaktimet nga studimi i gjurmëve të veglave

Gjurmën e veglës me vegël

- A. Vërtetimin e pranisë ose mos pranisë së karakteristikave të kategorive.
- b. Ekzaminimi i veglës për praninë e shtresave të huaja siç janë ngjyra ose metali që të krahasohet objekti i shënuar.

Gjurmën e veglës pa vegël

- a. Madhësia e veglës së përdorur
- b. Lloji i veglës së përdorur
- c. Veçoritë e pazakonshme të veglës
- e. Nëse gjurma e veglës ka vlerë për qëllime identifikimi

f. Forcën e autorit të veprës që ka përdorur veglën

h. Mikrogjurmë me përmbajtje organike dhe inorganike

Përfundimet

1. Që vegla e ka lënë gjurmën (e veglës)
2. Që vegla nuk e ka lënë gjurmën (e veglës)
3. Autorin e veprës, në rast se në vegël janë zbuluar gjurmë papilare ose biologjike

4.25 Ku gjenden dhe si merren këto gjurmë

Këto gjurmë gjenden në të gjitha vendngjarjet ku kemi të bëjmë me raste vjedhjesh, grabitjesh, vjedhjesh grabitqare dhe në raste të tjera. Ato mund të gjenden kudo në vendin e ngjarjes; në ato vende ku është përdorur vegla si mjet për të thyer ose për të hapur pengesën, që paraprakisht është shfaqur për autorin e veprës. Në një rast vjedhjeje, këto gjurmë mund të gjenden në dyert e shtëpisë, dyert e dhomave, dritare, kasaforta, kasa etj. Pra, një kujdes i veçantë kërkohet nga ekspertët e vendit të ngjarjes, të cilët bëjnë këqyrjen, për të ditur në ç‘vend duhet kërkuar për këto gjurmë. Këto gjurmë duhen kërkuar në ato vende, të cilat dyshohet se janë hapur me forcë nga i dyshuari, duke përdorur mjete më të cilat ka hapur ose ka thyer pengesat e ndryshme që i janë paraqitur në vend.

Këto gjurmë merren duke përdorur Mikrosil. Ai është mjeti apo substanca që përdoret për marrjen e gjurmëve të veglave, gjurmëve të gishtërinjve nga sipërfaqet e forta apo shenjave të gishtërinjve nga kufomat. Mikrosili bën pasqyrim të shkëlqyer dhe të saktë të gjurmës, në të cilën është hedhur dhe detajeve shumë të vogla që gjenden në të.

Ai përbëhet nga dy komponentë:

Tubi i madh, i cili përmban material stuko (me ngjyrë të bardhë, të zezë, hiri etj.) dhe tubi i vogël, që përmban katalizator gjithashtu me ngjyra të ndryshme. Për të përfutur këtë substancë, mikrosili hidhet së pari në një letër të fortë dhe dy komponentët e tij përzihen me një shpatull druri.



Fig.25 Mikrosili me shpatullat dhe letrën e fortë




Fig.26 Përgatitja e mikrosilit dhe vendosja në vendin e dyshuar për gjurmë
(foto nga: http://toolmarks_pictures.jpg)

KAPITULLI V

PËRMBLEDHJE E KAPITULLIT TË V

Vepra penale e vrasjes si një vepër e shëmtuar dhe e dëmshme për shoqërinë kërkon një hetim dhe zbulim të suksesshëm me qëllim që dënimet dhe sanksionet që do të pasojnë më vonë, të kenë ndikim në vetëdijesimin e të gjithë atyre që kryejnë këto vepra. Zbulueshmëria e këtyre veprave varet gjithmonë nga gjurmët dhe provat materiale që do të gjenden në një vend të ngjarjes, ku kemi të bëjmë me këtë vepër penale. Hetimi i veprës penale të vrasjes është njëra ndër veprimet hetimore shumë të rëndësishme, në punën të cilën e bëjnë hetuesit e rasteve të tilla. Kjo kërkon një profesionalizëm të lartë nga hetuesit si dhe një qasje të drejtë në kuptimin e hetimit sa më real, gjithnjë duke u bazuar në provat dhe faktet që ofron puna në terren. Edhe kjo punë kërkon një mbështetje ligjore sa i përket procedurave të marrjes së këtyre provave. Kjo mbështetje duhet të jetë e bazuar në procedurat dhe ligjet që janë në fuqi, të cilat duhet të zbatohen me rastin e hetimit të këtyre veprave. Duke filluar nga hetimi i vendit të ngjarjes, pastaj kërkimi i gjurmëve dhe provave materiale për të faktuar një gjë të tillë, gjithsesi kërkohet një harmonizim me procedurat e zbatueshme, në mënyrë që këto prova të jenë sa më të forta në kuptimin e vlefshmërisë së tyre. Në këtë kapitull janë paraqitur llojet e vrasjeve të parashikuara me KP dhe KPP të Republikës së Kosovës. Gjithashtu, që një rast i hetimit të këtyre veprave penale të ketë sukses duhet të menaxhohet në mënyrë të duhur, gjithnjë duke respektuar të gjitha parimet dhe procedurat si dhe rregullat e normat ligjore të cilat nevojiten me këtë rast.

Menaxhimi i mirë i një hetimi të rastit të vrasjes, pa dyshim që kërkon aftësi, shkathhtësi dhe një qasje profesionale, në mënyrë që gjatë këtij procesi të arrihen rezultate të dëshiruara. Në hetimin e një vendi të ngjarjes në një rast vrasjeje, rol të rëndësishëm luajnë edhe organet e ndjekjes ku përfshihen polica, prokuroria dhe gjykatat. Që ky bashkëpunim të jetë sa më efikas, atëherë duhet që i njëjti të bazohet në ligjet dhe rregulloret që kanë këto institucione të ndjekjes. Edhe këto janë paraqitur në këtë punim si dhe është paraqitur edhe roli i gjykatës së bashku me kompetencat që ka ajo. Kompetencat e prokurorisë dhe gjykatave luajnë një rol gjithashtu të madh në zbatimin e këtyre rregulloreve dhe aplikimin e ligjeve në fuqi.

5. KUPTIMI I VEPRËS PENALE TË VRASJES

Jeta e njeriut është e drejtë absolute, e drejtë natyrore. E drejta për jetë është para të gjitha të drejtave të tjera, është e drejta më e rëndësishme. Me humbjen e jetës humbin të gjitha të drejtat e tjera, humb ekzistenca e njeriut. Krahas jetës, edhe integriteti trupor konsiderohet një ndër vlerat themelore të njeriut, prandaj është e kuptueshme përse e drejta penale i kushton rëndësi të madhe mbrojtjes së këtyre të mirave juridike⁹².

Vrasja si vepër ka ekzistuar që nga kohët e lashta. Që atëherë njerëzit kanë pasur mosmarrëveshjet e tyre, problemet e tyre, të cilat edhe pse nuk kanë qenë të natyrës së njëjtë me problemet që njeriu ka sot, megjithatë si rrjedhojë e gjithë këtyre rrethanave kemi pasur rastet e privimit nga jeta të njerëzve të ndryshëm nga njerëzit e ndryshëm. Pra, lirisht mund të themi se vrasja si krim ka filltet e saj, nga fillimi i njerëzimit. Në kohët moderne ky lloj i krimit sanksionohet duke u mbështetur në ligjet që janë në fuqi nëpër vende ku këto vepra ndodhin. Varësisht nga vendet/shtetet edhe dënimet mund të ndryshojnë apo të kenë dallime, por në përgjithësi kjo vepër është e dënueshme nëpër të gjitha vendet e botës dhe nëse gjejmë ndonjë dallim në këto dënime apo në shqiptimin e tyre, atëherë ai dallim mund të jetë në mënyrën ose lartësinë e dënimit apo edhe në ndonjë moment tjetër më të parëndësishëm.

Vepra penale e vrasjes pa dyshim se është vepër e rëndë dhe e dënueshme, por ajo në vete përmban edhe pasojat e rënda. Krimi i vrasjes kryhet kur i pandehuri ka shkaktuar vdekjen e viktimës dhe ka dashur ta vrasë atë apo t'i shkaktojë dëmtim të rëndë fizik⁹³. Këto pasoja përveçse i shkaktohen personit i cili është viktimë në këtë vepër, të njëjtat bien edhe mbi anëtarët e tjerë të familjes, të cilët goditen drejtpërdrejtë nga kjo, duke ju shkaktuar dhembje dhe ç'rregullim të rendit familjar në njërin anë dhe pasoja do të ketë edhe mbi personin i cili kryen këtë vepër në anën tjetër, sepse dënimi që do ta marrë ai me këtë rast, mungesa e tij në familje etj., gjithashtu do të jetë pasojë e rëndë për ta, duke ditur se përgjegjësi për një rast të tillë mund të dënohet me vite të tëra me burgim dhe kjo mungesë është e theksueshme tek pjesa tjetër e familjes. Pra, jo vetëm ana juridike ligjore

⁹²Ismet Salihu , E Drejta Penale, Pjesa e Posaçme, Prishtinë 2009, faqe 27

⁹³Jonathan Herring, E Drejta Penale, Teori, kazuse dhe material, botimi V, volume I, Tiranë 2013, Faqe 241

por edhe aspekti moral, me rastin e vrasjes godet jo një a dy individë, po shumë më shumë të tjerë. Gjithashtu vepra penale e vrasjes, nëse ndodhë shpesh në një mjedis të caktuar ndikon edhe në ndjenjën e sigurisë brenda asaj shoqërie, duke mbjellë pasiguri dhe ndjenjë të frikës edhe në opinionin e gjerë.

Se kjo vepër është e rëndë dëshmon edhe fakti se me vrasje njëherë e përgjithmonë asgjësohet vlera me e madhe e individit dhe e shoqërisë, jeta e njeriut⁹⁴.

5.1 Përcaktueshmëria ligjore

Meqë e drejta e jetës është e garantuar me akte të ndryshme ndërkombëtare si dhe me ligjet e shteteve, atëherë mund të themi se e drejta për të jetuar është e drejtë absolute. Këto akte ndërkombëtare janë: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e Kombeve të Bashkuara (1948), Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore e Këshillit të Evropës (1950) apo edhe Pakti Ndërkombëtar i të Drejtave Civile dhe Politike (1966). Vepra penale e vrasjes është e përcaktuar dhe sanksionuar me kodet penale të shteteve të ndryshme. Në kodin Penal të Republikës së Kosovës, në Pjesën e Përgjithshme, Kapitullin e parë, **Neni 1, Bazat dhe kufijtë e sanksioneve penale**, pika 1 dhe 2 thuhet:

1. Veprat penale dhe sanksionet penale parashihen vetëm për ato sjellje me të cilat cenohen apo dëmtohen në atë masë liritë dhe të drejtat e njeriut si dhe të drejtat tjera dhe vlerat shoqërore të garantuara dhe të mbrojtura me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me të drejtën ndërkombëtare, mbrojtja e të cilave nuk do të mund të realizohet pa dhunën penalo juridike.

2. Parashikimi i veprave penale si dhe llojet e masave dhe lartësia e sanksioneve penale për kryesit e veprave penale bazohen në domosdoshmërinë e sanksionit penalo juridik dhe proporcionalitetit të shkallës dhe natyrës së rrezikshmërisë për liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të vlerave shoqëror⁹⁵.

⁹⁴Dr. Ismet Salihu, Vrasjet në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës, Rilindja, 1984, faqe 9.

⁹⁵KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PJESA E PËRGJITHSHME, KAPITULLI I, DISPOZITAT E PËRGJITHSHME, Neni 1 Bazat dhe kufijtë e sanksioneve penale. Kodi Nr. 04/L-82, 20 prill 2012, Kodi Penal i Republikës së Kosovës hyn në fuqi me 1 janar 2013.

Pra, në pikën e parë të këtij neni thuhet se sanksionet penale parashihen për ato vepra penale, ku dëmtohen liritë dhe të drejtat e njeriut si dhe vlerat shoqërore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Gjithashtu edhe në pikën e dytë të këtij neni parashikohet vepra penale dhe llojet e masave që duhet të merren dhe lartësia e sanksioneve për kryesit e këtyre veprave. Vlen të theksohet se në Kushtetutën e Republikës së Kosovës është e garantuar e drejta për jetën dhe secili individ e gëzon të drejtën për të⁹⁶.

Jeta e njeriut mbrohet nga moment i lindjes deri në vdekje. Pra, objekt i mbrojtës juridiko-penale tek vepra penale e vrasjes është jeta e njeriut. Shtrohet pyetja se kur fillon jeta e njeriut apo përcaktimi i momentit të lindjes së njeriut?

5.2 Përcaktimi i momentit të lindjes

Ky përcaktim është i rëndësishëm, përveç tjerash edhe për dallimin e vrasjes (privimit nga jeta) nga ndërprerja e palejuar e shtatzënisë. Se kur konsiderohet se fillon jeta, lind fëmija, ekzistojnë mendime të ndryshme. Sipas konceptit më të vjetër, për t'u konsideruar se ka lindë fëmija duhet t'i jetë prerë kërthiza dhe kështu të ndahet nga trupi i nënës; sipas disa të tjerëve fëmija lindë kur një pjesë e tij del nga trupi i nënës⁹⁷. Të tjerët mendojnë se fëmija lind prej momentit kur pushon frymëmarrja e placentave, ndërsa grupi i tretë i autorëve janë të mendimit se jeta fillon prej momentit të fillimit të lindjes së fëmijës, përkatësisht të kohëzgjatjes së lindjes. Mendimi i grupit të tretë të autorëve konsiderohet më i drejtë. Në favor të mendimit të grupit të tretë të autorëve është edhe fakti se e drejta penale e parasheh vepër penale të vrasjes edhe rastin kur e ëma e vret foshnjën e saj gjatë lindjes⁹⁸.

5.3 Përcaktimi i momentit të vdekjes

Shtrohet pyetja se kur konsiderohet se është shkaktuar vdekja. Në shkencën e mjekësisë bëhet dallimi midis vdekjes biologjike dhe klinike. **Vdekja biologjike** është absolute dhe

⁹⁶Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 25 E drejta Për Jetën, pika 1, hyrja në fuqi qershor 2008.

⁹⁷Prof.dr. Ismet Salihu, Prof.dr. Hilmi Zhitija, Prof.dr. Fejzullah Hasani, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, KOMENTAR, Botimi I, Kapitulli XVI: Vepra penale kundër jetës dhe trupit, pika 4, faqe 468.

⁹⁸ Po aty, faqe 468.

konsiderohet se ekziston në rastet kur asnjë pjesë e trupit dhe asnjë organ nuk ushtrojnë asnjë funksion jetësor. Kjo vdekje shoqërohet nga dëmtimet e papërsëritshme të funksioneve të korteksit cerebral dhe më pas të të gjitha proceseve metabolike të organizmit⁹⁹. Kjo është vdekje e të gjitha pjesëve të trupit dhe e të gjitha organeve të njeriut. **Vdekja klinike** konsiderohet në rastet kur pushojnë, nuk punojnë disa organe vitale të njeriut, siç janë frymëmarrja, qarkullimi i gjakut, shkaktimi i gjendjes së komës cerebrale, pushimi i aktivitetit të zemrës dhe të mushkërive, por ruhet ende një veprimtari jetësore minimale që zgjat 10 minuta¹⁰⁰. Sot është akceptuar mendimi se moment i shkaktimit të vdekjes duhet konsideruar rasti kur është shkaktuar **vdekja e trurit (vdekja cerebrale)**, ku individi humbet në mënyrë të pakthyeshme personalitetin ndjesimor dhe koshiençën¹⁰¹, ngase pa vetëdije nuk ka as jetë dhe se vdekja e trurit shpie edhe në vdekje biologjike, përkatësisht vdekje absolute.

Jeta e njeriut mbrohet deri në fund, deri sa zgjat, prandaj në shtetet ku është akoma i paraparë dënimi me vdekje, është e ndëshkuar edhe vrasja e personit të dënuar me vdekje, nëse kryhet nga personi i paautorizuar apo nëse kryhet para se të përmbushen të gjitha kushtet, siç janë p.sh.: që aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm apo para se të jetë refuzuar kërkesa për falje e vendimi të marrë formë përfundimtare¹⁰².

E drejta penale e mbron jetën e çdo qenieje njerëzore të gjallë, pa marrë parasysh moshën e saj dhe gjendjen shëndetësore. Vrasja konsiderohet edhe në rastet kur kryhet ndaj personave për të cilët ekzistojnë indikacionet mjekësore se nuk do të jetojnë gjatë, si dhe ndaj foshnjave tek të cilat nuk mund të ushtrohen në mënyrë normale funksionet jetësore¹⁰³.

⁹⁹Prof.dr. Sokrat Meksi, Vdekja nga Dhuna, Medaur, Botimi I Parë, 2005, faqe 10.

¹⁰⁰ Po aty, faqe 10.

¹⁰¹ Po aty, faqe 10.

¹⁰²Prof.dr. Ismet Salihu, Prof.dr. Hilmi Zhitija, Prof.dr. Fejzullah Hasani, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, KOMENTAR, Botimi I, Kapitulli XVI: Vepra penale kundër jetës dhe trupit, pika 6, faqe 469.

¹⁰³Prof.dr. Ismet Salihu, E Drejta penale, Pjesa e Posaçme, Prishtinë 2009, faqe 102.

5.4 Kodi i Procedurës Penale për Këqyrjen dhe Provat

Në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, në Kapitullin XVI, vepra penale kundër jetës dhe trupit nga neni 178 deri në nenin 182 është paraparë vepra penale e vrasjes si dhe llojet, format, mënyrat, rrethanat në të cilat mund të ketë ndodhur. Ligjvënësi në këtë Kod ka paraparë edhe dënimet si dhe rrethanat rënduese për se cilin nen dhe gjithashtu janë paraparë edhe të gjitha llojet e vrasjeve, duke filluar nga neni 178 Vrasja; neni 179 Vrasje e Rëndë me të gjitha paragrafët e saj nga 1 deri në 12; pastaj neni 180 Vrasja e Kryer në Gjendje të Tronditjes së Fortë Mendore; neni 181 Vrasja nga Pakujdesia dhe 182 Vrasja e Foshnjës Gjatë Lindjes.

KAPITULLI XVI

VEPRAT PENALE KUNDËR JETËS DHE TRUPIT

Neni 178

Vrasja

Kushdo që e privon personin tjetër nga jeta dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.

Neni 179

Vrasja e rëndë

1. Me dënim me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm dënohet personi i cili:

1.1. privon nga jeta fëmijën;

1.2. privon nga jeta femrën shtatzënë;

1.3. privon nga jeta anëtarin e familjes;

1.4. privon nga jeta personin tjetër në mënyrë mizore apo dinake;

1.5. privon nga jeta personin tjetër dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën e një ose më shumë personave tjerë;

1.6. privon nga jeta personin tjetër me qëllim të fitimit të dobisë pasurore;

1.7. privon nga jeta personin tjetër me qëllim të kryerjes apo të fshehjes së ndonjë veprë tjetër penale, ose për të ndaluar personin nga dhënia e dëshmisë ose sigurimi në ndonjë mënyrë tjetër të informatave për policinë apo në procedurë penale;

1.8. privon nga jeta personin tjetër nga hakmarrja e paskrupullt apo nga motive të tjera të ulëta, përfshirë hakmarrjen për dhënien e dëshmisë ose sigurimin në ndonjë mënyrë tjetër të informatave për policinë apo në procedurë penale;

1.9. privon nga jeta personin tjetër zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose në lidhje me detyrën zyrtare;

1.10. privon nga jeta personin tjetër për motive racore, kombëtare ose fetare.

1.11. me dashje kryen dy apo më shumë vrasje, përveç veprave të cilat janë paraparë në nenin 180 dhe 182 të këtij Kodi; ose

1.12. privon nga jeta personin tjetër dhe më parë ka qenë i dënuar për vrasje, përveç veprave të cilat janë të parapara në nenin 180 dhe 182 të këtij Kodi.

Neni 180

Vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore

Kushdo që personin tjetër e privon nga jeta në gjendje të tronditjes së fortë mendore, të shkaktuar pa fajin e tij nga sulmi, keqtrajtimi apo fyerja e rëndë nga ana e personit të vrarë,

dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

Neni 181

Vrasja nga pakujdesia

Kushdo që e privon nga jeta personin tjetër nga pakujdesia, dënohet me burgim prej gjashtë (6)

muaj deri në pesë (5) vjet.

Neni 182

Vrasja e foshnjës gjatë lindjes

Nëna që e privon nga jeta foshnjën e vet gjatë lindjes apo menjëherë pas lindjes, derisa tek ajovazhdon çrregullimi i shkaktuar nga lindja, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3)vjet.

Në Komentarin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës janë shpjeguar të gjitha këto nene të këtij kapitulli edhe atë në mënyrën më të mirë të mundshme nga profesorët e nderuar: prof. dr. Ismet Salihu, prof. dr. Hilmi Zhitija dhe prof.dr. Fejzulla Hasani të cilat

do t'i paraqesim edhe në këtë punim në mënyrë që të jenë sa më të qarta për lexuesin si dhe të jenë të kuptueshme për të gjithë ata që do t'a kenë në dorë këtë punim. Përveç këtij komentari ne do të bëjmë edhe disa krahasime tjera me Kodet Penale të disa shteteve, për të parë dhe krahasuar se si në disa vende janë të sanksionuara këto vepra penale. Duke ditur se në këtë punim është përdorur metoda komperative, kemi parë të nevojshme që të bëjmë krahasime jo vetëm me Kodet Penale të vendeve fqinje, por edhe me larg.

5.5 Llojet e veprës penale të vrasjes

Çdo vrasje është vepër penale shumë e rëndë, ngase privohet personi nga jeta. Mirëpo në aspektin e së drejtës penale njihen tri lloje të vrasjeve dhe ato janë: *vrasje të rëndomta apo forma themelore e vrasjes, vrasjet të rënda apo të cilësuar (të kualifikuara) dhe vrasjet e privileguara.*

-Vrasje e rëndomta apo forma themelore e vrasjes, këtu ligjvënësi nuk ka paraparë asgjë tjetër veç se një formë të thjeshtë apo të rëndomtë të kësaj veprë penale e cila kryhet në mungesë të rrethanave, mënyrës së kryerjes apo edhe motivit të posaçëm, prandaj pikërisht këto tipare e bëjnë këtë lloj të veprës penale të dallueshme nga vrasjet e rënda apo të privileguara. Së këndejmi, si vrasje të rëndomta konsiderohen të gjitha ato vrasje tek të cilat mungojnë tiparet e posaçme që i karakterizojnë vrasjet e rënda dhe të lehta, përkatësisht vrasjet e privileguara¹⁰⁴. Formën themelore të vrasjes Kodi Penal e përkufizon me dispozitë të thjeshtë - **“Kushdo që e privon personin tjetër nga jeta”**¹⁰⁵. Kjo vrasje kryhet me veprim dhe mosveprim. Me veprim kryhet kur është ndërmarrë ndonjë veprim në mënyrë aktive ndërsa me mosveprim kryhet kur ka ekzistuar obligimi juridik që të veprohet.

Lidhur me **mënyrën e veprimit të kryerjes**, vrasja mund të kryhet me veprim të drejtpërdrejtë apo indirekt¹⁰⁶. Mënyrë e drejtpërdrejtë apo direkte e kryerjes ekziston në

¹⁰⁴Prof. dr. Ismet Salihu, E Drejta penale, Pjesa e Posaçme, Prishtinë, 2009, faqe 104.

¹⁰⁵Prof. dr. Ismet Salihu, Prof. dr. Hilmi Zhitija, Prof. dr. Fejzullah Hasani, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, KOMENTAR, Botimi I, Neni 178 Vrasja, pika 3, faqe 471

¹⁰⁶Po aty, faqe 471

rastet kur autori vetë, me veprimin e vet drejtpërdrejt e privon nga jeta personin tjetër, p.sh.: duke shkrepur nga armë zjarri, duke e goditur me thikë, duke ia zënë frymën, duke i hedhur helm në ushqim etj.¹⁰⁷. Në mënyrë indirekte, vrasja kryhet, jo vetëm me veprimin e autorit (dorasis), por edhe me ndërmjetësimin e ndonjë personi tjetër, madje edhe të vetë viktimës. Raste të këtilla do të ekzistojnë p.sh. kur autori me postë ia dërgon paketën personit A. në të cilën gjendet eksplozivi i cili aktivizohet me rastin e hapjes së dërgesës dhe e shkakton vdekjen e tij; apo kur autori ia prish frenat e veturës personit A. dhe për shkak të kësaj ndodh aksidenti në trafik, në të cilin humb jetën personi A¹⁰⁸.

Objekt mbrojtës tek kjo vepër penale është jeta e njeriut. Apo mund të themi se objekt i kësaj vepre penale është vet njeriu i gjallë. Jeta e njeriut mbrohet prej momentit të lindjes e deri në vdekje.

Pasoja kur flasim për pasojën tek rastet e vrasjeve çfarëdo qofshin ato, duhet pasur parasysh që duke u bazuar në veprimin që ka kryer autori, atëherë na vie edhe pasoja që në këtë rast është vdekja e personit tjetër. Pra, shkaktimi i vdekjes së personit tjetër është pasojë e veprës penale të vrasjes. Lidhja kauzale duhet të ekzistojë midis veprimit të shkakut të vdekjes. Lidhur me kauzalitetin problemet lajmërohen në këto situata: a) kur pasoja nuk shkaktohet menjëherë pas ndërmarrjes së veprimit; b) në rastet kur në shkaktimin e pasojës kontribuojnë edhe veprimet e personave të tjerë; c) kur në shkaktimin e pasojës kontribuojnë disa rrethana të tjera objektive dhe subjektive¹⁰⁹.

- a) Pasoja e vdekjes në rastet e veprës penale të vrasjes, nuk është e domosdoshme të shkaktohet menjëherë pas ndërmarrjes së veprimit të kryerjes. Përkatësisht, nëse konstatohet se ka ekzistuar lidhja kauzale mes veprimit dhe pasojës (vdekjes), periudha kohore pothuaj është e relevante. Lidhur me këtë çështje, në disa vende anglosaksone konsiderohet se ekziston lidhja kauzale, nëse vdekja është shkaktuar

¹⁰⁷Po aty, faqe 471

¹⁰⁸Po aty, faqe 471

¹⁰⁹Prof.dr. Ismet Salihu, Prof.dr. Hilmi Zhitija, Prof.dr. Fejzullah Hasani, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, KOMENTAR, Botimi I, Neni 178 Vrasja, pika 8, faqe 472.

brenda periudhës prej 12 muajve. Organizata Ndërkombëtare e Shëndetësisë sugjeron që të konsiderohet se ekziston lidhja kauzale nëse vdekja është shkaktuar brenda afatit prej 30 ditësh. Nëse ndokush është dënua për lëndim të rëndë trupor, ndërsa pas aktgjykimit të plotfuqishëm shkaktohet vdekja e viktimës, përsëritja e procedurës mund të rezultojë me dënim për vrasje¹¹⁰.

- b)** Do të konsiderohet se ekziston lidhja kauzale edhe në rastet kur në ndonjë mënyrë edhe rrethanat tjera të me pastajme i kanë kontribuar, kanë participuar në shkaktimin e vdekjes, p.sh.: nëse vdekja ka mundur të parandalohet nëpërmjet dhënies së ndihmës mjekësore me kohë. Përgjegjësia në këso rastesh mbështetet në parimin se askush nuk mund të arsyetohet për gabimet ose lëshimet e të tjerëve. Fakti që vdekjes së personit tjetër i kanë kontribuar edhe të tjerët, përkatësisht edhe rrethanat tjera, mund të merret parasysh vetëm me rastin e matjes së dënimit për autorin e vrasjes¹¹¹.
- c)** Rrethanat e tjera objektive dhe subjektive të cilat, krahas veprimit të autorit, mund t'i kontribuojnë shkaktimit të vdekjes, mund të jenë të shumta dhe të natyrës së ndryshme. P.sh.: nëse viktimë ka lënguar nga ndonjë sëmundje e rëndë, ka qenë me të meta fizike, ose koha ka qenë shumë e ftohtë (acar), apo viktimë e ka mbështjellë plagën me fashë të papastër që ka shkaktuar infektimin etj. Edhe në të gjitha këto raste do të konsiderohet se ekziston lidhja kauzale midis veprimit të vrasjes dhe shkaktimit të vdekjes. Lidhur me këtë, do të konsiderohet se autori ka kryer vrasjen edhe në rastet kur me veprimet apo me mosveprimet e tij e ka përkeqësuar sëmundjen e viktimës apo gjendjen e rëndë shëndetësore të cilat kanë shkaktuar vdekjen e viktimës¹¹².

¹¹⁰Po aty, faqe 472.

¹¹¹Po aty, faqe 472.

¹¹²Po aty, faqe 472.

Tek ky lloj i veprës penale kemi edhe autorin e saj i cili mund të jetë çdo person (*delictumcommunium*).

Forma e fajit -Pa dyshim se ky lloj vepre nëse kryhet ka edhe fajtorin e vet dhe ky faj ka po ashtu formën e vet. Kjo vepër kryhet me dashje, direkte apo eventuale. Me dashje direkte kjo vepër kryhet atëherë kur personi që ka ndërmarrë këtë veprim ka pasur qëllim që tjetrit t'i privojë nga jeta apo ka qenë i vetëdijshëm se veprimi ose mosveprimi i tij sjellë si pasojë vdekjen dhe është pajtuar që kjo pasojë të shkaktohet (dashja eventuale). Sipas mënyrës së kryerjes, përkatësisht elementeve objektive përcaktohet ekzistimi i dashjes. Kështu p.sh.: nëse autori nga afërsia e vogël shtinë me revole ndaj personit tjetër në organe vitale, por nuk e godet, do të konsiderohet se ekziston tentativa e vrasjes, e jo tentativa e lëndimit të rëndë trupor¹¹³. Vlen të përmendet se në Kodi Penal i Republikës së Kosovës nuk e njeh Vrasjen me Paramendim (*doluspraemeditatus*) si dhe Tentativa e kësaj vepre ndëshkohet.

-Vrasjet e rënda apo të cilësuar (të kualifikuara), në këto raste janë të paraparë rastet e vrasjeve të cilat kryhen në rrethana të rënda edhe atë posaçërisht të rënda. Në këto raste shprehet një shkallë më lartë e kundërligjshmërisë dhe e fajësisë¹¹⁴. Tek këto raste të vrasjeve kemi edhe llojet, mënyrat, motivet etj., sipas të cilave kryhen ato.

Llojet e Vrasjeve të Rënda janë të parapara në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, në Kapitullin XVI, Veprat Penale Kundër Jetës dhe Trupit në nenin 179 edhe atë siç është paraqitur në vijim:

Vrasja e rëndë

(neni 179)

1. Me dënim me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm dënohet personi i cili:

¹¹³Stojanoviç, Komentar, faqe 328. Cituar nga Prof. dr. Ismet Salihu, Prof. dr. Hilmi Zhitija, Prof. dr. Fejzullah Hasani, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, KOMENTAR, Botimi I, Neni 178 Vrasja, pika 10, 11, faqe 473.

¹¹⁴Prof.dr. Ismet Salihu, E Drejta penale, Pjesa e Posaçme, Prishtinë 2009, faqe 107.

- 1.1. *privon nga jeta fëmijën;*
- 1.2. *privon nga jeta femrën shtatzënë;*
- 1.3. *privon nga jeta anëtarin e familjes;*
- 1.4. *privon nga jeta personin tjetër në mënyrë mizore apo dinake;*
- 1.5. *privon nga jeta personin tjetër dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën e një ose më shumë personave tjerë;*
- 1.6. *privon nga jeta personin tjetër me qëllim të fitimit të dobisë pasurore;*
- 1.7. *privon nga jeta personin tjetër me qëllim të kryerjes apo të fshehjes së ndonjë veprë tjetër penale, ose për të ndaluar personin nga dhënia e dëshmisë ose sigurimi në ndonjë mënyrë tjetër të informatave për policinë apo në procedurë penale;*
- 1.8. *privon nga jeta personin tjetër nga hakmarrja e paskrupullt apo nga motive të tjera të ulëta, përfshirë hakmarrjen për dhënien e dëshmisë ose sigurimin në ndonjë mënyrë tjetër të informatave për policinë apo në procedurë penale;*
- 1.9. *privon nga jeta personin tjetër zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose në lidhje me detyrën zyrtare;*
- 1.10. *privon nga jeta personin tjetër për motive racore, kombëtare ose fetare.*
- 1.11. *me dashje kryen dy apo më shumë vrasje, përveç veprave të cilat janë paraparë në nenin 180 dhe 182 të këtij Kodi; ose*
- 1.12. *privon nga jeta personin tjetër dhe më parë ka qenë i dënuar për vrasje, përveç veprave të cilat janë të parapara në nenin 180 dhe 182 të këtij Kodi.*

Këto lloje të vrasjeve të rënda mund të sistemohen apo ndahen sipas kritereve të ndryshme.

5.6 Mënyra e kryerjes

Sipas mënyrës së kryerjes këto vrasje mund të ndahen në:

- a. vrasja në mënyrë mizore apo dinake (pika 1.4)*

Kjo vrasje kryhet atëherë kur autori në mënyre dinake, në mënyrë të fshehtë , mashtruese privon nga jeta personin pa rezistencë apo me rezistencë shumë të vogël dhe në këtë rast dorasi shfrytëzon sinqeritetin apo besimin e viktimës¹¹⁵. Këto raste nga praktika konsiderohen rastet kur viktimën e thërret dikush në shtëpinë e vet për një punë ose marrëveshje që kinse do të bën me të, dhe të njëjtit në mënyrë të fshehtë (pas shpine) ia shkrepi armën duke e lënë të varur.

b. vrasja kur me dashje vihet në rrezik jeta e një ose e më shumë personave (pika 1.5)

Kjo vrasje kryhet kur autori duke kryer veprën e tij vë në rrezik konkret jetën e së paku edhe një person tjetër apo disa persona të tjerë përveç atij ndaj të cilit është drejtuar veprimi i kryerjes. Këto raste mund të hasim kur autori shkon në një lokal të mbushur me njerëz dhe qëllimi i tij është që ta vrasë dikë me të cilin dhe për të cilin qëllim edhe kishte shkuar aty, duke shtënë në të nuk mund të kontrollojë dot armën e tij, me çrast vë në rrezik konkret edhe njerëzit që ishin me viktimën në tavolinë në rastin e gjuajtjes.

5.7 Sipas motiveve

Sipas motiveve këto vrasje mund të ndahen në:

a. Vrasje nga motive racore, nacionale apo fetare (pika 1.10)

Për t'u konsideruar se është kryer kjo formë e vrasjes, privimi nga jeta i personit tjetër duhet të jetë kryer nga motive racore, nacionale apo fetare. Së këndejmi, motivi është vendimtar për kualifikimin e kësaj vepre. Rrjedhimisht, fakti se vrasja është kryer nga ky motiv, është tregues se motivi është i ulët, shovinist dhe i cili jo vetëm nga e drejta penale por edhe sipas opinionit të përgjithshëm konsiderohet si vrasje e rëndë në krahasim me

¹¹⁵Bacic-Pavlovic, Komentar, faqe 441, cituar nga: Prof. dr. Ismet Salihu, Prof. dr. Hilmi Zhitija, Prof. dr. Fejzullah Hasani, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, KOMENTAR, Botimi I, Neni 179, Vrasja e Rëndë, pika 1.10, Vrasja për motive racore, nacionale apo fetare, faqe 482.

vrasjet e rëndomta. Kjo vrasje mund të kryhet vetëm me dashje. Autor i kësaj vrasjeje mund të jetë çdo person¹¹⁶.

b. *Vrasja me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore (1.6)*

Fakti që ndokush e vret tjetrin me qëllim të fitimit të dobisë pasurore është tregues se bëhet fjalë për motiv të paskrupullt egoist që me çdo kusht të fitohet pasuri. Vrasja me qëllim të fitimit të dobisë pasurore konsiderohet në rastet kur privimi nga jeta i personit tjetër kryhet me qëllim që vetes apo tjetrit t'i sjellë ndonjë dobi pasurore, dobi materiale¹¹⁷. Kjo vepër konsiderohet se është kryer si në rastin kur pretendohet të realizohet ndonjë dobi materiale, përkatësisht të zmadhohet pasuria, ashtu edhe në rastet kur pretendohet pengimi i zvogëlimit të pasurisë që do të ndodhte¹¹⁸.

Për ekzistimin e kësaj vepre nuk është e domosdoshme që dobia edhe të realizohet. Madje, për ekzistimin e kësaj vepre nuk kërkohet që dobia të jetë e kundërligjshme. Së këndejmi, edhe ai që e vret borxhliun e vet me qëllim që t'i marrë të holla dhe kështu të arkëtojë borxhin e vet, konsiderohet se e ka kryer këtë vepër. Krahas vrasjes së borxhliut, si vrasje e këtyllë konsiderohet, p.sh.: edhe vrasja me qëllim të trashëgimisë, vrasja e kreditorit me qëllim që të mos paguhet borxhi, vrasja e paguar, vrasja me qëllim të eliminimit të konkurrentit. Gjykata e Qarkut të Gjilanit, me aktgjykimin P.nr.123/2007 gabimisht e ka cilësuar vrasjen e të akuzuarit F.P. si vrasje nga hakmarrja e paskrupullt, ngase i akuzuari e ka privuar nga jeta tani të ndjerin B.K. për shkak se ky nuk ia ka paguar borgjin prej 200 euro për punën të cilën ia ka kryer. Sipas teorisë dhe praktikës së gjykatave të Kosovës dhe

¹¹⁶ Prof. dr. Ismet Salihu, Prof. dr. Hilmi Zhitija, Prof. dr. Fejzullah Hasani, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, KOMENTAR, Botimi I, Neni 179, Vrasja e Rëndë, pika 1.4, Vrasja në mënyrë dinake, faqe 477.

¹¹⁷ Prof. dr. Ismet Salihu, Prof. dr. Hilmi Zhitija, Prof. dr. Fejzullah Hasani, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, KOMENTAR, Botimi I, Neni 179, Vrasja e Rëndë, pika 1.6, Vrasja me qëllim të fitimit të dobisë pasurore, faqe 478.

¹¹⁸ Po aty, faqe 478.

të shteteve të tjera, kjo vrasje është dashtë të kualifikohet si vrasje me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore¹¹⁹.

Ky lloj i vrasjes mund të kryhet edhe me dashje eventuale, ngase autori qëllimin e tij për të realizuar dobi pasurore mund ta arrijë edhe në rastin kur është i vetëdijshëm për shkaktimin e vdekjes dhe dakordohet që ajo të shkaktohet.

Gjykata Supreme e Kroacisë (Kzh.701/91) e ka kualifikuar si vrasjes me qëllim të përfitimit të dobisë pasuror edhe rastin kur personi e privon nga jeta personin tjetër, nëse dobinë pasurore do ta realizon personi me të cilën është në marrëdhënie shumë të ngushtë dhe këtë përfitim e konsideron si për vete. Kështu si vrasje e këtillë është kualifikuar edhe rasti kur personi N. së bashku me vajzën e vet e ka privuar nga jeta dhëndrin e mëparshëm me qëllim që vajza e tij dhe fëmijët e saj ta marrin pasurinë si trashëgimi¹²⁰.

Shtrohet pyetja se ku ekziston dallimi midis kësaj vrasje dhe rasteve të rënda të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare, me ç'rast shkaktohet edhe vdekja e viktimës. Dallimi kryesor konsiston në faktin se te grabitja dhe vjedhja grabitqare dhuna dhe kanosja përdoren aty për aty me qëllim të marrjes apo mbajtjes së sendit të vjedhur¹²¹.

c. Vrasje me qëllim të fshehjes së ndonjë vepre tjetër penale (1.7)

Si edhe tek lloji i mëparshëm i vrasjes, rrethanë kualifikuese tek kjo formë e rëndë e vrasjes është gjithashtu qëllimi i kryerjes. Këtu, privimi nga jeta i personit tjetër është mjet për realizimin e ndonjë qëllimi tjetër – me qëllim të kryerjes së ndonjë vepre tjetër penale apo

¹¹⁹Aktgjykim i Gjykatës së Qarkut të Gjilanit, P. nr. 123/2007 cituar nga: Prof. dr. Ismet Salihu, Prof. dr. Hilmi Zhitija, Prof. dr. Fejzullah Hasani, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, KOMENTAR, Botimi I, Neni 179, Vrasja e Rëndë, pika 1.4, Vrasja në mënyrë dinake, faqe 478.

¹²⁰Baqiç, Komentari, faqe 446, cituar nga: Prof. dr. Ismet Salihu, Prof. dr. Hilmi Zhitija, Prof. dr. Fejzullah Hasani, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, KOMENTAR, Botimi I, Neni 179, Vrasja e Rëndë, pika 1.4, Vrasja në mënyrë dinake, faqe 478.

¹²¹Prof. dr. Ismet Salihu, Prof. dr. Hilmi Zhitija, Prof. dr. Fejzullah Hasani, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, KOMENTAR, Botimi I, Neni 179, Vrasja e Rëndë, pika 1.4, Vrasja në mënyrë dinake, faqe 479.

të fshehjes së veprës penale të kryer më parë. Nga kjo rezulton se **kjo vrasje e rëndë i ka tri forma**¹²².

Forma e parë, shprehet në rastet kur autori e privon nga jeta personin tjetër, me qëllim që të bëjë të mundur ose të lehtësojë kryerjen e ndonjë vepre tjetër penale. Këtu vrasja i paraprin kryerjes së ndonjë vepre tjetër penale. Me këtë rast nuk është e rëndësishme nëse me vrasje autori ka për qëllim që vetes apo tjetrit t'i mundësohet apo vetëm t'i lehtësohet kryerja e veprës. P.sh.: autori e privon nga jeta rojën e ambasadës me qëllim që ai apo ndonjë person tjetër ta rrëmbejë ambasadorin apo që nga ambasada të merren dokumente konfidenciale. Vepra tjetër penale nuk është e domosdoshme të kryhet, është e qenësishme se vrasja është kryer për atë qëllim. Me këtë lloj të vrasjes kemi të bëjmë edhe atëherë kur ajo është kryer me qëllim përfundimi të veprës tjetër të filluar. Lidhur me këtë, mund të shprehen këto situata: që vepra tjetër penale të jetë kryer, që vepra vetëm është tentuar, apo që veprimi i kryerjes të mos jetë ndërmarrë fare. Është qenësore që të ketë ekzistuar qëllimi për kryerjen e veprës penale dhe që vrasja është dashur të mundësojë ose të lehtësojë kryerjen e veprës tjetër penale. Ky lloj i vrasjes do të konsiderohet se ekziston edhe atëherë kur kryerja e veprës tjetër penale nuk ka qenë fare e mundur. Nëse vepra tjetër penale edhe është kryer, atëherë kemi bashkimin e veprave penale¹²³.

Forma e dytë, e kësaj vrasjeje ekziston në rastet kur autori privon nga jeta personin tjetër me qëllim që të pengojë zbulimin e veprës penale, e cila është kryer më parë ose e cila është duke u kryer. P.sh.: vrasja e viktimës së dhunimit apo vrasje e dëshmitarit icili duhet të jap dëshmi në procedurë penale. Edhe tek kjo formë e vrasjes nuk është e rëndësishme se vepra e kujt fshihet, vepra e tij penale, apo vepra e personit tjetër¹²⁴.

¹²²Po aty, faqe 479.

¹²³Lubisa Lazarevic, Krivicno Pravo, Posebni Deo, Beorgard 1982, faqe 166, cituar nga: Prof. dr. Ismet Salihu, Prof. dr. Hilmi Zhitija, Prof. dr. Fejzullah Hasani, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, KOMENTAR, Botimi I, Neni 179, Vrasja e Rëndë, pika 1.7, Vrasja me qëllim të kryerjes apo fshehjes së ndonjë veprë tjetër penale ose për të ndaluar personin nga dhënia e dëshmisë ose sigurimi në ndonjë mënyrë tjetër të informatave për policinë apo për procedurë penale, faqe 480.

¹²⁴ Po aty, faqe 480.

Forma e tretë, e kësaj vrasje të rëndë konsiderohet se kryhet në rastet kur në ndonjë mënyrë tjetër pamundësohet dhënia e informative organeve të ndjekjes, përkatësisht organeve të policisë, prokurorisë apo gjykatave në procedurë penale.

Për ekzistimin e kësaj forme të vrasjes së rëndë nuk është e rëndësishme se a është zbuluar apo jo vepra e kryer më parë¹²⁵.

d. Vrasja nga hakmarrja e paskrupull apo nga motive të tjera të ulëta (pika 1.8)

Kodi Penal i Republikës së Kosovës si dhe Kodet Penale të shteteve tjera të cilat e njohin këtë lloj të vrasjes së rëndë, nocionin e paskrupulltësisë lidhet vetëm me hakmarrjen. Koncepti i tillë rezulton nga fakti se flet vetëm për hakmarrjen e paskrupull e jo për vrasjen e paskrupull, sepse një vrasje mund të jetë e paskrupull dhe fare të mos jetë kryer nga hakmarrja, por fjala vjen nga interesi¹²⁶. Dallojmë disa tipare dhe elemente kryesore të cilat një vrasje nga hakmarrja mund të bëjnë të paskrupull. Sipas profesorëve të nderuar prof. dr. Ismet SALIHU, prof. dr. Rexhep Murati dhe prof. dr. Fejzullah HASANI në KOMEMNTARIN e tyre të Kodit Penal të Republikës së Kosovës të cilët kanë cituar prof. dr. Ismet SALIHU në librin e tij “ Vrasjet në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës të vitit 1985” thuhet se:

“Një vrasje nga hakmarrja mund të konsiderohet si vrasje nga hakmarrja e paskrupull nëse në atë rast plotësohen njëri prej këtyre kushteve:

a. nëse hakmarrja është drejtuar ndaj anëtarit të pafajshëm të familjes (ndaj vëllait, motrës etj.),

b. nëse ajo haptas nuk është në përpjesëtim, në krahasim me të keqen e pësuar më parë,

c. nëse privohen nga jeta shumë persona,

ç. nëse edhe vet është kryer nga hakmarrja (hakmarrja ndaj hakmarrjes),

d. nëse është kryer ndaj personit i cili për veprën e mëparshme penale me aktgjykim të plotfuqishëm është dënuar ose liruar nga dënimi.

¹²⁵ Po aty, faqe 480.

¹²⁶ Po aty, faqe 480.

e. nëse me rastin e kryerjes se hakmarrjes cenohen disa rregulla ekzistuese pozitive të së drejtës zakonore (p.sh.: hakmarrja gjatë kohëzgjatjes se besës ose pas arritjes se pajtimit),

f. nëse hakmarrja është drejtuar ndaj personit, i cili në bazë të ligjit e ka kryer ndonjë veprim ose ka qenë i detyruar të veprojë ashtu, p.sh.: Vrasja e gjykatësit, policit, dëshmitarit, vrasja e personit për shkak se ka dhënë ndonjë informate në polici apo në procedurë penale etj.”

Motive të ulëta në kuptimin e kësaj forme të vrasjes së rëndë konsiderohen motivet që janë në kundërshtim të rreptë me rregullat ekzistuese sociale-etike dhe për to autori qortohet ashpër në aspektin moral. Këto janë motive veçanërisht të ulëta, motive veçanërisht negative të cilat shkaktojnë indinjatë të thellë edhe në opinionin e gjerë. Lidhur me këtë, në dispozitën e Kodit Penal të Kroacisë (neni 34) ku parashihet ky lloj i vrasjes së rëndë, shprehimisht parashihet se motivet duhet të jenë veçanërisht rënduese.

5.8 Sipas objektit mbrojtës (viktimës)

Sipas objektit të mbrojtjes apo viktimës vrasjet e rënda ndahen në:

a. Vrasja e fëmijës (pika 1.1)

Sipas konventave ndërkombëtare, fëmijë konsiderohet personi prej moshës zero deri në moshën tetëmbëdhjetë vjeçare. Kualifikimi i vrasjes së fëmijës si lloj i vrasjes së rëndë është shprehje e mbrojtjes më të madhe penalo-juridike të fëmijës. Mbrojtja më e madhe juridike-penale e fëmijës është e pranishme edhe në shumë dispozita të tjera të Kodit Penal. Duke u mbështetur në konceptin e këtillë të ligjdhënësit, por edhe në aspektin moral dhe shoqëror, vrasja e fëmijës konsiderohet më e rëndë se vrasja e personit madhor¹²⁷.

Për t'u konsideruar se është kryer kjo vrasje, autori duhet të dijë, të jetë i vetëdijshëm se viktima është fëmijë. Në rastet kur autori nuk është i vetëdijshëm se personi të cilin e vret

¹²⁷Prof. dr. Ismet Salihu, Prof. dr. Hilmi Zhitija, Prof. dr. Fejzullah Hasani, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, KOMENTAR, Botimi I, Neni 179, Vrasja e Rëndë, pika 1.1, Vrasja e fëmijës, faqe 474.

është fëmijë, atëherë lajthitja e këtillë nuk e përjashton nga përgjegjësia penale për vrasje dhe në këso rastesh të lajthitjes lidhur me viktimën, autori do të përgjigjet për vrasjen e rëndomtë apo të rëndë, varësisht nga motivi, rrethanat dhe mënyra e kryerjes, të paraparë në nenet 146 dhe 147 të Kodit Penal¹²⁸.

b. *Vrasja e femrës për të cilën autori e din se ajo është shtatzënë (pika 2)*

Kualifikimi i kësaj vrasjeje si vrasje e rëndë është tregues se Kodi Penal i kushton mbrojtje më të madhe gruas shtatzënë. Kjo është e arsyeshme, ngase edhe me të drejtën zakonore, si dhe në aspektin human dhe moral, vrasja e gruas shtatzënë konsiderohet si vrasje më e rëndë, në krahasim me vrasjen e rëndomtë¹²⁹.

Në rastet e vrasjes së gruas shtatzënë, në fakt, fjala është për të ashtuquajturën “vrasje të dyfishtë”, ngase me këtë veprë penale nuk vritet vetëm gruaja shtatzënë, por edhe fëmija e saj që ende nuk ka lindur¹³⁰.

Si në rastet e vrasjes së fëmijës, edhe ky lloj i vrasjes do të konsiderohet se ekziston vetëm nëse autori e ka ditur, ka qenë i vetëdijshëm se objekt i kësaj veprë penale është gruaja shtatzënë. Rrjedhimisht, në këso raste fjala është për të ashtuquajturin “qëllim të dyfishtë”. Qëllimi i dyfishtë të kjo veprë penale konsiston në faktin se autori i realizon dy qëllime: vrasjen e gruas shtatzënë, si dhe asgjësimin e frytit (fëmijës) që është dashur të lindë¹³¹.

Në rastet kur autori i veprës penale nuk e ka ditur se gruaja të cilën e privon nga jeta është shtatzënë, atëherë bëhet fjalë për lajthitjen në objekt dhe personi i këtillë do të përgjigjet për vrasje të rëndomtë, apo për ndonjë lloj tjetër të vrasjes së rëndë, varësisht nga motivi, rrethanat apo mënyra e kryerjes së vrasjes¹³².

c. *Vrasja e anëtarit të familjes (pika 1.4)*

Nëlegjislacionin Penal të Kosovës, kjo formë e vrasjes së rëndë për herëtë parë është paraparë në amendamentet e Kodit Penal që kanë hyrë në fuqi me 1 janar 2013. Për t'u

¹²⁸Po aty, faqe 474

¹²⁹Po aty, faqe 474

¹³⁰Po aty, faqe 474

¹³¹Po aty, faqe 475

¹³²Po aty, faqe 475

konsideruar se ekziston ky lloj i vrasjes, duhet të plotësohet kushti objektiv i cili konsiston në faktin se ky lloj i vrasjes kryhet ndaj anëtarit të familjes. Kush konsiderohet anëtar i familjes, më për së afërmi është përcaktuar me ligjin për martesën dhe familjen. Në sensin e kësaj anëtar të familjes konsiderohen edhe personat që bashkëjetojnë si dhe bashkëshorti apo bashkëshortja e mëparshme dhe fëmijët e tyre¹³³. Në Kodet e Maqedonisë (neni 123 paragrafi 2)dhe të Serbisë (neni 112 paragrafi 28) këtë lloj të vrasjes e emërtojnë:

“vrasje e anëtarit të familjes i cili paraprakisht është keqtrajtuar dhe kësaj ekzistimin e kësaj veprë e lidhin me dhunën në familje”. Kodi Penal i Republikës së Kosovës këtë vrasje të rëndë nuk e kushtëzon edhe me faktin që viktimi paraprakisht të jetë e keqtrajtuar, përkatësisht të jetë ekspozuar dhunës në familje¹³⁴.

d. *Vrasja e personit zyrtar gjatë kohës së ushtrimit të detyrës në mbrojtje të rendit ligjor, sigurimit të njerëzve apo pasurisë, zbulimit të veprave penale, arrestimit të autorit të veprës penale, ruajtjes së personave të privuar nga liria ose ruajtjes së rendit dhe paqes publike (pika 1.9)*

Nocioni person zyrtar është përcaktuar në nenin 120, paragrafin 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës në të cilin thuhet:

2. Person zyrtar - nënkupton:

2.1. personi i zgjedhur ose i emëruar në një organ shtetëror;

2.2. personi i autorizuar në një organ shtetëror, organizatë biznesi ose ndonjë person tjetër juridik i cili sipas ligjit apo ndonjë dispozite tjetër të nxjerrë në pajtim me ligj ushtron detyra të posaçme;

2.3. personi i cili ushtron detyra të posaçme zyrtare në bazë të autorizimit të dhënë me ligj¹³⁵.

Tek kjo formë e vrasjes rrethanë kualifikuese është vetia, statusi i viktimës dhe për këtë arsye duhet të theksohet fakti se personi zyrtar i cili ushtrinë detyrat e tij i ekspozohet rrezikut që të bëhet viktimë e vrasjes. Për këtë arsye këtyre personave u ofrohet mbrojtje juridiko-penale. Kur arrihet të sigurohet një mbrojtje e tillë ajo jo vetëm që është e mirë për

¹³³ Po aty, faqe 475.

¹³⁴ Po aty, faqe 475.

¹³⁵ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 04/L - 082, hyrja në fuqi 1 janar 2013, faqe 52.

personat e lartcekur, por ajo ndikon edhe në efikasitetin dhe kryerjen me sukses të detyrave dhe punëve që u janë caktuar me ligj.

5.9 Sipas pasojave

a. vrasja me dashje e dy apo më shumë personave përveç veprave të cilat janë paraparë me nenet 180 dhe 182

Ky lloj i vrasjes së rëndë konsiderohet se është kryer në rastet kur autori me dashje ka privuar nga jeta dy apo më shumë persona, përveç atyre që janë të parapara në nenin 180 dhe 182 të Kodit Penal (vrasja në gjendje të afektit mendor dhe vrasja e foshnjës gjatë lindjes). Meqë ky lloj i vrasjes së rëndë mund të kryhet vetëm me dashje, edhe vrasjet nga pakujdesia nuk mund të kualifikohen sipas kësaj dispozite. Sipas kësaj dispozite, vrasje e tillë konsiderohet se është kryer nëse autori dy apo më shumë vrasje i kryen në bashkimin ideal apo real, por me kusht që procedura penale të jetë e njëjtë dhe fajtori të ndëshkohet me dënim unik, të përbashkët. Pra, këtu nuk është fjala për recidiv të vrasjes. Lidhur me këtë, Kodi Penal i Maqedonisë, krahas vrasjes në gjendje të afektit mendor dhe vrasjes nga pakujdesia, në këtë dispozitë i parasheh edhe rastet e vrasjes në kapërcimin e mbrojtjes së nevojshme dhe nevojës ekstreme dhe vrasjen nga mëshira.

Vrasjet e Privileguara

Për shkak të rrethanave në të cilat ndodhin këto vrasje dhe për shkak të formës dhe mënyrës së kryerjes së tyre, ato janë po thuaj se rrethana lehtësuese që në të drejtën penale bashkëkohore quhen vrasje të privileguara. Vet fakti se quhen të tilla, ato janë forma të lehta të vrasjeve. Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës vrasje të privileguara konsiderohen këto:

Neni 180

Vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore

Kushdo që personin tjetër e privon nga jeta në gjendje të tronditjes së fortë mendore, të shkaktuar pa fajin e tij nga sulmi, keqtrajtimi apo fyerja e rëndë nga ana e personit të vrarë, dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

Neni 181

Vrasja nga pakujdesia

Kushdo që e privon nga jeta personin tjetër nga pakujdesia, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Neni 182

Vrasja e foshnjës gjatë lindjes

Nëna që e privon nga jeta foshnjën e vet gjatë lindjes apo menjëherë pas lindjes, derisa tek ajo vazhdon çrregullimi i shkaktuar nga lindja, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

Vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore (neni 180)

Kushdo që tjetrin e privon nga jeta në gjendje të afektit mendor, i vënë pa fajin e tij në gjendje të tronditjes së fortë mendore të shkaktuar nga sulmi, keqtrajtimi apo fyerja e rëndë nga ana e personit të vrarë, dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

Vrasja e kryer në gjendje të afektit mendor konsiderohet formë e privilegjuar apo e lehtë e vrasjes. Ky lloj i vrasjes në literaturë quhet edhe vrasje e provokuar, është privim i jetës së personit tjetër nga ana e personit, i cili pa fajin e tij ka rënë në një tronditje të fortë mendore (psikike) për shkak të sulmit, keqtrajtimit ose fyerjes së rëndë nga ana e të vrarit. Si veprime me të cilat autori vihet në gjendje të afektit mendor janë p.sh.: shpifja, fyerja e rëndë, pështymja në fytyrë¹³⁶.

Elemente dhe karakteristika të vrasjes në gjendje të afektit mendor janë: **sulmi, keqtrajtimi, fyerja e rëndë, dhe tronditja e fortë**¹³⁷.

Sulmi mund të jetë çdo veprim i njeriut i drejtuar me qëllim që ta lëndoj apo rrezikoj ndonjë të mirë të mbrojtur të autorit të kësaj vepre. Në sensin e kësaj forme të vrasjes, sulmin duhet kuptuar sikur edhe të mbrojtja e nevojshme. Kështu që edhe sulmi i shkaktuar, i provokuar e përjashton ekzistimin e kësaj vepre penale. Natyrisht, nga natyra e kësaj vepre penale rezulton se nuk kërkohet edhe aktualiteti, nga se këtu sulmi lajmërohet

¹³⁶ Prof. dr. Ismet Salihu, Prof. dr. Hilmi Zhitija, Prof. dr. Fejzullah Hasani, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, KOMENTAR, Botimi I, Neni 180, Vrasja e Kryer në Gjendje të Tronditjes së Fortë Mendore, pika 1, faqe 485.

¹³⁷ Po aty, faqe 486.

si shkak i tronditjes psikike. Sulmi zakonisht është i drejtuar ndaj integritetit trupor, por mund të jetë i drejtuar edhe ndaj pasurisë së autorit¹³⁸.

Keqtrajtimi nënkupton shkaktimin e qëllimshëm dhe intensive të dhembjeve fizike dhe psikike personit tjetër. Por në sensin e këtij inkriminimi, për ekzistimin e keqtrajtit nuk kërkohet shkaktimi i i lëndimit trupor apo dëmtim të shëndetit. Përkatësisht, keqtrajtimi konsiston në dhembje fizike dhe psikike të intensitetit më të vogël, shkaktimin e frikës, gërdisë, neverisë dhe përçmimit. Raste të keqtrajtit mund të jenë p.sh.: tërheqja për hunde apo për flokë, rënia me shuplakë, rënia me shqelm si dhe mënyra të tjera të nënçmimit të personalitetit të autorit apo të ndonjë të afërmi të tij¹³⁹.

Fyerja e rëndë nënkupton cenimin e rëndë të nderit dhe autoritetit të personit tjetër. Kjo reflektohet me dhembje të madhe psikike, emocionale, dhembje kjo e cila me arsye shkakton revoltë indinjatë. Situatat e fyerjes së rëndë kanë kuptimin më të gjerë dhe më të rëndë se fyerjet dhe shpifjet e rëndomta. Fyerjet e rënda janë të asaj natyre, të cilat sipas normave morale dhe etike ndaj personit tjetër shkaktojnë dhembje intensive psikike apo cenojnë rëndë ndjenjat e tjetrit. Rast tipik dhe fyerje shumë e rëndë dhe që shkakton afekt mendor është kur bashkëshorti e has në tradhti bashkëshorten e vet, ose e kundërta kur bashkëshortja e has në tradhti bashkëshortin¹⁴⁰.

Tronditja e fortë mendore është bazë e cila këtë lloj vrasje e bënë të privilegjuar. Andaj çdo lloj tronditje nuk mund të konsiderohet si rrethanë e cila një vrasjeje mund t'i jep karakter të vrasjes së privilegjuar.

Tronditja e fortë mendore është gjendje e jashtëzakonshme psikike, është gjendje e shkallës së të lartë e afektit, gjendje kjo e cila ka ndikim të madh në aftësinë e autorit që të veproj pa menduar mirë. Përkatësisht, në këtë gjendje personi pa menduar në mënyrë kritike dhe në moment, aty për aty vendosë ta vret provokuesin. Por, duhet theksuar se gjendja afektive mund ta shpënë personin edhe në gjendje të përgjegjësisë së zvogëluar.

¹³⁸Po aty, faqe 486.

¹³⁹Po aty, faqe 486.

¹⁴⁰Po aty, faqe 486.

Në rastet kur autori pa fajin e tij është vënë në gjendje afektive e cila ka shkaktuar përgjegjshmërinë e zvogëluar, atëherë në këso situatë vepra do të kualifikohej si vrasje në gjendje të afektit mendor, por njëherit nuk do të zbatohet dispozita për zbutjen e dënimit. Për ekzistimin e vrasjes së këtillë është e nevojshme të përmbushen këto kushte:

a) që vrasja të jetë kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore (psikike);

b) që autori i veprës pa fajin e tij të ketë rënë në gjendje të këtillë - për shkak të sulmit, keqtrajtimit apo fyerjes së rëndë nga ana e viktimës dhe

c) që vrasja të jetë kryer në gjendje të afektit mendor.

a) Në kuptimin e kësaj dispozite, tronditje e rëndë ekziston kur shkaktohet gjendje e jashtëzakonshme psikike, me ç'rast autori pa gjykuar në mënyrë kritike në moment vendos të kryejë vrasjen. Këto janë pikërisht gjendje afektive të shkallës së lartë. Mirëpo edhe nëse gjendja afektive e tillë autorin e shpie në gjendje të përgjegjësisë esenciale të zvogëluar, ai do të përgjigjet për këtë lloj të vrasjes së privilegjuar.

b) Autori duhet të vihet në gjendje të tronditjes së fortë mendore pa fajin e tij, për shkak të sulmit, keqtrajtimit ose fyerjes së rëndë të të vërtetës. Autori pa fajin e tij është sjellë në një gjendje të tronditjes së fortë psikike atëherë kur nuk e ka provokuar sulmin, keqtrajtimin ose fyerjen e rëndë. Ndërmjet sulmit, keqtrajtimit ose fyerjes së rëndë dhe tronditjes së fortë psikike patjetër duhet të ekzistojë lidhje kauzale.

c) Vrasja konsiderohet se është kryer në gjendje të afektit mendor (psikik) nëse ajo ka ndodhur menjëherë pas sulmit, keqtrajtimit ose fyerjes dhe nën ndikimin e afektit mendor. Mirëpo, nuk është e domosdoshme që ajo të jetë kryer menjëherë pas sulmit, keqtrajtimit ose fyerjes. Me rëndësi është që ndërmjet tronditjes mendore dhe vrasjes të ekzistojë vazhdimësi e caktuar kohore, të ekzistojë kontinuiteti, uniteti i rrjedhës së zhvillimit të gjendjes afektive të intensitetit të caktuar.

Veçmas duhet theksuar se gjendja e afektit mendor duhet të konstatohet sipas personit konkret, e jo sipas ndonjë mesatareje. Kjo nga fakti se nuk do të ishte në përputhje me kuptimin e kësaj vepre penale të privilegjuar e cila bazohet në fajësinë e personit të caktuar, i cili është gjithëherë personal, i individualizuar. Me fjalë të tjera, merret për bazë njeriu

konkret, me sensibilitetin dhe temperamentin e tij dhe vlerësohet nëse tronditja e fortë psikike ka qenë e provokuar me sulmin, keqtrajtimin apo fyerjen e rëndë. Këto tri elemente duhen vlerësuar objektivisht. Mirëpo, ndjeshmëria e madhe kur midis provokimit dhe shkallës së tronditjes nuk ekziston proporcioni përkatës, nuk mund të konsiderohet si kryerje e veprës penale. Gjithashtu, nuk do të konsiderohet vrasje në afekt edhe në rastin kur autori e shfrytëzon situatën e provokimit në mënyrë që thjesht nga hakmarrja e vret sulmuesin, nëse provokimi nuk ka qenë i intensitetit të tillë që të shkaktojë tronditje të fortë mendore, psikike¹⁴¹.

Vrasja në afekt kryhet me dashje. Këtu vendimi dhe dëshira për të kryer vrasjen nxirret shpejt, pa menduar, spontanisht, nxirret dhe shprehet aty për aty (dolusrepentinus).

Objekt i sulmit, keqtrajtimit apo fyerjes së rëndë në të shumtën e rasteve është autori i vrasjes, por duhet theksuar se në sensin e këtij inkriminimi, objekt sulmi, keqtrajtimi ose fyerja e rëndë mund të jenë të drejtuara edhe kundër të afërmeve të autorit: prindërve, vëllezërve apo motrave, fëmijëve, bashkëshortit etj.¹⁴²

Vrasja nga pakujdesia (181)

Kushdo që e privon personin tjetër nga jeta prej pakujdesisë dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.

Vrasje nga pakujdesia konsiderohet nëse ndokush është privuar nga jeta për shkak të pakujdesisë së autorit të veprës penale. Vrasja nga pakujdesia konsiderohet formë e lehtë e vrasjes vetëm për shkak të formës së fajit me të cilën kryhet. Dallimi ndërmjet kësaj vrasjeje dhe vrasjes së rëndomtë dhe të rëndë është i lidhur me fajin, sepse vrasjet e rëndomta dhe të rënda mund të kryhen vetëm me dashje. Është e mundur edhe vrasja e foshnjës nga pakujdesia gjatë lindjes, por nuk konsiderohet vepër penale¹⁴³.

¹⁴¹ Po aty, faqe 486

¹⁴² Po aty, faqe 486

¹⁴³ Prof. dr. Ismet Salihu, Prof. dr. Hilmi Zhitija, Prof. dr. Fejzullah Hasani, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, KOMENTAR, Botimi I, Neni 180, Vrasje nga pakujdesia, pika 1, faqe 488.

Bazë e përgjegjësisë penale për këtë lloj vrasjeje është pakujdesia me vetëdije apo pa vetëdije. Për ekzistimin e kësaj veprë penale është i relevante nëse vrasja është kryer me pakujdesin me vetëdije apo pa vetëdije. Mirëpo në aspektin penalo-juridik, për çdo rast duhet të konstatohet nëse është fjala për pakujdesinë me vetëdije apo pa vetëdije, ngase kjo rrethanë është e rëndësishme jo vetëm për përcaktimin e shkallës së fajësisë me rastin e matjes së dënimit, por edhe për të konstatuar nëse është fjala për pakujdesinë me vetëdije apo dashjen eventuale, si dhe nëse është fjala për pakujdesinë pa vetëdije apo rastin¹⁴⁴. Përgjegjësia penale për këtë lloj të vrasjes së privilegjuar sajohet nga fakti se autori i ka cenuar, nuk i ka respektuar rregullat e rregullat e kujdesit të duhur.

Tek vrasja nga pakujdesia privimi i ndonjë personi nga jeta manifestohet në një mënyrë specifike, zakonisht në mënyrë tjetër në krahasim me privimin me dashje nga jeta. Këtu zakonisht është fjala për veprimet të cilat janë ndërmarrë me ndonjë qëllim tjetër e jo me qëllim të privimit të ndonjë personi nga jeta. Për shkak të veprimeve të autorit, vdekja e personit tjetër shkaktohet si pasojë sekondare, pasojë e cila nuk dëshirohet. Kjo na bën të konkludojmë se në Kodin Penal të Zvicrës¹⁴⁵, të Sllovenisë¹⁴⁶ dhe të Kroacisë¹⁴⁷ janë gjetur zgjidhje më adekuate, sepse këtë vepër penale nuk e quajnë vrasje, por shkaktim i vdekjes nga pakujdesia. Ndërsa Kodi Penal i Serbisë¹⁴⁸, këtë vepër penale nuk e emërton vrasje nga pakujdesia por privim i jetës nga pakujdesia¹⁴⁹.

Dallimi ndërmjet vrasjes nga pakujdesia dhe lëndimit të rëndë trupor, për shkak të të cilit është shkaktuar vdekja qëndron në faktin se vepra e parë (vrasja) në tërësi është kryer nga pakujdesia, kurse te vepra e dytë autori vepron me dashje për të shkaktuar lëndimin e

¹⁴⁴Po aty, faqe 488.

¹⁴⁵ Kodi Penal i Zvicrës, neni 117.

¹⁴⁶ Kodi Penal i Sllovenisë, neni 129.

¹⁴⁷ Kodi Penal i Kroacisë, neni 95.

¹⁴⁸ Kodi Penal i Serbisë, neni 118.

¹⁴⁹ Prof. dr. Ismet Salihu, Prof. dr. Hilmi Zhitija, Prof. dr. Fejzullah Hasani, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, KOMENTAR, Botimi I, Neni 180, Vrasje nga pakujdesia, pika 4, faqe 488.

rëndë trupor, ndërkaq nga pakujdesia për të shkaktuar vdekjen. Në rastin kur lëndimi i rëndë trupor është kryer nga pakujdesia për shkak të së cilës është shkaktuar vdekja, atëherë duhet të konsiderohet se është kryer vetëm vrasja nga pakujdesia, pasi që ligjdhënësi nuk parasheh lëndime të rënda trupore të kryera nga pakujdesia e të kualifikuara si vrasje.

Vrasja nga pakujdesia mund të kryhet me veprim, por edhe me mosveprim. Ky lloj i vrasjes kryhet me mosveprim në rastet kur autori nuk i ndërmarr veprimet e duhura për ta penguar shkaktimin e pasojës – vdekjes¹⁵⁰.

Vrasja e foshnjës gjatë lindjes(neni 182)

Nëna që e privon nga jeta foshnjën e vet gjatë lindjes apo menjëherë pas lindjes, derisa te ajo vazhdon çrregullimi i shkaktuar nga lindja, dënohet me burgim prej tre muaj deri në tre vjet.

Kjo formë e vrasjes së privilegjuar konsiston në privimin e fëmijës nga jeta nga ana e nënës së vet gjatë lindjes ose menjëherë pas lindjes, derisa zgjasin ç ‘rregullimet e shkaktuara nga lindja. Konsiderohet vrasje e privilegjuar ngase tek lehona lindja zakonisht shkakton ç ‘rregullime fizike dhe psikike të përcjella me dhembje, për shkak të të cilave tek ajo manifestohet një gjendje kalimtare e aftësisë së përgjegjësisë së zvogëluar, ose për shkaqe sociale, siç janë për shembull shtatzënësia jashtëmartesore, varfëria dhe rrethanat e tjera sociale¹⁵¹.

Subjekt i kësaj vepre penale mund të jetë vetëm e ëma e cila e privon nga jeta fëmijën e vet (*delictum proprium*). Së këndejmi, nëse ndonjë person tjetër paraqitet si bashkëpunëtor me nënën e foshnjës ose pavarësisht vetë e kryen vrasjen e fëmijës, ai do të përgjigjet për vrasjen e rëndomtë apo të rëndë, varësisht prej mënyrës dhe motiveve të kryerjes së veprës.

¹⁵⁰Gjykata Supreme e Vojvodinës me aktgjykimin Kzh. 41/57, e ka shpallë fajtori pronarin ngase nuk e ka mbuluar gropën me gëlqeren e fikur në oborrin e vet të parrethuar, në të cilën ka rënë një fëmijë dhe e ka humbë jetën (Stojanović, Komentar, faqe 346), cituar nga: Prof. dr. Ismet Salihu, Prof. dr. Hilmi Zhitija, Prof. dr. Fejzullah Hasani, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, KOMENTAR, Botimi I, Neni 180, Vrasje nga pakujdesia, pika 6, faqe 489.

¹⁵¹Prof. dr. Ismet Salihu, Prof. dr. Hilmi Zhitija, Prof. dr. Fejzullah Hasani, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, KOMENTAR, Botimi I, Neni 180, Vrasja e Foshnjes gjatë lindjes, pika 1, faqe 489.

Në të kundërtën, nëse këtë vepër e kryen ndonjë person tjetër, ndërsa e ëma e ka shtytë apo i ka ndihmuar gjatë kohës së lindjes apo menjëherë pas lindjes, deri sa te ajo zgjasin ç'rregullimet e shkaktuara nga lindja, ajo do të konsiderohet bashkëpunëtorë sipas këtij neni, edhe pse personi tjetër përgjigjet për vrasje të rëndomtë apo vrasje të rëndë¹⁵².

Ky lloj i vrasjes mund të kryhet me veprim dhe me mosveprim (delikt komisivo-omisiv). Me mosveprim konsiderohet se kryhet kur e ëma nuk e ushqen apo nuk i ndërmerr masat e duhura, të domosdoshme për përkujdesjen e foshnjës.

Viktimë e kësaj vepre penale mund të jetë vetëm fëmija që është lindur gjallë, është e parëndësishme se a ka pasur aftësi për të jetuar. Nëse veprimi i kryerjes ka filluar para se të ketë filluar lindja, atëherë do të konsiderohet se është fjala për ndërprerjen e palejuar të shtatzënisë(neni 184).

Kjo vepër mund të kryhet me dashje direkte, por mund të kryhet edhe me dashje eventuale. Mirëpo është e mundur që e ëma ta privoj nga jeta foshnjën e vet edhe nga pakujdesia. Lidhur me këtë, në procedurën penale duhet të konstatohet nëse e ëma foshnjën e vet e ka privuar nga jeta duke menduar lehtë se kjo nuk do të ndodhë apo se do të mund ta parandalonte, apo kur nuk ka qenë e vetëdijshme se këtë vepër mund ta kryej, edhe pse sipas rrethanave dhe vetive të saja personale ka qenë e obliguar dhe ka mundë me qenë e vetëdijshme për këtë mundësi. Andaj, është gabim të mendohet se kjo vepër nuk mund të kryhet nga pakujdesia¹⁵³.

Së këndejmi, nuk konsiderohet vepër penale në rastet kur e ëma nga pakujdesia e privon nga jeta fëmijën e saj gjatë lindjes ose menjëherë pas lindjes. Konsiderohet se e ëma e

¹⁵² Stojaniviç, Komentar, faqe 340, cituar nga : Prof. dr. Ismet Salihu, Prof. dr. Hilmi Zhitija, Prof. dr. Fejzullah Hasani, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, KOMENTAR, Botimi I, Neni 180, Vrasja e Foshnjes gjatë lindjes, pika 2, faqe 489.

¹⁵³ Stojaniviç, Komentar, faqe 34, cituar nga: Prof. dr. Ismet Salihu, Prof. dr. Hilmi Zhitija, Prof. dr. Fejzullah Hasani, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, KOMENTAR, Botimi I, Neni 180, Vrasja e Foshnjes gjatë lindjes, pika 7, faqe 490.

kryen këtë lloj të vrasjes së privilegjuar edhe në rastet kur para se të lindë vendos që me rastin e lindjes ta privojë nga jeta dhe nëse këtë edhe e kryen¹⁵⁴.

Vepra mund të kryhet gjatë kohës së lindjes ose menjëherë më pas derisa zgjasin çrregullimet e shkaktuara nga lindja. Lidhur me këtë ç`rregullimet nuk vlerësohen në aspektin e dispozitave me të cilat përcaktohet përgjegjshmëria, përkatësisht përgjegjshmëria e zvogëluar. Gjithashtu edhe intensiteti i ç`rregullimeve nuk është me rëndësi për ekzistimin e kësaj vepre penale. Përkitazi me këtë është arritur pajtimi në teori dhe në praktikë dhe se intensiteti i ç`rregullimeve mund të ketë rëndësi vetëm për matjen e dënimit¹⁵⁵.

Midis ç`rregullimeve dhe lindjes duhet të ekzistoj lidhja kauzave. Nëse vrasja e foshnjës është kryer gjatë procesit të lindjes, atëherë nuk ka vështirësi për konstatimin e lidhjes kauzave. Mirëpo nëse vrasja e foshnjës kryhet pas lindjes, në teori dhe në praktikë lindin dilema se brenda cilit afat mund të konsiderohet se zgjasin ç`rregullime. Disa mendojnë se ky ç`rregullim nuk mund të zgjasë më shumë se 24 orë. Mirëpo, tek ne mbisundon mendimi se përpara nuk mund të caktohet koha sa do të zgjasë ç`rregullimi që të mund të konsiderohet se është kryer ky lloj i vrasjes. Rekomandohet që ekzistimin e ç`rregullimit pas lindjes ta konstatojë eksperti psikiatër. Privimi nga jeta i fëmijës pas 24 orëve nga lindja, përkatësisht pasi që kanë pushuar ç`rregullimet e shkaktuara nga lindja, konsiderohet vepër penale e vrasjes¹⁵⁶.

Meqë ky lloj i vrasjes mund të kryhet vetëm me dashje për të cilën mund të shqiptohet dënimi me burgim deri në tri vjet, është e mundur edhe tentativa e cila ndëshkohet. Në këso raste edhe tentativa, sikundër edhe vepra e përfunduar, duhet të jetë ndërmarrë gjatë kohës

¹⁵⁴ Prof. dr. Ismet Salihu, Prof. dr. Hilmi Zhitija, Prof. dr. Fejzullah Hasani, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, KOMENTAR, Botimi I, Neni 180, Vrasja e Foshnjes gjatë lindjes, pika 6, faqe 490.

¹⁵⁵ Stojaniviç, Komentar, faqe 34. cituar nga: Prof. dr. Ismet Salihu, Prof. dr. Hilmi Zhitija, Prof. dr. Fejzullah Hasani, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, KOMENTAR, Botimi I, Neni 180, Vrasja e Foshnjes gjatë lindjes, pika 7, faqe 490.

¹⁵⁶ Po aty, pika 8, faqe 490.

së lindjes apo menjëherë pas lindjes derisa të ëma zgjasin ç`rregullimet e shkaktuara nga lindja¹⁵⁷.

5.10 ROLI DHE RËNDËSIA E PROKURORIT TË SHTETIT NË RASTET E KËQYRJES SË VENDIT TË NGAJRES TEK VRASJET

Prokuroria në çdo shtet paraqet organin e ndjekjes që përbën zinxhirë shumë të rëndësishëm në sistemin e drejtësisë në përgjithësi. Roli kryesor i saj është ndjekja e veprave penale sipas detyrës zyrtare dhe ofrimi i provave për vërtetimin e fakteve të caktuara nga ana e gjykatave përkatëse¹⁵⁸.

Prokuroria është institucion shtetëror i formuar me Ligj të veçantë, e cila është e pavarur në veprimet dhe vendimet e saja. Prokurori i Shtetit përfaqëson interesat publike para gjykatave dhe në raste të ndjekjes sipas detyrës zyrtare, apo në rast të propozimit të të dëmtuarit mund të negociojë me autorin e veprës penale për të pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare¹⁵⁹. Kompetencat e prokurorit janë të parapara në Ligjin mbi Prokurorinë. Prokurori ka të drejtë të kryejë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm për të vërtetuar praninë e veprës penale. Ai ka të drejtë (kur e çmon të domosdoshme) të vërtetojë kryerjen e veprës penale në përputhje me rolin që ka si drejtues i veprimtarisë hetimore¹⁶⁰.

Roli i prokurorisë në parandalimin e krimit shprehet para së gjithash mes politikës kriminale që ndjek ky organ, ku një rëndësi të veçantë kanë politikat e procedimit (fillimi, mos fillimi i çështjes penale, pushimi, pezullimi dhe dërgimi në gjyq i një çështjeje penale). Politika e procedimit varet nga ligjet që veprojnë, por edhe nga strukturat që funksionojnë për zbatimin e tyre. Sikurse në polici, edhe në prokurori janë krijuar struktura të specializuara për hetimin e krimit ekonomik, korrupsionit, për hetimin e veprave penale të të miturve, dhunën në familje, dhe të tjera¹⁶¹.

¹⁵⁷ Po aty, pika 9, faqe 490.

¹⁵⁸ Prof. dr. Arsim Bajrami, Sistemi Kushtetues ë Republikës së Kosovës, Prishtinë 2011, faqe 327.

¹⁵⁹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Neni 49.

¹⁶⁰ Prof. Dr Vesel Latifi, “Politika kriminale”, Prishtinë 2008, faqe 130.

¹⁶¹ Vasilika Hysi, “Kriminologjia”, Tiranë 2010, Botimi i Dytë i përmirësuar, faqe 409-410.

Prokurori i Shtetit është organ i pavarur, i cili është përgjegjës për ndjekjen e të gjithë atyre që kanë bërë vepra penale. Prokurori i Shtetit është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen e personave të akuzuar për ndonjë vepër penale ose për ndonjë tjetër vepër siç është rregulluar me ligj¹⁶². Sikurse në të gjitha vendet tjera, institucioni i Prokurorit të Shtetit është i rregulluar me ligj. Edhe në sistemin tonë të drejtësisë kjo gjë është rregulluar me ligj dhe me Kodin e procedurës penale në të cilin lidhur me pavarësinë e punës së prokurorit thuhet:

Neni 47

Pavarësia e prokurorit të shtetit

Organet publike nuk mund të ndikojnë në mënyrë formale apo joformale, e as të drejtojnë veprimet e prokurorit të shtetit në trajtimin e çështjeve individuale penale apo në hetime, ndërsa me Ligjin mbi prokurorinë thuhet:

Neni 3

Pavarësia dhe paanshmëria e Prokurorit të Shtetit

- 1. Prokurori i Shtetit është institucion i pavarur që ushtron funksionet e veta në mënyrë të paanshme.*
- 2. Prokurori i Shtetit dhe secili prokuror para ligjit siguron trajtim të barabartë, objektiv dhe paparagjykime për të gjithë personat pavarësisht gjinisë, racës, prejardhjes kombëtare apo sociale, shoqatave apo lidhjeve politike, besimeve fetare, gjendjes apo të metave shëndetësore, apo pozitësshqerore.*
- 3. Është e kundërligjshme dhe në kundërshtim me Kushtetutën për cilindo person fizik apo juridik që të ndërhyjë, pengojë, ndikojë apo të përpiqet të ndërhyjë, pengojë apo ndikojë te Prokurori i Shtetit gjatë kryerjes së funksioneve prokuroriale lidhur me cilindo hetim, procedurë apo lëndë individuale.*

¹⁶²Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 109, paragrafi 1, hyrja në fuqi 15 qershor 2008, faqe 43.

Duke u bazuar në parimin akuzues, sipas të cilit nuk ka gjykim pa paditës (*nemo iudex sine actore*), procedura penale nuk mund të zhvillohet pa akuzë të Prokurorit të Shtetit¹⁶³. Roli i Prokurorit të Shtetit, varësisht nga sistemi i drejtësisë i shtetit përkatës, edhe mund të ndryshojë në kuptimin e cilësimit të tij dhe autorizimeve që ka.

Në procedurën penale të SHBA-së Prokurori i Shtetit nuk cilësohet si organ shtetëror, roli i të cilit është mbrojtja e ligjit, por, si palë e cila ka për detyrë që sa më shumë autor të veprave penale të shpallen fajtor dhe t'u shqiptohen dënime sa më të rënda¹⁶⁴.

Në procedurën tonë penale Prokurori i Shtetit merret me ndjekjen e veprave penale sipas detyrës zyrtare edhe tutje, parimisht, punën e tij e bën sipas parimit të legalitetit dhe vetëm përjashtimisht sipas parimit të oportunitetit, ndonëse sipas paragrafit 3. të nenit 6. të Kodit të Procedurës Penale¹⁶⁵, është krijuar mundësia për zbatim të parimit të oportunitetit. Edhe funksionet e Prokurorit të Shtetit janë të rregulluara me Ligjin për Prokurorinë.

Një prokuror i shtetit, i emëruar sipas rregullave është i autorizuar të iniciojë hetime penale, të paraqesë aktakuzën apo propozim akuzën, të zhvillojë ndjekjen penale apo të kryejë detyra apo funksione të tjera prokuroriale që janë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet e zbatueshme¹⁶⁶.

¹⁶³Prof. dr. Ejup SAHITI, Prof. dr. Rexhep Murati, E DREJTA E PROCEDURËS PENALE, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2013, faqe 152.

¹⁶⁴Prof. dr. Ejup Sahiti, prof. dr. Rexhep Murati, mr. sc. Xhevdet Elshani, KOMENTAR, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, KOMENTAR, Botimi i I, i publikuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Prishtinë, 2013, faqe 187.

¹⁶⁵Neni 6, paragrafi 3 “Prokurori i shtetit mund të fillojë procedurën penale në pajtim me paragrafin 2. të këtij neni pas marrjes së informacionit nga policia, institucioni tjetër publik, institucioni privat, qytetari, media, nga informacioni i marrë në një procedurë tjetër penale ose pas ankimit ose propozimit të të dëmtuarit. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 04/ L-123, Prishtinë, 13 dhjetor 2012, hyrja në fuqi 01.01.2013.

¹⁶⁶Ligji për Prokurorin e Shtetit, LIGJI Nr. 03/L-225, Neni 4, paragrafi 2, Ushtrimi i funksioneve prokuroriale, 30 shtator 2010, Shpallur me dekretin Nr. DL-049-2010, datë 18.10.2010 nga u.d. Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Jakup Krasniqi.

5.11 Detyrat dhe Kompetencat e Prokurorisë Publike

Në ligjin për prokurorinë e shtetit janë paraparë edhe detyrat dhe kompetencat që kanë prokurorët e shtetit gjatë punës së tyre.

KREU III

DETYRAT DHE KOMPETENCAT E PROKURORIT TË SHTESTIT

Neni 7

Detyrat dhe kompetencat e prokurorëve

1. Detyrat dhe kompetencat e prokurorëve të shtetit përfshijnë:

- 1.1. ushtrimin e funksioneve prokuroriale në mënyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme dhe të sigurohen që të gjithë personat trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit;
- 1.2. zbatimin e standardeve më të larta të kujdesit gjatë kryerjes së funksioneve zyrtare;
- 1.3. sjellje të ndershme dhe profesionale si në jetën personale ashtu edhe profesionale dhe bazuar në ligjin e zbatueshëm dhe kodin e etikës profesionale;
- 1.4. ruajtjen e nderit dhe dinjitetit të Prokurorit të Shtetit;
- 1.5. mbrojtjen e të drejtave ligjore të viktimave, dëshmitarëve, të dyshimtëve, të akuzuarve dhe personave të dënuar;
- 1.6. ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme juridike për zbulimin e veprave penale dhe të autorëve të krimit si dhe hetimin dhe ndjekjen me kohë të veprave penale;
- 1.7. marrjen e vendimeve mbi iniciimin, vazhdimin apo ndërprerjen e procedurës penale ndaj personave të dyshuar apo të akuzuar për kryerjen e veprave penale;
- 1.8. ngritjen e aktakuzave dhe përfaqësimin e tyre para gjykatës;
- 1.9. ushtrimin e mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve gjyqësore;
- 1.10. bashkëpunimin me policinë, gjykatat dhe institucionet e tjera;
- 1.11. ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të tjera të përcaktuara me ligj.

Përveç funksionit të hetimit dhe të ndjekjes së veprave penale në procedurë penale, në planin e gjerë të luftës kundër kriminalitetit, prokuroria e shtetit së bashku me këshillin

prokurorial të Kosovës ka të drejtë dhe për detyrë t'i përcjellë dhe t'i studiojë marrëdhëniet dhe dukuritë shoqërore të rëndësishme për realizimin e funksionimit të tyre dhe për vrojtimet e veta. Këshilli Prokurorial i Kosovës njofton Kuvendin e Kosovës dhe jep propozime për parandalimin e dukurive të rrezikshme dhe të dëmshme për shoqërinë si dhe për përforsimin e sundimit të ligjit¹⁶⁷.

5.12 Struktura Organizative dhe Juridiksioni i Prokurorit të Shtetit

Në ligjin për Prokurorin e Shtetit përshkruhet edhe struktura organizative dhe juridiksioni i Prokurorit të Shtetit, në të cilën thuhet:

Neni 11

Kryeprokurori i Shtetit

1. Kryeprokurori i Shtetit ka juridiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
2. Kryeprokurori i Shtetit ka juridiksion ekskluziv mbi lëndët në shkallë të tretë pranë Gjykatës Supreme.
3. Kryeprokurori i Shtetit ka juridiksion ekskluziv mbi të gjitha lëndët që përfshijnë mjete të jashtëzakonshme juridike.
4. Kryeprokurori i Shtetit mund të marrë në kompetencë secilën lëndë me kërkesë apo pajtim të Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.
5. Kryeprokurori i Shtetit mund të marrë në kompetencë secilën lëndë në secilën prokurori të Republikës së Kosovës siç është përcaktuar me ligj.
6. Kryeprokurori i Shtetit është kreu i Prokurorit të Shtetit dhe ka përgjegjësi të gjithmbarshme për menaxhimin e Prokurorit të Shtetit dhe mbikëqyrjen e të gjithë prokurorëve. Kryeprokurori i Shtetit mund të delegoj disa përgjegjësi të tij/saj.
7. Kryeprokurori i Shtetit nxjerr rregulla, instruksione, udhëzime dhe vendime për rregullimin e brendshëm të Prokurorit të Shtetit.

¹⁶⁷Prof. dr. Ejup SAHITI, Prof.dr. Rexhep Murati, E DREJTA E PROCEDURËS PENALE, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2013, faqe 153.

8. Selia e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit është në Prishtinë¹⁶⁸.

5.13 GJYKATAT

Funksioni i gjykatës është shumë i rëndësishëm dhe proces shumë i ndërlikuar, si një thirrje që duhet të bazohet në një shkallë të lartë të emancipimit, duke dalë nga baza primitive dhe dogmatike juridike, nëpërmjet shfrytëzimit të njohurive mbi individin dhe shoqërinë. Puna e gjyqit duhet të kuptohet si një punë analitike, proces studioz dhe në fund i sintetizuar dhe integruar, ku gjykatësi duhet të veprojë në kuadër të ligjit dhe në frymën e tij; kjo do të thotë mbi baza ligjore dhe mbi bazën e shikimeve dhe interpretimeve të sjelljes delikuede dhe në dritën e rrezikimit të tyre në një mjedis shoqëror, duke e kuptuar rolin e vetë shoqëror në funksion të mbrojtjes së shoqërisë dhe të vlerave të saj nga ato sjellje të inkriminuara¹⁶⁹.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 103, Kapitulli 14. në vija të trasha ka përfshirë organizimin dhe juridiksionin e gjykatave në Republikën e Kosovës. Përveç që përcaktohet se autoriteti më i lartë gjyqësor në vend është Gjykata Supreme, çështjet e tjera lidhur me organizimin dhe funksionimin e kësaj gjykate dhe gjykatave të tjera i lihen ligjit¹⁷⁰. Ligji përcakton këtë mënyrë të organizimit të gjykatave¹⁷¹.

Gjykata Themelore— janë gjykata të shkallës së parë dhe kompetencën e tyre territoriale e ushtrojnë në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Janë gjithësejt shtatë gjykata themelore në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Gjykatat themelore në kuadër të organizimit të tyre kanë *Departamentin e përgjithshëm, Departamentin e krimeve të rënda dhe Departamentin për të mitur*.

¹⁶⁸Ligji Nr. 03/ L-225, 30 shtator 2010, Shpallur me dekreten Nr. DL-049-2010, datë 18.10.2010 nga u.d. Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Jakup Krasniqi.

¹⁶⁹Prof. Dr. Vesel Latifi, “Politika Kriminale”, Prishtinë 2008, faqe 132.

¹⁷⁰Prof. dr. Arsim Bajrami, Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës, Prishtinë 2011, faqe 314.

¹⁷¹Ligji për Gjykatat, Nr.03/L – 199,Ligji Nr. 04/ L-171, 20 dhjetor 2012.

Gjykata e Apelit – është gjykatë e shkallës së dytë me seli në Prishtinë. Kjo gjykatë, në përbërjen e saj pasqyron shumë llojshmërinë etnike, me një kuotë prej 15% ashtu siç është paraparë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Gjykata e Apelit vendos vetëm në përbërje kolegjiale dhe atë, sipas rregullit, në kolegji gjyqësor të përbërë prej gjyqtarëve profesionistë¹⁷².

Gjykata Supreme - Gjykata Supreme e Kosovës është instanca më e lartë gjyqësore në Kosovë dhe ka juridiksion në gjithë territorin e Republikës së Kosovës¹⁷³. Gjykata Supreme përfshinë Kolegjin e Apelit të Agjencionit Kosovar të Pronës si dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, gjyqtarët e së cilës janë pjesë e Gjykatës Supreme.

Përbërja e Gjykatës Supreme pasqyron përbërjen etnike të popullsisë Kosovës. Së paku pesëmbëdhjetë (15%) të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, por asnjëherë më pak se tre (3) gjyqtarë, janë nga radhët e komunitetit që nuk është shumicë në Kosovë. Selia e Gjykatës Supreme është në Prishtinë¹⁷⁴ (Ligji për Gjykatat, 2013: Nr. 03/L – 199).

¹⁷²Prof. dr. Ejup SAHITI, Prof. dr. Rexhep Murati, E DREJTA E PROCEDURËS PENALE, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2013, faqe 140.

¹⁷³Ligji për Gjykatat, Nr 03/L – 199, neni 21, paragrafi 1, Gjykata Supreme, Ligji Nr. 04/ L-171, 20 dhjetor 2012.

¹⁷⁴Po aty, neni 21, paragrafi 2,3,4 Gjykata Supreme, Ligji Nr. 04/ L-171, 20 dhjetor 2012.

KAPITULLI VI

PERMBLEDHJE E KAPITULLIT TË VI

Vendi i ngjarjes ka edhe veçoritë e veta të cilat pa dyshim se janë të llojeve të ndryshme sepse edhe rastet që ndodhin janë të ndryshme për nga mënyra, forma, mjetet e përdorura etj. Veçoritë apo karakteristikat e vendit të ngjarjes në rastet e vrasjeve zënë një vend të rëndësishëm në gjithë këtë punim e në veçanti në këtë kapitull. Duke pasur parasysh këto veçori, edhe këqyrja e vendit të ngjarjes tek veprat penale të vrasjeve kërkon një angazhim profesional të një ekipi të trajnuar mirë dhe me eksperiencë. Autorët e krimeve të vrasjeve përdorin lloj-lloj metoda dhe taktika të ndryshme, në mënyrë që të dezorientojnë hetimin dhe në këtë mënyrë t'u shmangen ndjekjes dhe kapjes nga organet e rendit. Ata mund t'a marrin viktimën nga vendi ku kanë kryer krimin dhe t'a dërgojnë në një vend tjetër vetëm e vetëm për të hutuar ekipet e këqyrjes. Nëse hasim në një situatë të tillë, ekspertët e vendit të ngjarjes duhet pasur kujdes të madh, sepse me këtë rast mund të dëmtohen gjurmët dhe provat materiale në mase të madhe. Kjo mund të ndodhë për arsye të ndërrimit të vendit, shkatërrimit apo fshehjes së qëllimshme të provave etj., prandaj duhet një hetim detal dhe i kujdesshëm.

Menaxhimi i hetimit dhe këqyrjes së vendit të ngjarjes tek rastet e vrasjeve është një detyrë tjetër mjaft e rëndësishme e grupit hetimor në rastet e tilla. Dokumentimi dhe ruajtja e provave të cilat gjenden në një vend të ngjarjes në një rast vrasje, duhet të menaxhohet në mënyrën më të mirë. Tërë personeli i grupit hetimor në një rast të tillë, duhet të jetë i koordinuar në mes veti në mënyrë që të gjitha punët që duhet kryer, të kenë drejtimin e duhur dhe të kenë rezultatin e pritshëm. Mund të ndodhë që gjatë procesit të hetimit të një vendi të ngjarjes në një rast vrasje, të ketë nevojë për angazhim apo ndihmë edhe tëa gjencioneve tjera. Me këtë rast menaxhimi i mirë i tërë procesit do të koordinoj punët në atë mënyrë, që të gjithë do të kryejnë punën e tyre, me sukses dhe në bashkëpunim të mirë. Mund të ketë edhe pengesa të ndryshme gjatë menaxhimit të rasteve, por ato duhet tejkaluar dhe minimizuar në atë masë, sa që të mos jenë pengesa të pakalueshme, të cilat do të ndikojnë në suksesin e hetimeve. Detyrat që do t'i ndajë menaxheri i mirë në një rast të tillë duhet të jenë të qarta, në proporcion me aftësitë dhe

mundësitë që ka hetuesi i vendit të ngjarjes. Hetuesi nuk duhet ngarkuar me punë që nuk është në gjendje t'i kryej për çfarëdo lloj arsye.

Menaxhimi i mirë ka rëndësi të madhe edhe gjatë këqyrjes së kufomave tek rastete vrasjeve. Bashkëpunimi i ngushtë me ekspertet e mjekësisë ligjore dhe ekipet tjera të specializuara për këtë lëmi, patjetër se do të ketë efektin e vet pozitiv në këtë drejtim. Në tënjëjtin nivel, duhet të jetë edhe gjatë ekzaminimit të plagëve të viktimave në vendin e ngjarjes. Gjitha këto kanë zënë një vend të veçantë në këtë kapitull.

6. VEÇORITË E KËQYRJES SË VENDIT TË NGJARJES TEK RASTET E VRASJEVE

Vendi i ngjarjes ka karakteristikat e veta të veçanta në të gjitha veprat që ndodhin, po ashtu edhe tek rastet e vrasjeve na paraqiten këto karakteristika. Këto dallojnë njëra prej tjetrës varësisht se për çfarë vendi të ngjarjes bëhet fjalë. Njëra prej karakteristikave është edhe mënyra e kryerjes së veprës penale të vrasjes. Kjo ka rëndësi të madhe në këqyrjen e vendit të ngjarjes, sepse mënyra e kryerjes e përcakton edhe mënyrën e kërkimit dhe gjetjes së gjurmëve apo provave materiale. Nëse vrasja është kryer në mënyrë mizore apo dinake, siç është paraparë në KPRK, kjo vrasje kryhet atëherë kur autori në mënyrë dinake, në mënyrë të fshehtë e mashtruese privon nga jeta personin, pa rezistencë apo me rezistencë shumë të vogël dhe në këtë rast dorasi shfrytëzon sinqeritetin apo besimin e viktimës¹⁷⁵.

Nga praktika kemi raste kur viktimën e thërret dikush në shtëpinë e vet për një punë ose marrëveshje që kinse do ta bëjë me të, dhe të njëjtit në mënyrë të fshehtë (pas shpine) ia shkrep armën duke e lënë të vrarë. Me këtë rast, ai mundohet ose zhduk të gjitha gjurmët dhe provat materiale, trupin e viktimës mund edhe ta dërgojë në një vend tjetër (liqe, mal etj.) dhe në këtë mënyrë t'i asgjësojë provat. Në një rast të tillë këqyrja e vendit të ngjarjes është mjaft delikate, duke pasur parasysh faktin se zhdukja e gjurmëve dhe provave materiale vështirëson punën e ekipevetë këqyrjes dhe kërkohet një angazhim edhe i agjencioneve tjera siç janë: ekipet e kërkim-shpëtimit apo ekipet mjekësore.

Kemi edhe raste të tjera kur autori futet në ndonjë lokal, i cili është i mbushur me njerëz dhe duke kryer veprën e tij të vrasjes vë në rrezik edhe personat tjerë që gjenden në atë vend. Këqyrja e vendit të ngjarjes në këtë rast kërkon një angazhim të madh në fiksimin, kërkimin, gjetjen dhe marrjen e provave materiale, sepse njerëzit nga paniku dhe frika, duan që sa më shpejt të dalin nga ky vend, dhe me këtë rast ata mund edhe t'i shkatërrojnë gjurmët dhe provat materiale që gjenden aty.

¹⁷⁵Prof.dr. Ismet Salihu, Prof.dr. Hilmi Zhitija, Prof.dr. Fejzullah Hasani, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, KOMENTAR, Botimi I, Neni 179, Vrasja e Rëndë, pika 1.10, Vrasja për motive racore, nacionale apo fetare, faqe 482.

Tek sulmet terroriste, mundësia për të gjetur gjurmë dhe prova materiale është shumë e vështirë, duke pasur parasysh se mjetet/armët që përdorin terroristet janë të tilla, që shkaktojnë dëme të konsiderueshme, duke shkatërruar pothuaj çdo gjë. Në këto raste këqyrja e vendit të ngjarjes kërkon kujdes në qëmtimin, kërkim detal të gjurmëve dhe provave materiale si dhe kërkon angazhimin e agjencioneve tjera siç janë: zjarrfikësit, ekipet mjekësore, ekipet e kërkim-shpëtimit etj.

Praktika tregon se autorët e veprës penale të vrasjes mund edhe ta dërgojnë trupin në ndonjë vend tjetër, për t'i fshehur apo edhe zhdukur provat. Në këtë rast duhet pasur parasysh se kemi dy vende të ngjarjes, në të cilat mund të gjenden dëshmi. Pra, në vendin ku është kryer vepra dhe në vendin ku është gjetur viktima, apo gjithnjë sipas praktikës, mund të ndodh që viktimës t'i ndahet një pjesë e trupit dhe pjesa tjetër fshehët diku tjetër, në mënyrë që të vështirësohen punët e ekipeve të këqyrjes së vendit të ngjarjes. Kemi raste kur viktimës ju ka prerë koka dhe është dërguar në një vend tjetër, në mënyrë që kur trupi të gjendet, i njëjti të mos identifikohet. Kjo përbën njërën nga vështirësitë e mëdha që ekipi i këqyrjes mund të ketë në ndonjë vend ngjarje.

6.1 MENAXHIMI I VENDIT TË NGJARJES TEKRASTET E VRASJES

6.2 Menaxhimi i hetimit të rastit

Dy principet themelore për hetimin e drejtë dhe sa më korrekt të një rasti të vrasjes janë **dokumentimi** dhe **ruajtja** e të gjitha gjurmëve dhe provave materiale, që kjo të sigurohet dhe të realizohet në mënyrë sa më të drejtë, tërë rasti duhet të ketë një administrim të mirë e të duhur¹⁷⁶. Menaxhimi i mirë i rastit është i nevojshëm dhe i domosdoshëm për ecurinë e duhur të gjithë punës që bëjnë ekspertët e vendit të ngjarjes dhe hetuesit e rastit në përgjithësi.

Gjithashtu, menaxhimi i mirë i rastit orienton edhe përpjekjet e hetuesve për një hetim të duhur fillestar dhe përpjekjet e tyre për një dokumentim të të gjithë ngjarjes që ka ndodhur, si dhe kërkimin, gjetjen, marrjen e të gjitha gjurmëve dhe provave materiale, ruajtjen dhe ekzaminimin e tyre. Aktivitetet e organeve të ndjekjes duhet të jenë të menaxhuara në mënyrë të shkëlqyer ashtu që tërë ky organizim të ketë efektin dhe suksesin e dëshiruar.

Sido që të jetë, një menaxhim inteligjent i një rasti të vrasjes duhet të sigurojë fleksibilitet dhe mendim praktik të përbashkët. Gjithë personeli që angazhohet në lidhje me një rast vrasjeje, duhet të ketë koordinim mes vete dhe të gjitha agjencionet tjera të involvuara në këtë rast.

Duke e ditur rëndësinë e një hetimi dhe koordinimi të tillë, menaxhimi i mirë i gjithë kësaj shumësie të aksioneve dhe veprimeve që ndërmerr grupi hetimor, mund të konkludojmë se menaxhimi efikas është ai që koordinon, orienton dhe organizon të gjitha këto veprime në mënyrë të duhur.

¹⁷⁶Vernon J. Geberth M.S.,M.P.S.,B.B.A.,FBINA, PRACTICAL HOMICIDE INVESTIGATIONS, Tactics,Procedures and Forensic Techniques, Fourth Edition,page 903, Published in 2006,CRC Press,New-York ,Suite 300,USA.

Çdo departament i policisë në bashkëpunim edhe me agjencie tjera të cilat kyçen në këto raste, duhet të kenë një bashkërenditje, një rregullim qoftë në formë të shkruar ose në formë të urdhëresave apo njoftimeve të ndryshme lidhur me mbarëvajtjen e të gjitha punëve dhe veprimeve hetimore e procedurale që kanë të bëjnë me menaxhimin e një rasti në përgjithësi e posaçërisht të një rasti të vrasjes në veçanti. Rregulloret e secilit departament policor duhet të jenë kompatible (përshtatshme) me kërkesat ligjore dhe përgjegjësitë e agjencive tjera siç janë: zyra e prokurorit, ekzaminuesit mjekësor dhe agjencive tjera që mund të përfshihen në hetimin e rastit të vrasjeve. Duke marrë parasysh dallimet e rregulloreve të organizatave tjera, rregulloret e policisë brenda tyre duhet të përmbajnë kushtet e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informatave me këto agjenci.

6.3 Përgatitja paraprake

Grupet e këqyrjes së vendit të ngjarjes duhet të posedojnë pajisjet dhe automjetet e nevojshme. Më të përshtatshme janë automjetet e tipit “auto-lab”, në të cilat janë shumica e pajisjeve që kërkohen për ta zhvilluar një këqyrje të një vendngjarje. Ekipet e këqyrjes duhet pasur vëmendjen dhe të pajisen me materialet e duhura për paketimin dhe grumbullimin e gjurmëve dhe provave materiale në sasinë e zakonshme dhe të nevojshme për një vendngjarje. Ata duhet të kujdesen dhe të jenë siguruar se kanë me vete: veshjet dhe pajisjet personale mbrojtëse për stafin, automjetet që përdoren në vendngjarje duhet inspektuar rregullisht për t’u siguruar se janë të kompletuara në çdo moment, gjithashtu varësisht nga nevojat e paraqitura duhet mbajtur kontakt me specialistët e profiluar etj.¹⁷⁷

Ekipet e këqyrjes duhet pasur në konsiderate disa çështje të rëndësishme para se të jenë thirrur për të zhvilluar këqyrjen. Konsideratat që ekipi i këqyrjes duhet t’i ketë parasysh janë: veshjet, personeli, komunikimi, ndriçimi, sistemimi-strehimi, pajisjet e mbrojtjes personale, ushqimi dhe pijet, ndihma mjekësore, sigurimi i vendngjarjes, pajisjet, veglat e posaçme, pajimet e posaçme etj. Në bazë të praktikës dhe duke u bazuar në

¹⁷⁷Menaxhimi i Vendit të Ngjarjes, Material nga trajnimi i autorit në ILEA, Budapest, Hungari, mars-prill 2017

llojllojshmërinë e mënyrës së paraqitjes së rasteve në përgjithësi, me të drejtë shtrohet pyetja:

Cilët hapa duhen ndërmarrë për t'u përgatitur për këqyrjen e vendngjarjes?

Varësisht se për çfarë rasti bëhet fjalë, ekipi i këqyrjes do t'i komplotojë pajisijet e nevojshme. Grumbullimi i pajisjeve personale mbrojtëse për stafin, kompletimi i pajisjeve në automjetet e specializuara, kontakti me specialistët janë hapat kryesore që ekipi duhet t'i ndërmarrë kur është në fazën e përgatitjes për të zhvilluar një këqyrje.

Përveç përgatitjeve që u cekën më lartë, ekipi i këqyrjes duhet pasur parasysh edhe anëtarët e personelit që do të zhvillojë këqyrjen. Në bazë të rastit për të cilin janë thirrur, ekipi i këqyrjes duhet të mobilizohet dhe të thërras ekspertët e lëmive përkatëse, varësisht se për çfarë rasti bëhet fjalë. Në këtë situatë ekipi duhet të jetë i kompletuar dhe se cili prej tyre duhet ditur detyrat dhe përgjegjësitë që ka. Që ekipi i këqyrjes të jetë sa më i kompletuar dhe këqyrjen ta zhvillojë në mënyrën më profesionale, duhet ditur gjashtë funksionet kryesore që ka ky ekip, ato janë:

- *Udhëheqësi/përgjegjësi i grupit*
 - *Fotografi*
 - *Skicuesi*
 - *Përgjegjësi për regjistrimin dhe ruajtjen e gjurmëve dhe provave materiale*
 - *Personeli i mbledhjes së gjurmëve dhe provave materiale*
 - *Specialistë të tjerë*¹⁷⁸

¹⁷⁸ Menaxhimi i Vendit të Ngjarjes, Material nga trajnimi i autorit në ILEA, Budapest, Hungari, mars-prill 2017

Udhëheqësi/përgjegjësi i ekipit/grupit

Është detyrë e udhëheqësit të përgjigjet për vendin e ngjarjes, të garanton sigurinë e personelit, harton/mban procesverbalet e veprimeve procedurale, harton përshkrimin e vendngjarjes, bën këqyrje paraprake dhe njofton ekipin mbi situatën, ngre/vendos postë-komandën apo qendrën komanduese, lejon shkëmbimin e informacionit midis anëtareve të grupit, koordinon punën me agjencitë e tjera në rajon, vëzhgon dhe rivlerëson procesin e këqyrjes, cakton funksionet në grup, përgjigjet për sigurinë e vendngjarjes, kontrollon hyrjet në vendngjarje, mediat, eprorët, kalimtarët, bën këqyrjen përfundimtare, liron vendngjarjen. Gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes mund të paraqitet nevoja edhe për asistencën e ekspertëve të lëmive të ndryshme. Udhëheqësi i grupit në bashkëpunim me anëtarët tjerë të grupit të këqyrjes, sipas nevojave që paraqiten gjatë këqyrjes, vendos se çfarë specialistë të profiluar mund të duhen për të ndihmuar në përpunimin e vendngjarjes. Profilet e specialistëve përfshijnë: antropologë, botanistë, gjeologë, ekspertë të daktiloskopisë, xhenierë, specialistë për materialet e rrezikshme, ekipet e deminimit etj.¹⁷⁹

Fotografi

Duke ditur se fotografimi i vendit të ngjarjes është njeri ndër veprimet e rëndësishme të ekipit të këqyrjes, atëherë fotografi luan një rol të rëndësishëm në këtë proces. Ai kryen këto veprime: bën fotografi në hyrje dhe në dalje, fotografon gjithë vendngjarjen (fotografimi orientues, i pamjes së përgjithshme, i distancës së mesme dhe i objektit me shkallë ose pa shkallë), fotografon provat e rëndësishme, gjurmët e padukshme të gishtave dhe gjurmët e tjera, përgatit procesverbalin fotografik në të cilin vendos sipas radhës të gjitha fotografitë që ka bërë nga fillimi deri në fund. Procesverbali fotografik, mund të bëhet nga fotografët apo edhe nga ndonjë person tjetër që është pjesë e grupit¹⁸⁰.

¹⁷⁹ Menaxhimi i Vendit të Ngjarjes, Material nga trajnimi i autorit në ILEA, Budapest, Hungari, mars-prill 2017

¹⁸⁰ Po aty.

Skicuesi/vizatuesi

Për dokumentimin e vendit të ngjarjes, nuk mjafton vetëm fotografia. Skicimi apo vizatimi i vendit të ngjarjes është gjithashtu njëri ndër veprimet shumë të rëndësishme në vendin e ngjarjes. Ai që skicon apo vizaton kryen këto detyra: bën skicën/vizatimin, ndan dhe etiketon zonat, dokumenton në skicë se ku janë gjetur gjurmët dhe provat materiale, bën matjet e duhura, regjistron të dhënat e rëndësishme në skicë siç janë: nr. i dosjes, data, vendi, emri i skicuesit, shënon veriun në skicë, vë shënimin “Pa shkallë” apo “ e pa shkallëzuar”, çelësi ose legjenda¹⁸¹.

Përgjegjësi për gjurmët dhe provat materiale

Në ekipin e këqyrjes duhet caktuar njërin nga anëtarët e tij që të jetë përgjegjës për gjurmët dhe provat materiale që mund të gjenden në atë vendngjarje. Detyrë e përgjegjësit të këtyre provave është: harton procesverbalin e gjurmëve dhe provave materiale, merr në dorëzim dhe regjistron çdo gjurmë dhe provë materiale, koordinon punën e paketimit dhe ruajtjes së gjurmëve dhe provave materiale, sigurohet se të gjitha paketimet janë të rregullta dhe me dokumentacion të plotë, është në funksionin e përgjegjësit të kujdeset për gjurmët dhe provat materiale dhe për kontrollin e cilësisë etj.¹⁸²

Procesverbali i gjurmëve dhe provave materiale

Personeli i mbledhjes së gjurmëve dhe provave materiale gjatë kërkimit të këtyre provave, të njëjtat duhet t'i shënojë në procesverbal i cili krijohet enkas për shënimin e këtyre provave. Informatat që përfshihen në këtë procesverbal janë: shënimi se kush gjen dhe grumbullon gjurmët dhe provat materiale, sigurohet se provat e rëndësishme janë fotografuar në vend para se të grumbullohen, polici vë inicialet e tij dhe datën mbi provat e grumbulluara dhe ia dorëzon përgjegjësit të provave etj.¹⁸³

¹⁸¹ Menaxhimi i Vëndit të Ngjarjes, Material nga trajnimi i autorit në ILEA, Budapest, Hungari, mars-prill 2017.

¹⁸² Po aty

¹⁸³ Po aty

6.4 Pengesat në menaxhimin e rastit

Duke pasur parasysh se në menaxhimin efikas të një rasti të vrasjes doemos paraqitet nevoja për angazhimin dhe ndihmën edhe të agjencioneve tjera, atëherë patjetër se gjatë këtij procesi shfaqen apo paraqiten edhe disa pengesa që ndonjëherë janë mjaft të ndërlikuara dhe për eliminimin e tyre duhet një qasje profesionale. Disa nga këto pengesa janë:

- *Rregulloret dhe procedurat jo adekuate të hetimeve të cilat janë të bazuara në burokraci, çështje politike dhe nuk janë të lidhura me objektivat primare që kanë të bëjnë me zgjidhjen e rasteve*¹⁸⁴.

- *Interferimi i eprorëve të lartë, që në praktikë ndodhë shumë shpesh duke shkelur zinxhirin komandues dhe duke tejkaluar përgjegjësitë e tyre*¹⁸⁵.

- *Rivaliteti mes agjencive, që nënkupton se agjencionet e ndryshme që merren me hetimin e vrasjeve siç janë policia, prokuroria, ekipet mjekësisë ligjore etj. duhet të krijojnë marrëdhënie të bazuar në bashkëpunim, besim dhe respekt të ndërsjellë*¹⁸⁶.

Nuk duhet të ketë hapësirë për rivalitet mes agjencive që marrin pjesë në një hetim profesional të vrasjes. Agjencitë e zbatimit të ligjit kanë përgjegjësi për hetimin e vdekjeve të papritura dhe të pasqaruara dhe të arrijnë në një përfundim lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë konkrete që i ka secili agjencion gjatë një hetimi, sepse në aktin e fundit, ***“Hetimet e krimeve nuk janë industri e shërbimit”***¹⁸⁷.

Nëse analizojmë fjalinë e cituar më lartë, atëherë, hetimet e krimit përfaqësojnë funksion thelbësor dhe të specializuar në shkallë të lartë e jo shërbim në raste të caktuara. Se kjo me të vërtetë është e saktë ne duhet të mbajmë në mendje se gjatë punës nëpër këto njësitate

¹⁸⁴Vernon J. Geberth M.S.,M.P.S.,B.B.A.,FBINA, PRACTICAL HOMICIDE INVESTIGATIONS, Tactics,Procedures and Forensic Techniques, Fourth Edition, page 909,Published in 2006,CRC Press,New-York,Suite 300,USA.

¹⁸⁵Po aty, faqe 909.

¹⁸⁶ Po aty, faqe 909.

¹⁸⁷Po aty, faqe 909.

personeli duhet të jetë mjaft i përgatitur, i trajnuar, të kenë njohuri, aftësi, të jenë të vetëdijshëm, se me çka në të vërtetë ballafaqohen gjatë punës së tyre të përditshme.

Dimë së gjatë ekzaminimit të gjurmëve dhe provave materiale kërkohen njohuri në fusha të ndryshme shkencore. Gjithashtu edhe gjatë intervistave të ndryshme që hetuesit kryejnë, varësisht se kë e intervistojnë ata; të dyshuar mund të jenë edhe njerëzit që janë të përgatitur nëpër fusha të caktuara dhe një bisedë apo intervistë me të njëjtit, kërkon njohuri, shkathtësi dhe teknikë të jashtëzakonshme të marrjes në pyetje të këtyre personave.

6.5 Procedurat dhe rëndësia e tyre në rastet e vrasjeve

Menaxhimi dhe mbikëqyrja e një rasti të vrasjes është e ndarë në pesë segmente specifike:

- 1. Mbikëqyrja e hetimeve të para në vend të ngjarjes;** informatat që mund të sigurohen në fillim të hetimit të rastit janë të një rëndësie të veçantë, pasi që më vonë deklaratat e të dyshuarve a dëshmitarëve mund të pësojnë ndryshime si rrjedhojë e kërcënimeve apo humbjes së kujtesës për rastin.
- 2. Udhëheqja e detyrave specifike hetimore;** gjatë procesit të hetimeve kemi edhe detyra specifike që hetuesit duhet t'i kryejnë në mënyrë që të sigurojnë dëshmi dhe prova të nevojshme për procedurën e mëtutjeshme. Këto detyra përfshijnë përgjimet e ndryshme, fotografimet, incizimet...
- 3. Mbikëqyrja gjatë kontrollimit të vendit të ngjarjes në rast vrasje;** duhet kujdes i veçantë i oficerëve që sigurojnë vendin e ngjarjes, sepse ky vend mund të atakohet nga njerëzit e afërt me të dyshuarin apo nga pakujdesia e njerëzve që janë kureshtarë të dinë se çka ka ndodhur në atë vend. Gjithashtu mbikëqyrësi duhet të sigurohet se të gjitha punët janë duke ecur në mënyrë të duhur dhe të koordinojë veprimet me agjencionet tjera të specializuara.

Praktika tregon se të afërmit e viktimës kanë shpërndarë gëzhoja nëpër gjithë terrenin e vendit të ngjarjes, vetëm që të duket se aty ka pasur numër të madh të të shtënave me armë dhe janë përdorur disa armë. Një kujdes i veçantë i gjithë ekipit, mbikëqyrësit në veçanti, ka bërë që gjithçka të evitohet dhe të sqarohet në mënyrën më të mirë.

4. **Sigurimi i dokumentimit efektiv të ngjarjes;** që dokumentimi të ketë vlerën e vet, ai duhet të sigurohet se është bërë në mënyrën më të mirë të mundshme. Procesverbali, fotografimi dhe skicimi i vendit të ngjarjes janë tre hapat kryesor që ekipi i këqyrjes duhet t'i bëjë.
5. **Kryerjen e hetimit në përgjithësi;** pas këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe administrimit të të gjitha gjurmëve dhe provave materiale si dhe punës së hetuesve në sigurimin e fakteve tjera që na dërgojnë tek autori i veprës penale, mund të themi se këto janë një sukses për gjithë njësinë e hetimeve të krimit. Sukses në hetimin e kryer mund ta vlerësojmë atëherë kur ekipet e këqyrjes dhe ekipet tjera të hetuesve kanë siguruar të gjitha provat materiale dhe të njëjtat janë prezantuar para gjykatës në mënyrë që ajo ta marrë vendimin e duhur.

6.6 Mbikëqyrja e rasteve të vrasjeve

Që nga marrja e informatës së parë lidhur me një rast vrasjeje, menjëherë duhet të mendohet se si të mbikëqyret dhe menaxhohet ky rast.

Marrja e informatës fillestare përfshinë këto të dhëna:

- *Data dhe koha e pranimit të informatës,*
- *Mënyra si është pranuar informata,*
- *Emri i personit që ka dhënë informatën (përfshirë edhe zyrtarin policor),*
- *Detajet e kompletuara.*

Pas marrjes së këtyre informatave, menjëherë caktohet një person që të komunikojë me zyrën qendrore (komandën) detyra e të cilit është që të:

- *Kërkojë ndihmë për shërbime të specializuara,*
- *Mbajë eprorët e informuar,*
- *Përcjellë të gjitha kërkesat nga vendi i ngjarjes tek qendra komanduese.*

Pas caktimit të këtij personi në këtë detyrë, ekipi i këqyrjes, menjëherë dhe pa humbur kohë fare vazhdon për në lokacionin ku ka ndodhur ngjarja.

6.7 Detyrat pas arritjes në vendin e ngjarjes

Kur eksperti arrin në vendin e ngjarjes, ai duhet të duhet të ndër marrë këto veprime:

1. Prezanton dhe identifikon vetveten dhe rolin e tij, pasikjo i ndihmon ekspertit që të krijojë një raport zyrtar me policët tjerë si dhe me përfaqësuesit e agjencioneve tjera në vendin e ngjarjes. Kjo nënkupton identifikimin edhe të anëtarëve të tjerë të ekipit, me qëllim që të arrihet një bashkëpunim sa më i mirë në mes të të gjitha palëve të përfshira në këtë rast.

2. Udhëzon për masat që do të merren në sigurimin dhe mbrojtjen e vendit të ngjarjes. Në këtë fazë duhet të eliminohen të gjitha rreziqet mjedisore dhe fizike, në mënyrë që të krijohet ambienti i përshtatshëm për punë. Kjo përfshinë mbajtjen nën kontroll të turmës, shembjen e objekteve, trafikun, rreziqet nga materiet kimike, biologjike, radiologjike, nukleare dhe eksplozive. Në raste kur ka rreziqe të tilla, hetuesit duhet të përdorin pajisje mbrojtëse në mënyrë që të parandalojnë lëndimet, infeksionet si dhe t'i mbrojnë dëshmitë nga kontaminimi dhe humbja.

3. Koordinon punët me të gjitha agjencionet që janë të përfshira në atë vendngjarje. Në këtë pikë është me rëndësi të sqarohen përgjegjësitë ligjore të se cilës organizatë si dhe të bëhet një planifikim paraprak për punën e secilës agjenci. Po ashtu, kjo fazë ka për qëllim shkëmbimin e informatave të rëndësishme mes këtyre akterëve.

4. Kryen shikimin vizual të vendit të ngjarjes. Shikimi vizual i ndihmon hetuesit që të lokalizojë dhe shoh trupin, të identifikojë dëshmitë e vlefshme dhe ato të ndjeshme/fragjile si dhe të përcaktojë hapat e domosdoshëm për ekzaminimin dhe dokumentimin e vendit të ngjarjes dhe të kufomës që gjendet në atë vend.

5. Bënë trajtim adekuat të dëshmive. Nënkupton dokumentimin dhe marrjen e dëshmive në mënyrë profesionale si dhe çdo lëvizje e dëshmisë nga një person tek tjetri apo nga një agjencion tek tjetri, të jetë e dokumentuar saktë me anë të zingjirit të ruajtje¹⁸⁸.

6.8Zbatimi i ligjeve në fuqi

Hetuesit e vendit të ngjarjes duhet të kenë parasysh Procedurat dhe Standarde e Operimit të tyre, Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, Ligjin për Mjekësinë Ligjore, si dhe aktet e tjera ligjore në fuqi, ndërsa detyrë tjetër e hetuesit pas arritjes në atë vend, është marrja e disa informatave të rëndësishme që do të nevojiten më vonë gjatë rrjedhës së hetimit dhe këto informata përfshijnë këto fakte me rëndësi:

- *Koha e saktë e arritjes,*
- *Adresa e saktë,*
- *Njësitët policore të pranishme,*
- *Caktimi i një eksperti si përgjegjës i rastit,*
- *Këshillimi me mbikëqyrësin e njësive të uniformuara policore dhe bashkëpunimi me to,*
- *Këshillimi me oficerin e parë në vendin e ngjarjes, për të marrë informatat fillestare,*
- *Të bëjë një inspektim vizual të vendit të ngjarjes,*
- *Komunikon me oficeret tjerë për të marrë ide dhe teori të tjera lidhur me rastin, të cilat në fund i vlerëson vet,*

¹⁸⁸Zingjiri i ruajtjes është e kaluara e gjurmës, rruga që bën ajo nga momenti i gjetjes deri tek prezantimi i saj në gjyq.

- I cakton të gjitha nevojat e hetimit duke ngarkuar persona të veçantë për detyra të veçanta,
- Përpilon listën e personelit të angazhuar dhe përcjellë realizimin e detyrave që i ka dhënë personelit të tij.

Pas këtyre veprimeve, mbikëqyrësi i rastit menjëherë përpilon një pyetësor lidhur me atë hetim dhe kërkon nga hetuesit që të shkojnë derë më derë për të kërkuar informata dhe për të identifikuar dëshmitarët e mundshëm. Ky pyetësor duhet të përmbajë:

- Caktimin e një numri të mjaftueshëm të oficerëve për të grumbulluar informata të nevojshme,
- Mbikëqyrjen dhe udhëzimin policëve për realizimin e pyetjeve nga ky pyetësor,
- Kontrollimin dhe analizën e përgjigjeve të ardhura.

Pjesa tjetër e ekipës që është në vendin e ngjarjes duhet të interesohet për gjendjen shëndetësore të viktimës; nëse ajo është dërguar në spital duhet të caktohet një patrullë ose një hetues që të merret me sigurimin e viktimës:

- Që të mbledhë të gjitha dëshmitë siç mund të jenë rrobat, dokumentet identifikuese etj.,
- Varësisht nga gjendja shëndetësore e viktimës të marrë një deklaratë prej tij,
- Të intervistohet personeli i ambulancës nëse ata kanë ardhur të parët në vendin e ngjarjes dhe kanë komunikuar me viktimën.

Nëse nga gjithë këto veprime ekipi i këqyrjes dhe hetuesit kanë arritur të mbledhin ndonjë informacion të vlefshëm, atëherë bëhet shpërndarja e informatave të rëndësishme të gjitha njësive dhe personelit të përfshirë në hetim si dhe rifreskimi i tyre me informata të reja që mund të vijnë më vonë. Ekspertët e vendit të ngjarjes gjatë punës së tyre, përveç gjurmëve dhe provave materiale që mund të gjejnë në atë vend duhet të kenë kujdes edhe me trajtimin

e njerëzve kureshtar që janë rreth vendit të ngjarjes. Që ky trajtim të jetë i nivelit të duhur, njëri nga hetuesit duhet të caktohet me detyrë që të:

- *mbikëqyrë turmën,*
- *fotografojë turmën.*

Në aspektin e këqyrjes së vendit të ngjarjes mbikëqyrësi i hetimeve duhet të mbajë parasysh këto çështje:

- a. *Me të arritur në vendin e ngjarjes caktohen kufijtë (perimetri),*
- b. *Vendosen hyrjet dhe daljet për qasje të kujdesshme në vendin e ngjarjes, duke u konsultuar edhe me oficerin e parë,*
- c. *Bëhet një vëzhgim vizual i tërë hapësirës së vendit të ngjarjes,*
- d. *Konstatohet nëse ndonjë dëshmi fragjile¹⁸⁹, gjendet në vendin e ngjarjes dhe ato duhet të procedohen sa më parë,*
- e. *Caktohen personat për përpilimin e skicës dhe për fotografimin e vendit të ngjarjes.*

Viktima është pjesë e vendit të ngjarjes, pra është njëra nga dëshmitë kryesore. Ekzaminimi i viktimës në vendin e ngjarjes bëhet nën kujdes të madh. Në aspektin e ekzaminimit të trupit/viktimës në vendin e ngjarjes duhet të ndërmerren këto veprime:

- *Të gjitha fotografimet dhe skicat e vendit të ngjarjes duhet të përfundojnë para se të ekzaminohet viktim/kufoma,*
- *Të bëhet përshkrimi i kompletuar i trupit/kufomës si dhe i veshjeve të saj,*

¹⁸⁹Dëshmi fragjile/ndjeshme janë ato dëshmi të cilat mund të rrezikohen apo kontaminohen tërësisht në rast të ekspozimit të tyre ndaj kushteve atmosferike si: dielli, shiu, bora, era etj. Në disa raste ndodh që shirat e rrëmbyeshëm të zhdukin tërësisht njollat e gjakut, reshjet e borës të mbulojnë gjurmët e këpucëve dhe gomave apo edhe dëshmi tjera.

- Pjesët e trupit të cilat nuk ka qenë e mundur të fotografohen më herët tani mund të fotografohen dhe ekzaminohen,

- Gjatë ekzaminimit sigurohuni se janë përshkruar të gjitha plagët dhe shenjat e ndryshme në trupin e viktimës (gërvishtjet, tatuazhet etj.),

- Largimi i trupit nga vendi i ngjarjes mund të bëhet vetëm pasi që jemi siguruar se të gjitha veprimet e nevojshme janë kryer. Trupi vendoset në një çarçaf të bardhë të pastër para se ai të vendoset në qesen për transportin e kufomave.

Largimi nga vendi i ngjarjes është një veprim po ashtu kritik. Ekipet e këqyrjes duhet të qëndrojnë sa më gjatë që është e mundur në vendin e ngjarjes, për shkak se mund të paraqitet nevoja për marrjen e informatave apo fotografive shtesë si dhe për grumbullimin e ndonjë materiali që nënkupton që vendi duhet të kontrollohet përsëri. Pra, këqyrja përfundon atëherë kur i tërë personeli që ka marrë pjesë në të, konsultohet. Ky konsultim, ka të bëjë me faktin se:

- a janë marrë dhe a janë përfunduar të gjitha veprimet e nevojshme lidhur me këqyrjen?*
- a janë paketuar dhe a janë vendosur në mjetin e transportit të gjitha dëshmitë që janë gjetur?*
- a është kontrolluar dhe fotografuar e gjithë hapësira?*

Pasi të konstatohet se të gjitha veprimet e nevojshme për këqyrjen e vendit të ngjarjes janë ndërmarrë dhe kryer, atëherë mund të largohemi nga ky vend.

6.9 KËQYRJA E KUFOMËS TEK RASTET E VRASJEVE

Para se të fillojë këqyrja e kufomës, së pari duhet të jemi të sigurt se është konfirmuar vdekja e kufomës nga ekipet mjekësore pasi që një konfirmim zyrtar nga ekipet mjekësore është i nevojshëm për procedurat e më tutjeshme. Gjithashtu, duhet të dihet a është lëvizur kufoma apo jo; kjo lëvizje mund të bëhet nga kalimtarët e rastit me qëllimin e dhënies së ndihmës së parë, nga familjarët, policët e parë që kanë arritur në atë vend etj. Nëse ka ndodhur një gjë e tillë, ajo duhet shënuar në procesverbal. Nëse nuk ka ndodhur atëherë fillojnë veprimet tjera.

Kufomat janë objekti kryesor i këqyrjes në të gjitha rastet e vdekjeve me dhunë ose në rrethana që lejojnë të dyshohet për një vdekje të tillë, prandaj asaj i kushtohet vëmendje e posaçme në vendin e ngjarjes dhe më vonë në morg ku kryhet autopsia¹⁹⁰. Për këqyrjen e kufomave në vendin e ngjarjes, ekipet e këqyrjes duhet të ndjekin disa hapa të rëndësishëm e ata janë:

- ***Fotografimi i kufomës***

Si hap i parë i dokumentimit, fotografimi i kufomës krijon një regjistrim të përhershëm të detajeve esenciale siç janë pozita e trupit, dukja/pamja e tij, identifikimi dhe lëvizjet eventuale. Kufoma duhet të fotografohet ashtu siç është gjetur në momentin e arritjes së ekipit hetimor në atë vendngjarje, pa e lëvizur atë, pa e pastruar dhe pa ndryshuar asnjë rrethanë; nëse trupi është gjetur brenda në veturë, të mos lëvizet pa u bërë fotografimi apo nëse është gjetur i zhytur në baltë, së pari të bëhet fotografimi ashtu siç është, pa u pastruar.

- ***Të kryhet ekzaminimi i jashtëm i kufomës***

Kjo nënkupton se duhet të dokumentohet pozita e trupit (si është gjetur ai; ulur, i shtrirë në shpinë, i shtrirë në bark, në krah etj.), të përshkruhen karakteristikat fizike siç janë: flokët, mjekra, sytë etj., veshmbathja, gjërat e ndryshme karakteristike (stolite, ora e dorës, unazat, shenjat dhe tatuazhet), lëndimet e dukshme e kështu me radhë.

¹⁹⁰Prof.asc. dr. Ilir Mandro, “Këqyrja e vendit të ngjarjes në vrasjet me armë zjarri”, Ilir” 2002, Tiranë, faqe 28.

- ***Marrja e dëshmive nga kufoma***

Ky hap kërkon një qasje profesionale për kërkimin, gjetjen dhe marrjen e gjurmëve dhe provave materiale nga kufoma dhe rreth saj, siç janë lëngjet trupore (gjaku, sperma, urina etj), qimet e trupit apo edhe indet trupore. Për marrjen e këtyre dëshmive kërkohet një personel i kualifikuar dhe pajisje të avancuara teknike siç janë llojet e ndryshme të burimeve të dritës alternative.

- ***Identifikimi i kufomës në vendin e ngjarjes***

Identifikimi mund të bëhet përmes fotografisë, dokumenteve identifikuese apo kur familjarët dhe të afërmit e identifikojnë kufomën në vendin e ngjarjes. Në raste më të komplikuar, kur kjo formë e identifikimit nuk është funksionale, për arsye të ndryshme, përdoren metoda tjera të identifikimit siç janë: gjurmët e gishtërinjve, të dhënat dentale dhe krahasimet e ADN-së.

Nga praktika, kam pasur raste kur kufoma ka qenë e dëmtuar rëndë në fytyrë, deri në atë masë sa nuk ka qenë i mundur identifikimi i saj (sepse fytyrën e kishte të dëmtuar nga shtazët e egra). Në këtë rast, si mjet identifikimi është marrë një fotografi nga familjarët e tij dhe është krahasuar me pamjen e trupit të kufomës, e cila kishte deformime që nga lindja dhe ky identifikim është dëshmuar edhe nga familjarët e saj.

Në një rast tjetër që kam pasur gjatë praktikës sime, koka e viktimës ka qenë e ndarë nga trupi edhe atë në largësi prej disa qindra metrave, madje duke kaluar edhe vijën kufitare të shtetit teksa trupi ka mbetur në pjesën tjetër të kufirit. Këtu unë dhe ekipi im i këqyrjes, së bashku me ekipet e mjekësisë ligjore, kemi bërë identifikimin në bazë të analizave të AND-së dhe dëshmisë së familjareve, pasi që trupi kishte qëndruar për një kohë të gjatë në atë vend dhe ishte dekompozuar mjaft; gjithashtu edhe koka ishte mjaft e dekompozuar dhe nuk mund të bëhej identifikimi i saktë vetëm me ekzaminim të jashtëm.

6.10 Këqyrja e plagëve të kufomës në vendin e ngjarjes

Mjetet me të cilat mund të kryhet një vrasje janë të shumta, por nëse i referohemi praktikës dhe literaturës vrasjet më së tepërmi kryhen me armë të zjarrit, por edhe me mjete të mprehta (thika, kaçavida, gërshërë, gjilpëra, sëpata, shpata etj.), me mjete mbretëse (tulla, shkopinj, mjete të punës, gurë, grushte), me helme e djegie (zjarr), me ngulfatje e zhytje në ujë dhe me shumë mjete dhe forma të tjera.

Në këtë punim do të fokusohemi tek vrasjet me armë të zjarrit, duke e ditur se armët e zjarrit kanë shtrirje të gjerë, jo rrallë në praktikë nga përdorimi i tyre në rrethana kriminale ose pakujdesie mund të shkaktohen dëmtime të rënda deri në vdekje¹⁹¹.

Arma e zjarrit e gjetur në vendin e ngjarjes është një provë në vete, sepse ajo përmban shumë të dhëna të cilat ndihmojnë në zbulimin e personit që e ka përdorur atë armë. Mirëpo, tek çdo armë e gjetur në vendin e ngjarjes së një veprë penale të vrasjes, e cila supozohet se është përdorur, mund të gjenden edhe gjurmë apo prova të tjera, të cilat gjithashtu janë shumë të rëndësishme për zbulimin e asaj veprë penale.

Çka mund të gjendet në armën e përdorur në një rast vrasjeje?!

Në armën e përdorur në një rast vrasjeje mund të gjenden gjurmë të gishtërinjve, mbetje të barotit, mbetje të ADN-së, etj. Për fat të keq, armët e përdorura në një krim, shumë rrallë ndodh të gjenden në vendin e ngjarjes, sepse autorët e krimit, në shumicën e rasteve i marrin ato me vete. Në situata të tilla duhet të fokusohemi tek gjurmët që shkakton shkrepja e një arme në vendin e ngjarjes, më konkretisht tek dëmtimet trupore që shkakton arma e zjarrit në rastet e vrasjes apo plagosjes. Me dëmtime trupore nga armët e zjarrit nënkuptojmë të gjitha ato dëmtime të cilat shkaktohen nga çdo lloj arme e zjarrit (fishek, gjyle) si dhe nga mjetet e posaçme të luftës (mina, granata, dhe lëndë të tjera eksplozive)¹⁹².

¹⁹¹Gramoz Ylli, Kontributi i ekspertit mjekoligjor në dëmtimet nga armët e zjarrit, Botuar në Revistën Shkencore “Justiniani I”, Nr.1, dhjetor 2009, faqe 66.

¹⁹²Fadil Batalli, Mjekësia Ligjore, Botimi i I, shtëpia botuese Rilindja, Prishtinë 1987, faqe 46.

Hetimi i dëmtimeve të shkaktuara nga arma e zjarrit kërkon një angazhim maksimal dhe një profesionalizëm të lartë. Shpeshherë hasim në disa keqkuptime apo edhe në disa mite të krijuara, të cilat më tepër janë paragjykime se sa që janë të bazuara në fakte shkencore. Konkluzionet të cilat mund të pengojnë hetimin, janë ato sipas të cilave:

- *Plaga dalëse është **gjithmonë** më e madhe se plaga hyrëse.*
- *Plaga dalëse **asnjëherë** nuk i përngjanë plagës hyrëse.*
- *Individët me dorën e djathtë dominante, **gjithmonë** kryejnë vetëvrasje duke e qëlluar veten në anën e djathtë të kokës.*
- *Me **tepër se një e shtënë** (gjuajtje) tregon vrasje e jo vetëvrasje¹⁹³.*

Shmangia ndaj paragjykimeve të tilla është vendimtare për një hetim profesional, sepse edhe ashtu karakteristikat e plagëve të shkaktuara në një rast të vrasjes, vetëvrasjes apo vrasjes aksidentale shpeshherë janë shumë të përafërta, madje në disa raste edhe të njëjta. Karakteristikat e dëmtimeve (plagëve) të shkaktuara nga arma e zjarrit janë të shumta, por zakonisht ekspertët dhe ekipet mjeko-ligjore fokusohen tek vrima hyrëse, vrima dalëse, kanali ku ka kaluar predha dhe dëmtimet që i ka shkaktuar, identifikimi i faktorëve plotësues të qitjes, përcaktimi i kalibrit dhe llojit të armës (municionit), përcaktimi i distancës së qitjes dhe përcaktimi i drejtimit të qitjes.



Foto. 1 Gazrat që liron arma në momentin e shkrepjes dhe daljes së predhës nga tyta

Përgjithësisht edhe aspekti teorik po edhe ana praktike profesionale kanë vërtetuar se plagët e shkaktuara nga armët e zjarrit janë plagë me karakter *shkues, tejshkues dhe tangjentor*.

¹⁹³Artur E. Westveer, “Behavioral Science Unit, FBI”, “Managing Death Investigation 1997, U.S. Department of Justice, Federal Bureau of Investigation, faqe 425.

Tek plagët **shkuese** dallojmë vrimën hyrëse dhe kanalën, kurse tek plagët **tejshkuese** kemi vrimën hyrëse, kanalën dhe vrimën dalëse. Tek veprimi **tangjentor** i predhës mund të formohen gërvishtje, dërmishje apo plagë mbretëse¹⁹⁴. Plagët tangjentore, më saktësisht, janë ato lloje të plagëve që shkaktohen kur predha nuk hyn në trup por vetëm rrëshqitazi ka kontakt me trupin në ndonjë pjesë të tij.

Vrima hyrëse normalisht është më e vogël dhe më simetrike se vrima dalëse, por jo në të gjitha rastet, dhe shkakton copëtimin (dëmtimin) e lëkurës, indeve dhe eshtrave. Vrima hyrëse shpeshherë është e rrethuar me mbetje të barotit të djegur dhe të padjegur (dhe mbetje të tjera) të cilat substanca i merr plumbi kur del nga tyta. Në rastet e të shtënave nga afër, atëherë kur arma ka kontakt me trupin, do të krijohet ajo që quhet “ **unazë** ” e mbetjeve të faktorëve plotësues të qitjes si dhe do të ketë një stampim të qartë të tytës së armës. Këto gjurmë mund të ndihmojnë në identifikimin e llojit të armës së përdorur. Përcaktimi i saktë i vrimës hyrëse, bën të mundur zgjidhjen e disa problemeve si përcaktimin e largësisë së qitjes, drejtimi i qitjes, kalibri i armës me të cilën është realizuar qitja dhe lloji i armës (kur kemi të bëjmë me qitje me puqitje)¹⁹⁵. Plagët hyrëse zakonisht marrin disa ngjyra me ç` rast krijohet një unazë e zezë e djegieve të barutit, kur tyta ka kontakt me lëkurën-trupin.

Gjithnjë kur ekzaminohet një plagë hyrëse duhet të përcaktohet nëse kjo është plagë me kontakt, nëse plaga është shkaktuar nga distanca e afërt, nëse është shkaktuar nga distanca e ndërmjetme (mesme) apo nga distanca e largët si dhe të përcaktohet distanca e qitjes dhe aktorët plotësues (gazrat e nxehta, djegiet dhe përcëllimet, bloza, grimcat e barotit, pikëzimet, etj)¹⁹⁶.

¹⁹⁴Fadil Batalli, Mjekësia Ligjore, Botimi i I, shtëpia botuese Rilindja, Prishtinë 1987, faqe 48.

¹⁹⁵Prof.asc.dr. Ilir Mandro, Këqyrja e vendit të ngjarjes në vrasjet me armë zjarri, “Ilir” 2002, Tiranë, faqe 45

¹⁹⁶Artur E. Westveer, “Behavioral Science Unit, FBI”, “Managing Death Investigation 1997, U.S. Department of Justice, Federal Bureau of Investigation, faqe 426.

Vrima dalëse është karakteristikë e plagëve tej shkuese (depërtuese). Zakonisht kanë formë të çrregulltë; të dërrmuara, të mbuluara me gjak dhe të fryra në anën e jashtme. Përmasat e vrimës së daljes zakonisht janë më të mëdha sesa ato të vrimës hyrëse, por jo në të gjitha rastet. Vrima dalëse nuk paraqet brezin e fërkimit dhe brezin e mbretjës¹⁹⁷. Ekzistojnë dy arsye përse vrima dalëse mund të jetë më e madhe se vrima hyrëse. E para është sepse rrotullimi që bëhet për stabilizimin e drejtimit të plumbit në ajër, nuk është efektiv në inde për shkak të dendësisë së indit dhe kështu, ndërsa predha udhëton nëpër trup, kursi i lëvizjes do të jetë më i theksuar, e kur udhëton nëpër inde më të dendura, predha do të humb forcën dhe do të përfundojë rrugëtimin e saj më shpejt. Së dyti, gjatë kalimit nëpër trup (inde), predha do të deformohet. Këta dy faktorë ndikojnë që predha me rastin e daljes nga trupi në plagë dalëse, të krijojë një vrimë më të madhe dhe të çrregullt¹⁹⁸. Pra, forma e vrimës së daljes së predhës kushtëzohet nga ***energjinë që ka predha në momentin e daljes nga trupi, deformimet e copëtimet që mund të ketë pësuar predha brenda në trup, kalibri i predhës si dhe ekzistenca e pjesëve të forta që hyn në lëkurë së bashku me predhën***¹⁹⁹

Sa i përket faktit se vrima hyrëse është më e vogël se vrima dalëse, duke u bazuar në praktikën kriminalistike, në këtë punim kam sjellë dy raste sa i përket kësaj çështjeje. Duke respektuar gjithmonë mendimet që e thonë të kundërtën, unë do të paraqes këtë çështje, duke arsyetuar, argumentuar dhe mbështetur në fakte, të cilat do t'i paraqes në vijim, sigurisht mbështetur në këto dy raste të ndryshme, në të cilat gjatë ekzaminimit të kufomave, është vërejtur, pikërisht, fakti se vrima hyrëse është më e madhe se ajo dalëse. Ky ekzaminim është bërë me kujdes të veçantë dhe në fund është arritur përfundimi se **jo në të gjitha rastet vrima hyrëse është më e vogël se ajo dalëse**. Në të dyja rastet e lartpërmendura është përdorur arma pistoletë TT, kalibri 7.62x29, modeli jugosllav. Ky konstatim është mbështetur në faktin se kjo vrimë mund të jetë më vogël sepse aty ndikojnë

¹⁹⁷Fadil Batalli, Mjekësia Ligjore, Botimi i I, shtëpia botuese Rilindja, Prishtinë 1987, faqe 50.

¹⁹⁸Kimberley Molina, *Gunshot Wounds*, Adapted, with permission, from Gunshot Wounds Handout by Vincent J.M. DiMaio, 2013, faqe 7.

¹⁹⁹Prof.asc.dr. Ilir Mandro, Këqyrja e vendit të ngjarjes në vrasjet me armë zjarri, Ilar 2002, Tiranë, faqe 52.

disa faktorë siç janë: distanca e gjuajtjes, lloji i armës së përdorur, këndi i goditjes, kalibri, pozita e plagës, deformimi që mund të pësojë predha brenda në trup etj. Pas këtij ekzaminimi, jam konsultuar edhe me disa persona kompetent për këtë çështje, njëri ndër të cilët është as.dr.Arsim GËRXXHALIU, ekspert i mjekësisë ligjore, me të cilin kam diskutuar këtë çështje dhe ai është pajtuar që ky konstatim është i drejtë. Në vazhdim do t'i paraqes fotografitë e të dyja këtyre rasteve të lartpërmendura, në mënyrë që ky konstatim të jetë edhe më bindës dhe më argumentues për të gjitha ata që kanë rastin ta lexojnë këtë punim.

Rasti i parë:



Foto nr. 1

Foto nr.2



foto nr. 3

foto nr. 4

Foto numër 1 dhe 3 - vrima hyrëse

Foto numër 2 dhe 4 - vrima dalëse

Rasti i dytë:



Foto nr.1



Foto nr.2



Foto nr.3



Foto nr.4

Foto numër 1 dhe 3 vrima hyrëse Foto numër 2 dhe 4 vrima dalëse

Qitja me puthitje (me kontakt) konsiderohet në ato raste kur gryka e armës (tyta) mbahet mbi sipërfaqen e trupit në kohën e shkrepsjes²⁰⁰. Plagët e kontaktit mund të jenë me kontakt të fortë, të butë, me kënd ose të paplota²⁰¹.

Tek qitja me puthitje zakonisht vërejmë këto karakteristika:

- djegie në buzët e plagës; blozë në kufijtë e plagës;
- grimca të barotit në drejtim të vrimës;
- shenjë (shtypje) e tytës së armës (në rastet kur plaga është në eshtra e veçanërisht në kokë, atëherë bloza shpërndahet në kafkë);
- `ylli` i krijuar i plagës ndodh për shkak të zgjerimit nën lëkuror të gazrave të barotit në mes të lëkurës dhe eshtrave (kafkës);
- bloza mund të depozitohet edhe në pjesët e brendshme të kafkës;
- mund të shfaqen fraktura të ndërprera të kafkës²⁰².

Karakteristikë për shumicën e armëve në qitjet me puqitje, është shpërthimi i sipërfaqes rreth e përqark vendit të hyrjes, gjë kjo që ndodh si pasojë e gazrave që dalin prej tytës²⁰³.

Qitje nga afërsia janë ato qitje ku distanca në mes të tytës dhe objektit nuk është më e madhe se 60-100 cm, ku përveç veprimit dinamik të predhës veprojnë edhe faktorët plotësues të qitjes (gazrat, flaka, pjesët e padjegura të barotit). Gazrat janë pasojë e djegies së barutit, që dalin nga predha me një shpejtësi të madhe. Flaka gjithashtu mund të veprojë rreth vrimës hyrëse duke formuar gradë (shkallë) të ndryshme të djegies. Bloza kryesisht përmban metale, varësisht nga lloji i barotit. Pjesët e padjegura të barotit formojnë një masë kompakte në formë koni, që me largimin nga distanca fillestare shkon duke u shpërndarë në atmosferë. Pjesët e padjegura gjatë fluturimit ndeshen në objekt dhe vendosen rreth vrimës

²⁰⁰Material trajnimi nga Policia Shkencore, Tiranë, 2011, faqe 9.

²⁰¹Po aty, faqe 9.

²⁰²Vincent J.M. Dimao, "A Summary of Gunshot Wounds", Managing Death Investigation 1997, U.S. Department of Justice, Federal Bureau of Investigation, faqe 433.

²⁰³Prof. asc. dr. Ilir Mandro, Këqyrja e vendit të ngjarjes në vrasjet me armë zjarri, Ilir 2002, Tiranë, faqe 74.

hyrëse. Gazrat mund të udhëtojnë më së largu 3 cm nga tyta; flaka si dhe bloza 20-30 cm, ndërsa pjesët e padjegura të barotit udhëtojnë 60-100 cm²⁰⁴.

Goditjet me armë zjarri nga kjo distancë në trupin e njeriut krijojnë ‘tatuazhin me barot’ të lëkurës. Tatuazhi i barotit është një fenomen ‘para vdekjeje’ (antemortum) dhe tregon që individi ishte gjallë në kohën kur është qëlluar²⁰⁵.

Qitje nga largësia konsiderohen të gjitha ato qitje ku largësia mes tytës dhe objektit është më e madhe se 60-100 cm, ku nuk mund të arrijnë faktorët plotësues të qitjes. Pra, këto qitje karakterizohen vetëm nga veprimi dinamik i predhës²⁰⁶.

Tek këto lloje të qitjeve, përveç dëmtimit të shkaktuar nga plaga nuk ka mundësi të gjendet asnjë faktor plotësues i qitjes, për shkak se distanca është më e madhe dhe faktorët plotësues nuk arrijnë të udhëtojnë aq larg. Qitje nga largësia mund t'i konsiderojmë të gjitha ato qitje të realizuara nga një metër (1m) e më shumë, që nënkupton se qitje nga largësia konsiderohen edhe qitjet nga distanca me qindra metra.

Nga pikëpamja kriminalistike dhe mjekoligjore, njohja e përbërjes së barotit ka rëndësi specifike, sepse prania e gjurmëve të produkteve të dekompozimit të tij (gazrave, flakës, blozës dhe pjesëve të padjegura të barotit) rreth vrimës së hyrjes së predhës në rroba ose në trup mund të shërbejë jo vetëm për njohjen e armës, por edhe për të përcaktuar largësinë e vendin nga është bërë qitja²⁰⁷.

²⁰⁴Fadil Batalli, Mjekësia Ligjore, Botimi i I, shtëpia botuese Rilindja, Prishtinë 1987, faqe 51-52.

²⁰⁵Material trajnimi nga Policia Shkencore, Tiranë, 2011, faqe 10.

²⁰⁶Po aty, faqe 10.

²⁰⁷Gramoz Ylli, Kontributi i ekspertit mjeko-ligjor në dëmtimet nga armët e zjarrit, Revista Shkencore ‘Justiniani I’, Nr. 1, dhjetor 2009, faqe 70.

KAPITILLI VII

PËRMBLEDHJE E KAPITULLIT TE VII

Ofrimi i sigurisë për viktimën dhe dëshmitarin janë një ndër detyrat kryesore dhe mjaft të rëndësishme për grupin hetimor që janë të ngarkuar me këqyrjen e vendit të ngjarjes tek rastet e vrasjeve. Ata të dy, së bashku janë një burim i mirë i informacioneve lidhur me rastin e ndodhur. Gjithmonë duhet mbajtur parasysh faktin se dhënia e ndihmës së parë viktimës, me të arritur në një vend të ngjarjes, është detyrë dhe obligim njerëzor e human. Dhënia e ndihmës së parë viktimës, ndihmon edhe për faktin se ai mund të jap informacione të sigurt dhe të sakta lidhur me ngjarjen e dhënë.

Gjithashtu edhe dëshmitarët kanë rëndësinë e vet të madhe në procesin e hetimit të një rasti në përgjithësi, e posaçërisht tek rastet e vrasjeve në veçanti. Dëshmitarët duhet siguruar që ata mos të kenë frikë të flasin për ngjarjen, të tregojnë të vërtetën, të mbahen në vendin e ngjarjes deri sa aty të arrijnë ekipet e specializuara për hetime etj.

Bashkëpunimi me njësitet tjera gjatë hetimit të një vendi të ngjarjes tek veprat penale të vrasjes është një rëndësi e veçantë. Kjo për faktin se varësisht nga rasti i dhënë, duhet kërkuar edhe ndihmën apo asistencën e ekipeve tjera. Këto ekipe mund të jenë nga më të ndryshmet siç janë: ekipet mjekësore, zjarrfikësit, ekipet e kërkim shpëtimit, mjekësisë ligjore etj. Gjithashtu bashkëpunim duhet pasur edhe me agjencionet tjera të cilat u nevojiten hetuesve gjatë procesit të hetimeve siç janë: laboratorët e ndryshëm që kryejnë analizat e balistikës, AND-së, grafologjisë, analizat e ndryshme serologjike etj.

Duke ditur se suksesi i një hetuesi gjatë punës se tij është gjetja, ekzaminimi dhe prezantimi i provave në gjyq, atëherë mund të themi se provat kanë rëndësinë kryesore gjatë hetimit, këqyrjes së një vendi të ngjarjes në përgjithësi e në rastet e vrasjeve në veçanti. Provat janë ato që drejtojnë apo gjejnë pistën e duhur të hetimeve. Provat janë zëri i viktimës, ato flasin vet. Duhet një administrim i kujdesshëm i hetuesve apo atyre që merren me paketimin dhe ruajtjen e tyre. Mund të ndodhë që një provë e vetme të gjendët në një vend të ngjarjes, nëse edhe ajo kontaminohet, apo nga neglizhenca e atyre që e kanë në dorë,

ajo pëson dëmtime duke u shkatërruar, atëherë mund ta marrim me mendë se nëçfarë drejtimi mund të ecin hetimet lidhur me rastin në fjalë.

7.OFRIMI I SIGURISË PËR VIKTIMËN DHE DËSHMITARIN

Siguria e viktimës dhe dëshmitarit është njëra ndër çështjet kryesore të ekipit të këqyrjes së vendit të ngjarjes. Që të dy, edhe viktima edhe dëshmitari janë nga thesaret e çmuar dhe ashtu duhet të konsiderohen e trajtohen nga gjithë ekipi i këqyrjes. Ofrimi i sigurisë për ta, përveç se është detyrë ligjore, në vete përmban edhe anën e çmuar të saj, sepse që të dy, edhe viktima edhe dëshmitari kanë tregimet e tyre lidhur me ngjarjen. Këto tregime pastaj do të nevojiten shumë për ecurinë e rastit, në vazhden e gjithë atij procesi.

7.1 Siguria për viktimën

Me të arritur ekipet mjekësore në vendin e ngjarjes, oficeri përgjegjës për këtë vend duhet t'i shoqërojë ata në brendësinë e vendit të ngjarjes apo në qendrën e tij²⁰⁸. Dhënia e ndihmës mjekësore në rast se viktima është ende gjallë tejkalon të gjithë kufijtë e ruajtjes së atij vendi. Vetëm në rast se viktima është gjallë dhe duhet t'i jepet ndihma e parë, atëherë puna e ekipeve mjekësore ka përparësi në raport me gjurmët dhe provat materiale apo me këqyrjen e vendit të ngjarjes në tërësi.

Sidoqoftë, ekipet mjekësore nuk duhet të pengohen në asnjë mënyrë, kur ato kryejnë punën e tyre, por vetëm duhet të shikohen dhe vëzhgohen se çka janë duke bërë, a kanë lëvizur diçka apo jo etj. Pra, duhet shikuar se mos është lëvizur ndonjë dëshmi apo mikrogjurmë, të cilën nuk e kanë parë dhe kjo të shënohet në mënyrë që gjatë ekzaminimit të tyre, të merret parasysh se është lëvizur apo edhe dëmtuar e njëjta. Nëse ekipi mjekësor vendos që viktimën ta dërgoj në spital për trajtim të mëtutjeshëm, atëherë nëse lejojnë kushtet, njëri nga oficerët duhet të shkojë me ekipin mjekësor në ambulancë deri në spital. Nëse nuk ka kushte të tilla, që ai të shkojë me ekipin mjekësor në autoambulancë, atëherë duhet të shkohet pas ambulancës në spital, gjithnjë duke u konsultuar me mjeket përgjegjës për gjendjen e viktimës, dhe nëse viktima është në gjendje të flas ata do ta intervistojnë

²⁰⁸Qendra e vendit të ngjarjes zakonisht llogaritet vendi ku është viktima, pasi që ajo është edhe dëshmia kryesore e rastit

qoftë edhe shumë shkurt, vetëm sa për të marrë ndonjë informacion të rëndësishëm për ngjarjen. Për çfarëdo informacioni që mëson oficeri që gjendet aty duhet menjëherë ta njoftojë mbikëqyrësin dhe ekspertin e vendit të ngjarjes. Këto informata mund t'ju shërbejnë ekspertëve gjatë këqyrjes dhe gjatë ecurisë së punës në vendin e ngjarjes. E gjithë kjo bëhet për arsye se nëse gjendja e viktimës keqësohet dhe në fund ai vdes, duhet pasur parasysh se gjithë ato që ai ka ditur deri në atë moment dhe i ka dëshmuar do të jenë me vlerë pastaj..

Se viktima ka më se shumti njohuri për ngjarjen nuk ka fare dyshim, përndryshe nuk do të quhej viktimë, prandaj një bisedë sado e shkurtër me viktimën mund të jetë një dëshmi e rëndësishme. Gjithashtu nëse ka mundësi, rrobat e viktimës të cilat mjekët ose ia kanë zhveshur gjatë dhënies së ndihmës së parë ose në gjë të tilla do ta bëjnë aty, ato duhet të merren nga oficeri që është i pranishëm²⁰⁹. Këto rroba merren për arsye se aty ka dëshmi të vlefshme dhe shumë të rëndësishme për fazat e mëvonshme të hetimit²¹⁰

Nëse viktima vdes gjatë rrugës për në spital apo pas arritjes në spital, atëherë oficeri i cili është dërguar aty duhet menjëherë të shënojë emrin e mjekut që ka konstatuar vdekjen, shkaku të vdekjes, kohën dhe ndonjë fakt tjetër me rëndësi. Ai gjithashtu duhet të njoftojë menjëherë mbikëqyrësin e vet për vdekjen e viktimës.

Nëse viktima gjendet e vdekur në vend të ngjarjes, atëherë me kujdes bëhen veprimet e nevojshme lidhur me ekzaminimin e saj, duke shënuar të gjitha informatat e nevojshme siç janë: përshkrimi i rrobave, përshkrimi i lëndimeve, gjendja e kufomës, pozita e saj etj. Mund të ndodh që viktimës është tentuar t'i jepet ndihma e parë nga kalimtarët e rastit apo nga familjarët, me ç'rast është lëvizur ajo, atëherë duhet përshkruar gjendja se si është gjetur.

²⁰⁹Vernon J. Geberth M.S.,M.P.S.,B.B.A.,FBINA, PRACTICAL HOMICIDE INVESTIGATIONS, Tactics,Procedures and Forensic Techniques, Fourth Edition, page 51,Published in 2006,CRC Press,New-York ,Suite 300,USA.

²¹⁰Këto rroba duhet të merren për arsye se aty gjenden dëshmi të cilat do të nevojiten në fazat e mëvonshme të hetimit. Aty mund të ketë shenja të dukshme të gjakut, vrimat në rroba që janë bërë nga veprimi i mjetit me të cilin është shkaktuar plaga, mjeti mund të ketë qenë thikë, armë etj.

7.2 Siguria për dëshmitarin

Me dëshmi, dëshmitari shpreh informatat dhe perceptimet e veta lidhur me faktet të cilat janë me rëndësi për ndriçimin e çështjes penale²¹¹. Të gjithë dëshmitarët që gjenden në vendin e ngjarjes, me të arritur polici i parë aty, duhet të mbahen deri sa aty të vijnë hetuesit. Ata duhet të mbahen të ndarë ashtu që deklaratat e tyre të jenë të pavarura dhe mos të ndikohen nga njeri - tjetri.

Nuk duhet harruar se gjatë mbajtjes së dëshmitarëve në vendin e ngjarjes duhet pasur kujdes të veçantë për gjurmët dhe provat materiale që gjenden në atë vend. Pra, duhet kujdesur që ato të mos kontaminohen nga vetë dëshmitarët. Ata nuk duhet lejuar të largohen me premtimin se do të kthehen prapë në vendin e ngjarjes, apo do të vijnë në ditët në vijim në stacionin policor. Nëse ata lejohen të shkojnë me premtimin se do të kthehen, atëherë nuk duhet harruar se ata mund të jenë të kërcënuar nga vetë i dyshuari apo rrethi i tij, mund të mos u kujtohet ngjarja apo mund të mos flasin të vërtetën pastaj a ta ndryshojnë dëshminë.

Varësisht prej numrit të oficerëve që janë në atë vend të ngjarjes në njërën anë dhe numrit të dëshmitareve në anën tjetër, atëherë se cilin dëshmitar duhet mbajtur aty, të ndarë nga njeri-tjetri, deri sa aty të arrijnë hetuesit e rastit dhe ata pastaj do t'i intervistojnë një nga një²¹². Oficeri që është kujdesur për sigurinë e tyre, duhet që gjithë informatat që ka marrë gjatë kësaj kohe, t'ua tregojë hetuesve kur ata të kenë ardhur në vendin e ngjarjes.

²¹¹prof. dr. Ejup Sahiti, prof. dr.Rexhep Murati, E DREJTA E PROCEDURËS PENALE, UNIVERSITETI I PRISHTINËS, FAKULTETI JURIDIK, Prishtinë 2013, faqe 265.

²¹²Vernon J. Geberth M. S. , M. P. S. , B. B. A. , FBINA, PRACTICAL HOMICIDE INVESTIGATIONS, Tactics, Procedures and Forensic Techniques, Fourth Edition, page 54, Published in 2006, CRC Press, New-York,Suite 300,USA.

7.3 Zbulimi, fiksimi dhe marrja e armës së zjarrit në vendin e ngjarjes

Si për çdo gjurmë dhe provë materiale tjetër që gjendet në vendin e ngjarjes, ashtu edhe për armën e zjarrit nga organi procedues kërkohet një kujdes i veçantë dhe një koordinim i veprimeve taktike në procesin e këqyrjes së vendit të ngjarjes. Së pari, organi procedues duhet të ketë parasysh:

7.4 Kërkimi dhe zbulimi i armës së zjarrit

Arma e zjarrit si mjet me të cilën është kryer vepra, në shumicën e rasteve mund edhe të mos gjendet në vendin e ngjarjes. Përveç rasteve kur si pasojë e ndonjë përleshjeje, e cila përfundon me vrasje kur arma e zjarrit mbetet në atë vend, rrallë mund të ndodhë që autori e gjuan armën në vendin e ngjarjes. Përveç këtyre, në rastet tjera arma e zjarrit gjendet në ndonjë vend tjetër të caktuar siç është shtëpia e autorit të veprës, ndonjë pus afër shtëpisë së tij ose më larg, ndonjë shkurre, kanal etj. Arma e zjarrit mund të gjendet në vendin e ngjarjes edhe në rastet e vrasjeve të inskenuara si vetëvrasje²¹³. Pra, për kërkimin e saj, organi procedues duhet të ketë parasysh faktin se ajo jo gjithmonë gjendet në vendin ku është kryer vepra.

7.5 Fiksimi dhe marrja e armës së zjarrit

Fiksimi i armës në vendin e ngjarjes është njëri nga hapat më të rëndësishëm të cilën e kryen ekipi i këqyrjes. Arma fiksohet si çdo provë tjetër në vendngjarje, por në këtë rast veçanti paraqet evidentimi i tipit të armës, kalibri, modeli, veçoritë dalluese të pamjes së jashtme, si gdhendje dhe mbishkrime në pjesët e drurit apo plastikës, dëmtime dhe mungesa në kompletin e saj luftarak, numrin e fishekëve në karikator si dhe numrin e serisë së kësaj arme²¹⁴. Nëse organi procedues gjen armën e zjarrit në vendin e ngjarjes, atëherë duhet ndjekur hapat si në vijim: arma duhet të fiksohet, të mos lëvizet dhe preket fare pa u fotografuar; fotografimi bëhet me njësi matëse e pastaj shënohet në procesverbal pozita e

²¹³Prof. acc. dr. Luan Veliçoti, Kriminalistika vëllimi i I, Geer, Tiranë 2015, faqe 187.

²¹⁴Prof. asc. dr. Ilir Mandro, Këqyrja e vendit të ngjarjes në vrasjet me armë zjarri, Ilar 2002, Tiranë, faqe 64.

saj dhe raporti me largësinë nga kufoma. Arma duhet të preket me kujdes dhe në duar duhet të vendosen dorezat; ajo duhet të preket në ato pjesë të saj, ku nuk mund të mbesin gjurmët papilare apo biologjike²¹⁵, pastaj me kujdes të veçantë të kontrollohet se a është e zbrazur apo jo; nëse e ka fishekun në tytë, të pastrohet duke e tërhequr atë(fishekun) nga tyta dhe të shënohet në procesverbal gjendja se si është gjetur ajo, të zhvendoset ngadalë karikatori/krehri dhe të shikohet se sa fishekë mban në të, dhe në fund, në procesverbal duhet të shënohet edhe pozicioni i rrahësit nëse duket. Pasi të jenë zhvilluar të gjithë këta hapa, duhet bërë edhe një fotografi pas kontrollimit, duke i lënë afër njëra-tjetrës gjithë pjesët e armës; karikatorin/krehrin, fishekët nëse ka etj. Është mjaft e rrezikshme të merret arma duke e futur një laps apo ndonjë shufër metali ose plastike të hollë në tytë. Nëse janë ndjekur këta hapa që u thanë më lartë, duke respektuar procedurat e marrjes së gjurmëve dhe provave materiale në vendin e ngjarjes, atëherë bëjmë marrjen apo paketimin e armës. Paketimi i saj bëhet në këtë mënyrë. Arma pasi të jetë zbrazur, kontrolluar për ndonjë gjurmë biologjike, siç është gjaku etj., duhet të shikohet dhe nuhatet në fund të tytës për ndonjë aromë eventuale karakteristike baroti, fakt ky që përcakton kohën e qitjes. Arma paketohet në kuti të posaçme për armët e zjarrit apo edhe në ndonjë qese të tejdukshme/transparente dhe dërgohet në laboratorin kriminalistik për analiza të mëtutjeshme.

²¹⁵Prof.acc. dr. Luan Veliçoti, Kriminalistika vëllimi i I, Geer, Tiranë 2015, faqe 187.

7.6 BASHKËPUNIMI ME NJËSITET TJERA TË SPECIALIZUARA

Hetuesit e rastit, duke pasur parasysh rëndësinë që kanë hetimet në përgjithësi dhe vështirësitë që kanë ato gjatë zhvillimit të tyre, si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë fushor (dalja në terren, sigurimi i informacioneve etj.), duhet të kenë një bashkëpunim të ngushtë me të gjitha agjencionet e zbatimit të ligjit së pari, pastaj edhe me agjencionet, institutet, organizatat apo organet e ndryshme që me veprimtarinë e tyre mund të ndihmojnë në ecurinë dhe suksesin e hetimeve. Meqë hetimet janë një proces ku në të duhet të involvohen mjaft faktorë, atëherë hetuesit duhet pasur kujdes që të gjitha sfidat që paraqiten gjatë këtij procesi, të njëjtat të kalohen me zgjuarsiri dhe me kujdes të konsiderueshëm.

Departamentet e ndryshme policore e kanë të rregulluar formën e bashkëpunimit në mes të njësive, varësisht nga madhësia e departamentit dhe struktura organizative e tij. Ky bashkëpunim fillon që në momentin e parë të marrjes së thirrjes për një krim që ka ndodhur. Varësisht se për çfarë krimi bëhet fjalë, atëherë duhet të kërkohet asistencë nga njësitet përkatëse të specializuara për atë fushë. Ekipi i këqyrjes duhet të kërkojë ndihmën e njësive të specializuara edhe atë për secilin ekzaminim veç e veç, për të arritur në një përfundim të saktë dhe të dokumentuar mirë.

Njësitet e specializuara të balistikës. Nga këto njësi kërkohet ndihma, asistencë në ekzaminimin e armëve, gëzhgojave, predhave etj. që gjenden në atë vend. Ky ekzaminim ka rëndësi të madhe në aspektin hetimor pasi që në bazë të përfundimeve të tij, hetuesve u bëhet e qartë se nga cila armë është shtënë/shkrepuar gëzhgoja e caktuar, predha etj.

Ndihma e ekipeve mjekësore. Është një ndihmë e vlefshme dhe shumë e rëndësishme, duke e ditur punën që këto njësite kryejnë. Një ekzaminim korrekt i ekipeve mjekësore si në vendin e ngjarjes ashtu edhe spital, do ta bëjë të mundur që viktimat të kthehet në gjendje stabile, të mund të flas dhe të deklarohet për të gjitha ato që kanë ndodhur.

Mjekësia ligjore. Ndihmën e vet e jep në aspektin e ekzaminimit të trupave të vdekur, duke caktuar shkakun e vdekjes si dhe duke kryer disa ekzaminime shtesë që janë në kuadër të punës së tyre.

Njësitet e ekzaminimit të dëshmive serologjike dhe ADN-së. Nëpër laboratorë të ndryshëm, ndihmën e tyre e japin në aspektin e kryerjes së analizave të ndryshme serologjike si analizat e gjakut, spermës, pështymës, mostrave të ADN-së etj.

Njësitet e ekzaminimit të dokumentacioneve. Gjithashtu kanë një rol të rëndësishëm në aspektin hetimor, sepse ndihmojnë në zbardhjen e rasteve të ndryshme të falsifikimit të dokumentacioneve të ndryshme, analizat grafologjike²¹⁶, parave etj.

7.7 Mjekësia Ligjore

Mjekësia ligjore apo Forenzika është një sistem i njohurive të shkencave të mjekësisë që kanë rëndësi për aplikimin e normave penale-juridike²¹⁷.

7.8 Detyrat dhe Përgjegjësit

Të gjitha ekzaminimet mjekoligjore kryhen në lokalet e Departamentit të Mjekësisë Ligjore dhe kryhen nga specialisti (ekspert) i certifikuar mjekoligjor. Departamenti i mjekësisë ligjore është formuar me ligj²¹⁸dhe veprimtarinë e vet e zhvillon në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

Detyrat e Departamentit të Mjekësisë Ligjore përfshijnë, mirëpo nuk kufizohen vetëm në:

- *mbajtjen e të drejtës për të siguruar ekspertizë mjekoligjore për organet publike,*
- *për të udhëhequr hetimet mjekësore për vdekjen në vendin e ngjarjes,*
- *për të kryer ekshumime (zhvarrosje),*
- *për të kryer inspektive post-mortem(pas vdekjes) dhe autopsi,*
- *ekzaminimin e viktimave që kanë pësuar nga veprat penale kundër jetës dhe trupit,*

²¹⁶Analizat grafologjike janë ato analiza që bëhen për të ekzaminuar shkrimin.

²¹⁷Prof.dr.Ismet Salihu, E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme,Prishtinë, 2010, faqe66.

²¹⁸LIGJI Nr. 03/L-187, 25 shkurt 2010, Shpallur me dekretin Nr. DL-019-2010, datë 13.05.2010 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.

- *përcaktimin e seksit (gjinisë), racës, gjatësisë, moshës dhe shkakun e vdekjes, pastaj të mbetjeve mortore të një personi të pa identifikuar kurdoherë që është e mundur,*
- *kryerjen e autopsisë dhe/ose profilit antropologjik-biologjik dhe lëshon raport të autopsisë në raste të zbulimit të mbetjeve mortore,*
- *mbajtjen e të drejtës ekskluzive për koordinimin dhe udhëheqjen e ekzaminimeve klinike për viktimat,*
- *dëshmitarët dhe autorët e mundshëm(supozuar) të krimit kundër integritetit seksual,*
- *kërkimin e dokumenteve mjekësore që kanë të bëjnë me viktimën dhe/ose pandehurin për krimet kundër jetës dhe trupit,*
- *mbledh ose ekzaminon dëshmitë e gjetura nga viktimat, dëshmitarët apo të pandehurit e krimeve kundër integritetit seksual dhe veprave penale kundër jetës dhe trupit, bazuar në Kodin Penal të Kosovës*

7.9 SIGURIMI I PROVAVE MATERIALE

Kur një vepër penale kryhet, përveçse cenohet jeta e njeriut, pasuria e të mirat material, cenohet edhe aspekti i sigurisë në përgjithësi. Për t'i mbrojtur këto të mira, shteti duhet të sigurojë mbrojtjen e tyre. Kjo mbrojtje sigurohet duke zbatuar ligjin dhe duke shqiptuar sanksionet e ndryshme, varësisht se për çfarë veprë bëhet fjalë si dhe duke pasur parasysh se qëllimi i dënimit nuk është vetëm për ta dënuar njeriun, por është edhe për ta mbrojtur shoqërinë nga kriminaliteti si preventivë, me qëllim që kryerësit/autorët në të ardhmen të mos kryejnë vepra penale²¹⁹.

Që të jetë gjithçka e parashikuar me ligj, pra që të jetë brenda kornizave ligjore si në kuptimin e sanksionimit ashtu edhe në atë të vetëdijesimit të qytetarëve, organet e zbatimit të ligjit duhet pasur kujdes që me marrjen e këtyre masave të respektojnë këto parime dhe të jenë sa më të qëndrueshme dhe legjitime. Para se të shqiptohet dhe të ekzekutohet sanksioni i merituar, është e nevojshme që në procedurë penale të konstatohet se i pandehuri vërtetë është kryerës dhe përgjegjës i veprës me të cilën ngarkohet²²⁰. Për t'i zbatuar të gjitha këto, organet e ndjekjes duhet të kenë kujdes të veçantë për kërkimin, marrjen dhe administrimin e provave.

Me prova materiale do të kuptojmë çdo objekt i cili në kushte e rrethana të caktuara mbart në vetvete një burim të dhënash mbi faktin për t'u provuar i tillë ose si burim prove që përcakton rrethana të rëndësishme të çështjes²²¹.

Provat janë një mekanizëm kryesor në procedurën penale, sepse të provuarit e një pohimi se dikush ka kryer vepër penale apo një hetimi se ekziston dyshimi i bazuar se dikush ka kryer veprën e caktuar penale, duhet të ketë mbështetje të fuqishme në prova. S'ka dyshim që procesi i të provuarit në procedurë penale gjyqësore, i cili rezulton me një

²¹⁹Prof. dr. Ismet SALIHU, E DREJTA PENALE, Pjesa e Përgjithshme, Prishtinë 2010, faqe 431.

²²⁰Prof. dr. Ejup SAHITI, Prof. dr. Rexhep Murati, E DREJTA E PROCEDURËS PENALE, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2013, faqe 225.

²²¹Prof. asc. dr. Ilir Mandro, Këqyrja e vendit të ngjarjes në vrasjet me armë zjarri, Ilar 2002, Tiranë, faqe 41.

vendim gjyqësor, zë vend qendror në atë procedurë²²². Të gjitha organet e ndjekjes dhe ato të procedimit, të cilat zbatojnë këto rregulla, si parim kryesor të tyre duhet të mbajnë faktin se kërkimi i së vërtetës dhe konstatimi i saj, duhet të jetë qëllimi dhe objektivi kryesor i tyre gjatë zbatimit të punës dhe të gjitha veprimeve hetimore që ata ndërmarrin me atë rast. Kërkimi i së vërtetës nuk nënkupton se ajo duhet të kërkohet dhe gjendet pa i zgjedhur mjetet. Në këtë drejtim duhet të vihet në pah se për ndriçimin dhe zgjidhjen e një çështjeje penale konkrete, gjykata nuk mund të shërbehet me çfarëdo mjatesh të provës²²³. Ajo mund t'i përdorë vetëm mjetet e provës të lejuara me ligj apo ato që dalin nga parimet dhe fryma e normave procedurale, njëherësh duke ju përmbajtur formës së paraparë ligjore.

Kodi penal i Republikës së Kosovës parasheh se cila provë që nuk ka të bëjë me të provuarit e ndonjë elementi të veprës penale, dëmit të shkaktuar me vepër penale, mbrojtjen nga ndjekja apo ndonjë çështjeje tjetër të rëndësishme, mund të çmohet si provë, qartazi e parëndësishme dhe është provë e papranueshme (thellësisht e papranueshme)²²⁴. Pra, nëse nuk kemi argumentim të mjaftueshëm, i cili mbështetet në aktet, normat dhe rregullat e parapara me ligj, atëherë e tërë puna që është bërë në drejtim të sigurimit të tyre, hidhet poshtë si e papranueshme dhe parëndësishme.

Që këto prova të jenë valide apo të çmuara, ato duhet së pari të sigurohen në mënyrë të duhur, të administrohen në bazë të rregullave të parapara me ligj dhe në këtë mënyrë të zënë vend të çmuar në procedurë. Sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë “çmuarja e provave është përcaktimi i vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre,

²²²Prof. dr. Ejup Sahiti, prof. dr. Rexhep Murati, mr. sc. Xhevdet Elshani, KOMENTAR, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Botimi i I, i publikuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Prishtinë 2014, faqe 667.

²²³ Po aty, faqe 668.

²²⁴Neni 259, Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 04/L-123, Hyrja në fuqi 01.01. 2013, Provat qartazi të parëndësishme apo thelbësisht të pambështetshme janë të papranueshme, dhe neni 19, paragrafi 1, nenparagrafi 1.29.

çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar dhe gjykata çmon provat sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi”²²⁵.

Në rastet e ndryshme gjatë punës në terren, ekipet e këqyrjes së vendit të ngjarjes duhet të kujdesen që gjatë këqyrjes të gjejnë, fiksojnë, marrin, paketojnë dhe të kryejnë të gjitha ekzaminimet e nevojshme dhe të domosdoshme lidhur me ato prova. Sigurimi i tyre bëhet nga momenti i parë i arritjes në vendin e ngjarjes e tutje gjatë gjithë procesit hetimor, i cili pa dyshim që shoqërohet me angazhimin dhe implikimin edhe të organeve tjera të zbatimit të ligjit.

Pra, që nga marrja e thirrjes për të shkuar për një vend ku ka ndodhur krimi, ekipi i këqyrjes duhet shënuar gjithçka që mendon së është provë, duhet konsideruar provë apo dëshmi gjithçka që gjendet në vendin e ngjarjes deri sa të argumentohet e kundërta. Termi dëshmi mund të përdoret edhe në kuptimin e përgjithshëm të provës²²⁶. Pra, në këtë kuptim ky term shpjegohet edhe më gjerë²²⁷.

7.10 Rregullat e përgjithshme për prova

Për të administruar dhe paraqitur provat në mënyrën e duhur, patjetër se duhet të ekzistojnë rregullat për zbatimin e dispozitave që janë paraparë edhe me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Në këtë kod në kapitullin XVI për provat thuhet:

²²⁵Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, Neni 152, paragrafi 1, faqe 81.

²²⁶Prof. dr. Ejup SAHITI, Prof. dr. Rexhep Murati, E DREJTA E PROCEDURES PENALE, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2013, faqe 227.

²²⁷Termi “dëshmi” kupton pohimin me shkrim ose me gojë, që bën dikush për të vërtetuar diçka....fjalët që thotë dëshmitari në gjyq, me fjalë të tjera dëshmia është prove-argument që në procedurë penale merret nga dëshmitari. Termi dëshmi nënkupton dokument zyrtar që vërteton diçka, dëftesë, vërtetim etj. Fjala dëshmi përdoret edhe jashtë procedurës penale si dëshmi e miqësisë etj. Sipas Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe, botuar në redaksinë e botimeve RILINDJA, Prishtinë 1981.

KAPITULLI XVI

PROVAT

Neni 257

Rregullat e përgjithshme për prova

- 1. Rregullat e provës të parapara në këtë nen zbatohen në të gjitha procedurat penale para gjykatës dhe, në rastet kur e parasheh ky Kod, ato gjithashtu zbatohen në procedurat para prokurorit të shtetit dhe policisë.*
- 2. Provat e marra me shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të papranueshme kur ky Kod ose dispozita të tjera të ligjit shprehimisht parashikojnë kështu.*
- 3. Gjykata nuk mund ta mbështesë vendimin e saj në prova të papranueshme.*
- 4. Gjatë çdo intervistimi ose marrjeje në pyetje ndaloheq që:*
 - 4.1. liria e të pandehurit për të formuluar dhe shprehur mendimin e tij të ndikohet nëpërmjet keqtrajtimit, lodhjes së shkaktuar, ndërhyrjes fizike, përdorimit të drogës, torturës, shtrëngimit ose hipnotizimit;*
 - 4.2. i pandehuri të kanoset me masa të ndaluara me ligj;*
 - 4.3. të premtohet ndonjë përfitim që nuk parashihet me ligj; dhe*
 - 4.4. të dobësohet kujtesa e të pandehurit ose aftësia e tij për të kuptuar.*
- 5. Ndalesa nga paragrafi 4. i këtij neni zbatohet pavarësisht nga pëlqimi i personit të intervistuar ose të marrë në pyetje.*
- 6. Kur intervistimi ose marrja në pyetje është zbatuar në kundërshtim me paragrafin 4. të këtij neni, procesverbali i intervistimit ose marrjes së tillë në pyetje është i papranueshëm.*

Siç e përshkruan neni 257. i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës ekzistojnë dhe janë të obliguara të zbatohen dispozitat nga ky nen kur kemi të bëjmë me

provat, duke filluar nga paragrafi 1. i këtij neni i cili këto rregulla ia dedikon gjykatës në procedurë penale, ndërsa kur ky Kod e parasheh ndryshe ato i dedikohen edhe prokurorit dhe policisë. Gjithashtu, në këtë Kod është paraparë edhe marrja e këtyre provave dhe mënyra se si ato merren paragrafi 2 e përcakton qartë se si procedohen ato dhe kush i procedon. Se gjykata nuk mund ta mbështesë vendimin e saj në prova të papranueshme flet shume mirë paragrafi 3. i këtij neni në Kodin Penal të republikës së Kosovës.

7.11 Klasifikimi i Provave

Meqë provat janë të ndryshme si për nga forma ashtu edhe për nga mënyra e gjetjes së tyre, në procedurën penale dhe me ligjet e aplikuara nëpër vende të ndryshme ato mund t'i hasim të klasifikuara në mënyra të ndryshme, në kuptim të emërimit dhe ndarjes së tyre. Zakonisht, mund të hasim në emërime si: *prova akuzuese dhe prova mbrojtëse, të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, origjinale dhe të prejardhura, prova personale dhe materiale, prova të plota dhe jo të plota etj.*²²⁸.

Provat akuzuese dhe mbrojtëse, nga vetë fjala mund të kuptojmë se këtu bëhet fjalë për prova të cilat në rastin e parë (prova akuzuese) paraqiten në favor të akuzës dhe në rastin e dytë (prova mbrojtëse) paraqiten në favor të të pandehurit²²⁹.

Provat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta, edhe këtu në bazë të fjalisë mund të kuptojmë se bëhet fjalë për prova që në rastin e parë (prova të drejtpërdrejta) janë të drejtpërdrejta, ku dëshmitari që jep provën e ka parë ngjarjen, pra kjo është provë e dëshmitarit okular. Provë e drejtpërdrejtë mund të jetë edhe prova e dhënë nga deklarimi i të pandehurit, ekspertit të çështjes, këqyrjes²³⁰. Provat e tërthorta ndryshe quhen indicie (parashenjë, tregues), dhe kontribuojnë për vërtetimin e faktit kontestues në mënyrë indirekte. Me këto prova në

²²⁸Prof. dr. Ejup SAHITI, Prof. dr. Rexhep Murati, E DREJTA E PROCEDURES PENALE, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2013, faqe 234.

²²⁹Po aty, faqe 234.

²³⁰Po aty, faqe 234.

mënyrë indirekte vërtetohet ekzistimi apo mosekzistimi i ndonjë fakti, në bazë të të cilit konkludohet se ekziston ose nuk ekziston fakti relevant kontestues²³¹.

Provat origjinale dhe të prejardhura. Baza e kësaj ndarjeje qëndron në burim të të dhënave me të cilat vërtetohen faktet. Provë origjinale është ajo provë që merret drejtpërdrejtë nga burimi i saj, siç mund të jetë dëshmia e dëshmitarit, pohimi i të pandehurit, pastaj shkresat (dokumentet) origjinale²³², ndërsa prova të prejardhura janë ato prova ku organi procedurës mëson tërthorazi nga ndonjë burim tjetër e jo nga burimi i saj i drejtpërdrejtë, siç mund të jetë dëshmia e dëshmitarit, pohimi i të pandehurit, pastaj shkresat (dokumentet) origjinale²³³.

Provat personale dhe materiale – Bazë e këtij klasifikimi është natyra e burimit të provës d.m.th.se mbështetet në mjetin e provës nga i cili rrjedh prova. Prova personale janë njohuritë e drejtpërdrejta ose të tërthorta të individit ose të shumë personave, ndërsa prova materiale janë sendet, dokumentet²³⁴.

Provat e plota dhe jo të plota-Themel i këtij klasifikimi është pesha me të cilën flet prova për të vërtetën apo të pavërtetën e faktit kontestues. Provë e plotë konsiderohet ajo që në tërësi e provon të vërtetën ose të pavërtetën e faktit kontestues, kurse prova e paplotë këtë e bën vetëm pjesërisht²³⁵.

²³¹Po aty, faqe 234.

²³²Po aty, faqe 238.

²³³Po aty, faqe 238.

²³⁴Po aty, faqe 238.

²³⁵Po aty, faqe 238.

PËRFUNDIMI

Sfida kryesore për çdo ekip që zhvillon këqyrjen e vendit të ngjarjes është ballafaqimi me ngjarjet të cilat nuk i kanë parë më parë dhe të cilat kërkojnë një angazhim dhe punë shumë profesionale. E gjithë kjo për arsye se veprat, në shikim të parë, duken të njëjta, por mënyra e kryerjes së tyre dallon shumë njëra nga tjetra, edhe nëse bëhet fjalë për të njëjtën vepër. Përdorimi i saktë i mjeteve shkencore dhe teknike zbulon e faton se edhe nëse lloji i veprës është i njëjtë, mënyra e kryerjes së saj dallon nga tjetra.

Këqyrja e vendit të ngjarjes kërkon gjithashtu edhe njohuri shkencore nga fusha të ndryshme, të cilat zbatohen apo kërkohet të zbatohen, si gjatë zhvillimit të këqyrjes, ashtu edhe gjatë ekzaminimit të gjurmëve dhe provave të ndryshme materiale, të gjetura gjatë këqyrjes. Që një këqyrje të jetë e suksesshme, ekipi i cili zhvillon atë, duhet që të hulumtojë në vazhdimësi për njohuri të reja shkencore, metodike e teknike. Ekipet duhet të trajnohen dhe të ndjekin zhvillimin e teknikës dhe teknologjisë së re, e cila dita ditës po zhvillohet me shpejtësi të madhe. Zbatimi i këtyre njohurive shkencore dhe teknike, ndihmon në ndjekjen dhe kapjen e autorëve të mundshëm të këtyre veprave.

Këqyrja e vendit të ngjarjes konsiderohet mjaft e rëndësishme, pasi radhitet ndër veprimet e para të grupit hetimor. Gjatë këqyrjes, grupi i cili merret me të, duhet të jetë i fokusuar dhe mjaft i koncentruar në kërkimin, gjetjen, fiksimin, dokumentimin, fotografimin pastaj edhe me veprimet e tjera lidhur me ekspertizat dhe ekzaminimet e ndryshme të të gjitha gjurmëve dhe provave materiale që janë gjetur dhe marrë nga ajo vendngjarje. Këqyrja duhet të jetë efikase, duke u mbështetur në standardet dhe procedurat e përpiluara për këtë qëllim. Në këtë punim, janë paraqitur mënyrat më të përshtatshme të këqyrjes dhe arritjet më të reja sa i përket çështjes së ndërlikuar të këqyrjes. Së këndejmi në këtë punim është hulumtuar mjaft edhe për ekzaminimin e gjurmëve dhe provave materiale. Po ashtu, edhe ekzaminimin dhe kontrollimin e viktimave dhe plagëve që ato marrin në rastin kur janë shënjestër e veprës penale të vrasjes. Të gjeturat e reja në këtë aspekt janë paraqitur në këtë punim dhe kanë të bëjnë me ekzaminimin e plagëve që viktimat merr gjatë momentit kur

është objekt i sulmit. Gjithashtu, në këtë punim është shfrytëzuar edhe literaturë dhe praktikë perëndimore nga shtetet më të zhvilluara e me përvojë siç janë SHBA, Anglia apo Gjermania. Kjo literaturë është krahasuar me përvojat praktike që autori ka në këtë drejtim. Pra, kemi gërshetimin e çështjeve praktike dhe teorike, të mbështetura në fakte dhe argumente të sigurt, të shoqëruara dhe dokumentuara edhe me fotografi. Në pjesën e dytë të punimit, kemi shtjelluar rastet e vrasjeve dhe menaxhimin e vendit të ngjarjes në këto raste. Këtu kemi paraqitur detyrat që ka ekipi i këqyrjes, që nga momenti kur merr thirrjen për një rast të caktuar e deri tek prezantimi i saj në gjyq. Kjo kronologji e veprimeve përfshinë arritjen në vendin e ngjarjes, hapat preliminar që duhet marrë ekipi i këqyrjes kur arrin në atë vend, kërkimin e dëshmive dhe provave materiale, paketimin e tyre, ekzaminimin etj. Në fund të punimit është paraqitur edhe roli i Prokurorit të Shtetit, që është mjaft i rëndësishëm në procesin hetimor, pastaj bashkëpunimi i policisë me prokurorinë si dhe roli i gjykatave në gjithë këtë proces.

Përfundimisht, ky punim me metodologjinë e aplikuar, çështjet e shtjelluara, me strukturën e rrjedhën kompozicionale si edhe me rezultatet konkrete të ofruara pas analizës dhe sintetizimit të fakteve teorike dhe atyre praktike, besoj se paraqet kontribut me rëndësi për zhvillimet e ekspertizës, respektivisht të këqyrjes së vendit të ngjarjes, jo vetëm në kuptimin teorik, pra hulumtues shkencor, po edhe në atë praktik, në drejtim që ndihmës që kjo lëndë mund t'u ofrojë specialistëve të fushës konkrete në institucionet kosovare të hetuesisë e të drejtësisë.

KAPITULLI VIII

8. KONKLUZIONE

- Duhet një bashkëpunimi i ekspertëve me agjencionet tjera, sepse kjo ndikon drejtpërdrejtë në kërkimin, zbulimin, marrjen dhe administrimin e gjurmëve dhe provave materiale. Ekspertët e caktuar tëfushave të ndryshme janë të përgatitur dhe specializuar nëpunën e tyre. Varësisht se me çfarë rasti apo ngjarje kemi tëbëjmë, duhet thirrur dhe kërkuar ndihmë/asistencë nga ekspertët përkatës tëfushës. Ekspertët e kërkim-zbulimit janë të përgatitur dhe nëseështë paraqitur nevoja e angazhimit të tyre, gjatë një rasti të kërkimit të ndonjë trupi të pajetë që është fundosur në ujë (lumenj, liqene etj.), atëherë bashkëpunimi me këtënjësi duhet të jetëimenjëhershëm dhe pa asnjë vonesë. Prandaj një bashkëpunimi ngushtë vetëm sa do tangritë në nivel më të lartë profesionalizmin dhe besueshmërinë e punës dhe angazhimit që kanë bërë agjencionet e caktuara.
- Ekipet e këqyrjes të mos e lënë përshtypjen se janë aty sikurse një “industri e shërbimit”, por, ato të tregojnë një profesionalizëm dhe përkushtim të lartë në punën e tyre. Thënia “industri e shërbimit” duhet të kuptohet atëherë kur për ekipet e këqyrjes krijohet përshtypja se ato janë aty vetëm sa për të kryer një shërbim sipërfaqësor dhe jo punë profesionale. Kjo nuk duhet të ndodhë në asnjë moment. Kjo bindje ndryshohet atëherë kur qasja që kanë këto ekipe është profesionale dhe të gjithë pjesëtarët e saj janë të përgatitur dhe njohin mirë punën e tyre.
- Ekspertët e vendit të ngjarjes duhet të jenë këmbëngulës në kërkimin e gjurmëve dhe provave materiale, gjithashtu të mbajnë parasysh faktin për gjurmët dhe provat materiale “që do të duhet të ishin në atë vend”. Pra, këmbëngulja në kërkimin e tyre është me shumë rëndësi për gjetjen e

autorëve të veprave penale. Autorët e veprave penale nganjëherë mundohen t'i fshehin gjurmët menjëherë pas kryerjes së veprës penale. Autori pas kryerjes së veprës penale mund t'i mbledh gëzhojat nga vendi i ngjarjes. Në këtë rast ekipi i këqyrjes duhet të ketë parasysh se gëzhojat në atë rast duhet të ishin aty. Gjithashtu ato mund të merren edhe nga dikush tjetër që nuk ka lidhje me veprën penale të kryer, por një gjë të tillë e bën vetëm nga kureshtja. Nëse një kalimtar rasti has në një pistoletë të cilën e ka hedhur autori i veprës penale gjatë ikjes së tij nga ai vend, atëherë ai nga kureshtja mund ta marrë atë. Kjo mund të ndodhë brenda apo edhe jashtë kufijve të vendit të ngjarjes. Përkërkimin dhe gjetjen e gjurmëve dhe provave materiale në një vend ngjarje duhet të ketë gjithmonë një angazhim nga gjithë grupi hetimor.

- Dëshmitarët gjatë marrjes në pyetje ose gjatë bisedës fillestare që zhvillohet në vendin e ngjarjes, duhet të ndahen nga njeri-tjetri, në mënyrë që më vonë të japin deklaratat të pavarura. Dëshmitarët mund të kërcënohen për deklaratat e tyre. Nëse ata merren në pyetje apo intervistohen afër njeri-tjetrit dhe dëgjojnë bisedat e tyre, atëherë mund të ndodhë që edhe deklaratat e tyre për rastin të jenë të njëjta. Kjo mund të ndodhë nga frika, kërcënim apo edhe nga fakti se disa prej tyre thjeshtë nuk duan të dëshmojnë se çka në tëvërtetë kanë parë. Që të mos ndodhë kjo gjë, ata duhet të intervistohen ndaras mes veti. Në këtë mënyrë ata nuk e dëgjojnë njeri-tjetrin dhe deklaratat e tyre janë të pavarura dhe pa asnjë ndikim.
- Të mos ngutet askush gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes; koha është në anën e hetuesve; ata kanë kohë sa të duan dhe kur ata e vlerësojnë se është përmbyllur gjithçka, atëherë këqyrja mund të përfundojë. Çdo nguti për ta përfunduar sa më parë këqyrjen është e dëmshme dhe rrezikon prishjen apo kontaminimin e gjurmëve dhe provave materiale. Procesi i këqyrjes së vendit të ngjarjes është një nga çështjet kryesore që grupi hetimor i zhvillon, prandaj kërkon një qasje shumë serioze dhe pa asnjë nguti. Nuk duhet harruar se

ngutja mund të rezultojë në kontaminimin e gjurmëve dhe provave materiale edhe nga vet ata që nguten. Nëse një gjurmë apo provë zhvendoset nga vendi ku e ka lënë autori i veprës, ajo më nuk mund të kthehet/vendoset në gjendjen e saj fillestare. Prandaj asnjëherë nuk duhet ngutur dhe nuk duhet harruar faktin se koha është në anën tonë.

- Gjate përpilimit të procesverbalit, skicave dhe fotografive ekspertët duhet pasur kujdes dhe gjithë kjo të ketë lidhje logjike. Kushdo që merr në shqyrtim materialin nga vendi i ngjarjes, ai duhet të jetë i përpiluar në mënyrë të tillë, që të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe i përpiluar në mënyrë profesionale.
- Konform rastit të dhënë, të merren edhe pajisjet adekuate për hetimin e asaj veprë. Kjo bëhet për arsyen e thjeshtë; kur fillon këqyrja e vendit të ngjarjes mund të paraqitet nevoja përndonjë pajisje shtesë. Nëse nuk është marrë me kohë ajo pajisje, atëherë duhet të kthehemi prapë në laborator përta marrëatë dhe dërguar në vendin e ngjarjes. Kjo merr kohë dhe njëgjë e tillë nuk duhet të ndodhë.
- Të vlerësohen gjurmët e gishtërinjve; ato janë argument i sigurt i kontaktit të atij personi me sipërfaqen ku janë gjetur ato. Në asnjë mënyrë nuk duhet të lihen anash gjurmët e gishtërinjve edhe nëse ato nuk janë të dukshme. Duhet përdorë metoda të ndryshme për nxitjen e tyre, kështu që ato duhet patjetër të merren nga ai vend.
- Kujdes gjatë paketimit dhe transportimit të provave. Dëmtimi i tyre është i pakthyeshëm dhe godet rëndë hetimet e rastit. Të gjitha provat e gjetura në vendin e ngjarjes, duhet të paketohen ndaras mes veti. Kjo eliminon kontaminimin e tyre. Transporti duhet të jetë i sigurt dhe gjatë tij ato duhet të vendosen në atë mënyrë, që të mos lëkunden në mënyrë që mos të ketë fërkime mes tyre gjatë transportit.

- Viktima ka përparësi edhe ndaj provave, por duhet pasur kujdes megjithatë edhe për provat. Me rastin e arritjes së grupit hetimor në vendin e ngjarjes, dhe viktima ka ende shenja jete, atëherë duhet menjëherë të merren masat e duhura dhe viktimës t'i ofrohet ndihma e parë. Në këtë rast përparësia është në anën e viktimës. Kjo vlen vetëm kur viktima është me shenja jete. Në të gjitha rastet tjera dëshmitë janë ato që duhet konsideruar primare.
- Përcaktimi i rrugës së ikjes së autorit të veprës është shumë i rëndësishëm. Edhe aty mund të ketë gjurmë dhe prova materiale. Nuk duhet harruar se autori gjatë ikjes nga vendi i ngjarjes, mund të fsheh apo të gjuaj ndonjë vegël, armë apo diçka tjetër që ka përdorur për kryerjen e veprës penale. Prandaj kjo rrugë duhet kontrolluar me kujdes të veçantë.
- Mbani në mend se gjatë punës suaj në një vendngjarje, shumë njerëz ju shikojnë nga jashtë. Këtu hynë edhe mediat. Jashtë shiritit rrethues të vendit të ngjarjes, mund të qëndrojnë gjithkush. Aty zakonisht janë mediat të cilat filmojnë çdo gjë. Nga ekipet e këqyrjes kërkohet sjellje korrekte dhe profesionale.
- Këqyrja e viktimës/kufomës në mënyrë të detajuar tregon se a ka qenë aty, në atë vend, apo është sjellë nga diku tjetër. Mikrogjurmët që gjenden në trupin e viktimës, e tregojnë këtë gjë. Ekspertet e mikrogjurmëve duke analizuar të gjeturat në trupin e viktimës, konstatojnë se viktima mund të jetë sjellë aty nga ndonjë vend tjetër.
- Në një rast vrasjeje janë dy dëshmitarë kryesor; viktima në njërin anë dhe autori i veprës në anën tjetër. Prandaj kërkohet një ekzaminim detal i viktimës në njërin anë dhe i autorit të veprës në anën tjetër. Kjo përfshinë edhe gjendjen në të cilën gjendet viktima, sepse nganjëherë ajo mund të jetë edhe pa shenja jete.

- Gjurmët dhe provat materiale janë i vetmi zë i viktimës. Vetëm ato flasin, prandaj kujdes gjatë trajtimit të tyre. Gjatë ekzaminimit të viktimës, rëndësi e veçantë i kushtohet gjurmëve apo provave materiale që gjenden në trupin e tij/saj, atëherë mund të themi lirisht se këto gjurmë janë zëri i viktimës.

8.1 REKOMANDIME

- Për kërkimin, zbulimin, ekzaminimin e gjurmëve dhe provave materiale në vendin e ngjarjes, duhet të përdoren mjetet e sofistikuara të teknikës kriminalistike si dhe personel i trajnuar dhe i përgatitur mirë me njohuri të kësaj fushe. Varësisht se për çfarë rasti bëhet fjalë, duhet angazhuar ekspertët e fushës përkatëse. Në një rast ku janë përdorur mjetet eksplozive, njësia për deminim është e nevojshme dhe duhet kërkuar asistencë e tyre.
- Të vlerësohet dhe llogaritet gjurmë e provë materiale gjithçka që gjendet në vendin e ngjarjes deri sa të argumentohet e kundërta. Nuk duhet nxituar në vlerësimin e gjurmëve dhe provave materiale menjëherë pasi t'i gjejmë ato gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes. Duhet pasur kujdes në çdogjë që gjendet aty. Gjatë ekzaminimeve të mëvonshme ato edhe mund të eliminohen, nëse konstatohet një gjë e tillë nga ekspertët e fushës, por në asnjë situatë ky konstatim të mos bëhet aty për aty, pra gjatë këqyrjes në vendin e ngjarjes.
- Askush nuk duhet lejuar të futet brenda shiritit rrethues të vendit të ngjarjes përveç atyre që janë duke punuar aty. Kjo nënkupton që as eprorët apo mbikëqyrësit e rangut më të lartë nuk mund dhe nuk duhet të hynë brenda vendit të ngjarjes pa pasur ndonjë arsye. Menjëherë pas arritjes në vendin e ngjarjes, njeri ndër veprimet e para që bëhen aty, duhet të krijohet një listë e hyrjeve dhe daljeve nga ai vend. Kjo do të zvogëlonte numrin e atyre personave që kanë dëshirë të futen brenda shiritit rrethues pa pasur ndonjë punë apo obligim aty.

- Nuk duhet të ketë paragjykime lidhur me rastin. Nëse themi se ky rast është i njohur për ne, sepse të njëjtin e kemi punuar më herët, atëherëky paragjykim është i dëmshëm dhe nuk dërgon askund. Siç u tha me lartë, provat janë zëri i viktimës. Vetëm provat janë ato të cilat tregojnë se çka në të vërtetë ka ndodhur. As edhe një herë të vetme nuk duhet të ketë asnjë lloj paragjykimi lidhur me rastin në të cilin jeni thirrur për ta hetuar.
- Nuk është praktikë e mirë vonesa për të shkuar në vendin e ngjarjes. Mos të humbet koha; sa më shpejt që është e mundur të shkohet në vendin e ngjarjes. Vonesa për shkuarjen në vendin e ngjarjes, mund të ketë pasoja edhe sa u përket gjurmëve dhe provave materiale që gjenden aty. Dihet se kontaminimi i tyre mund të ndodhë edhe për shkak të kushteve atmosferike siç janë: shiu, bora, erërat e ndryshme etj. Për këtë arsye nuk duhet humbur kohë dhe sa më parë që është e mundur, duhet të shkohet në atë vend.
- Trajnimi i vazhdueshëm i personelit në fushën e Forenzikës dhe përdorimit të mjeteve të reja që përdoren në këtë fushëështë i domosdoshëm dhe freskon njohuritë e hetuesve. Duke ditur faktin se shkenca dhe teknologjia çdo ditë e më shumë njohin arritjet e tyre të mëdha, atëherë personeli i kësaj fushe duhet të ketë trajnimet e caktuara dhe të vazhdueshme. Njohuritë e reja ofrohen edhe përmes materialeve të ndryshme shkencore, literaturë etj.
- Këqyrja e vendit të ngjarjes duhet të jetë e harmonizuar me ligjet dhe rregulloret në fuqi, në veçanti të zhvillohet duke u bazuar në kërkesat e Kodit të Procedurës Penale.
- Mbani mend shprehjen “ngutu ngadalë”.
- Gjatë marrjes së thirrjes për një lokacion të caktuar, t’u rikujtohet oficerëve të parë në vendngjarje që ta ruajnë atë derisa aty të shkojë ekipi i këqyrjes.

BIBLIOGRAFIA

LITERATURA

1. Ademaj, Xhemajl; Shkenca e daktiloskopisë, 2008.
2. Batalli, Fadil; Mjekësia Ligjore, Botimi i I, Rilindja, Prishtinë 1987.
3. Begeja, Skënder; Kriminalistika, vëllimi II, 2011, Tiranë.
4. Bajrami, Arsim; Sistemi Kushtetues ë Republikës së Kosovës, Prishtinë 2011.
5. Fisher, Barry; Techniques of Crime Scene Investigations, seventh edition, 2004, CRC press LLC.
6. Geberth, Vernon J.; M.S., M.P.S., B.B.A., FBINA, PRACTICAL HOMICIDE INVESTIGATIONS, Tactics, Procedures and Forensic Techniques, Fourth Edition, Published in 2006, CRC Press, New-York , Suite 300, USA.
7. Hajdari, Azem; Procedura Penale – Komentar, Prishtinë, 2010
8. Hysi, Vasilika; “Kriminologjia”, Tiranë 2010, Botimi i Dytë i përmirësuar.
9. Herring, Jonathan; E Drejta Penale, Teori, kazuse dhe material, botimi V, volume I, Tiranë, 2013.
10. Inman, Keith & Rudin, Norah; Principles and Practice of Criminalistics the profession of Forensic Science, CRC PRESS LLC, 2001.
11. Koçollari, Irakli, Tribunë Juridike, Tiranë, Nr. 85, 2010.
12. Latifi, Vesel; Kriminalistika, zbulimi dhe të provuarit e krimit, Prishtinë, 2009.
13. Locard, kriminalist francez, cituar në “Terrorizmi”, prof. Haki DEMOLLI, Prishtinë, 2002.
14. Lee, Henry C.; Materijalni Tragovi, 1998, Zagreb.

15. Lazarevic, Lubisa; Krivicno Pravo, Posebni Deo, Beorgard 1982
16. Mandro, Ilir ; Këqyrja e Vendit të Ngjarjes në Vrasjet me Armë Zjarri, Tiranë, 2002
17. Myftari, Estref; Shishani Fitim; Kotri, Hysen; Kriminalistika, Prishtinë, 2010
18. Meksi, Sokrat; Vdekja nga Dhuna, Medaur, Botimi I Parë, 2005.
19. Modly, Dushko; TEORITË BASHKËKOHORE KRIMINALISTIKE, Titulli i origjinalit:“SUVREMENE KRIMINALISTIČKE TEORIJE“ Përktheu nga kroatishtja: Reçica, Mustafë; SARAJEVË / Prishtinë, 15. 01. 2007, FSK/S - 14/06.
20. Molina, Kimberley, *Gun shot Wounds*, Adapted, with permission, rom Gun shot Wounds Hand out by Vincent J. M. Di Maio, 2013.
21. Sahiti, Ejup; Murati, Rexhep; Elshani, Xhevdet; KOMENTAR, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, KOMENTAR, Botimi i I, i publikuar nga Deutsche Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Prishtinë, 2013
22. SWANSON, Charles R. ; CHAMELIN, Neil C ; TERRITO, Leonard; Criminal Investigations, 7 th edition 2000.
23. Salihu, Ismet; E Drejta Penale, Pjesa e Posaçme, Prishtinë 2009.
24. Salihu, Ismet; Vrasjet në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës, Rilindja, 1984
25. Sahiti, Ejup; Murati, Rexhep; E drejta e procedurës penale, Universiteti i Prishtinës,fakulteti juridik,Prishtinë2013.
26. Veliçoti, Luan; Tribunë Juridike, Tiranë Nr. 82, 2010.
27. Veliçoti, Luan; Kriminalistika, vëllimi i I, GEER, Tiranë, 2015.
28. Vodineliq,Vllado; Kriminalistika, Prishtinë, 1972.
29. Westveer, Artur E.;“*Behavioral Science Unit, FBI*”, “ Managing Death Investigation 1997, U. S. Department of Justice, Federal Berau of Investigation.

BURIME PARËSORE

1. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 04/L-082, KAPITULLI II,VEPRAT PENALE DHE PËRGJEGJËSIA PENALE, neni 10, par.1 dhe 2, 2013
2. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.
3. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë. - TITULLI IV, PROVAT, KREU I, RREGULLA TË PËRGJITHSHME, Tiranë: Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, 2011,ISBN 978-9928-01-021-6.
4. Kodi Nr. 04/ L-123, 13 dhjetor 2012, Shpallur me dekretin Nr.DL-057-2012, datë 21.12.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës AtifeteJahjaga.
5. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, PJESA E PËRGJITHSHME, KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME, Neni 1 Bazat dhe kufijtë e sanksioneve penale.Kodi Nr. 04/L-82, 20 prill 2012, Kodi Penal i Republikës së Kosovës hyn në fuqi me 1 janar 2013.
6. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
7. Kodi Penal i Zvicrës, neni 117.
8. Kodi Penal i Sllovenisë, neni 129.
9. Kodi Penal i Kroacisë, neni 95.
10. Kodi Penal i Serbisë, neni 118.

11. Ligji për Prokurorin e Shtetit, LIGJI Nr. 03/L-225, Neni 4, paragrafi 2,
Ushtrimi i funksioneve prokuroriale, 30 shtator 2010, Shpallur me dekretin Nr.
DL – 049 - 2010, datë 18.10.2010 nga u. d. Presidenti i Republikës së
Kosovës, Dr. Jakup Krasniqi.
12. Ligji Nr. 03/ L - 225, 30 shtator 2010, Shpallur me dekretin Nr. DL – 049 -
2010, datë 18.10.2010 nga u. d. Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Jakup
Krasniqi.
13. Ligji Nr. 03/L - 187, 25 shkurt 2010, Shpallur me dekretin Nr. DL – 019 -
2010, datë 13.05.2010 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir
Sejdiu.
14. Aktgjykim i Gjykatës së Qarkut të Gjilanit, P. nr. 123/2007 cituar nga: Prof. dr.
Ismet Salihu, Prof. dr. Hilmi Zhitija, Prof. dr. Fejzullah Hasani, Kodi Penal i
Republikës së Kosovës, KOMENTAR, Botimi I.
15. Gjykata Supreme e Vojvodinës me aktgjykimin Kzh. 41/57.

BURIME DYTËSORE

- Artikuj revistash

1. Tribunë Juridike, Tiranë, Nr. 85, 2010. KOÇOLLARI, Irakli.
2. Këqyrja e vendit të ngjarjes, doracak për studentë, Kursi bazik i forenzikës, Vushtri, 2002.
3. Tribunë Juridike, Tirane Nr.82, 2010, VELIQOTI, Luan.
4. Material trajnimi nga Policia Shkencore, Tiranë, 2011.
5. Revistë Shkencore “Justiniani I”, Nr.1, dhjetor 2009, Gramoz Ylli, Kontributi i ekspertit mjekoligjor në dëmtimet nga armët e zjarrit.
6. Mbrojtja dhe këqyrja e vendit të ngjarjes, doracak për studentë, Akademia Policore Vushtri, Kosovë.

- Burimet nga interneti

1. http://fingerprint_pictures.jpg
2. <http://www.csitechblog.com/.a/6a01348648f6e4970c014e89c2a5c7970d-pi>
3. http://footprintandtireimpression_pictures.jpg)
4. http://footprintandtireimpression_pictures.jpg)
5. <http://www.science.marshall.edu/murraye/images/images/>
6. http://toolmarks_pictures.jpg

7. http://38.media.tumblr.com/f2eaaedd6b8807c982732ad2b375a2c5/tumblr_inline_mxnxdnoEHe1raa8wb.png
8. http://o.quizlet.com/ej9VRiLVaR4yJKds7GRJ5Q_m.png
9. [www.sierchie .com](http://www.sierchie.com)
10. www.crimescenesketch.com
11. <http://www.md-ks.net/?page=1,26> ligji për detyrat e mjekësisë ligjore
12. <http://flashmedia.glynn.k12.ga.us/webpages/rchunn/imageGallery/pie%20wheel%20search.png>
13. http://seichie_product_crimescene_equipement.jpg)